

BERZH PIRANJANI

# ARMENIA DHE ARMENËT

Përmbledhje shkrimesh nga autorë të ndryshëm





BERZH PIRANJANI

# ARMENIA DHE ARMENËT

Përmbledhje shkrimesh nga autorë të ndryshëm



Mblodhi dhe Përgatiti për shtyp: Berzh Piranjani

Redaktoi: Berzh Piranjani

Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:

Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Kjo përmbledhje shkrimesh mbi “Armeninë dhe Armenët” ka natyrë informative dhe edukative.  
Çdo përdorim ose ribotim i këtij libri për qëllime komerciale ndalohet.

Tirazhi 100 kopje

ISBN: 978-9928-05-257-5

Shtëpia Botuese “albPaper”, Tiranë, 2019

Rruga: “Shemsi Haka”, ish-Poligrafiku, Tiranë

Tel.: +355 42 35 89 37

# PËRMBAJTJA

Në vend të parathënies .....	5
Armenia (Histori e Shkurtër) .....	21
Armenia (Njerëzit dhe Vendi).....	55
1500 – Vjetori i Kanunit të shkruar Armen .....	187
Legjenda të vjetra Armene.....	221
Emra njerëzish (të përdorur nga Armenët).....	229
Kalendari i vjetër Armen .....	241
Kalendari i festave Armene (Ditët Përkujtimore) .....	242
Harta e Armenisë.....	243
Stema e Republikës Armene.....	244
Flamuri Armen .....	245
Himni Armen .....	246
Këngë përfaqësuese Armene .....	249
Fjalor themelor Armenisht - Shqip (rreth 2.000 fjalë).....	267



Në vend të parathënies

## ARMENIA DHE ARMENËT

[Kultura, Letërsia – Arti i tyre]

Prej A. Burnazian\*

Zonja dhe Zotërinj,

Para se të hyjmë në temë, do t'ju lutesha që të keni parasysh tri gjëra:

E para, të mos keni paragjykimin e lëvdatës së tepruar.

E dyta, të merrni parasysh shkaqet e mia lehtësonjëse që kjo temë nuk është zhvilluar ashtu siç e meriton, për arsëye se bazat e konferencës (referatit – shënim i përpunuesit) sime janë vetëm kujtimet e mia me pak dokumentacion, mbasi biblioteka ime dhe sidomos të gjitha dorëshkrimet e mia u zhdukën në zjarrin që sollën në Shqipëri Ushtritë Naziste.

---

\* Harutiun Burnazian (shkurt Arto Burnazian)

Lindi në vitin 1905, në Shahbin, Karahissar, Turqi.

I shpëton masakrave të vitit 1915, pasi merret për t'u adaptuar nga familja e një oficeri turk. Pas valës së masakrave, gjendet nga daja i tij, Ervant Ozanian, dhe merret nën kujdestarinë e tij. Së bashku me dajën emigrojnë në Francë, ku me ndihmën e Kishës Armene mbaron shkollën dhe diplomohet Kirurg Ortoped Stomatolog në Universitetin e qytetit Lion të Francës. Në vitin 1929 martohet në Angli me Anahid Pashaian, familja e së cilës kishte emigruar në Angli që në vitin 1916.

Në vitin 1930 vijnë familjarisht në Shqipëri (Tiranë, Elbasan, Berat deri në vitin 1938). Pas kësaj rikthehen në Tiranë, ku punon si stomatolog në klinikë private deri në vitin 1948, kur bëhet shtetëzimi i tyre. Emërohet KryeDentist në Qarkun e Beratit, ku vendoset familjarisht. Vdes në vitin 1955 në Berat. Është vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi i Beratit” (pas vdekjes).

E treta, të keni parasysh vështirësitë e mia për shprehjen e gjuhës, mbasi gjuha Shqipe nuk është gjuha ime amtare.

Qëllimi i këtyre konferencave është të njohim më tepër popujt e mëdhenj dhe ata të vegjël, përpjekjet dhe kulturën e tyre, siç është në programin e Shtëpisë së Kulturës.

Është një temë me përgjegjësi të madhe, që e kam zgjedhur ose ma kanë zgjedhur disa miq të mi të Shtëpisë së Kulturës.

Është vështirë të paraqisësh një popull, shpirtin, kulturën, letërsinë dhe artin e tij në një Institut Shqiptar për herë të parë. Jam fatmirë të jem i pari, por kam edhe frikën të mos kënaq dëgjuesit dhe të përdor keq mirësinë e tyre. Megjithatë do të përpiqem ta trajtoj temën dhe ndofta ta bëj interesante.

Interesante është sidomos të vemë në dukje lidhjet ose përafrimet raciale, historike, gjuhësore dhe fatale të popullit Armen me popullin Shqiptar. Gjithë antropologët e botës janë në një mendje se raca Shqiptare dhe raca Armene paraqisin një lloj kranii (kran – kafka e kokës – shënim i përpunuesit). Kjo nuk diskutohet se Armenët janë një popull Trako-Arian dhe në pemën gjenealogjike kanë degën Keltike, duke pasur me vete popullin Irlandez dhe Shqiptar.

Linguistët si, Hubescmani<sup>1</sup>, prof. (Zeeller) dhe të tjerë kanë gjetur disa afrime në mes të gjuhës Shqipe dhe Armene, gjë që neve do të na duket e çuditshme. Përveç gjuhës, janë zakonet dhe traditat që na ndihmojnë. Mënyra e të jetuarit të fshatarit Shqiptar dhe atij Armen është pothuaj një lloj. Urimet, ngushëllimet, fejesat, martesat, besa

---

<sup>1</sup> Johann Heinrich Hubschmann – kishte studiuar për Filologji Orientale në Jena, Tubingen, Leipzig dhe Mynih; në vitin 1876 u bë profesor i gjuhëve Iraniane në Leipzig dhe në vitin 1877 u bë profesor i Filologjisë së krahasuar në Strasburg. Ishte i pari, që demonstroi në vitin 1875 se gjuha Armene nuk ishte një degë e gjuhëve Iraniane (më herët mendohej të ishte kështu për shkak të ndikimit të madh Iranian në Armeni përgjatë historisë së tij), por një degë krejt e veçantë e gjuhës Indo-Europiane me të gjitha karakteristikat e saj individuale. Ai përdori metodën krahasuese për të ndarë huazimet Iraniane, të cilat përbëjnë shumicën e fjalëve Armene, nga një shtresë më e vjetër e fjalëve Armene amtare.

Lindur: 01 Qershor 1848, Erfurt, Germany.

Vdekur: 20 Janar 1908, Freiburg im Breisgau, Germany.

dhe hakmarrja. Kanë edhe shembëllim të kostumeve, gjë që fakton pretendimet tona dhe sidomos pretendimet e arkeologëve të mirënjohur.

“Afrimi Fatal” ...!! (e ka fjalën për fatkeqësitë që i kanë shoqëruar këta dy popuj gjatë jetës së tyre – shënim i përpunuesit).

“Afrimi Fatal” – është ai (ka dashur të thotë - Me “Afrimi Fatal” kuptohet fakti – shënim i përpunuesit), që të dy këta popuj kanë vuajtur po prej të njëjtit invador, vuajtje që fillon në shekullin e XIV-të dhe mbaron në shekullin e XX-të. Bashkëpunimi ndërmjet kryengritësve Armenë dhe Shqiptarë në kohën e XhonTurqve ka qenë shumë i përzemërt. Ismail Qemali dhe Hasan Prishtina ishin nga njera anë, avokati Armen Grigor Zohrab<sup>2</sup> dhe Vartkes nga ana tjetër dhe gjithmonë bashkë përpiqeshin për Shqipëri dhe Armeni. Në kohën kur u rrah Ismail Qemali prej një deputeti Turk të ekzaltuar brenda në Parlament, ishte vetëm Grigor Zohrabi që mori guximin të protestojë dhe aty për aty mbajti një fjalim protestues që vazhdoi një orë të tërë. (Shih gazeta “Drita” e datës 28 Nëntor 1937).

X

X X

Tani do të përpiqemi të paraqesim popullin Armen historikisht në vija të përgjithshme. Dymijë e pesëqind vjet kombësi me një histori mitologjike shumë interesante dhe më realiste se mitologjia Greko – Romake, por domosdo më pak e përhapur për shkak të gjuhës.

---

<sup>2</sup> Grigor (Krikor) Zohrab - ishte një jurist, politikan dhe shkrimtar Armen me shumë influencë nga Konstantinopoja. Në vitin 1908 ju bashkëngjiti Revolucionit të Turqve të Rinj dhe u zgjodh anëtar i Parlamentit në Këshillin Otoman, duke shërbyer njëkohësisht edhe si këshilltar Armen për çështjet e Komunitetit Armen. Me fillimin e Genocidit Armen, ai u arrestua nga qeveria Turke dhe u dërgua të paraqitej pranë gjykatës Ushtarake në Diarbakir.

Lindur: 26 Qershor 1861, Istanbul, Turkey.

Vrarë më: 20 Korrik 1915, Urfa, Turkey.

Kombësia: Ottoman, Armenian.

Harta më e vjetër gjeografike e botës është sot në British Museum, ku Armenia paraqitet e shtrirë prej Detit Kaspian deri në malet Taurus dhe prej Detit të Zi deri në Detin Mesdhe.

Dymijë e pesëqind vjet jetë politike, shoqërore. Katakлизma, skllavëri, përpjekje, liri; prapë skllavëri, përpjekje; prapë liri; mërgim, kthim në Atdhe; përsëri mërgim. Dhe vazhdimisht ky popull ka qenë i lëkundur në një djep mes lirisë dhe skllavërisë për shkak se ky popull ishte i pajisur me merita dhe virtute, që fqinjët e tij nuk i kishin, për shkak se tributë barbare nuk kishin asnjë skrupull ose respekt për qytetërimin.

Armenia është ajo tokë, që sipas Biblës ka qenë një herë e një kohë parajsë tokësore, e vendosur mes lumenjve Tigri dhe Eufrat, si edhe rreth malit Ararat, në majën e të cilit qëndroi Arka e Noes; ai Ararat, historikisht i bukur, me lartësinë e tij prej 5155 m., është Parnasi – Olimpi, frymëzonjësi i mendjeve Armene të të gjitha kohrave.

Letërsia e shkruajtur, e përbërë nga mijëra volume, dhe me mijëra autorë të shquar, duke filluar prej ...Tagor ?? dhe deri tek Gladstone, Tolstoi, Jacques de Morgan<sup>3</sup>, kanë qarë hallin e Armenisë dhe Armenëve duke lartësuar cilësitë e atij populli si popull trim, martir, popull me pozitë gjeografike jo të përshtatshme, popull fisnik, puntor, rindërtonjës i vendosur, racë e thjeshtë dhe jo e degjeneruar, i paasimilueshëm. Por, për ne, kualifikimin më të përshtatshëm e më të përsosur na e ka falur dijetari i famshëm Norvegjez, eksploratori Nansen<sup>4</sup>, që ka quajtur popullin Armen si “popull i gënjyer” (Le Armenien c’est un people trompe’).

<sup>3</sup> Jean-Jacques de Morgan – ishte një inxhinier Francez minierash, gjeolog dhe arkeolog. Ai ishte drejtor i antikitetëve në Egjipt gjatë shekullit të 19të, dhe kreu gërmime ne Memfis dhe Dashur, duke siguruar vizatime të shumta nga shumë piramida egjiptiane.

Lindur: 03 Qershor 1857, Huisseau-sur-Cosson, France.

Vdekur: 12 Qershor 1924, Marseille, France.

Autor i librit: Historia e popullit Armen nga kohët e hershme deri në ditët tona, (The History of the Armenian People, from the Remotest Times to the Present Day).

<sup>4</sup> Fridtjof Nansen - ishte një eksplorator Norvegjez, shkencëtar, diplomat, humanist dhe laureat i Çmimit Nobel për Paqe.

Lindur: 10 Tetor 1861, Oslo, Norway.

Vdekur: 13 Maj 1930, Lysaker, Norway.

X

X X

Populli Armen është i njëkohshëm me Finikasit, Babilonasit, Asirianët, Egjyptianët, etj. Legjendat dhe historitë e para shekullit të X-të para Krishtit flasin për popullin Armen, që quhet “Urarta”, d.m.th. me emrin e vjetër të Araratit. Mbreti i tyre i parë konsiderohet Armini, i cili në shekullin e IX-të para Krishtit themeloi dinastinë e parë Armene. Për gjashtë shekuj me rradhë populli Armen jetoi një jetë të qetë dhe përparimtare. Në shekullin e IV para Krishtit, Aleksandri i Madh e skllavëroi Armeninë. Pas vdekjes së Aleksandrit në vitin 332 para Krishtit, mbreti Jervant themeloi Dinastinë e II-të. Me largimin e fuqive Maqedonase nga Armenia, një pjesë e madhe e saj kishte mbetur në dorë të Persisë. Mbreti Jervant i dërgoi një letër mbretit Sirius të Persisë, ku i thotë: “Nuk do të mbaj dot fjalën që të kam dhënë. Më tepër dashuroj lirinë e popullit tim se sa fjalën time. Dua të liroj Armeninë dhe përgatitem për luftë”. Jervanti luftoi dhe fitoi. Tigrani i Madh (94 – 45 para Krishtit) i zgjeroi kufijtë e Armenisë prej Kaukazit në Mesopotami dhe nga Deti i Zi deri në Detin Mesdhe.

Njeri nga të tre antarët e Triumviratit Romak, Mark Antoni, pati disfatën e tij të parë në Armeni, të cilën donte ta zaptonte për t’ja ofruar Kleopatërës. Një dimër “Moskovit” dhe rezistenca fanatike e Armenëve, shkaktuan thyerjen dhe turpin e Mark Antonit, i cili u kthye në Antiokus duke vajtuar të dhjetëmijat (bëhet fjalë për trupat ushtarake – shënim i përpunuesit), që la në malësitë e larta të Armenisëx. ((x) – PLUTARQUE: Histoire des homes illustre).

Pierre Corneille<sup>5</sup>, klasiku i famshëm Freng, ka shkruajtur dy tragjedi: “NICOMEDE” dhe POLYEUCTE”, ku lartëson shumë meritat dhe

---

<sup>5</sup> Pierre Corneille - ishte një Tragjedian Francez. Ai është konsideruar si një nga tre dramaturgët më të mëdhenj Francezë të shekullit të 17të, së bashku me Molierin dhe Racine’. Dy nga Tragjeditë e tij janë: Polyeucte 1642 dhe Nicomede 1651.

Lindur: 06 Qershor 1606, Rouen, Francë.

Vdekur: 01 Tetor 1684, Paris, Francë.

patriotizmin e Armenëve. Por luftrat ndërmjet Persisë dhe Bizantit, në mes të Romakëve dhe Persisë, Persisë dhe Selxhukëve e kanë bërë një fushë lufte natyrale të gjithë tokën Armene. Ashtu si një Poloni në mes të Gjermanisë dhe Rusisë, një Belgjikë ndërmjet Francës dhe Gjermanisë, Armenët, me hir apo me pahir, do të merrnin pjesë në këto luftra, që vazhduan me shekuj.

Populli Armen ka vuajtur dhe u konsumua moralisht, fizikisht dhe demografikisht. Herodoti, gjyshi i historianëve e numëron popullin Armen prej 18 - 20 milion. Por në shekullin e XXI-të, një pjesë e popullsisë Armene, nën udhëheqjen e një princi emigrohet në Silisi (Cilicia, Kilikia – shënim i përpunuesit) dhe përgjatë Detit Mesdhe, ku krijojnë Armeninë e Vogël me Dinastinë e Roupinianëve. Në shekullin e XIII-të vjen invadimi i Xhengis Khanit dhe shkatërron Persinë, Gjeorgjinë dhe Armeninë. Në vazhdën e këtyre ngjarjeve, Ashiretë (Ashiretë – Tributë; shënim i përpunuesit) e Melik Eshref Shabanit invadojnë Armeninë. Herën e parë në shekullin e XIV-të filloi emigracioni në masë. Turmat e para nisen për në Krime, Astrakan dhe në Moldavi e Poloni. Mbreti i fundit, Leoni i V-të Lusini, emigrohet në Spanjë dhe pastaj në Paris. Ishte lufta e 30 vjetve me Anglinë. Franca i premton ndihmën e saj me kusht që të dilte mirë nga lufta kundër Anglisë. Leoni i V-të provoi edhe ndërmjetësime në mes të dy fqinjëve. Dhe më së fundi vdes i dëshpëruar në Paris dhe varroset në Saint Denis, në Pantheonin e Mbretërve, ku është edhe sot.

Prej asaj date fillojnë premtimet dhe gënjeshttrat; edhe Papët e Romës, të cilët gjatë madhështisë së Armenisë nuk kanë kursyer mjet dhe hipokrizi për të bërë katolike Kishën Armene, e cila prej shekujsh është kundra për infalibilitetin (pagabueshmërinë) e Papës, filluan të neveritin dhe të marrin hak për indiferencën e tyre.

Kalojnë shekujt. Armenia në pjesën më të madhe është nën sundimin Turk, kurse pjesët malsore dhe më të pa afrueshme kanë ruajtur vetqeverisjen e tyre, por gjithmonë me armë në dorë.

Jemi në vitin 1878.

E gjithë Europa i di persekutimet dhe masakrat në Armeni prej Turqve dhe Kurdëve.

Konferenca e Berlinit: Delegacioni Rus mbron të drejtat e Armenëve me përkrahjen e të gjitha shteteve të Europës. Aty është edhe delegacioni Armen. Artikulli 16 i Kongresit parasheh formimin e një vatre Armene. Por në fund të Kongresit, nga një lodër e fatit, Artikulli 16 kthehet ters dhe na ofrohet Artikulli 61, ku parashihen vetëm reformat në krahinat e banuara prej Armenëve. Kryetari i delegacionit Armen, kur u kthye bëri këtë deklaratë karakteristike: “Na kishin përgatitur një kazan të madh me qeshqek. Të gjitha delegacionet kishin me vete lugë të mëdha prej hekuri. Unë kisha një lugë prej kartoni. Luga më mbeti brenda qeshqekut”. Me atë rast fillon letërsia revolucionare Armene: “Armenë, nuk ka shpresë prej të huajve!” “Vetëm me luftë, .... dhe vdekje do të kemi liri, shpëtim dhe Atdhe!”

Jemi në kohën e Sulltan Abdyl Hamitit, Sulltanit që mundi të fitojë dy tituj internacionalë, një për vete dhe një për popullin: “Sulltan i Kuq” dhe “Njeriu i Sëmurë”.

Victor Hygo-i shkroi një nga vjershat e tija më të bukura “Les Turcs ont passe la” (Turqit kanë kaluar andej).

Viti 1915. Lufta e Përgjithshme. Aleancë Gjermano – Turke. Aleancë e Aleatëve ....

Revolucioni valon në të gjitha krahinat Armene. Heroi Kombëtar Armen, Antranik, me partizanët e tij , pas 30 vjet lufte, zbret në qytetet me popullsi Armene dhe proteston kundrejt masakrave dhe deportimeve Armeniane. Populli Armen mbasi që la në shkretëtirat e Arabisë afër 1 milion martirë, shpalli më 28 Maj 1918 Indipendencën me një kufi prej 42 mijë km. katrore.

Konferenca e Sevrës dhe Vilsoni, i cili ishte ngarkuar të bënte hartën e Armenisë, ofruan një Armeni prej 180 000 km. katrore. Konferenca e Sevrës dhe Versaille janë në favorin e Armenëve. Përkrahje e nxehtë nga Vilsoni, Lloyd Georges, Clemenceau, Tardieu, Mareshalli Francez d'Espery, Morgenthau, Venizelos, Benes, Leon Blumi dhe me qindra figura të tjera politike nga më të njohurat në Europë. Në një çast u duk sikur të gjithë kishin braktisur interesat e tyre kombëtare dhe personale dhe ishin të dhënë pas çështjes Armene. Revistat “Mercure de France”, “Revue de Paris”, organet politike shkruanin me vendosmëri: “Ose një Armeni e lirë dhe e bashkuar ose lufta nuk ka kuptim”. Vendime të bukura, por, u mbars mali dhe polli një mi.

Konferenca e Laussane-s i përmbushi të gjitha vendimet e para.

Turqia përfitoi nga dobësia e politikës oksidentale dhe i shpalli luftë Armenisë, duke i marrë provincat më të begata: Karsin dhe Ardahanin. Armenët që për njëfarë kohe e kishin harruar këngën: “Oh, Armeni, nga Evropa mos mbaj shpresë”, filluan ta këndojnë përsëri.

1921; pas tre vjet e ca të Revolucionit të Madh Rus, sovjetizohen të gjitha Republikat e Kaukazit: Kaukazi i Veriut, Gjeorgjia, Azerbajxhani dhe Armenia. Sot Armenia është prej 31 000 km. katrore dhe me një popullsi prej 2 milion banorë. Porsa u shuan luftërat, porsa u sigurua popullsia nga epidemitë dhe zija, ky popull i çuditshëm fillon, pa humbur asnjë ditë, nga rindërtimi dhe, përputhet me kulturën, me letërsinë dhe me artin edhe një herë.

x

x x

Kultura dhe letërsia Armene është shumë e vjetër. Na kanë arritur deri në ditët tona këngët epike nga kohërat pagane, bashkë me ato që Kristianizmi i ka quajtur prudente. Më vonë, nga shekulli

i IV, fillon klasicizma Armene me vjershat, poemat, poezitë dhe me këngët lirike.

Folklori Armen i shërben historisë së Armenisë si burimi më i sigurtë, domosdo i tepëruar dhe i legjenduar shumë herë. Deri në vitin 403 Armenët përdornin shkronjat Greke. Më 403, Sahak Katolikosi së bashku me Dhespotin Mesrop Mashtotc krijojnë alfabetin Armen origjinal me 38 germa. Pas 31 vjetësh, më 434, Bibla përkthehet në gjuhën Armene me gerrat e veta origjinale. Më 1934 u festua Jubileu i 1500 vjetëve të përkthimit në sallën e Sorbonës në Paris, ku muarën fjalë shumë akademikë dhe dijetarë vendas dhe të huaj, në mes të të cilëve poeti akademik Henry Bordeaux, historian Frederic MacLair, Luis Marin dhe Victor Bach, profesorë në filozofinë e artit në Sorbonë.

Vjershat e shenjta dhe këngët kishtare janë larg nga fanatizmat e verbëta. Janë punuar ndërgjegjshëmrisht me rregullat e klasicizmit të kohës, ritmikisht dhe teknikisht janë në lartësinë e duhur. Veç këtyre kemi edhe thesaret e letërsisë Armene që na vijnë prej shekujve të V-të dhe VI-të me një përmbajtje morale dhe filozofike. Kjo provohet me nxitimin e përkthimit të tyre në gjuhërat e vjetra dhe moderne. Prej këtyre autorëve janë të famshëm Naregatsi (Grigor Narekatsi), Nerses Shënoralit dhe Movses Korenaci.

Letërsia dhe arti nuk ngelën për shumë kohë monopoli i fatrave. Prej shekullit të IX-të, kultura e përgjithshme mori një zhvillim në çdo klasë të popullsisë. Nahabet Kuçak është një nga lirikët më të vjetër Armenë, bilbili i Armenisë së vjetër, i cili në shekullin e XI-të ka prodhuar vjersha dashurie për herë të parë dhe ka marrë guximin ta përshkruaj femrën shpirtërisht dhe fizikisht. Pjesë nga Nahabet Kuçak (Kuchak) i kam parë të përkthyer në vitin 1936 në gjuhën Shqipe, por të ripërkthyer nga Rumanishtja.

Me mijëra janë dorëshkrimet e vjetra në pergamenë në bibliotekën e kryeqytetit Armen, në Erivan (Erevan – shënim i përpunuesit), në thesarin e Eçmiaxinit (afër Erivanit). Veç këtyre ka

shumë dorë shkrime nëpër muzeumet e kryeqyteteve të Europës, si në Bibliotekën Nacionale të Parisit, në British Museum, etj.

Si qendra të kulturës Armene jashtë Armenisë janë bibliotekat e Kongregacioneve Mekhitariste në Venecia dhe në Vienë. Në këto dy qendra Armene ka një thesar shumë të madh të shenjave të qytetërimit të vjetër, ku, filologët, historianët, arkeologët dhe shkrimtarët e botës ushqehen. Në këto dy qendra të kulturës, njerëzit, porsa paraqiten, kanë për të gjetur një pritje jashtëzakonisht të përzemërt, një mikpritje unike dhe mistike, që është tepër e rallë në Europën e industrializuar.

Të paraqitësh kulturën Armene prej shekullit të V-të deri në ditët e sotme me një konferencë të vetme është një gjë e pamundur, prandaj të më lejoni të kapërcej në kohë dhe të vijmë në fillimin e shekullit të XVIII-të, kur fillon shekulli i Rilindjes për kulturën Armene dhe, që të mos bëhem i mërziur, do të parashtroj fakte me fraza të shkurtra.

Më 1701 themelohet Kongregacioni dhe Kolegji Armen në Venetik dhe më pas një tjetër në Vienë. Edhe sot ishulli San Lazo është një pronë e Mekhitaristëve; për pak kohë (brenda një kohe të shkurtër – shënim i përpunuesit) kolegji i Venetikut bëhet Sorbonnei i Armenëve. Të parët e Rilindjes Armene janë nxënësit e Mekhitaristëve, të cilët kanë përhapur në Turqi dhe Armeni idealin e tyre kombëtar dhe kultural.

U formuan katër qendra të kulturës: Stambolli, Tifisi, Erivani dhe Moska. Në çdo qendër filloi lëvizja me një vrull dhe një dashuri të magjepsur. Erdhi një kohë që njerëzit nuk bisedonin gjë tjetër, por vetëm për veprat poetike dhe ato në prozë. I mjeri ai që nuk kishte dijeni nga lëvizja kulturore e ditës! Ishte turp! Kjo fanatizmë ka bërë dobira kolosale, sepse edhe më përtaci e më Don Zhvani filloi të merret me kulturën kombëtare dhe atë botërore. Qytetet dhe katundet u pajisën me shkolla. Prej mësuesve të krahinave

dualën më vonë një shumicë e madhe shkrimtarësh provincialë, të cilët në degët e tyre letrare siguronin konservimin e dialekteve, evitonin bastardimin e gjuhës, bëheshin më të kuptueshëm për provincialin, mblihdnin folklorin Armen.

Më 1794 botohet revista e parë Armene në Kalkuta të Indisë me emrin Azdarar (Lajmëtari). Revista e dytë del më 1844 dhe pas kësaj date inondohet bota Armene me revista dhe me fletore të përditshme dhe të përkohshme.

Më 1939 numëroheshin, prej Armenie në Buenos Aires dhe prej Belgjike në Egjipt, 48 fletore të përditshme, 25 revista kulturele, 8 revista mjeksore si dhe shumë të tjera shkencore dhe artistike. Kolonia e Francës, Amerikës, Egjiptit, Bullgarisë, Rumanisë, Persisë, etj., të gjithë kanë almanakët e tyre me 500 – 600 faqe me përmbajtje kulturele; lëvizje kulturele dhe lëvizje kombëtare. Kongregacioni Mekhitarist boton çdo pesë vjet një vepër artistike monumentale me një format 80 cm. me 60 cm., me kartë të trashë (papier casse), një vepër krejt artistike me emrin Këghuni (Bukurija), ku paraqiten veprat më të bukura e më të çmuara të pikturës, arkitekturës, skulpturës dhe poezisë.

Në çerekun e fundit të shekullit të XIX-të kultura Armene është në lartësinë e pakrahasueshme, duke marrë parasysh konditat e jetës politike e shoqërore. Në këtë periudhë, Armenët janë që krijojnë artin teatral në Turqi. Universiteti i Stambollit dirizhohet pothuaj prej profesorëve Armenë. Piktura dhe arkitektura është krejtësisht Armene. Pallatet Mbretërore dhe ndërtimet e rëndësishme janë vepra të inxhinierave dhe konstruktorëve Armenë.

Tani, u japim fjalën për arkitekturën Armene, arkeologëve.

Arkitektura Armene është më e vjetër se letërsia Armene. Për mungesë burimesh ne do të përmendim vetëm emrat e 3 – 4 Bizantologëve dhe Armenologëve që japin një ide të përgjithshme përmbi arkitekturën Armene.

Prof. Charles Diehl<sup>6</sup>, më 1905, mban një konferencë në sallën Turgot për artin Armen, ku thotë në mes të tjerave që “midis artit Bizantin dhe Armen sheh një afrim, por jo shembëllim ose kopjim”; përmenden disa nuanca të artit Armen, që nuk ekzistojnë në artin Bizantin. Në veprën e tij “Manuel d’art Bizantin”, Charles Diehl ofron 315 shënime për artin Armen, duke analizuar imtësisht veprat arkitekturale dhe miniaturat. Në kohërat e para të Kristianizmit, veprat arkitekturale dhe miniaturat paraqiten dy llojesh në Azinë e Vogël: veprat oksidentale, d.m.th. Bizantine dhe veprat orientale, d.m.th. Armene.

Në Bizant, bazilikat janë prej druri të punuar; në Armeni, veprat analoge janë prej guri, ose tjegulle dhe me arke (harqe – shënim i përpunuesit). Në këtë periudhë, arti duket më i përsosur në Armeni në pikëpamje të stilit dhe të lëndës. Archeologu i famshëm, Odeikovski, shkon më larg dhe deklaron: “Arti Bizantin është një amalgamë e artit Armen, Asirian dhe Egjyptian”. Charles Diehl, në një vend tjetër, thotë: Arti Armen nuk është kurrë një kopje e artit Bizantin. Përkundrazi, artet Ruse, Gjeorgjiane dhe Sllave i detyrohen shumë gjëra artit dhe artistëve Armenë. Mund të ngulim këmbë se kishat dhe manastiret e vjetra Ruse janë vepra të arkitekturës Armene.

Më 1928 bëhet Kongresi Internacional i shkencave historike në Oslo. Charles Diehl është raportori i arteve të Orientit të Afërm. Në pjesën ku flitet për artin Armen, shkencëtari deklaron: “Prej shekullit të IV-t deri në shekullin e XIV-të, njëmijë vjet plot, arti i Kristianizmit Oriental ka bërë një dyndje të madhe mbi Oksidentin dhe këtu do të provojmë se arti Armen është një nga të parët... (xx)

---

<sup>6</sup> Charles Diehl - ishte një historian Francez i lindur në Strasburg. Ishte autoritet në fushën e historisë dhe artit Bizantin. Mori formim në Shkollën Normale Superiore dhe më vonë studjoi për Historinë Bizantine në Sorbonë.

Lindur: 19 Janar 1859.

Vdekur: 01 Nentor 1944.

x

x x

### Shënime të përpunuesit:

Më poshtë, vazhdojnë disa rreshta të palexueshëm, me të cilët mbyllet faqja Nr. 8 e këtij materiali të fotokopjuar nga një shkrim i shtypur me makinë daktilografike.

a. Bizantologu i famshëm, Choisy<sup>7</sup>, thotë: “Gjatë Danubit, në ... shenjat e artit Armen janë edhe sot të gjalla”. Ornsen?? ... na le të kuptojmë se ato vise kanë qenë vende të ... .. ishave të Serbisë dhe Rumanisë janë më të ...”

“Mos kishnja njojtur artin Armen, nuk do të...

...

b. Emri i plotë i autorit të këtij shkrimi është Harutiun Burnazian (shkurt emri Harutiun përdoret Arto, prandaj edhe në hyrje të këtij shkrimi emri i autorit shfaqet me: A. Burnazian)

c. Në këtë shkrim nuk ka datë se kur është punuar apo referuar. (Autori ka jetuar 1905 – 1955)

d. Nuk kuptohet dhe nuk dihet nëse shkrimi vazhdon më tej, por hamendja le të kuptohet se duhet të ketë pasur edhe diçka më tepër se sa është paraqitur.

e. Gjatë përpunimit të këtij materiali është përpjekur të ruhet identiteti i Autorit në mënyrën e të perceptuarit të çështjes që trajton, si edhe në mënyrën si e ka paraqitur për lexuesin shqiptar në gjuhën Shqipe të kohës dhe me aq sa ai e njihnte atë. Pavarësisht modestisë

---

<sup>7</sup> Auguste Choisy - ishte një historian i historisë së arkitekturës dhe autor i librit “Historia e Arkitekturës”.

Lindur: 07 Shkurt 1841.

Vdekur: 18 Shtator 1909.

në hyrje të këtij materiali, autori duket se e zotëron mirë Shqipen, gjë kjo, që duket në mënyrën se sa qartë e shpreh me shkrim mendimin e formuluar prej tij.

x

x x

Përpunoi për botim: Berzh Piranjani

Tiranë, 20 Korrik 2018





# ARMENIA

Histori e shkurtër

Përshtatur në Shqip nga libri: Armenia, a Very Brief History  
By Christopher J. Walker  
(Aptdated by G. Hovhannisyan)  
Yerevan, 2014

Gjeografia Historike .....	23
Koha e Hershme .....	24
Armenia e Krishterë.....	25
Pushtimi dhe Humbja e Pavarësisë.....	27
Armenia Ciliciane.....	29
Beteja e Perandorisë .....	30
Politikat Britanike dhe Ruse.....	31
Masakrat në Sasun.....	36
Ngritja e Diasporës Armene.....	37
Gjenocidi i viteve 1915 – 1923 .....	38
Republika e Parë.....	43
Armenia Sovjetike .....	44
Republika e Tretë .....	48

## Gjeografia Historike

Atdheu i Armenëve, i njohur nga historianët si Armenia e Madhe, përfshin një sipërfaqe të madhe territori malor. Nga perëndimi shtrihej deri pranë Kharput-it në Turqinë e sotme, nga lindja deri në Nagorno-Karabakh dhe Khoi-n Iranian, distancë kjo që është rreth 720 km; ndërsa në drejtimin veri – jug shtrihej ndërmjet Ardahan-it dhe Liqenit Sevan në veri deri në kufi me Kurdistanin në drejtim të Jugut, pikërisht pas liqenit Van, distancë kjo që është rreth 400 km. Duke qenë se vendi nuk është një katror i përsosur, arrihet në një shifër prej rreth 250 000 km. katrorë. As në kohët e lashta, as në kohët moderne, Armenia nuk ka pasur dalje në det.

Armenia e vogël ka ekzistuar në Mesjetën e hershme në perëndim të Euftratit, rreth qytetit modern të Ernjizan-it; dhe nga shekulli i njëmbëdhjetë deri në të katërmëdhjetin epiqendra e jetës Armene u zhvendos në Cilicia, në veri të gjirit të Alexandretës (Iskënderun). Kjo mbretëri u qeveris fillimisht nga Rupenids-ët dhe Hetumids-ët Armenë, dhe pastaj nga Lusignan-ët Francezë. Sot, Republika e Armenisë (ish Armenia Sovjetike) përfshin brenda kufijve të saj një sipërfaqe prej 29800 kilometra katrorë, që përbën vetëm dhjetë përqind (10%) të territorit të Armenisë së Madhe. Nagorno Karabakh-u (Karabaku Malor) nga ana e vet përfshin brenda kufijve të tij një sipërfaqe prej 4800 kilometra katrorë. Sot, në Turqi, asnjë hartë e këtij vendi, nuk përmend ish Armeninë “Turke”. Krahina shfaqet, jashtë çdo diskutimi, si krahinë turke. Emrat Armenë janë zëvendësuar me emra Turq.

Në tërësinë e saj, Armenia e Madhe përfaqëson një pllajë të vendosur mesatarisht 1700 metra mbi nivelin e detit. Si rezultat, stina e dimrit është jashtëzakonisht e ftohtë dhe e gjatë.

(Stina e verës është e shkurtër dhe e nxehtë). Pjesë të vendit janë të bukura dhe pjellore, ndonëse zona të mëdha janë malore dhe shkëmbore. Poeti Gurgen Mahari ka shkruar fuqishëm në lidhje me peisazhin shkëmbor të atdheut të tij. Mali Ararat, i cili sot gjendet brenda kufijve të Turqisë, është mali më i lartë dhe më i famshëm i Armenisë, me 5137 metra lartësi.

## Koha e Hershme

Armenët janë një popull shumë i lashtë. Ata janë pasardhës të njerëzve që kanë jetuar në këtë vend që nga kohët parahistorike. Arkeologët kanë regjistruar aty një vazhdimësi të ekzistencës njerëzore që nga Epoka e Gurit të Vjetër. Rreth 1000 vjet para Krishtit, në territorin e Armenisë ishte mbretëria Urartu (emër ky, i ngjashëm me emrin «Ararat»), i cili rreth viteve 600 para Krishtit u shkel nga pushtues të ndryshëm (Scythians, Medët, dhe “Hasaya”), disa prej të cilëve të ardhur nga shteti i vjetër i Hittitëve në Anadollin Qendror (Anatolinë Qendrore). Gjuha e përdorur, si rezultat edhe i ndikimit të të ardhurve të rinj, i përkiste një dege të qartë të grupit të gjuhëve indo-europiane. Ajo kishte disa ngjashmëri me gjuhët Iraniane. Burimet Iraniane dhe Greke filluan të flisnin për Armeninë dhe Armenët duke nisur nga vitet 500 para Krishtit. Mbretërit e mëdhenj Darius dhe Kserksi i njohnin këta popuj me këta emra, ashtu si edhe Herodotusi. Në 401 para Krishtit, Ksenofoni kaloi nëpër Armeni dhe aty vuri re zakonet e vendasve për të pirë birrën nëpërmjet një kallami prej kashte.

Kështu, të dhënat tregojnë se Armenët kanë një vazhdimësi të ekzistencës në atdheun e tyre prej të paktën dy mijëvjeçarë e gjysëm, deri në shkatërrimin e tyre gjenocidal dhe shpërndarjes në 1915 (me përjashtim të zonës së vogël të ish Armenisë Ruse).

Në shekullin e parë para Krishtit, në kohën e Pompeit dhe Cezarit, brenda një kohe të shkurtër Armenia ishte rritur fuqimisht, duke marrë tiparet e një perandorie. Perandoria e arriti shtrirjen e saj më të madhe gjate kohës së sundimit të mbretit Tigran i II-të (Tigrani i Madh), i cili

sundoi nga viti 95 deri në vitin 55 para Krishtit. Mbretëria e tij shtrihej nga deti Kaspik deri në kufi me Egjiptin. Por Roma u ndje e kërcënuar, dhe ndërmori fushata të ndryshme nga Lucullus dhe Pompei, dhe në shekullin e ardhshëm nga Korbulo, duke e reduktuar perandorinë nga një fuqi botërore në një fuqi rajonale.

## Armenia e Krishterë

Krishterimi hyri në Armeni shumë herët; tradita tregon se apostujt Tadeus dhe Bartolomeu arritën këtu në shekullin e parë. Armenia ishte vendi i parë që përqafoi besimin e krishterë si besim kombëtar shtetëror. Kjo ndodhi në vitin 301 pas Krishtit, rreth dymbëdhjetë vjet para dekretit të Konstandinit për tolerimin e këtij besimi në Perandorinë Romake. Futja e Krishterimit në Armeni i është atribuar Grigor Iluminator-it (I Përndrituri), i cili, pas torturave të gjata në një gropë të thellë, që shërbente si birucë burgu për të për shkak të besimit të tij, u lirua nga mbreti i Armenisë (Tiridates, Trdat), me qëllim që të kuronte mbretin nga një sëmundje e tmerrshme mendore. Grigori ja arriti të përmirësonte shëndetin mendor të Mbretit, dhe prej këtij momenti i gjithë oborri mbretëror dhe popullsia e vendit filloi konvertimin në fenë e re, Krishterimin.

Vlen të përmendet se konvertimi i Armenisë në Krishtërim në këtë datë nuk ka të bëjë me futjen në grupin e ndonjë fuqie të madhe botërore, pasi në atë kohë akoma nuk kishte gjëra të tilla si “Perëndimi i Krishterë”. Europa ishte akoma pagane. Krishterimi në këtë kohë ishte një fe që dominonte kryesisht në rajonin Aziatik dhe Afrikan.

Njëqind vjet më vonë një shkruer i devotshëm shpiku një dorëshkrim për gjuhën Armene. Deri atëhere kishte qënë përdorur shkrimi kuneiform Grek dhe Aramaik; tashme ishte krijuar një alfabet i mirë, i cili pasqyronte me saktësi tingujt e gjuhës Armene. Bibla ishte libri i parë, që u përkthye në Armenisht me shkrimin e ri; kjo pasoi me të tjera tekste dhe vepra që përmbanin shkrime të shenjta, duke kulmuar kështu në shekullin e pestë të njohur si «Epoka e Artë»

e shkrimit Armen. Besimi dhe shkrimi i dhanë krahë Armenëve në përpjekjet e tyre për mbijetesë dhe mbrojtjen e kulturës kombëtare. Deri në vitin 431 pas Krishtit, Kisha e Krishterë ishte një. Pastaj ndodhi ndarja e parë doktrimore; në vazhdim të Këshillit të Efesit ndodhi një shkëputje, në të cilën Kisha e Lindjes (ndonjëherë e njohur si Kisha Nestoriane, apo Asiriane) shpalli shkëputjen e saj, duke deklaruar se ajo refuzonte të njihnte vendimet e Këshillit, dhe se do të vazhdonte të mbështetej në besimin e saj në dallimin ndërmjet natyrës hyjnore dhe natyrës njerëzore të Krishtit.

Në një tjetër këshill, të mbajtur më pas në Kalcedonia, Armenët arritën në konkluzionin se temat e trajtuara aty devijonin shumë nga teologjia Nestoriane, prandaj ata hodhën poshtë gjetjet e tij (së bashku me kishat e Egjiptit dhe Etiopisë), duke deklaruar se natyra hyjnore dhe njerëzore e Krishtit janë të lidhura ngushtë me njera tjetrën, edhe pse të ndashme. Armenët janë karakterizuar si monofizitë (mono-një, physis-naturë), por teologjia e tyre ka shmangur gjithmonë çdo pozitë ekstreme monofizite.

Në Këshillin e Kalcedonia-s nuk ishte i pranishëm asnjë delegacion Armen, sepse Sasanidët Persianë kishin filluar një fushatë për të fshirë besimin e Krishterë nga Armenia, dhe po përballeshin në fushën e betejës me Armenët e sapo kthyer në të Krishterë.

Armenët ishin në gjendje për të përballuar agresionin Persian të udhëhequr nga mbreti Yazdigerd II, i cili më së fundmi hoqi dorë nga ideja për t'i konvertuar Armenët në Zoroastrianë. Përfundimisht, Armenia u njoh nga Persia si një vend i Krishterë në vitin 485 pas Krishtit. Armenia ka vuajtur shumë për shkak të betejave të ashpra të zhvilluara ndërmjet perandorive të mëdha të Bizantit dhe Persisë në shekullin e gjashtë dhe në fillim të shekullit të shtatë. Vendi i tyre u bë një fushëbetëje, ashtu siç ka qenë ndërmjet Romës dhe Parthës në antikitet. Ndonëse, për shkak të besimit, ata ndjenin një afërsi më të madhe me Bizantin e Krishterë se sa me Persinë, shumë nga lidhjet e tyre kulturore e kishin bazën në Persi / Iran, dhe për aq kohë sa ata nuk ishin të trazuar prej tyre (për aq kohë sa jetonin në paqe me njeri tjetrin), ata ndjenin

zakonisht një afërsi më të madhe me fuqitë lindore. Nga Jeruzalemi Bizantin, Persia largoi relikën e shenjtë të Kryqit të Vërtetë në vitin 614; ajo u rivendos nga perandori Bizantin Heraklius në vitin 629. Lajmet e fitores së madhe gjetën jehonë edhe në vende të largëta, madje deri në Arabi, dhe gjetën pasqyrim edhe në Kuran.

### **Pushtimi dhe Humbja e Pavarësisë**

Pas vdekjes së Muhamedit në vitin 632, ushtritë e fuqishme islamike arritën të mposhtin me shpejtësi dinastitë e rraskapitura perandorake të Bizantit dhe Sasanidëve Persianë, dhe mesazhi Islamik për një Zot të vetëm, me Jezusin si të zgjedhur të tij, por jo si Djali i tij, u pa nga shumë të Krishterë lindorë, më tepër, si një largim i mëtejshëm nga Kristianizmi se sa krijimi i një feje të re. Por Islami nisi procesin e shkatërrimit në Armeni; me luftë, vrasje dhe shkatërrim. Posa që situata qetësohej sado pak, në perputhje me situatën e perandorisë, gjendja e Armenisë përmirësohej; vendi u njoh (si “Arminiyya” - shiko hyrjen në Enciklopedinë e Islamit) si njësi administrative, dhe lidhjet e gjera të Perandorisë Islame i dhanë hapësirë për tregti. Në jetën e tij civile kishte pak ose aspak persekutim. U ndërtuan kisha dhe jeta Armene u zhvillua, madje edhe lulëzoi. Në mënyrë të kujdesshme, stuktura sociale Armene u rishfaq me dëshirën e saj për autonomi, ndërkohë që Kalifati dobësohej. Në vitin 861 një përfaqësues i familjes fisnike Bagratuni u njoh si princ i princave, dhe brenda disa viteve ai ishte ngritur në rang mbreti. Kishte lindur një familje e re mbretërore në Armeni. Por kishte edhe probleme. Një rival, nga familja Ardzruni, u vetëshpall mbret i Vaspurakanit (në jug të liqenit Van).

Megjithatë uniteti u arrit në fillim të shekullit të dhjetë, dhe u pasua nga një shekull i shkëlqyer, kur jeta dhe dashuria, arti dhe poezia, lulëzuan rreth tokës pjellore Armene. Princat ishin, sipas një kronikani, “të veshur me ngjyra të shkëlqyera dhe u ngjanin kopshteve pranverore... Tingujt e flautit, të cembaleve dhe të instrumenteve të tjera mbushin zemrën e çdokujt me kënaqësinë e një gëzimi të madh “. Bagratidët Armenë ndërtuan një kryeqytet të ri në Ani, një monument

të arkitekturës mesjetare, dhe një qytet që tejkalonte çdo ndërtesë në Evropën e asaj kohe. Sot ai ndodhet në Turqi. Muret masivë të tij, dhe katedralja madhështore (e ndërtuar ndërmjet viteve 989 dhe 1001) e rrethuar nga Kishat, ndonëse sot, në vitin 2013, të ruajtuara në një gjendje të mjerueshme, janë dëshmi e një gjenie të madhe arkitekture.

Në një datë pak më të hershme, Arzrunis ndërtoi një tjetër mrekulli arkitekture; Kishën e Kryqit të Shenjtë, në ishullin Ahtamar, në liqenin Van, e cila është restauruar pjesërisht vetëm tani së fundmi. Pjesa e jashtme është e zbukuruar me skulptura të gdhendura dhe skena biblike në relief. Figurat tregojnë dinjitet të madh shpirtëror të pasur me energji pozitive; shenjtorët dhe patriarkët, të kombinuar me vreshta dhe kafshë të gjalla, përfaqësojnë një kombinim unik Armen. Kjo kishë është një pikë referimi në artin fetar të Lindjes së Afërme. Ndërkohë Bizanti kishte hyrë në një fazë ekspansioniste, dhe aneksoi mbretërinë e Bagratidit në vitin 1045. Në vitin 1064, Turqit Selxhukë e sulmuan atë nga lindja, shtatë vjet para Betejës së Manzikertit (viti 1071), e cila në mënyrë përfundimtare shënoi fundin e sundimit Bizantin në Anatinë qendrore dhe lindore. Pati njëfarë ringjallje në Armeninë lindore, që përkon me ripërtëritjen e shtetit të Gjeorgjisë nën Mbretëreshën Tamarë dhe pasardhësit e saj. Shumë prej gurëve-kryq të punuar me mjeshtëri (khachkars), të cilët çdokush i sheh në Armeni dhe Karabak, datojnë në shekujt trembëdhjetë ose katërmëdhjetë; por pushtimi Mongol i 1236 dhe fushata jashtëzakonisht shkatërruese e Tamerlanit (Timurlengut)(1386-1388) solli vdekje dhe shkatërrim në masë. Pas kësaj, në malësitë Armene pushteti ra në dorë të dy bashkësive Turkomane rivale, “Ramët e Bardhë” (Akkoyunlu) dhe “Ramët e Zi” (Karakoyunlu); disa prej liderëve të këtyre grupimeve treguan njëfarë mbështetje për Armenët; për shembull rasti, kur Peshkopata (selia e kreut të lartë të kishës - Katolikosit) u kthye (u transferua) nga Cilicia në Ecmiaksin në vitin 1441, një ngjarje e shënuar në përparimin dhe konsolidimin e Kishës Armene, duke hapur rrugën për zhvillimin e një qendre shpirtërore dhe vërtet të fuqishme për kohën, duke i dalë përpara shekujve të stuhishëm që po vinin.

## Armenia Ciliciane

Ndërkohë, me rënien e fuqisë së Bagratidëve, Armenia filloi të zhvendoste veten në Cilicia, në pjesën jugqendrore të Turqisë së sotme, në veri të Qipros, me Kryepeshkopatën Armene të vendosur në Sis. Armenia Ciliciane u ngrit në nivel principate në vitin 1080 dhe në nivel mbretërie në vitin 1199, dhe monarkët e saj mbretëruan për pothuajse 300 vjet. Armenia e krishterë u lidh me kryqtarët e krishterë, megjithëse koha nuk ishte e përshtatshme; pikërisht në kohën e kurorëzimit të mbretit Armen, kryqtarët kishin humbur Jeruzalemin, dhe brenda 100 viteve të ardhshme ata do të humbisnin të gjitha zotërimet e tyre në Mesdheun lindor.

Megjithatë, pavarësisht nga momenti jo i përshtatshëm, Armenia Ciliciane u dallua për përparimin kulturor: tekste të shenjta të Katolikosit (Katolikos = Kryepeshkop) Nerses IV (Gracious - Shnorhali – I Hijshmi) datojnë nga kjo periudhë, ashtu si edhe zhvillimet mjekësore të Mkhitar Heracit dhe tekste ligjore të Mkhitar Goshit. Tregtia lulëzoi në portin e Ayas (e njohur edhe si Layas - Lajazzo për Italianët). Cilicia zinte, gjithashtu, një vend të rëndësishëm në imagjinatën mesjetare të Evropës Perëndimore, veçanërisht në Angli, ku ajo shpesh përfshihej në poemat narrative. Kalorësi i Shoserit në Tregimet e Kanterburit (Knight Chaucer's, Canterbury Tales) ka luftuar në Ayas. "Abilent" = Dabilent, që është një version i Dvin, kryeqytet i vjetër Armen. (Shih diskutimin e Dorothee Metlitzki, Çështja e Arabisë në Anglinë Mesjetare, 1977). Armenia shfaqet edhe në udhëtimet e Sir John Mandeville (1356). Megjithatë teksti tregon për shumë eksperiencë të konsiderueshme të udhëtimit jashtë vendit, të cilat ishin në modë në Europën Perëndimore në mesin e shekullit të katërmëdhjetë. Udhëtarë të tjerë Europianë dhe Arabë kaluan përmes Armenisë dhe shumë prej tyre sjellin informacione rreth vendit dhe banorëve të tij. Këtu përfshihet Uilliam de Rubruck (1220-1290), Marco Polo (1254-1324), Johann Schiltberger (1381-1449), Rui Gonzales De Klavizo (d.1412), Josafa Barbaro (1413-1494), Anthony Jenkinson (1529- 1610), Alexandre De Rhodes (1591-1660), Adam Olearius (1602-1671), Jean Baptiste

Tavernier (1605-1689), Sir John Chardin (1643-1713) dhe të tjere. Mbreti i fundit Armen, Levoni i Vtë, u rrëzua nga Mamlukët në vitin 1375. Pas kësaj ai udhëtoi nëpër Europë, veçanërisht në Angli dhe Francë, në përpjekje për të vendosur paqe ndërmjet këtyre vendeve me marrëdhënie të acaruara ndërmjet tyre. Ai u prit me mirësjellje nga Mbreti Richard II në Pallatin Elt'ham, por asnjë marrëveshje paqeje nuk u arrit, dhe ai vdiq në Paris në 1393. Eshtrat e tij janë varrosur në Bazilikën Saint Denis pranë Parisit.

### **Beteja e Perandorisë**

Për Armenët, bota e hershme moderne fillon ndoshta me kapjen e Kostandinopojës nga Turqit Otomanë rreth gjysëm shekulli më vonë, ose ndoshta me ardhjen në fron të Safavidëve në Persi në vitin 1502. Safavidët Shiitë do të jenë armiqtë e papajtueshëm të Otomanëve Suni për gati 140 vjet; dhe për Armenët, të cilët ishin të vendosur në zonat kufitare ndërmjet dy vendeve, situata ishte e rrezikshme. Në Perandorinë Otomane situata për Armenët u rregullua, kur peshkopit Armen të Bursës ju propozua nga sulltani Otoman në vitin 1481 për t'u bërë patriarku i komunitetit Armen për Perandorinë Otomane, duke u bërë në fakt përkohësisht edhe si një lider shpirtëror. Situata për Armenët e Persisë/Iranit ishte akoma më paradoksale dhe, edhe pse e karakterizuar nga dhuna dhe shpronësimi, në terma afatgjatë komuniteti pati më shumë përfitime. Kur Shah Abbas u bë udhëheqësi i Iranit në vitin 1588, luftërat me Otomanët dhe Uzbekët ishin duke vazhduar. Vetëm më vonë ai qe në gjendje të krijojë një shtet të lulëzuar kulturor, i cili do të impresiononte Europeanët. Dhe si pjesë të politikës së tij luftarake me Turqinë Otomane ai shpopulloi krahinat kufitare nga banorët Armenë me një zell të tepruar. Ai i urdhëroi ata, që të vinin të gjithë në Iran, dhe virtualisht e pastroi etnikisht Armeninë nga Armenët.

Ishte koha e një vuajtjeje të pamasë për Armenët dhe vdiqën me mijëra prej tyre. Por, sapo që ata u vendosën në Iran, ai i trajtoi mirë, dhe i sistemoi në komunitete (shumë prej të cilave nuk mbijetuan). Ajo

që bie më tepër në sy ishte fakti, që Shah Abbasi i vendosi Armenët në funksion të tregtisë së vendit të tij dhe u dha atyre një qytet të tërë, ku mund të jetonin dhe prej nga ku të mund të zhvillonin operacionet e tyre tregtare. Ky ishte New Julfa (Nor Xhuga - sipas gjuhës Armene, që në shqip do të përkthehej – Xhuga e Re), pak jashtë Isfahanit, përqark lumit Zayndeh Rud. Shah Abbasi madja hyri edhe në diskutime teologjike me Armenët.

Për rreth 100 vjet aktivitetet e tyre lulëzuan; tregtia e tyre qeverisej prej një kodi të brendshëm të ashpër, i cili e ndihmoi praktikën e tregtisë, kombet tregtare dhe operatorët tregtarë. Disa familje Armene u bënë shumë të pasura. Nga New Julfa ata krijuan lidhje me Indinë (duke arritur në Kalkuta, madje para britanikëve), me Azinë Lindore, dhe është për t'u vënë në dukje, edhe me Carin e Moskës. Tregtarët Armenë kaluan edhe nëpër lumenjtë e Europës për të arritur portet Hanseatike (portet e brigjeve veriore të Hollandës, Gjermanisë, etj).

### **Politikat Britanike dhe Ruse**

Anglia hodhi një vështrim të shpejtë mbi Armeninë në shekullin XVII, si rezultat i interesit të shfaqur nga ana e Kishës Ortodokse Greke, dhe në lindje, nga mbreti Çarls I<sup>ri</sup> dhe kryepeshkopi Laud. Ideja ishte të ushqenin kontaktet midis Kishës Anglikane dhe Kishave Lindore, dhe në këtë mënyrë të ishin në gjendje të anashkalonin “krahun e djathtë” të Kishës Katolike Romake, dhe “krahun e majtë” të Calvinistëve. Me vdekjen e patriarkut grek Cyril Lukaris dhe vetë kryepeshkopit Laud, projekti dështoi; por si rezultat i projektit, pas disa dekadave në vazhdim, mori jetë një vepër voluminoze me titull “Gjendja aktuale e kishave Armene dhe Greke” nga Sir Paul Rycaut (1678). Më vonë akoma, në vitin 1736, një botim i rëndësishëm “Historia e Armenëve” nga Movses Khorenatsi, një nga tekstet e epokës së artë të Armenisë, u printua në Londër, në gjuhën Armene dhe me përkthim Latin, nga George dhe William Whiston.

Armenia filloi të kishte një ngjyrim politik sërish, kur Pjetri i

Madh nisi një përpjekje që të përvetësonte tregtinë e Persisë duke e pushtuar atë në vitin 1722. Në atë kohë Irani ishte nën presionin e sulmeve Afgane. Armenët shpresonin që, në vend që të pushtonte tregtinë e komshiut të tij jugor, ai do të çlironte vendin e tyre dhe do të kthente në vend mbretërinë e tyre, por historia mëson se zgjidhje ideale shumë rrallë parashikohen kur ke të bësh me monarkë pushtues. Pas një pushtimi të shkurtër të Transkaukazisë lindore, Pjetri u tërhoq, dhe Rusia nuk shfaqti më interes për Armeninë për 50 vjet. Një Melik Armen (melik – princ, ose udhëheqës), David Beg, deklaroi një pavarësi të shkurtër në një zonë malore, në kohën e trazuar që pasonte pushtimin Afgan të Iranit; por pas disa vitesh u rivendos sundimi Iranian.

Modernizimi i vendit nëpërmjet edukimit filloi të ndodhte rreth kësaj kohe. Një Armen nga Madrasi financoi një shtypshkronjë printimi në Eçmiaksin në 1771, dhe po në Madras u shkrua vepra e parë Armene e filozofisë politike në 1772. Një gazetë e quajtur Azdarar (“Monitor”) u publikua në 1794 -1796. Në Venecia (të Italisë sot), vëllazëria Mkhitariste (e Armenëve Katolikë) fitoi të drejtën e një hapësire për ndërtimin e një manastiri në ishullin San Lazzaro në vitin 1715, dhe themeloi atje një komunitet sa intelektual aq edhe shpirtëror. Në këtë vend, 100 vjet më vonë, poeti i madh Anglez, Bajroni, mësoi Armenisht (Ai nuk u lejua të qëndronte në ishull mbrëmjeve, pasi u konsiderua shumë i lig nga Babai Suprem). Vetë-ndërgjegjësimi Armen dhe vetëdija kombëtare nuk ishin “importe Perëndimore”, siç është pohuar me mendjelehtësi nga akademikë sipërfaqësorë, por ishin zhvillime natyrale ndërmjet vetë Armenëve, ndonjëherë me ndihmën e Lindjes, por jo të Perëndimit.

Rusia akoma mendonte për kushtet e të krishterëve Kaukaziane, dhe Katerina e Madhe së bashku me Potjemkinin parashikuan një projekt të ri për krijimin e një principate Armene. Potemkin deklaroi në vitin 1784 se “Armenia ngre duart e saj drejt fronit të shenjtë të Madhërisë Suaj Perandorake duke kërkuar çlirim”. Sërisht, asgjë nuk funksionoi, edhe pse shtyrja Ruse drejt jugut (sidomos me fitoret rreth veriut të Detit të Zi gjatë viteve 1770 dhe 1780, të cilat çuan në krizën

Anglo-Ruse të Oçakovit në vitin 1791) nxorri në pah disa problematika ndërkombëtare, të cilat do të mbizotëronin fushën diplomatike të shekullit XIX. Problematika kryesore për politikën e huaj të Britanisë në rajon ishte: cilën do të mbështeste ajo: perandorinë Turke apo atë Ruse? Në shekullin XVIII Franca kishte qenë përkrahëse e perandorisë Turke. Britania ishte një mike e Rosisë, që në kohët kur Pjetri i Madh punonte në kantieret detare të Londrës. Tashmë William Pitt i riu propozonte që Britania duhet të çonte flotën në Detin e Zi për të mbështetur Turqinë. Ky ishte një ndryshim. Por kjo përpjekje dështoi. Dhe pas më pak se një gjysëm shekulli më vonë Britania (në aleancë me Francën dhe Rusinë) shkatërron flotën Otomane në një përlëshje detare në Navarino, duke ndihmuar kështu në krijimin e shtetit modern Grek.

George Canning, kryeministri britanik, i dobishëm në udhëheqjen drejt fitores, nuk jetoi që të shikonte vazhdueshmërinë e kësaj politike. Në fakt, kryesia e Britanisë kaloi në duart e Dukës së Wellingtonit, një njeri që e konsideroi betejën e Navarinos si një “ngjarje të pakëndshme”, dhe perandorinë Turke si “aleatja e hershme” e Britanisë. Ishte Wellingtoni ai që vendosi tonin në marrëdhëniet Anglo-Otomane për pjesën tjetër të shekullit XIX, gjë që pati ndërlikime të rënda për Armenët. Politika e mbështetjes së fuqishme për Turqinë dhe kundërshtimit të Rosisë nënkuptonte që edhe ndonjë mbështetje e butë, siç mund të ishte njohja aktive e konditave të Armenëve ose interesimi për komunitetet e tyre si përfaqësues të vlerave kristiane, do të ishte në nivelin e konsideratave minimale.

Është gjithashtu instruktive, që të shihet pozicionimi i të huajve dhe sidomos i Britanikëve në lidhje me perandorinë Otomane dhe popujt e saj. Nocioni i Komunitetit Kristian ishte i rëndësishëm, apo me rëndësi kryesore? Të dhënat historike nuk janë bindëse. Në kohën e rebelimit Grek, mbështetësit më të fuqishëm të Greqisë nuk ishin klerikët, por Filohelenët dhe ateistët si Bajroni dhe Shelley. Gjatë luftës së Krimesë, kleriku anglikan dhe autori i “The Water Babies” (bebet e ujit), Charles Kingsley, u çoi një mesazh trupave britanike që luftonin përkrah atyre turke në Sevastopol duke i kërkuar atyre që “të ishin të

sigurt se po kryenin shërbimet ndaj Zotit”. Ishte vetëm në vitet 1870, me Gladstonin dhe lëvizjen e Kishës së Lartë në krye, dhe nën jehonën e Laudianizmit të dy shekujve e gjysëm më herët, që të krishterët Anglezë mbështetën kauzën e të krishterëve të Lindjes, të cilët vuanin nën shtypjen e qeverisë Otomane.

Madje edhe atëhere, popujt, si ai Armen, përfituan pak ose aspak ndihmë nga jashtë, duke qenë se mbështetja e Britanikëve për Otomanët ishte ende shumë e fortë, fillimisht për shkak të rivalitetit Anglo-Rus në lidhje me Azinë Qendrore dhe frika për frontin Veri-Perëndimor, së dyti, për shkak të investimeve të mëdha të Britanisë në perandorinë Otomane (në formën e obligacioneve), dhe së treti sepse Mbretëresha Viktoria ishte personalisht antipatike ndaj të Krishterëve të Lindjes.

Në Kaukaz, Rusia kishte aneksuar Gjeorgjinë në 1801; dhe më në jug presioni vazhdonte. Rusia mësoi për historinë dhe situatën aktuale të Armenisë gjatë themelimit të institutit Lazarian (ose Lazarev) në Moskë, një institucion kulturor dhe edukativ, në 1815. Themeluesi i këtij institucioni vinte nga New Julfa. Në atdhe, Persia/Irani nisi një sulm të pavend ndaj pozicioneve ruse në vitin 1827, e cila mundësoi përfitime më të mëdha për Rusinë cariste. Jerevani dhe Nahiçevani u çliruan, dhe u emëruan nga Cari si “Provinca Armene” (Armyanskaja oblast). Edhe kryeqyteti fetar, i famshëm dhe historik i Eçmiaxinit u vu nën kontroll të Rusisë, dhe stabiliteti, që buroi nga kjo gjë, e lejoi të zhvillohej si një qendër autoriteti dhe udhëheqje për Armenët. Raportet midis shtetit Rus dhe vëllazërisë së Eçmiaxinit u rregulluan nga statutet e vitit 1836. Armenët, të dëbuar nga tokat e tyre rreth dy shekuj më herët nga Shah Abbas, ishin tani në gjendje të ripopullonin tokën, dhe shumë prej tyre ashtu bënë. Shumë erdhën nga provinca të keq-qeverisura të perandorisë Otomane, ku paaftësia politike po degradonte në keqdashje.

Rusia bëri disa pushtime ushtarake në rajonin e Kaukazit gjatë luftës së Krimesë, por u detyrua t'i lëshonte ato fill pas Traktatit të Parisit. Dokumentat, që Turqia Otomane u detyrua t'i firmoste në lidhje me trajtimin dhe barazinë e anëtarëve të kombësive jo Muslimane në

perandori, nuk kishin asnjë impakt në jetët e qytetarëve Otomanë jashtë kryeqytetit të mbretërisë dhe në disa qytete të mëdha në Perëndim. Asgjë nuk ndryshoi në Armeninë Otomane: padrejtësitë dhe poshtërimi vazhdonin si më parë. Por kjo nuk ishte e vërtetë për Armeninë Ruse. Këtu, në kohën e trazirave të luftës Ruso-Turke në 1877- 1878, ndjehej një frymë mirëbesimi dhe sigurie, mbase kjo edhe nga fakti që katër gjeneralë Rusë në frontin Kaukazian ishin me origjinë Armene. Në komandën e përgjithshme ishte gjenerali M.T. Loris Melikov, i cili më pas ishte kancelari i fundit i Aleksandrit të II-të (Gjithashtu ka edhe një pikturë fiktive të tij në tregimin e shkurtër të Tolstoit “Haxhi Murad”). Dhënia e të drejtës për të marrë pjesë në ushtri ishte një bonus i madh për masat e Armenëve, duke qenë se për shumë shekuj ata ishin mësuar me idenë se nuk ishin ushtarakë, ndërsa Turqit mendoheshin të ishin raca luftarake. Tashmë ishin Rusët dhe Armenët që ishin klasa luftarake, duke fituar pjesën më të madhe të betejave, dhe duke treguar njohuri të konsoliduara në strategji dhe taktikë. Një komandant Armen çliroi qytetin-kala të Karsit në Nëntor të 1877. E ardhmja dukej plot me shpresë.

Zgjidhja varej nga kombi më i fuqishëm, Britania, dhe këtu ne gjejmë një çoroditje dhe mungesë qëllimi. Pas luftës Ruso-Turke në 1877-1878, Britania modifikoi traktatin e mëparshëm të Shën Stefanit (i përcaktuar si paraprak) me propozime të reja në tekstin e traktatit përfundimtar të Berlinit (1878) në lidhje me sa i përkiste Armenëve, të cilat parashikonin zbatimin e reformave në Armeninë Turke të varura jo nga prezenca aktuale e ushtrisë Ruse, por nga dashamirësia shumë e dyshimtë e “Fuqive Europiane” (gjashtë fuqive më të mëdha të kontinentit). Britania e zhveshi përmbajtjen e traktatit fillestar të Shën Stefanit, dhe e bëri zbatimin e reformave të kushtëzuara nga një garanci ideale, jo reale.

Disraeli ishte duke vazhduar vijën e Wellingtonit, dhe ishte në akord të plotë me vijën anti-Ruse të Mbretëreshës Viktoria dhe të “shovinistëve” të tjerë. Por megjithatë, ai çoi konsuj specialë në Armeninë Otomane në vitin 1878, të cilët kontrolluan mbi padrejtësitë

e zyrtarëve Otomanë. Sidoqoftë, kur Gladstoni u kthye në fuqi në vitin 1880, ai i pa këta konsuj si mbetje të një politike të diskredituar të paraardhësit të tij, dhe i tërhoqi ata. Gladstoni u përpoq të punonte vetëm nëpërmjet unitetit të “Fuqive Europiane”. Ai e urrente idenë që një Fuqi të merrte më shumë përgjegjësi se të tjerat. Por në realitet “Harmonia e Fuqive Europiane” ishte një mirazh, ashtu siç ishte bashkimi i botës së Krishterë gjatë kohës së kryqëzatave. Kështu Armenët, të cilët ndodheshin aty në tokat e Armenisë Turke, nuk kishin askënd ku të drejttoheshin për të kërkuar të drejtat e tyre: as ushtrisë Ruse, siç u parashikua fillimisht nga traktati i Shën Stefanit, as konsujve specialë Britanikë. Shtypja dhe padrejtësia vazhduan me të njëjtin ritëm, dhe sollën rezistencë. Një tufë raportesh nga konsujt Britanikë në rajon, lëshuar në vitin 1884, ishte kaq shqetësues, sa nuk u publikuan. Armenët filluan të kundërshtonin qeverinë Otomane. Ata morën disa ndihma nga Armenët Rusë, një komunitet më i politizuar dhe më me vetbesim, dhe qeveria Otomane u kundërpërgjigj me egërsi. Pati disa trazira në fillimet e viteve 1890, dhe më pas një rebelim në shkallë të madhe në malet Sasun (në perëndim të Liqenit Van) në vitin 1894.

### **Masakrat në Sasun**

Në Sasun, Armenët jetonin si një komunitet malor, me një lloj bashkë-ekzistence feudale me Kurdët e vendit. Ata gëzonin një masë të madhe autonomie; por Kurdët ishin të prirur që të peshonin rëndshëm mbi ta për sa i përket taksave, si edhe kërkesave financiare të bëra mbi Armenët kur një prej tyre martohej. Taksimi sapo kishte arritur në zonë nga qeverisja qendrore, dhe tani ata duhet të paguanin taksa dy herë (ose edhe tre herë, nëse do të përfshihej taksa mbi martesën). Ata refuzuan të paguanin, dhe kjo mosbindje u bë shkak për një pohim të përgjithshëm mosbindjeje ndaj shtypjes dhe gjendjes së tyre poshtëruese. Qeveria qendrore nisi një forcë të armatosur që t'i masakronte ata deri në nënshtrim. Fshat pas fshati, banorët e vendit u vranë nga agjentët e qeverisë. Dhe vërtet, aq tërësor ishte operacioni i vdekjes, sa një diplomat Britanik i cili shqyrtoi provat, e konsideroi atë

si plan të qeverisë për shfarrosje dhe jo nënshtrim. Lajmet për masakrën e Sasunit u përhapën në Nëntor të 1894, dhe një fushatë e gjerë u vu në lëvizje në qarqet klerikale dhe humane të Europës duke kërkuar që të ndalonin qeverinë Otomane, dhe ndoshta të rrëzonin Sulltanin. Qeveria Otomane u kundërpërgjigj me një politikë të ashpër mohimi dhe pengimi: ajo deklaroi që ajo që kishte ndodhur, nuk kishte ndodhur. Më në fund një komision Otoman u lejua të mblidhej me vëzhgues ndërkombëtarë. Vëzhguesit vunë re, se procedurat penguese kishin ndërmend ta vononin sa më shumë të ishte e mundur daljen në shesh të së vërtetës. Megjithatë dolën në dritë mjaft fakte, të cilat jepnin një pamje të ashpër të një vrasje masive zyrtare. Në Kryeqytet, në mes të vitit 1895, një demonstratë e Armenëve kundër politikave qeveritare shkoi për keq, dhe disa muaj më vonë, në Tetor-Dhjetor të atij viti, Sulltani përforcoi mesazhin e tij të dhunës ndaj Armenëve duke nxitur një seri masakrash brutale kundrejt Armenëve në lindje. Mbi më tepër se 200,000 Armenë vdiqën. Agjentët e qeverisë ishin të kujdesshëm që të sulmonin fshatrat periferike në fushat përreth qyteteve Armene, dhe vazhdonin me vrasjet, duke treguar se kishte një element gjenocidi në operacionet e tyre. Si kundërpërgjigje Armenët pushtuan një bankë në Kryeqytet, por operacioni ishte pa rezultat.

## **Ngritja e Diasporës Armene**

Shumë Armenë u larguan nga Armenia Otomane dhe Diaspora Armene nëpër botë u rrit si pasojë e persekutimeve. Armenët ishin mësuar të udhëtonin dhe të stabilizoheshin jashtë vendit, por ashpërsia e sulmeve të bëra mbi ta në Atdhe i dha një shtysë edhe më të madhe procesit të kërkimit të një shtëpie dhe jetese diku tjetër. Franca dhe Shtetet e Bashkuara ishin shtetet më të pëlqyer. Politikat e dekadave në vazhdim sollën një rritje masive të komuniteteve të diasporës. Sot komuniteti më i madh i diasporës është në Federatën Ruse, i ndjekur nga Shtetet e Bashkuara, me mbi një milion banues Armenë.

Pas vitit 1896 u arrit një lloj “modus vivendi”, njëfarë paqeje, për

Armenët në Perandorinë Otomane. Por është e rëndësishme që të vihet në dukje, se askush nuk u akuzua për vrasjen e Armenëve. Nuk pati një proces të ligjshëm dhe asnjë dënim. Dukej sikur, marrëveshje politike të pandershme kishin bërë, që vrasjet e Armenëve të mbeteshin pa pasoja ligjore. Në Armeninë Ruse, teksa regjimi carist bëhej më i ashpër dhe më autokratik, Armenët u shënjestruan për shpirtin e tyre demokratik dhe të kulturuar. Në vitet 1880 dhe 1890 u mbyllën shkollat, dhe nga një dekret i vitit 1903 gjenerali-gubernator (një aristokrat me horizont të ngushtë dhe fanatik) deklaroi se Kisha Armene dhe përmbajtja e saj ishin pjesë e shtetit Rus. Kleri rezistoi. Ushtarët pushtuan Eçmiaxinin, duke kthyer edhe borgjezët Armenë në revolucionarë. Politika anti-Armene u shfaq në revolucionin e vitit 1905, ku Armenët vuajtën sulmet e qeverisë në Karabak, Nahiçevan dhe në fushat e naftës në Baku. Por ata organizuan një rezistencë të besueshme. Në fund të fundit, në Rusi ata nuk mund të klasifikoheshin si “Armenë të përvuajtur”. Ishte vetëm në vitin 1912, që autoritetet Ruse u zbutën, dhe ndaluan së persekutuari Armenët, me idenë se mund të kishin nevojë për mbështetjen e tyre në një fushatë të propozuar ushtarake cariste në Persinë Veri-Perëndimore.

### Gjenocidi i viteve 1915 – 1923

Në Turqinë Otomane, sundimi i Sulltanit të vjetër zgjati deri në vitin 1908, kur u shemb nga Revolucioni i Turqve të Rinj. Me anë të një lëvizje, që kishte në krye oficerë të ushtrisë, u rivendos Kushtetuta Otomane e vitit 1876. Ndërmjet të mërguarve, që kishin kontribuar për rrëzimin e Sulltanit, Armenët kishin luajtur një rol të rëndësishëm në bashkimin e grupeve të ndryshme drejt këtij qëllimi. Për rreth gjashtë muaj pas Revolucionit, në Perandori mbretëroi një paqe dhe vëllazëri e vërtetë, si edhe një ndjenjë optimizmi për të ardhmen. Por pas kësaj periudhe gjërat filluan të përkeqësohen. Turqit e rinj mbetën në hije, duke komplotuar dhe planifikuar, dhe duke refuzuar të bëheshin pjesë e një qeverie transparente demokratike. Në prill të vitit 1909 shpërtheu një kundërrevolucion me synim rikthimin në fron të Sulltanit. “Ne duam Sharian (ligjin Islamik)” – kjo ishte parulla e demonstruesve

kundërrevolucionarë. Ata u shpartalluan nga forcat besnike ndaj Turqve të Rinj. Njëkohësisht, në Adana, qytet në Cilicia, shpërtheu një masakër e madhe, në të cilën u vranë më shumë se 30 000 Armenë. Kush e organizoi dhe bëri masakrën, akoma nuk është plotësisht e qartë; ishin dy masakra, dhe dukej sikur e dyta ishte bërë nga ushtarët e grupit të Turqve të Rinj, të cilët po përpiqeshin të rivendosnin kontrollin mbi qytet.

Në vitet në vijim, Partia e Turqve të Rinj (Komiteti për Bashkim dhe Përparim) mori një orientim të theksuar shovinist të djathtë në rrafshin ideologjik politik. Dukej sikur Turqit, deri më tani grupi etnolinguistik dominant në Perandori, ndihej i kërcënuar nga zhvillimi i demokracisë që pati sjellë revolucionin. Fuqia e tyre si perandori tashmë ishte vënë në pikëpyetje; kjo ndodhte për herë të parë që prej vitit 1453. Ata po kërkonin një alternativë të re politike, duke u përqëndruar në idenë raciste jofetare mbarë-Turke (pan-Turke) të turqishtfolësve. Kjo ideologji i kishte rrënjët në të kaluarën e largët të kohës së Atilës, Xhinxhis Kanit dhe Timurlengut. Vatër mbështetëse e kësaj ideologjie do të shërbenin Turqit e Azisë Qendrore deri në Jakuti. Implikimi i Armenëve në këtë teori do të ishte me pasoja fatale. Ata ndodheshin në mes të rrugës që synonte ekspansionin Turk drejt Lindjes. Dhe në të vërtetë, zbatimi i këtij plani të ndarë në dy faza synonte fillimisht një presion të madh mbi popullsinë e Anadollit dhe turqizimin e tyre dhe pastaj një zgjerim të vogël drejt Lindjes në drejtim të qytetit Baku, me dalje në detin Kaspik.

Ideja e zgjerimit drejt Lindjes do të shërbente si ngritje e moralit për humbjet e pësuar në Europë gjatë vitit 1912. Pothuajse i gjithë pushteti Otoman në pjesën Europiane të Turqisë kishte rënë dhe Ballkani kishte tashmë shtetet e veta jashtë sundimit Turk. Si shprehje në vazhdimësi e besnikërisë së disa armenëve në Revolucionin Otoman, ata ishin rregjistruar në numër të madh në ushtrinë Otomane të Ballkanit. Në Nëntor 1912, ambasadori Britanik në Stamboll vinte në dukje se “disa mijëra trupa Armene kanë luftuar më mirë se sa ndonjë tjetër element jo-Turk”, koment ky, që rrëzon poshtë pretendimet e mëvonshme Turke se Armenët Otomanë ishin zhytur në tradhëti.

Gjatë vitit 1914 Turqia Otomane ishte në dorë të një fraksioni të krahut të ashpër të Partisë për Bashkim dhe Përparim. Udhëheqësi i saj, Enver Pasha, ishte i vendosur për zgjerimin Turk drejt Lindjes dhe admironte përdorimin e metodave të forcës dhe të armëve që përdorte Gjermania. Me gjithë disa lëvizje politike në prag të luftës, vetëm pak vëzhgues besonin se Turqia nuk do t'i bashkohej Gjermanisë në luftë. Në gusht 1914, një marrëveshje sekrete ndërmjet këtyre të dyjave, qartësonte se Gjermania do të lehtësonte kalimin e Turqve drejt Lindjes në Rusinë Transkaukaziane, në tokat që konsideroheshin me etnicitet Turk. Me fjalë të tjera, ata do të ndihmonin Turqit të impononin Turqizimin në provincën Ruse, dhe të shtypnin dhe të asgjësonin Armenët.

Në prag të Luftës së Parë Botërore, Armenët në pjesën më të madhe të tyre deklaruan se do të ishin besnikë ndaj perandorive të tyre, ndonëse një numër i madh Armenësh u larguan nga Perandoria Turke për në Tbilis të Gjeorgjisë për t'ju bashkuar regjimentit të vullnetarëve. Në të njëjtën kohë agjentët Turq u bënë thirrje Turqishfolësve të Transkaukasisë të bashkoheshin në masë me Otomanet. Turqit, me vetbesim, sulmuan njëkohësisht në shumë fronte. Ata pësuan një humbje të thellë në Sarikamish (fundi i vitit 1914 dhe fillimi i vitit 1915), kur pothuajse një ushtri e tërë Turke vdiq nga të ftohtit në një fushatë pan-Turke me synimin për t'u bashkuar me Azinë Qendrore. Ata, gjithashtu, dështuan në Iranin veri-perëndimor dhe në kalimin e kanalit të Suezit, ndonëse arritën t'i bllokojnë aleatët (bëhet fjalë për forcat Anglo – Franceze) në Dardanele. Në Mars 1915 ushtarët Armenë të ushtrisë Otomane u çarmatosën dhe u grupuan në batalione pune, ku ishin të detyruar të kryenin punë të rënda, që çuan në vdekjen në masë të tyre. Dukej sikur kjo bëhej me qëllim që të justifikoheshin humbjet e ushtrisë Otomane. Në Van, në zemrën e Armenisë Turke, guvernatori Otoman ndërmori një vrasje në masë ndërmjet Armenëve të fshatrave përreth qytetit, duke synuar të provokonte një revoltë masive të Armenëve që banonin në qytetin Van. Armenët organizuan mbrojtjen, por pa shkaktuar revoltë, ndonëse më vonë qeveria Otomane e akuzoi komunitetin Armen të qytetit për rebelim. Në 24 Prill 1915,

pothuajse të gjithë udhëheqësit e komunitetit Armen të Stambollit u arrestuan, u dërguan në brendësi të Anadollit, ku edhe u vranë.

Ajo çfarë ndodhi më pas, për afër katër muaj në vazhdim, ishte gjenocidi i popullit Armen. Prej pothuajse të gjitha zonave të populluara prej Armenëve, nëpër të gjithë Anadollin dhe në zonat që ishin larg prej frontit të luftimeve, Armenët, pa dallim seksi e moshe, burra, gra e fëmijë, u identifikuan, u nxorrën jashtë vendbanimeve të tyre dhe u detyruan të udhëtojnë pa bukë e ujë nëpër rrugë të përzgjedhura që më parë prej autoriteteve Turke deri sa rrëzoheshin të vdekur në tokë. Disa prej tyre u vranë pa filluar mirë udhëtimi, posa që kishin dalë jashtë zonave të tyre të banimit. Përfaqësuesit e Fuqive Europiane Neutrale në luftë nuk u lejuan të ndihmonin me ushqime ose ujë karvanet e të deportuarve të cflitur, që po vdisnin nga lodhja dhe të paushqyerit, gjë që tregonte se autoritetet vendase kishin si qëllim më tepër t'i vrisnin se sa t'i shpërngulnin ata. Të mbijetuarit e marshimit të vdekjes u mblodhën së bashku nëpër kampe përqëndrimi në shkretëtirë, në ajër të hapur, deri sa vdiqën nga kushtet e këqija dhe uria. Ky ishte një akt i pashembullt vrasjeje në masë me paramendim nga qeveria. Një panoramë e qartë e këtyre bëmave të llahtarshme të masakrës vjen nga konsujt Amerikanë, veçanërisht nga njeri prej tyre, Lesli Davis, nga Karputi (Elazigu i sotëm), i cili asokohe ishte i mirënjohur për dashamirësinë ndaj Turqve. Gjatë udhëtimeve të tij me kalë përreth zonës së konsullatës në muajt e verës të vitit 1915, atij i ra në sy sasia e madhe e të vdekurve; me qindra, madje me mijëra trupa të Armenëve të vdekur të hedhur grumbull nëpër prroska dhe në liqenet aty pranë. Individë Armenë, të cilët i kishin shpëtuar kapjes së parë, u kapën më pas duke i cilësuar “dezertorë”, dhe u trajtuan në të njëjtën mënyrë. Të dhëna nga burime Gjermane dhe Turke të çojnë në përfundimin se e gjithë kjo ishte një gjenocid i planifikuar. Madje edhe Armenët që flisnin vetëm Turqisht, siç ishin Armenët Katolikë të asimiluar të Azisë Qendrore, në vitet në vazhdim u morën nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan në shkretëtirë ku edhe vdiqën.

Bashkë me Armenët vdiqën edhe shumë vendas jo-Armenë,

veçanërisht Kurdë. Turqit u justifikuan duke ja veshur këto vdekje Armenëve. Në fakt, Kurdët, si edhe shumë të tjerë, vdiqën si rezultat i epidemive të shkaktuara nga numri i madh i trupave Armene të vdekur, të padjegur e të lënë në mëshirë të natyrës, si rezultat i gjenocidit ndaj tyre nga ana e qeverisë Otomane. Shumë prej tyre vdiqën nga uria për shkak të zisë së bukës që pllakosi vendin, pasi prodhuesit e grurit, fshatarët Armenë, ishin larguar nga fshatrat e tyre dhe ishin eliminuar. Qëllimi dhe politika e ndjekur ishin të dukshëm në operacionin e ekzekutimit të vrasjes masive të Armenëve. Të tjerët vdiqën në vitin 1915 po prej të njëjtit fat të keq. Fati i tyre ishte i lidhur me organet e shtetit: burgjet, policinë si edhe guvernatorët lokalë. Autoritetet turke madje krijuan një “Organizatë Speciale”, e cila në Anadollin Qendror përbëhej nga kriminelë ordinerë, detyra e të cilëve ishte të kryenin punët e pista si, vrasjet dhe plaçkitjet. Tentativat e propagandistëve Turq për ta paraqitur atë që ndodhi në vitin 1915 si “luftë civile” ndërmjet Turqve dhe Armenëve janë absurde, pasi nga njera anë qëndronte një qeveri që zotëronte një polici, ushtri dhe shumë agjentë të saj, pra të gjitha mjetet që i duhen një shteti për të vepruar, dhe nga ana tjetër ishin Armenët, që nuk kishin asgjë prej këtyre, me përjashtim të disa pushkëve të vjetra. Otomanët e kuptuan që politika e tyre anti-Armene shkoi përtej asaj që ishte e kuptueshme në një situatë lufte dhe që aktet e tyre përbënin një krim të rëndë (një pikë kjo, që ishte fiksuar në deklaratën e Fuqive Aleate të muajit Maj të vitit 1915, duke e cilësuar atë si një krim kundër njerëzimit, të pranuar më vonë edhe prej Gjykatës Otomane, dhe që kërcënonte me ndjekje, kapje dhe ndëshkim individual të gjithë ata që planifikonin dhe organizonin vrasje dhe vdekje masive), pasi urdhërat për deportimin shpesh ishin hartuar në një mënyrë të dyfishtë: urdhërat e para do të ishin zyrtare dhe ishin më të buta dhe më të kufizuara në veprime, por fshehurazi, krahas tyre shkonin edhe urdhërat e dytë, të cilët ishin të ashpër dhe nuk pranonin mosbindje.

Vdiq një numër i madh Armenësh. Duke folur në Dhomën e Lordëve në Tetor 1915, Lordi Brus paraqiti një shifër prej 800 000 të vdekur. Shumë të tjerë vdiqën në vitet në vijim, dhe së fundmi ishin

vdekjet që solli invazioni Otoman në Transkaukazi në vitin 1918. Sulmi Qemalist në Cilicia solli akoma vdekje të tjera. Normalisht pranohet që numri i viktimave të gjenocidit Armen shkon rreth 1,5 milion njerëz, dhe konsiderohet një vlerësim i arësyeshem.

## Republika e Parë

Me shembjen e perandorisë Ruse (dhe ushtrisë Ruse) në vitin 1917, fillimisht Transkaukazia dhe më pas Armenia fituan pavarësinë. Armenia u bë shtet i pavarur në Maj 1918. Ndërkohë vazhdonte mësymja Turke, përparimi i së cilës ishte bllokuar në zemër të Armenisë, pranë Jerevanit dhe Eçmiaxinit, në sajë të një akti masiv trimërie të paparë me qëllim mbrojtjen e vendit, në të cilin mori pjesë i gjithë populli Armen; ngjarjet e asaj kohe njihen zakonisht si beteja e Sardarapatit. Ushtria Turke vazhdoi rrugën me qëllim që të arrinte qytetin Baku dhe të vriste pothuajse të gjithë Armenët që ndodheshin atje; por lufta kishte mbaruar dhe në Transkaukazi ishin shfaqur oficerët Britanikë. Ata ishin vendosur atje me qëllim që të krijonin idenë e stabilitetit, por në realitet ata anuan më tepër nga ana e popullsisë Transkaukaziane muslimane (Tatarëve, të cilët më vonë u quajtën “Azerë”), dhe i mbështetën Armenët vetëm sa për të thënë, pavarësisht afërsisë së Azerëve me Itihadistët Turq dhe pavarësisht ndihmës konkrete, që Armenët u kishin dhënë Aleatëve për gjatë disa muajve kritikë në vitin 1917, pas rënies së Rusisë. Britanikët refuzuan t’ua dorëzonin Nagorno – Karabakun Armenëve, ndonëse 90% e popullsisë ishte Armene dhe këta të fundit kishin kërkuar disa herë që toka e tyre të konsiderohej pjesë e Armenisë. Oficerët Britanikë preferuan që të mbanin një feudal të madh tokash me origjinë Azere në krye të vendit: “një prej miqve tanë tradicionalë” siç shpreheshin ata; njëjloj siç ishte një “landlord” (feudal) në Skoci apo Irlandë; kjo ishte edhe një nga arësytet, që lidhjet e tij me vrasjet makabre të kryera në Perandorinë Otomane u anashkaluan.

Kushtet në Armeni, për shkak të luftës dhe mungesave të jashtëzakonshme në ushqime, ishin të mjerueshme; vendit i duhej gjithashtu të kujdesej për një ushtri të tërë refugjatësh, që kishin

ardhur nga përtej kufirit. Armenia u mbajt gjallë në sajë të ndihmave (lëmoshave) humanitare. Shumica e Aleatëve kishin bërë deklarata të bujshme dhe kishin shpërndarë fletushka, ku tregonin vuajtjet e tyre, por të gjitha këto rezultuan të ishin veçse një fluskë sapuni, duke provuar hipokrizinë e tyre. Këtu është rasti të thuhet qe, ndoshta, Llojd Xhorxhi ishte ofenduesi më i madh: duke përdorur elokuencë të madhe në favor të Armenëve kur ja donte rasti, ai mbante qëndrim shumë negativ ndaj Armenëve në dhomat e komiteteve ku luhej politika. Në kontrast me ta, Amerikanët jo-politikë u treguan fisnikë të pamasë, duke dhuruar fonde, të cilat bënë të mundur mbijetesën Armene.

Gradualisht, gjatë vitit 1919, Armenisë filluan t'i bashkëngjiten territoret e saj, dhe vendi filloi të funksionojë si shtet. Por Fuqitë fituese Europiane (me Llojd Xhorxhin në krye) ishin jashtëzakonisht të ngathta në realizimin e një traktati me Turqinë. Kur ata e realizuan këtë në formën e Traktatit të Sevres të vitit 1920, situata në terren kishte ndryshuar rrënjësisht: Turqit ndërkohë ishin rigrupuar si Nacionalistë Turq ndën komandën e Mustafa Qemalit (Ataturkut) dhe traktati i propozuar nuk u pranua. Bolshevikët dhe Nacionalistët Turq ishin marrë vesh për të krijuar një aleancë informale, me qëllim që të largonin influencën e Fuqive Aleate. Presidenti Uillson (Wilson), në Traktatin e Sevres, ishte ngarkuar të përcaktonte vijën kufitare ndërmjet Armenisë dhe Turqisë, dhe ai e bëri këtë në një mënyrë të tillë, që në vija të përgjithshme ishte e pëlqyeshme, ndonëse duhet thënë, që kalimi i një pjesë të konsiderueshme të Trebizondës brenda Armenisë i kalonte parashikimet Armene. Por do të kishte qenë më e drejtë që qytetet Van, Bitlis, Mushi dhe Erzerum të ishin përfshirë brenda kufijve të Armenisë së propozuar, veçanërisht pas gjithë atyre krimeve masive të luftës, të cilave u ishte nënshtruar populli Armen. Kjo nuk u bë.

## Armenia Sovjetike

Pas luftës, Ushtria Otomane nuk u çarmatos në kohën e disfatës së vitit 1918; ajo u rigrupua dhe krijoi bazën e Ushtrisë Nacionaliste. Në

fund të vitit 1920 ajo ishte e aftë t'i impononte vullnetin e saj Armenisë. Qyteti Kars ra në 30 Tetor të vitit 1920 dhe Armenia e mbetur ishte në tehtë të asgjësimit. Komunistët i ofruan Armenëve një ndihmë shumë të dyshimtë; sidoqoftë, vendosja e pushtetit të Sovjetëve në Armeni ndaloi përparimin e trupave Turke dhe pushtimin e krejt Armenisë nga Turqia. Pas kësaj pati një revoltë antikomuniste, por pa rezultat. Në Prill 1921 në Armeni ishte vendosur përfundimisht pushteti Sovjetik. Periudha e Armenisë Sovjetike është shumë afër me periudhën në të cilën po trajtohet kjo histori (bëhet fjalë për vitin 2000), dhe si e tillë është lehtësisht e kuptueshme për bashkëkohësit. Por disa çështje duhen trajtuar. Në rradhë të parë duhet vënë në dukje ekzistenca e shtetit njëpartiak, të mbështetur nga policia sekrete, në të cilin çdo disident i mundshëm ishte i predispozuar të vritej apo të zhdukej nëpër kampet e përqendrimit. Por për ata, që arritën të qëndronin jashtë kritikës politike, ishte e mundur të mbijetonin dhe në vitet e fundit edhe të begatoheshin. Mund të dallohen rreth gjashtë momente karakteristike gjatë periudhës Sovjetike afro 70-vjeçare:

- ① vitet e para të Planit të Ri Ekonomik, u karakterizuan nga një ekonomi kapitalisto - komuniste;
- ② kolektivizimi i detyruar, që filloi më 1930 e vazhdoi më tej;
- ③ spastrimet e vitit 1936, të cilat përfshinë pa mëshirë të gjithë Transkaukazinë;
- ④ hapja në kohë të luftës ndaj Diasporës Armene (e cila sponsorizoi një regjiment tankist të quajtur Davidi i Sasunit në luftë kundër nazistëve), kohë kjo që përfshiu edhe rishugurimin e Katolikosit të Eçmiaxinit dhe që u shoqërua me humbje të mëdha jetësh njerëzore nga Armenët që morën pjesë në “luftën e madhe patriotike”;
- ⑤ paranoja Staliniste e viteve menjëherë pas vitit 1945 (pavarësisht faktit që Armenët e Diasporës u inkurajuan të imigrojnë në Armeni);

- ⑥ shkrimi Hrushoviane, e cila çoi në një hapje më të madhe ndaj Diasporës, veçanërisht në vitet 1960 – 1980, e ndjekur nga një e tatëpjetë në vitet e sterilitetit post-Brezhnevian. Tregu i madh për mallra dhe zanate, që ofronte BRSS (Bashkimi i Republikave Socialiste Sovjetike) nënkuptonte, që me pak imagjinatë dhe fantazi, dhe kur politikatat të ishin çliruar nga paranojat, në Armeninë Sovjetike do të mund të realizohej një standart i arësyeshem jetese.

Lëvizja për kthimin e Nagorno – Karabakut (i cili në vitin 1987 përbëhej nga një shumicë prej 75% banorë Armenë), në fund të vitit 1987 dhe gjatë vitit 1988, kishte fituar një mbështetje masive në të gjithë Armeninë. Udhëheqësit Sovjetike Armenë u pozicionuan pozitivisht për çështjen e kalimit të krahinës nga Azerbaixhani në Armeni, dhe qëndrimi i tyre u shoqërua me një fushatë masive popullore. Lëvizja nuk u sajua nga hiçi. Fati i komunitetit Armen, që përbënte maxhorancën absolute në Karabak, tashmë ishte gjë e njohur. Banorët e “Krahinës Autonome” i kishin bërë Autoriteteve Sovjetike disa peticione për ndryshimin e statusit: në vitin 1963, 1965, 1966 dhe 1977. Në Armeni, vendosmëria e Gorbaçovit për të kritikuar metodat e Partisë Komuniste lokale në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme, siç ishte p.sh. çështja e ndotjes së ambientit, pasi vendi prodhonte shumë ndotje nga mbeturinat industriale, ishte gjithashtu një nga elementet që çoi në shpërfilljen e kësaj partie. Një demonstratë me kërkesa ambientaliste e zhvilluar në Erevan në vitin 1987 u shndrrua në kërkesë për kthimin nën sovranitetin Armen të territoreve në diskutim.

Më pas iniciativën e mori në dorë vetë populli i Nagorno – Karabakut. Në Shkurt 1988 filluan demonstratat, dhe Këshilli lokal i Stepanakertit (kryeqytet i Nagorno - Karabakut) nxorri një vendim, sipas të cilit pushonte së njohuri sovranitetin e Azerbaixhanit mbi Nagorno – Karabakun dhe vendoste të bashkohej me Armeninë. Moska e refuzoi këtë vendim. Vetë Armenia u shndrrua në një skenë demonstratash masive pa dhunë. Dhuna filloi kur Armenët e qytetit

Sumgait, në Azerbaixhan, u bënë subjekt i vrasjeve masive në ditët e fundit të muajit Shkurt 1988. Vdiqën disa qindra vetë. Paraqitja zyrtare e Azerbaixhanit Sovjetik për gjoja vetëm 32 vetë të vdekur ishte vetëm një mashtrim. Mesazhi ishte i qartë: Armenët duhej të ndalonin me kërkesat e tyre, ndryshe do të vriteshin. Si në Armeni ashtu edhe në Karabak, grevat dhe demonstratat vazhduan për pothuajse gjithë vitin 1988. Situata u shoqërua me largime etnike masive: Azerbaixhanasit etnikë shpërngulehin nga Armenia dhe Armenët etnikë u dëbuan nga Azerbaixhani. Në muajt në vijim, Sovjeti Suprem në Moskë ripërsëriti se Nagorno – Karabaku nuk mund të ndryshonte status. Pavarësisht thirrjeve të Gorbaçovit për hapje dhe ristrukturim, ishte e qartë se çdo ndryshim kufijsh, qoftë edhe për hir të ndreqjes së ndonjë gabimi Stalinist, ishte i pamundur. Nagorno – Karabaku e riemëroi veten Artsak – emri me të cilin ai njihej në periudhën e mesjetës feudale. Violenca Azere u intensifikua edhe më shumë pas dënimit që i dha gjykata njerit prej vrasësve të Sumgait (18 Nëntor 1988).

Në 7 Dhjetor 1988, Armeninë e goditi një tërmet shumë i fuqishëm me epiqendër në Leninakan (sot Gumri). Vdiqën 25 000 vetë dhe mbi 400 000 banorë mbetën pa strehë. Armenia u bë qendër e simpatisë botërore dhe u ndërmor një operacion i heshtur e i fuqishëm humanitar, në kontrast me paaftësinë e treguar në këtë rast nga autoritetet Sovjetike. Ishin po këto autoritete, që duke përfutur nga situata e krijuar në Armeni, burgosën intelektualët Armenë të Komitetit të Karabakut, të cilët kishin kërkuar ndryshimin e statusit të krahinës.

Nga Janari deri në Nëntor 1989, Karabaku u qeveris direkt nga Moska, dhe krahina provoi një periudhë qetësie. Kthimi i tij Azerbaixhanit, solli një rilindje të militantizmit Azerbaixhanas, dhe krijimin e një bllokade Turko – Azerbaixhanase përreth Armenisë dhe Karabakut (bllokadë që vazhdon edhe sot e kësaj dite). Vëmendja u përqëndrua në goditjen e Armenëve të mbetur në Baku (Janar 1990), disa prej të cilëve u ndoqën me dhunë përgjatë gjithë rrugës nga Bakuja për në aeroport. Trazirat çuan në ndërhyrjen e tankeve sovjetike të keqorganizuar.

## Republika e Tretë

Në mes të vitit 1990 komunistët u mundën dhe u dëbuan nga Armenia. Në ato momente, vendit ju desh të përballej me aksin Moskë-Baku, e cila kishte synim të sulmonte kufijtë e Armenisë dhe të pastronte Armenët etnikë nga Karabaku dhe Shahumianovski (një krahinë e banuar nga Armenët në veri të Karabak – Shahumian). Afro 20 000 Armenë u bënë refugjatë. Armenia u bë e pavarur më 1991, dhe BRSS pushoi së ekzistuari në Dhjetor të po atij viti, duke u zëvendësuar nga Bashkësia e Vendeve të Pavarura (BVP). Konditat ekonomike u përkeqësuan me shpejtësi dhe tre dimrat në vazhdim u karakterizuan nga mungesa e lëndës djegëse në kushtet e temperaturave nën zero. Në kondita dëshpërimi, për të gjetur mundësi ngrohjeje, banorët filluan të presin pemët. Vetëm me rivënien në punë të Centralit bërthamor të Metsamorit në vitin 1994 – 1995, Armenia filloi të ketë energjinë e nevojshme për periudhën e dimrit.

Në Janar, Armenia u bashkua me OSBE dhe në mars 1992 u bë anëtare e Kombeve të Bashkuara, duke ju bashkëngjitur kështu bashkësisë botërore të vendeve sovrane.

Ndërkohë, ndërmjet Armenisë, Nagorno – Karabakut dhe Azerbaixhanit lufta vazhdoi për gjatë gjithë vitit 1992 dhe në fillimet e 1993. Armenët e Karabakut kapën qytetin Shushi dhe krahinën - korridor të Lakinit, që lidhte Armeninë me Karabakun. Në Prill – Maj të vitit 1993 ushtria Azerbaixhanase u shemb si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe regjimi i Baku-së u shndërrua në një rregjim që udhëhiqej nga dy bashkëkryetarë, Surat Huseinov dhe Hajdar Aliev. Armenët përfituan nga situata e favorshme dhe morën në zotërim Karabakun dhe krahina të konsiderueshme, që ndodheshin përtej ish krahinës autonome.

Një armëpushim i dytë, i arritur në 1994, vazhdon të qëndrojë në fuqi akoma edhe sot. Bisedimet për të ardhmen politike të krahinës, deri më sot, kanë rezultuar të pafrutshme, pavarësisht ndërhyrjes aktive të OSBE. Politikisht, Armenia kishte qenë mbizotëruar nga Komiteti i Karabakut, i cili u shndërrua në një Lëvizje Kombëtare Mbarë Armene,

me udhëheqës, për dy mandate, politikanin e karrierës Levon Ter-Petrosian; por akuzat dhe zhurma për mashtrim elektoral në rastin e mandatit të dytë u bënë të forta. Situata u tensionua.

Në mars 1997, presidenti emëroi Robert Koçarianin, President i zgjedhur i Nagorno – Karabakut, si kryeministër të Armenisë. Koçariani ishte një fanatik i vendosur i ndarjes së Karabakut nga Azerbaixhani. Në Shkurt 1998, Levon Ter-Petrosiani u detyrua të jepte dorëheqjen si President, dhe në muajt në vazhdim në vend të tij u vendos Koçariani.

Në Tetor 1999, ndërkohë që vazhdonin punimet e sesionit parlamentar, në ndërtesën e Parlamentit hyri një grup i armatosur i përbërë nga pesë vetë, të udhëhequr nga Nairi Unanian, dhe sulmoi kryesinë. Gjatë këtij sulmi mbetën të vrarë kryeministri Vazgen Sarkisian dhe kryetari i Parlamentit Karen Demirçian së bashku me gjashtë zyrtarë të tjerë. Sulmi ishte një gjë shumë e rëndë për shoqërinë politike Armene, dhe u desh të kalonte një kohë e gjatë, që populli Armen të kuptonte ç’kishte ndodhur dhe përse.

Ndër çështjet e brendshme, që e shqetësonin Armeninë, më tepër se gjithçka ishte emigracioni. Duke filluar nga viti 1991, pothuajse 30% e popullsisë kishte emigruar. (ky problem i rëndë ka prekur të gjitha Republikat e Transkaukazisë, dhe shumicën e vendeve post-sovjetike). Shumë Armenë u larguan edhe nga vetë Rusia dhe ndoshta disa prej tyre mund të jenë kthyer më vonë; por një grup i madh është larguar për në SHBA ose Kanada, dhe si zor që të kthehen ndonjëherë. Çështja bëhet akoma më serioze për krahinat me popullsi fshatare, dhe kjo tregon rëndësinë e ringjalljes së ekonomisë duke gjetur rrugë për të shmangur bllokadat dhe ritrajtimin e Armenisë, duke nxjerrë në dukje traditat më të mira të saj, si vend të krenarisë dhe të një kulture të lashtë e të qëndrueshme, në mënyrë të tillë që shoqëria civile e vendit të mund të nxirrte në pah atë, që Armenia realizoi faktikisht në dy apo tre dekadat e rregjimit Sovjetik.

- Nga viti 2001 e në vazhdim kronologjia e ngjarjeve të rëndësishme në jetën Armene është si më poshtë:

- Në Shtator 2001, Armenia festoi 1700 vjetorin e pranimit të Krishterimit si fe zyrtare. Në Jerevan u shenjtërua Katedralja e Shën Gregorit të Përndritur, Kisha më e madhe Armene në botë.
- Në Janar 2001 Armenia u bë anëtare e Këshillit të Europës (KE) dhe në vitin 2003 – anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT).
- Në vitin 2001, Fondacioni Linsi, nën udhëheqjen e miliardërit filantrop Armen, Kirk Krikorian, filloi një numër të madh projektesh zhvillimi në Armeni.
- Brenda 10 viteve, Fondacioni realizoi projekte ndërtimi dhe rinovimi rrugësh, objektesh kulturore, historike dhe shoqërore me vlerë rreth 500 milion dollarë US.
- Në raundin e dytë të zgjedhjeve elektorale të vitit 2003, Robert Koçarian u bë president dhe po atë vit asnjë parti politike nuk mori shumicën absolute të vendeve në parlament. U formua një koalicion politik dhe si rezultat një qeveri koalicioni. Po kjo gjë, u përsërit edhe gjatë vitit 2007.
- Gjatë dekadës së parë të shekullit të 21të situata financiare e Armenisë pati një rritje pozitive. Ndërmjet viteve 2001 – 2008 eksportet u rritën rreth shtatë herë, por gjatë vitit 2008, si rezultat i reçesionit në Perëndim, Armenia rregjistroi një rënie me 18%.
- Në Qershor 2004, Unioni Europian e përfshiu Armeninë në programin e saj të Iniciativës Lindore ”të Politikës së Fqinjësisë Europiane”, e cila logjikisht duhej të përmbyllej gjatë vitit 2013, duke kulmuar me firmosjen e një marrëveshjeje bashkimi me EU.
- Duke filluar nga viti 2006, Armenia është përfshirë në programin e qeverisë Amerikane “Sfida e Mijëvjeçarit”, në bazë të së cilës, në ekonominë Armene u injektuan 18 milion dollarë US.
- Në Mars 2007 u inagurua gazsjellësi Iran – Armeni, i cili ishte një alternativë ndaj importit të gazit nga Federata Ruse.

- Në vitin 2007, në themel të Iniciativës së Madridit për zgjidhjen e konfliktit të Karabakut ishin vendosur tre pika kyçe të normave ndërkombëtare: e drejta e vetëvendosjes së popujve, integriteti territorial dhe përjashtimi i forcës ushtarake. Duke filluar nga viti 2009 janë në qarkullim disa versione të rishikuara të kësaj iniciative. Si rezultat i takimit të muajit Korrik të Grupit të Tetë Superfuqive, tre presidentët e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSBE - krijuar në 1992), SHBA, Federata Ruse dhe Franca, shpallën propozimin e tyre unanim në lidhje me çështjen e Karabakut, e cila e risolli në skenë këtë çështje.
- Në Shkurt 2008 u zhvilluan zgjedhjet e pesta presidenciale, të cilat nxorrën në krye Serzh Sarkisian.
- Në vitin 2008, Armenia filloi me Turqinë “Diplomacinë e Futbollit”, që pati si rezultat vizitën e Presidentit të Turqisë për herë të parë në Armeni. Në Tetor të 2010 u nënshkrua një protokoll në Zyrin ndërmjet Armenisë dhe Turqisë, i cili synonte të normalizonte marrëdhëniet ndërmjet këtyre dy vendeve dhe të largonte pengesat kufitare: ky protokoll akoma edhe sot nuk është ratifikuar për shkak të parakushteve që propozoi Turqia.
- Gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2012, partia fituese përsëri mori shumicën absolute dhe formoi qeverinë. Në zgjedhjet presidenciale të vitit 2013 u rizgjedh presidenti në fuqi, Serzh Sarkisian.
- Dekada e parë e shekullit të ri e pa trashëgiminë kulturore Armene të vendosur në vendin e saj krahas kombeve të tjerë të kulturuar të botës. UNESCO aprovoi një rezolutë sipas së cilës instrumenti muzikor Armen, Duduku, si edhe Gurët-Kryq Armenë (Kaçkars) dhe poema epike kombëtare “Davidi i Sasunit” u konsideruan si pjesë e pandashme e trashëgimisë kulturore njerëzore dhe UNESCO e shpalli Erevanin - Kryeqyteti Botëror i Librit për vitin 2012.

- Si rezultat i gërmimeve arkeologjike në krahinën e Arenit, u zbulua një fustan i shkurtër 5900 vjeçar, një këpucë 5000 vjeçare dhe kantina e verës më e vjetër në botë.

Shënim shtesë i përpunuesit të këtij materiali:

- a) Nga data 9 Prill 2018 President i Armenisë është Armen Sarkissian i zgjedhur nga Parlamenti.
- b) Në zgjedhjet parlamentare të Dhjetorit 2018 shumicën e vendeve e fitoi Blloku “My Step” i udhëhequr nga Partia “Civil Contract” e drejtuar nga Nikol Pashinyan, sot Kryeministër.

x

x x

Në politikën e jashtme, përveç çështjes së Karabakut, çështja më e nxehtë Armene ka qenë fushata për t'i bërë të njohur botës se vrasjet masive të organizuara të Armenëve gjatë vitit 1915 nga ana e Perandorisë Otomane, përbënin një Gjenocid. Raportet bashkëkohore të paanshme të ambasadorëve dhe konsujve Gjermanë si dhe zyrtarëve të tjerë, siç ishte Ambasadori i SHBA, Henry Morgental (Henry Morgenthau) dhe konsulli i SHBA, Lesli A. Davis, si edhe diplomatë dhe zyrtarë të tjerë të huaj, konfirmojnë përfshirjen e plotë të autoriteteve Otomane në skemën e vdekjes masive të Armenëve në Turqi. Këtë gjë e dëshmojnë edhe një sasi e konsiderueshme të dhënash të brendshme nga vetë burimet Otomane. Armenët vuajtën si rezultat i një Gjenocidi të paramenduar, dhe jo për shkak të masakrave rastësore fatkeqe. Opinioni publik vazhdon të jetë i lëkundur në pranimin e këtij fakti, ndoshta i shtyrë edhe nga interesi vetiak për të mos fyer Turqinë (madje edhe vetë shteti Turk aktual nuk ndihet akoma përgjegjës për

ngjarjet e asaj periudhe). Rishkrimi i historisë nga departamentet qeveritare, të cilët njohin vetëm pak fakte, është një aspekt akoma më qesharak i kësaj çështjeje. Por për mbi dy dekadat e fundit në këtë drejtim është bërë përparim i dukshëm nga pala Armene, nga shtete të veçantë si edhe nga Parlamenti Europian. Çdo njeri i vëmendshëm shpreson se kuptimi i natyrës së vërtetë të ngjarjeve, që ndodhën në vitin 1915 në vendet që tani përbëjnë Turqinë, do të fitojë gjithnjë e më tepër mbështetje, ndonëse kapaciteti i qënieve humane për të pranuar marrëzinë si mënçuri, të pavërtetën për të vërtetë, është çuditërisht shumë i madh.



# ARMENIA

Njerëzit dhe vendi


Përshtatur në shqip nga libri me të njëjtin titull  
i shkrimtares Susan Solomon  
Botim i vitit 2010

Hyrje.....	61
Të dhëna kryesore.....	63
<b>VENDI DHE NJERËZIT</b> .....	65
Vendndodhja.....	65
Gjeografia.....	66
Klima.....	68
Popullsia.....	69
Një historik i shkurtër.....	71
Qeveria dhe Politika.....	85
<b>VLERAT DHE MENTALITETI</b> .....	87
Familja.....	88
Edukimi.....	89
Armenët dhe tradita.....	90
Qëndrimi ndaj grave.....	90
Qëndrimi ndaj Homoseksualitetit.....	93
Minoritetet Etnike.....	93
Rëndësia e Fesë.....	94
Pasuria dhe Paraja.....	95
Influenca Ruse në shoqërinë Armene.....	99
Karakteristika përcaktuese: Aftësia për të Mbijetuar.....	100
<b>FESTIMET DHE ZAKONET</b> .....	101
Pushimet e dimrit.....	102
Në Pranverë.....	104
Në Verë.....	107
Martesa: Festa më e madhe nga të gjitha.....	109
Mikpritja.....	111

<b>TË BËSH MIQ</b> .....	113
Miqësia .....	113
Rregullat e Mirësjelljes.....	114
Takimet e Para.....	115
Mënyra e komunikimit me miqtë.....	118
Ftesë për në Shtëpi .....	118
Takimet .....	121
<b>ARMENËT NË SHTËPI</b> .....	123
Shtëpia Armene .....	123
Struktura Familjare .....	125
Të rritesh në Armeni.....	125
Shopping-u i përditshëm .....	126
Vernisazh .....	128
Dita e punës .....	129
Të gjesh punë .....	130
Shërbimi Ushtarak.....	131
<b>KOHA E LIRË</b> .....	133
Të largohesh nga gjithçka .....	133
Mënyrë për t'u shplohur.....	134
Café' Life .....	137
Restorantet.....	138
Ushqimi Armen .....	140
Për të pirë.....	146
Eventet Kulturore.....	147
Sportet .....	151

<b>UDHËTIMI, SHËNDETI DHE SIGURIA</b> .....	153
Viza.....	154
Mbërritja në Armeni.....	155
Të vizitosh Erevanin.....	156
Destinacionet.....	161
Monedha.....	163
Ku të qëndroni.....	165
Shëndeti.....	166
Siguria.....	167
<b>PËRSHKRIM I SHKURTËR I SITUATËS EKONOMIKE</b> .....	169
Kultura e Biznesit.....	170
Takimet.....	171
Prezantimet.....	172
Negociatat.....	173
Kontratat dhe Respektimi i tyre.....	174
Dy fjalë rreth Korrupsionit.....	174
Gratë në Biznes.....	175
<b>KOMUNIKIMI</b> .....	177
Gjuha Armene.....	177
Kontakti me Njerëzit.....	178
Media.....	179
Telefoni.....	181
Interneti.....	181
Mail.....	182
Konkluzion.....	183

# HARTA E ARMENISË





## HYRJE

Në hartën e botës së sotme, shteti i Armenisë duket shumë i vogël. Ai ka afërsisht madhësinë e Shqipërisë. Pa dalje në det, rrethuar nga të gjitha anët me tokë dhe male, ai kufizohet me shtete fqinj më të mëdhenj se ai, dhe pikërisht me Turqinë, Azerbaixhanin, Gjeorgjinë dhe Iranin.

Krahasimet, megjithatë, mund të jenë zhgënjyese. Ky komb i vockël në malet e Kaukazit përvijohet shumë i madh në zemrat e Armenëve, si të atyre tre milion njerëzve që jetojnë brenda tij, ashtu edhe të atyre tetë milion të tjerëve që janë pjesë e Diasporës Armene në mbarë botën. Për popullin Armen që ka ekzistuar për pesë mijë vjet, shpeshherë pa një vend që ta quanin të tyrin, kufijtë aktualë janë thjesht vija artificiale të vizatuara nga fuqitë e mëdha të huaja në fillim të shekullit të njëzetë.

Gjeografia është shumë më pak e rëndësi shme se sa ajo çka përfaqëson të qënurit Armen – të kesh krijuar një kulturë krenare, ta kesh transmetuar atë ndër breza, dhe më e rëndësishmja, të kesh mbijetuar në rrethana tragjike ndaj goditjeve nga më të pabesueshmet.

Për udhëtarin që merr përsipër të vizitojë këtë vend, disa njohuri rreth historisë dhe kulturës së vendit do të ishin shumë të rëndësishme për të vlerësuar popullin e tij.

Armenia meriton një përshkrim të përmbledhur historik nga lashtësia deri në kohët moderne. Si rruga më e përshtatëshme për të paraqitur atë çka përfaqëson populli Armen, sidoqoftë, duhet konsideruar rruga mbi të cilën mijëra vjet luftë kanë gdhendur një

memorie kulturele që vazhdon edhe sot e kësaj dite të përkufizojë popullin Armen.

Libri përpiket të paraqesë se si kultura dhe historia e tij kanë ndikuar në shumë elemente të Armenisë moderne; nga jeta familjare, për të shkuar pastaj në rrugët plot gjallëri të Erevanit dhe në aktivitetet e ndryshme tregtare.

Nga larg Armenët duken të padepërtueshëm, por është e nevojshme të kuptosh arësyet që i bëjnë ata të duken të tillë. Shumë nga njerëzit që ju mund të takoni kanë mbijetuar ditët e vështira të fillimit 1990, kur lufta, bllokada, mungesat, dhe pasojat e tërmetit të tmershëm e çuan vendin në shkatërrim, mjerim, dhe errësirë. Ata e kanë parë dhe përjetuar këtë eksperiencë të hidhur.

Armenia e sotme, ashtu si edhe në të kaluarën, është vendi i sfidës dhe triumfit. Ende në përpjekje për të dalë nga vështirësitë ekonomike, ajo përballet me papunësinë, problemet ambientale, trazirat politike, kufijtë e mbyllur, korrupsioni, një ekonomi e pastabilizuar dhe emigracioni në rritje. Megjithatë ka shenja ndryshimi dhe një erë e re – ndërtimi, rilindja e artit, dhe qetësimi i tensioneve me fqinjët turq. Ju mund ta shihni “Armeninë e Re” nga vrojtimi i jetës së përditëshme, nga dasmat luksoze dhe festimet e tjera që zhvillohen pothuajse çdo ditë, në qëndrimin e të rinjve, të cilët janë të vendosur që të punojnë fort, të gëzojnë dhe të kontribuojnë për vendin e tyre.

Armenia përpiket të zgjerojë njohuritë tuaja për të kuptuar një popull, krenaria kulturele e të cilit, natyra mikpritëse, dhe vullneti i fortë janë të njohura përtej kufijve të atdheut të tyre. Ai do t’ju ndihmojë të shmangni keqkuptimet dhe ta kthejë vizitën tuaj në një eksperiencë të paharrueshme dhe me plot vlera.

## TË DHËNAT KRYESORE

<b>Emri Zyrtar</b>	Republika e Armenisë (Hajasdan – emri i Armenisë në gjuhën Armene)	Dita e deklarimit të Indipendencës nga Bashkimi Sovjetik konsiderohet data 21 Shtator 1991
<b>Kryeqyteti</b>	Erevan (popullsia 1 107 800 banorë)	
<b>Qytete të tjerë të mëdhenj</b>	Gymri, Vanadzor, Eçmiaxin	
<b>Sipërfaqja</b>	29 743 km <sup>2</sup> , pa dalje në det, i vendosur në malësine e Kaukazit të vogël	Afërsisht e barabartë me sipërfaqen e Shqipërisë
<b>Shtetet kufitare</b>	Turqia, Azerbaixhani, Gjeorgjia dhe Irani	Kufijtë me Turqinë dhe Azerbaixhanin aktualisht janë të mbyllur
<b>Terreni</b>	Kryesisht malor, me lumenj të rrëmbyeshëm, pak pyje	Liçeni Sevan është liçeni më i madh në zonën e Kaukazit të vogël
<b>Klima</b>	Malore kontinentale me verë të ngrohtë dhe dimër të ftohtë	Në verë, drita e diellit çfaqet në ngjyrë ari rreth orës 3.00 – 4.00 p.m.
<b>Ekonomia</b>	Agrikultura 17.2% Industria 36.4% Shërbimet 46.4%	Burimet natyrore: Depozita të vogla ari, bakri, molibdeni, zink, baokside
<b>Monedha</b>	Dram (AMD)	1 Dram = 100 luma
<b>Popullsia</b>	2 967 004 (sipas vlerësimit në vitin 2009); 64% e popullsisë banon në qytete	Rritja e popullsisë -0.03% (sipas vlerësimit në vitin 2009); Rritja negative-si rezultat i emigracionit në mbarë Diasporën Armene

<b>Jetëgjatësia</b>	72.68 vjet (mesatarisht)	
<b>Përbërja Etnike</b>	Armene (97.9%). Minoritet përfshijnë Jazidi (Kurd), Molokët(Ruse)	
<b>Gjuha</b>	Armene. Gjuha Ruse flitet gjerësisht	Sinjalizimet janë shpesh edhe në gjuhën Angleze dhe Ruse
<b>Niveli i arsimimit</b>	99.4%	
<b>Besimi Fetar</b>	Kisha Apostolike Armene është Kisha Zyrtare	“Kombi i parë Kristian në botë”
<b>Qeverisja</b>	Republike Demokratike Presidenciale	E drejta e votimit të përgjithshëm – mbi 18 vjeç. Parlamenti është me një dhomë (Azkajin Zhohov) dhe ka 131 vende. Ka 11 provinca, të quajtura ndryshe marze.
<b>Media</b>	Shitja e gazetave është e vogël; televizioni është shumë më tepër popullor	Ndërhyrja e Qeverisë në Media vazhdon të mbetet problem
<b>Elektriciteti</b>	220 V ; 50 hz	Pajisjet elektrike në Armeni janë të sistemit European: spinat janë me dy kunjat të rrumbullakët dhe prizat me dy vrima po të rrumbullakta
<b>Video/TV</b>	SECAM	
<b>Telefoni</b>	Kodi i vendit: 374 Kodi i qytetit Erevan: 10	Për të telefonuar një numër në USA, formoni 001 + kodin e vendit dhe numrin
<b>Internet Domain</b>	.am	
<b>Zona Kohore</b>	4 orë përpara me Kohen e Meridianit të Greenwich-it (GMT + 4)	Kursimi i dritës diellore (GMT + 5)

# VENDI DHE NJERËZIT

## VENDNDODHJA

Armenia ndodhet në jug të Kaukazit. Ajo ka një sipërfaqe prej 29743 km<sup>2</sup>, që përfaqëson rreth 10% të madhësisë së saj në ditët e lavdishme të Mbretërisë së lashtë të Armenisë (në vitet 190 B.C deri 387 A.C). Një reklamë për turizmin Armen paraqet shkrimin “Rruga e Noas, Rruga Juaj”, një referencë për malin Ararat me majë gjithnjë të mbuluar nga bora, i cili duket shumë qartë nga kryeqyteti Erevan.

Ky është vendi, referuar Librit biblik të Gjenezës, ku Arka e Noes qëndroi pas përmbytjes së madhe dhe rifilloi jeta. Për Armenët mali Ararat është simboli i identitetit të tyre. Pjesë e të kaluarës së tyre të lavdishme, tashmë mbetet një dëshmitar tragjik i humbjes së tyre, pasi ky mal shumë i dashur për ta aktualisht ndodhet brenda kufijve të Turqisë. Nga pikëpamja kulturore, Armenia konsiderohet as Lindje, as Perëndim. Gjuha e saj i përket një dege të pavarur të familjes Indo-Europiane – pa dallime të qarta Aziatike apo Europiane. Ajo i ka të mbyllur kufijtë me dy nga fqinjët e saj dhe ajo në mënyrë të qartë tregon për statusin e saj jo të qetë. Çdokush mund ta vërejë menjëherë që pjesa e saj jugore ndan Azerbaixhanin. Në veri të saj është një pjesë toke në formë bizeleje, e quajtur Nagorno-Karabak.

Në vitin 1990, kjo pjesë ishte një zonë lufte, ku u zhvilluan përleshje të përgjakshme dhe të gjata ndërmjet Armenisë dhe Azerbaixhanit. Në jug është Republika Autonome e Nahiçevanit, që ndonëse geografikisht

nuk është e lidhur me Azerbaixhanin, internacionalisht njihet si pjesë e tij. Sot, kjo Republikë e brishtë mbetet e izoluar nga Azerbaixhani dhe shumica e krahinave përreth.

Në perëndim dhe jug, kufiri me Turqinë është i mbyllur si pjesë e solidaritetit të Turqisë me Azerbaixhanin gjatë konfliktit në Nagorno-Karabak në periudhën 1988-1994, dhe vazhdon të mbetet i mbyllur. Armenët theksojnë se Turqia po e përdor bllokadën për të mbajtur Armeninë të izoluar nga vijat e rëndësishme të lëndës djegëse dhe të lëvizjes transit; megjithatë ka shenja se kjo situatë mund të zbutet ndonjë ditë. Në vitin 2008, Presidenti Turk Abdullah Gull, udhëtoi për në Erevan për të nxitur dëshirën e mirë dhe ndoqi një lojë shtesë të Kupës së Botës ndërmjet të dy vendeve. Në vazhdim, Turqia hapi disa korridore ajrore për linjat ajrore Armene, duke lejuar fluturime Charter ndërmjet Erevanit dhe Stambollit.

Në vitin 2009, ndërmjet Armenisë dhe Turqisë filluan bisedime serioze për një pajtim të mundshëm. Armenia mbështetet në kufijtë e saj të hapur me Iranin në jug dhe Gjeorgjinë në veri. Kufirri Armeno-Gjeorgjian është veçanërisht i rëndësishëm për tregtinë, si me Gjeorgjinë ashtu edhe me Rusinë. Gjatë konfliktit Ruso-Gjeorgjian të vitit 2008, Armenët vuajtën mungesën e atyre pak mallrave dhe shërbimeve që hynin në vendin e tyre – një tregues ky i varësisë së Armenisë nga ky kufi i hapur. Kufiri ndërmjet Iranit dhe Armenisë vazhdon të jetë i hapur si për lëvizjen e mallrave ashtu edhe për atë të njerëzve. Shumë Iranianë vijnë në Armeni: disa prej tyre studiojnë në universitete, të tjerë janë familjarë që largohen për t'ju shmangur konflikteve të mundshme që shpërthejnë herë pas here në vendlindjen e tyre.

## GJEOGRAFI

Armenia ofron një peisazh të larmishëm dhe intrigues. Në këtë vend të vogël mund të gjeni klimën e thatë subtropicale, fusha gjysëmshkretëtirë, stepa malore, pyje dhe lëndina pastorale.

Në veri të vendit shtrihet vargu i njohur si Malet e Kaukazit të Ulët,

i cili përfshin pikën më të lartë të Armenisë, Malin Ararat (4090 m. i lartë). Në kontrast me të, Lugina Ararat, në të cilën është vendosur kryeqyteti i Armenisë, Erevani, është pika më e ulët e Armenisë dhe rajoni kryesor agrikultural i tij. Këtu kulturat bujqësore gëzojnë rrezet e diellit për kohëzgjatjen më të madhe në botë (2700 orë në vit).

Në jug të Erevanit, vargu i maleve Vaik dhe Zangezur kalon nga veriu në jug, duke shënuar kufirin me Nahicëvanin. Vargu Sunik, që gjithashtu ka drejtimin veri-jug, shënon kufirin ndërmjet Armenisë dhe Azerbaixhanit. Rrafshina e lartë Armene ndërmjet qyteteve Vaik dhe Goris karakterizohet si një krahinë malore, e ashpër dhe pa pemë. Të kalosh nëpërmjet saj është e vështirë, por ja vlen të shohësh këtë vend të virgjër dhe të egër.

Jugu i largët, zona rreth Kapanit, dominohet nga mali Kustup, maja e të cilit është e mbuluar nga mjegulla për pjesën më të madhe të kohës. Në pjesën më jugore të vendit, krahina rreth qytetit Megri, pranë kufirit me Iranin, karakterizohet nga një tjetër zonë klimatike. Ajo është shumë më e ngrohët se pjesa tjetër e Armenisë, ka një klimë të ngjashme me atë të Iranit, dhe është e njohur për kultivimin e fikut dhe shegës së rrallë me ngjyrë të verdhë.

Një tjetër tipar i mrekullueshëm i ambientit natyral të zonës është liqeni Sevan, një nga liqenet alpinë më të mëdhenj në botë. Ai është i madh dhe i thellë, dhe ze 5% të të gjithë sipërfaqes së Armenisë.

Terreni i ndryshueshëm ka krijuar mundësinë për ekzistencën e një shumëllojshmërie bimësh dhe kafshësh që është gjë e rrallë për një hapësirë gjeografike kaq të vogël (disa Armenë thonë se kjo shpjegon se si Noa arriti të mblidhte kaq shumë specie pikërisht këtu përpara përmytjes së madhe). Për shembull, Armenia ka më tepër se 365 specie zogjsh, krahasuar me 400 apo 500 që ka i gjithë kontinenti Europian. Ky vend, gjithashtu, shërben si një vend migrimi për shumë kafshë dhe zogj.

Armenia është një vend akoma në formim – ajo ndodhet në një zonë sizmike shumë aktive. Tërmeti shkatërrues i 1988 është një kujtim i paqëndrueshmërisë së peizazhit të bukur që është pjesë e këtij vendi.

## KLIMA

Armenët i konsiderojnë ekstremet e klimës së tyre si shenjë tipike e paqëndrueshmërisë në jetën e tyre. Përgjatë viteve, ata provojnë gjithë kënaqësitë dhe dhimbjet e kontrasteve që paraqet klima e tyre. Oborret me diell rreth kafeneve të famshme të Erevanit, aq popullore në verë, shndërrohen në sipërfaqe akulli të pabesa, ku njerëzit mund të rrëshqasin dhe rrëzohen në dimrin e acartë.

Dimrat në Erevan janë veçanërisht sfidues. Në Janar, temperatura mund të ulet deri në -20 gradë Celcius. “Rallë mund të shohësh ndonjë molekulë të lëvizë” shprehet një vizitor për ditët e një dimri tipik. Po t’i shtosh kësaj situatë edhe faktin që trotuaret nuk janë pastruar nga bora ose nga akulli, atëherë bëhet e lehtë të kuptosh përse shkollat dhe universitetet shpesh mbyllen në fillim të Dhjetorit dhe nuk rihapen përpara muajit Shkurt.

Nga ana tjetër, në verë, zakonisht është shumë nxehtë, me temperatura që në muajin Gusht arrijnë në 40 gradë Celcius. Gjatë muajve të verës bie pak shi, dhe Erevani është shumë i thatë dhe me pluhur në Korrik dhe Gusht. Sidoqoftë, drita ngjyrë ari në të verdhë (kuqërreme) e krahinës së Kaukazit në një mbasdite vere, është një fenomen që nuk duhet lënë pa parë. Rreth orës 3.00 të pasdites, çdokush mund të hasë shkëlqimin qelibar që është veçanërisht special në këtë pjesë të botës.

Për ata që duan të jenë në dijeni të ndryshimeve klimatike të Armenisë, në majë te Teatrit të Operas në qendër të Erevanit, është vendosur një termometër dixhital i madh dhe shumë i dukshëm. Sidoqoftë, saktësia e leximit mbetet shpesh burim diskutimi. Përflitet, që ekstremet, si ato të ultat ashtu edhe ato të lartat, nuk tregohen, me qëllim që të evitohen pretendimet e popullsisë për të mos shkuar në punë.

Armenët realisht jetojnë “sezon pas sezoni”. Në dimër, ka festa në ditët e pushimeve, por pasi këto ditë kalojnë, shumë prej familjeve mbyllen në shtëpitë e tyre. Në pranverë ka vërshim aktiviteti, dhe në verë fillon periudha e grumbullimeve sociale masive. Duket sikur Armenët, gjatë dimrit, depozitojnë energjinë e tyre për aktivitetet

sociale që zhvillohen gjatë verës. Në fakt, shumë vizitorë nga Rusia dhe vendet fqinje, shpesh presin Korrikun ose Gushtin për të udhëtuar në Armeni dhe për të marrë pjesë në jetën “Cafe” të verës në Erevan. Vjeshta është stina e shirave, dhe në fund të sezonit shiu bëhet shumë i ftohtë. Në Tetor, të gjitha kafenetë fillojnë të mbyllen – shenjë e qartë kjo, që gjallërisë së sezonit veror po i vjen fundi.

## POPULLSIA

Ku e ka origjinën populli Armen? Kjo pyetje është, gjithashtu, një temë që ngjall shumë diskutime. Ka një histori biblike për Arkën e Noes. Armenët pretendojnë që janë pasardhës të Jafetit, djalit të Noes. Sipas legjendës, pasi Arka takoi në tokë, familja e Noes fillimisht u vendos në Armeni, për t’u zhvendosur më pas në jug, në Babiloni.

Studjuesi i shek. V, Khorenatsi, e përshkruan Hajkun, babain themelues të Armenisë, si një pasardhës të Jafetit, si një burrë të fuqishëm e të pashëm, me flokë të zinë e të dredhur, i cili u rebelua ndaj tiranisë Babilonase dhe udhëhoqi rikthimin në tokat e Araratit. Hajku u përndoq nga Bel, tirani i keq Babilonas, të cilin ai e vrau me një shigjetë me fat: pas kasaj ai e solli popullin e vet shëndoshë e mirë në tokat e Araratit, - ngjarje kjo që daton në vitet 2490 BC. Sot Armenët e quajnë veten e tyre “Haj” dhe vendin e tyre “Hajk ose Hajasdan” në nderim të Hajkut. Përveç legjendave dhe historive biblike, ekziston edhe një material i bollshëm fizik i kulturave të lashta në zonat malore të vendit. Shënimi më i vjetër që identifikon popullin Armen është një mbishkrim që daton rreth viteve 2300 BC që përmend një sulm të “Armani” në jug të lartësive Armene. Një tjetër mbishkrim, i Faraonit Tutmes III i Egjyptit, i referohet popullit “Ermenen” në vitin 1446 BC.

Gjatë Epokës së Bronzit lulëzuan disa shtete në atë krahinë që konsiderohet Armenia e Madhe. Këtu përfshihen Mitanni (në jugperëndim të Armenisë historike, rreth vitit 1400 BC, Hittitet (rreth vitit 1300 BC), Hayasa Azzi (1600 – 1200 BC), Nairi (1400 – 1000 BC)

dhe Mbretëria Urartu (1000 – 600 BC ). Secili prej këtyre kombeve dhe tribuve kontribuoi në formimin e popullit Armen. Erevani (atëhere i njohur si “Erebouni”) është themeluar në vitin 782 BC prej Argishtit I, Mbreti i Urartu. Shumë artefakte nga civilizimi Urartian ndodhen sot të ekspozuara në Muzeun Historik të Armenisë.

## Diaspora Armene

Diaspora Armene (ata që jetojnë jashtë vendit) është shumë më e madhe se sa popullsia që jeton brenda vendit. Influenca e tyre çfaqet në jetën e pothuajse të gjithë shtetasve Armenë që jetojnë në Armeni. Ndonëse emigracioni ka filluar shumë më herët, shekulli i XX përjetoi disa ikje massive për në vende të tjera. Eksodi i parë masiv i shekullit të XX ndodhi pas Gjenocidit të viteve 1915 – 1916. Shumë të tjerë u larguan në epokën sovjetike ose u bënë pjesë e deportimeve staliniste. Akoma më tepër u larguan në periudhën e vështirë të viteve 1990.

Marrëdhënia ndërmjet Armenëve dhe Diasporës Armene është e komplikuar. Vendi ka qenë gjithnjë i interesuar që Diaspora të mund të investonte sa më shumë në atdhe, të dërgonte vlera monetare si dhe të ndihmonte në forma të ndryshme. Nga ana tjetër diaspora i ka sytë nga Armenia për frymëzim në përpjekjet e saj për të ruajtur identitetin kultural në vendet ku ndodhet. Armenët kanë respekt dhe njëkohësisht disa rezerva ndaj tyre. Shumë prej tyre e vlerësojnë sasinë e valutës që hyn në atdhe. Të tjerët e shohin këtë pjesë të popullsisë si njerëz që nuk i kanë vuajtur kohët e vështira dhe si rezultat nuk mund ta kuptojnë realisht situatën në vend. Në fund të viteve 1990 u bënë disa përpjekje për të forcuar marrëdhëniet ndërmjet Armenisë dhe Diasporës. U organizua Aktiviteti i quajtur “Lojrat Mbarë Armene” me qëllim që të mblidhte atletët e Diasporës së bashku. U organizua Ministria e Diasporës pranë Qeverisë Armene me qëllim që të ndihmonte forcimin e marrëdhënieve dhe të përmirësonte kushtet e bashkëpunimit tregtar. Gjithashtu, në vitin 2005, Qeveria Armene hoqi ndalimin e dyshtetësisë.

## NJË HISTORIK I SHKURTËR

Të ndjekësh kursin e historisë së Armenisë është njëloj si të ndjekësh një lojë futbollit ku topi shkon herë nga njera anë e fushës, herë nga ana tjetër. Gjatë kohëve, vendi është dominuar herë nga Perëndimi, herë nga Lindja. Gjithë këto lëvizje para-prapa natyrisht që kanë lënë gjurmën e tyre në këtë vend, si edhe në kulturën e tij. Ajo që të bën përshtypje është fakti që gjithë këto influenca të jashtme sidoqoftë mbeten thjesht influenca. Gjatë gjithë kësaj periudhe Armenët arritën të ruajnë identitetin e tyre kombëtar.

### Fillimet e hershme

Tashmë kemi përmendur Hajkun, pasardhësin e Noes dhe hero, të cilit i atribuohet kthimi i popullit Armen në Atdhe. Një nga pasardhësit e Hajkut, gjashtë breza më vonë, Arami, ishte një udhëheqës ushtarak i cili i zgjeroi kufijtë e vendit të tij dhe e bëri kombin e tij të fuqishëm. Gjatë mbretërimit të tij, Grekët dhe Persianët filluan t'i referohen këtij vendi si vendi i Aramit; kështu mund të interpretohet origjina e emrit "Armenia".

Rreth vitit 600 BC u bë protektorat "një vend i zotëruar" nga Perandoria Achaemenide (Persiane) ndën Dariusin I. Gjatë disa shekujve pas kësaj, trupat Armene luftuan për Persinë në shumë beteja historike. Kavaleria Armene ishte e mirënjohur, veçanërisht gjatë mbretërimit të Vahes, një pjestar i dinastisë së fundit Hajk. Vahe u vra në vitin 331 BC ndërsa luftonte për Persinë në një betejë kundër Aleksandrit të Madh.

Pas kësaj beteje, Armenia u bë një shtet helenistik dhe me kohë do të bëhej pjesë e Perandorisë Helene të themeluar nga gjenerali i Aleksandrit, Seleucus. Rreth vitit 200 BC, mbreti Seleucid, i quajtur Antiochus, emëroi Artashes (i njohur edhe si Artaxias) si zotërues të Armenisë së madhe. Sidoqoftë, pas disfatës së Antiochus nga Romanët në betejën e Magnesias në vitin 190 BC, Artashes dhe Zareh, bashkëqeverisesi i tij në Armeninë e Vogël, u ngritën në revoltë dhe me pëlqimin e Romanëve filluan të mbretërojnë në mënyrë autonome

me titullin Mbret; Artashesi mbi Armeninë e Madhe dhe Zareh mbi Armeninë e Vogël.

Nga viti 95 deri në vitin 55 B.C, ndën mbretërimin e gjatë të Tigranit II (gjithashtu i njohur si Tigrani i Madh), Armenia ishte një vend i fuqishëm i pavarur dhe një shtet i bashkuar, që shtrihej nga “deti në det”, - nga Deti Kaspik në Detin Mesdhe.

Sidoqoftë, madhësia dhe fuqia e Armenisë nuk kaloi pa u vënë re nga Roma. Me zgjerimin në drejtim të lindjes nga ana e romakëve gjatë luftërave Mithridatike, Pompei e mundi Tigranin dhe e bëri Armeninë një protektorat roman në vitin 66 B.C. Për 100 vitet e ardhëshme, Armenia mbeti nën influencën romane. Atëhere, Persia filloi të ritregojë interes për këtë zone dhe tensionet u rritën. Për vite, Armenia u kthye në zonë luftimi ndërmjet dy perandorive, pasi secila prej tyre tentonte të vendoste sunduesit që mund t'i mbeteshin besnikë asaj. Në vitin 387 CE sipërfaqja u nda zyrtarisht në dy pjesë. Armenia perëndimore u bë provincë e perandorisë romake, Armenia lindore mbeti një mbretëri e varur nga Persia deri në vitin 428, kur u kthye në një marzpanat (zoterim plotësisht i varur) i dinastisë Sassaniane të Persisë.

## Koha e Artë

Ndërkohë, një tjetër forcë e fuqishme – Kristianizmi – ishte duke hyrë në Armeni. Ajo po e provonte veten më të qëndrueshme se romanët dhe persianët. Apostulli Thaddeus dhe Bartolomeu udhëtuan nëpër zonë dhe atyre u dedikohet fakti që Armenia përqafoi shumë herët Kristianizmin. Gjatë udhëtimeve të tyre, ata konvertuan shumë njerëz dhe krijuan shumë komunitete kristiane sekrete. Në vitin 301, Shën Gregori, Iluminatori, pagëzoi mbretin Tiridat III të Armenisë, i cili e vendosi Kristianizmin si fe zyrtare të vendit. Të gjithë tempujt pagane u shkatërruan; në ditët e sotme vetëm njeri ka mbetur, dhe ky ndodhet në fshatin Garni. Armenët e konsiderojnë kohën e konvertimit të vendit si një periudhë shumë të shenjtë. Sipas legjendës, Shën Gregori pati një vizion sikur vetë Krishti zbriti në luginën Ararat dhe e goditi

tokën me një çekan të artë për të treguar se ku duhej ndërtuar katedralja e parë, Shën Eçmiaxin. Sot, kjo është qendra zyrtare e Kishës së Shenjtë Apostolike Armene. Në ditët e hershme të Kristianizmit në Armeni, meshat këndoheshin në greqisht. Sidoqoftë, kjo nuk ishte e pranueshme për mbretin, i cili donte të zhvillonte dhe të çonte përpara gjuhën armene. Ai ia ngarkoi këtë detyrë murgut të shkolluar dhe gjenit në linguistikë Mesrob Mashtots. Murgu shpenzoi shumë vjet duke rishikuar shkrimet e vjetra Armene në përpjekje për të rikonstruktuar gjuhën dhe të zhvillonte një alfabet të veçantë. Në fund, ai jo vetëm që arriti të krijojë një gjuhë, por realizoi gjithashtu një nga përkthimet e para të Biblës në një gjuhë moderne. Përkthimi i tij biblik është konsideruar një nga më të mirët në histori.

Por koha e artë nuk zgjati shumë. Gjatë 200 viteve të ardhshme ndodhën një numër luftërash dhe përleshjesh. Gjatë luftës së Shën Vardanit në vitin 451, Mbreti Sasanid Persian, Yazdegerd i II, u përpoq ta shtypte Kristianizmin në Armeni dhe ta zëvendësonte me Zoroastrianism. Armenët u revoltuan kundër priftërinjve persianë të cilët u përpoqën të ngrinin tempuj dhe të futnin praktika të tilla siç ishte nderimi i zjarrit. Një betejë e përgjakshme u zhvillua dhe 66,000 mijë armene, përfshirë Shën Vardanin, luftuan heroikisht deri sa u mundën nga ushtria shumë më e madhe persiane. Kjo konsiderohet si lufta e parë e dokumentuar për mbrojtjen e Kristianizmit.

Në shekullin e VII, perandoria Osmane dorëzoi kontrollin mbi këto zona në duart e ushtrive pushtuese arabe. Armenia ra ndën sundimin Arab në vitin 645 dhe provoi një shkallë autonomie fetare. Si një principatë autonome brenda perandorisë arabe, princi i saj u njoh si prej Khalifit, ashtu edhe prej perandorit bizantin. Eventualisht, ndën mbretërit Bagratidë, Ashot I (862-890) dhe Ashot II (952-977), u rifitua pavarësia dhe Armenia kaloi në një kohë të dytë të artë. Për vite, mbretëria mbeti autonome duke shfrytëzuar rivalitetin që ekzistonte ndërmjet Arabëve dhe Bizantinëve.

Por as kjo periudhë e gjatë nuk mund të zgjaste përjetë. Në shekullin XI, bizantinët pushtuan nga perëndimi dhe turqit selxhukë nga lindja,

dhe mbretëria e pavarur Armene u mbyt. Një grup të mërguarish formuan një shtet të ri përgjatë brigjeve verilindore të detit Mesdhe, të njohur si Mbretëria Armene e Cilicisë (ose Armenia e Vogël). Ky shtet ishte i mirënjohur për kullat e rrumbullakta të arkitekturës së saj dhe aleancat e saj me kryqtarët europianë. Armenia Ciliciane luftoi kundër muslimanëve në favor të Europës Kristiane deri sa u mposht nga vala e re e turqve që erdhën nga Azia qendrore në vitin 1375.

Në shekullin e XIII, Armenia Kaukaziane vuajti pushtimet e mongolëve dhe të tribuve të tjera të Azisë qendrore. Në shekullin XIV, Turqit Otomanë në Anadoll, u zgjeruan në kurriz të Perandorisë Bizantine dhe pushtuan Konstandinopojën në vitin 1453. Ndërmjet shekujve XVI-XVIII, Armenia Kaukaziane u nda ndërmjet Otomanëve dhe Persianëve Safavidë.

## Rusët dhe Turqit

Në shekullin XVIII një tjetër lojtar hyri në skenën e luftërave që zhvilloheshin në territorin Armen: Rusia. Ndonëse për një kohë të gjatë ndën zotërimin Turk dhe Persian, në fillimet e shekullin XVIII Armenët filluan t'i drejtojnë sytë për ndihmë nga Rusia, një fuqi në rritje. Ata dërguan disa delegatë tek Cari rus për të kërkuar mbrojtje nga Turqia. Komuniteti i fuqishëm tregtar Armen i New Gulfa në Isfahan për më tepër i bëri Carit Aleksis I Mihajllloviç si dhuratë një fron të zbukuruar me ar dhe gurë të çmuar, me qëllim që të fitonte simpatinë e tij. Megjithatë, kërkesa për ndihmë mbeti për një kohë të gjatë pa përgjigje, siç ishin edhe kërkesat e tjera drejtuar kombeve të tjera Europiane për të ndihmuar “një vend mik të krishterë”.

Më së fundi u duk një rreze shprese në vitin 1800, kur Gjeorgjia dhe Karabaku ranë ndën sundimin Rus. Një sërë revoltash të komuniteteve joTurke ndërkohë e kishin gërryer Perandorinë Otomane tashmë në rënie. Rënia e Perandorisë tashmë dukej e afërt, dhe Car Nikolla I filloi të bëjë lëvizje më agresive për të përfituar nga kjo situatë.

Gjatë luftës Ruso – Turke të vitit 1828 – 1829, forcat e tij arritën rreth 72 km. afër Kostantinopojës, dhe Sulltani Turk u detyrua të kërkojë paqe. Traktati i Adrianopojës i dha Rusisë sovranitet mbi Gjeorgjinë dhe pjesë të tokave të Armenisë së sotme. Trajtimi i Armenëve dhe i të drejtave të tyre ndën Perandorinë Otomane fqinjë filloi të njihet në rrethet diplomatike Europiane si “Çështja Armene”. Kjo çështje mori rëndësi ndërkombëtare gjatë luftës së fundit Ruso – Turke të vitit 1877 – 1878 kur situata e rënduar e Armenëve u bë objekt i vëmendjes ndërkombëtare.

Pavarësisht kësaj vëmendjeje, situata u keqësua akoma më tepër për Armenët që ishin ndën sundimin Turk. Nga viti 1894 deri në vitin 1896 u urdhëruan masakra masive nga Sulltani Turk Abdyl Hamiti II. Sulltani (për nënën e të cilit, ironikisht, flitej se ishte Armene) e konsideronte popullsinë Armene si një kërcënim i cili mund të shërbente si pretekst për ndërhyrjen e Rusëve dhe Europianëve. Qeveria Turke projektoi dhe organizoi sulme në fshatrat Armene të cilat shpejt u përhapën në tërë zonen dhe veçanërisht në tërë Armeninë Perëndimore. Shumë fshatra Armene organizuan rezistencë të armatosur, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për të ndalur progromet e përgjakëshme si rezultat i të cilave gjetën vdekjen me dhjetra ose mbase qindra mijra Armenë – shifrat shkojnë nga 100 000 deri në 300 000.

Gjatë rregjimit të Sulltan Abdyl Hamiti, një parti e reformuar opozitare e njohur si Turqit e Rinj filloi të rriste popullaritetin e saj brenda Perandorisë Otomane. Me parullën “Vëllazëri dhe Atdhe i Përbashkët”, Turqit e Rinj arritën bile të shikoheshin me simpati edhe nga disa pak Armenë, të cilët besuan në premtimin për “Armeni Perëndimore Autonome”. Në fakt, disa Armenë e ndihmuan financiarisht fushatën e tyre kundër Sulltanit. Pas Revolucionit të Turqve të Rinj të vitit 1908, Sulltani pasardhës, Muhameti V, u reduktua në një figurë simbolike pa pushtet.

Fitorja e Turqve të Rinj, sidoqoftë nuk i lehtësoi shqetësimet e Armenëve. Në vitin 1909, turma Turqish sulmuan me një tërbim

gjakësor Armenët në Adana dhe Cilicia. U raportua që, milicia Turke që ishte dërguar për të vendosur rregullin, u bë bashkëpjesëmarrëse me turmat në aktet e dhunës.

Në momentin që Turqia hyri në Luftrat Ballkanike të vitit 1912 – 1913 me Bullgarinë, Serbinë, Greqinë dhe Malin e Zi, nacionalizmi që ishte gjerësisht i përhapur, shpërtheu në një gjallërim shumë të madh të armiqësisë ndaj Armenëve. Armenët shiheshin si një rrezik shumë i madh. Bankierët Armenë u akuzuan se vidhnin shtetin, bizneset Armene u bojkotuan, dhe dolën në qarkullim fjalë për një organizatë të fshehtë Armene që tentonte të shkatërronte shtetin.

## Gjenocidi Armen

Gjenocidi Armen filloi më 24 Prill 1915. Në këtë ditë të 250 udhëheqësit Armenë u arrestuan dhe u vranë në Kostantinopojë. Gjithashtu në Prill 1915, trupat Turke filluan sulmin mbi qytetin Van. Ndën udhëheqjen e Aram Manukiahe, Armenët u përpoqën të mbrohën – një mbrojtje që zgjati 36 ditë dhe përfundoi me vdekjen e 55000 Armenëve. Ushtarët vullnetarë Armenë të ushtrisë Cariste arritën të shpëtojnë të mbijetuarit.

Pas asaj që Turqit e cilësuan si “Revolucioni i Vanit”, Armenët u emërtuan armiq të brendshëm të Perandorisë Otomane. Brenda një viti, filloi deportimi në masë i popullsisë Armene dhe Qeveria Turke kaloi një ligj sipas të cilit autoritetet kishin të drejtë të konfiskonin të gjitha pasuritë, bagëtinë dhe shtëpitë që u përkisnin Armenëve. Gjatë kësaj kohe, shumë Armenë jo vetëm që u detyruan forcërisht të linin shtëpitë e tyre, por qindra mijëra u nisën në marshimet e vdekjes dhe u vranë barbarisht.

Sipas New York Times, “rrugët ishin të mbushura me trupa të të dëbuarve, dhe ata që mbijetonin ishin të destinuar t’i nënshtroheshin vdekjes së sigurt. Ky ishte një plan për të shfarrosur të gjithë popullin Armen”. Në total, vlerësohet që të kenë vdekur rreth 1,5 milion Armenë në vitet 1915 – 1916.

## 24 Prill. Duke kujtuar Gjenocidin

Gjenocidi që ndodhi në fillim të shekullit të kaluar pati një ndikim të fuqishëm në brezat që mbijetuan, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Ai është një kujtim i ngulitur fort në djemtë dhe vajzat Armene që i bën thirrje për të ruajtur kulturën dhe popullin e tyre.

24 Prilli është konsideruar si Dita e Përkujtimit të Gjenocidit Armen. Për herë të parë ai është përkujtuar në vitin 1965, kur mijëra Armenë filluan një demonstratë 24 orëshe në rrugët e Erevanit. Trupat sovjetike u përpoqën të rivendosin rregullin ndërkohë që turma e ekzaltuar thërriste, “Vendi ynë, Vendi ynë”. Sidoqoftë, për të parandaluar që kjo të përsëritej në të ardhmen, Kremli pranoi të ndërtojë një kompleks memorial në nderim të viktimave të Gjenocidit. Ndërtimi i memorialit përfundoi në vitin 1967 në Tsitsernakaberd (Xixernagaberd) mbi luginën Hrazdan, në Erevan.

Përkujtimi i Gjenocidit bëhet në mbarë globin. Çdo vit, në Europë dhe në Amerikën e Veriut dhe të Jugut zhvillohen evente në Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit. Memoriale të Gjenocidit Armen janë ngritur në shumë vende, përfshirë Francën, SHBA, Libanin, Uruguain dhe Venezuelën. Studime të vazhdueshme mbi gjenocidin, pasojat e tij, dhe mësimet globale zhvillohen në shumë universitete.

Megjithatë, njohja e faktit të gjenocidit vazhdon të mbetet pikë debati në disa vende. Shumë vende shqetësohen se mos ofendojnë Turqit (të cilët deklarojnë se të dyja palët patën humbje gjatë luftës) dhe disa nga aleatët e saj, dhe nuk e kanë dënuar zyrtarisht aktin. Në vitin 2006, SHBA e zëvendësuan ambasadorin e tyre në Armeni; supozohet, që shkaku ishin vërejtjet e bëra në favor të Armenisë dhe njohja e Gjenocidit.

Në vitin 2009, Presidenti Barak Obama duke ju adresuar parlamentit Turk e anashkaloi fjalën “gjenocid” dhe në vend të saj përdori “ngjarje të tmerrshme të 1915”.

Në vitin 2007 Hrant Dink, botuesi Turko - Armen i gazetës Agos, u vra pas kritikave që i bëri deklaratave mohuese këmbëngulëse të Turqisë se nuk ka patur kurrë gjenocid. Dink mbetet një hero i shquar Armen. Në funeralin e tij në Stamboll, mijëra nga ata që shoqëronin procesionin deklarorin “Ne jemi të gjithë Armenë” dhe “Ne jemi të gjithë Hrant Dink”.

### Rihyjnë Rusët

Në vitin 1916, pjesa më e madhe e Armenisë Otomane ishte pushtuar nga Rusia cariste, por këto fitore humbën me revolucionin bolshevik të 1917.

Gjatë të njëjtës periudhë, një grup Armenësh që jetonin në pjesën më veriore, në Tbilisi, ishin duke formuar Federatën Revolucionare Armene. Ata ishin avoketër të fortë të socializmit dhe nacionalistë armenë pasionantë, dhe punuan për të bashkuar grupet e vogla të Armenëve në të gjithë zonën dhe për të mbrojtur fshatrat Armene. Si rrjedhim, në vitin 1918, ARF shërbeu si instrument për krijimin e shtetit të pavarur Republika Demokratike e Armenisë, e cila u mbështet nga fuqitë fituese aleate.

Pavarësia ishte jetëshkurtër. Në vitin 1920 forcat e Lëvizjes Nacionale Turke të Qemal Atatürkut hynë nga lindja dhe kështu shpërtheu lufta Turko-Armene. Pothuajse në të njëjtën kohë pati rebelime komuniste brenda DRA. Në fund të vitit, ushtria e kuqe filloi të pushtojë zonën. I lodhur nga vitet e luftës dhe duke tentuar të kujdesej për nevojat e mijëra refugjatëve Armenë që kishin ardhur prej Perandorisë së mëparëshme Otomane, kombi i ri i sulmuar nuk mundi të rezistojë më gjatë. Në 4 Dhjetor 1920, Ushtria e Kuqe hyri në Erevan.

Në vitin 1922, Armenia u bë pjesë e Republikave Socialiste Sovjetike Transkukaziane, që përbëhej nga Armenia, Gjeorgjia dhe Azerbaixhani. Armenia Perëndimore mbeti pjesë e Turqisë dhe Iranit veriperëndimor.

Në 13 Tetor 1921 u nënshkrua traktati i Karsit ndërmjet Turqisë dhe Republikave Socialiste të Azerbaixhanit, Gjeorgjisë dhe Armenisë. Ky traktat përforcoi traktatin e mëparshëm të Moskës (të nënshkruar në 16 Mars 1921) ndërmjet Rusisë Bolshevike dhe Turqisë Qemaliste. Kjo vendosi kufijtë aktualë ndërmjet Turqisë dhe Armenisë duke i lëshuar Turqisë sipërfaqe të marra prej Rusisë Imperiale nga Perandoria Otomane gjatë luftës Ruso-Turke të vitit 1877-1878. Më simboliku, Mali Ararat - simboli i dashur i kombit Armen- ju la Turqisë.

Në vitin 1936 Republika Transkaukaziane u shpërbë dhe Armenia u bë një nga 15 Republikat Socialiste përbërëse të Bashkimit Sovjetik. Si edhe republikat e tjera Armenia udhëhiqej nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Republikës.

## **Armenia ndën Sovjetët**

Në vitin 1930 Armenët, ashtu si edhe gjithë minoritetet e tjera etnike brenda Bashkimit Sovjetik vuajtën persekutimet dhe deportimet masive të ndërmarrë nga Stalini. Pothuajse çdo familje Armene u prek nga brutaliteti i tij. Çdo përpjekje për zhvillimin e artit dhe shkencave Armene u shtyp dhe shumë shkrimtarë, artistë, shkencëtarë dhe udhëheqës politikë Armenë u ekzekutuan ose u internuan. Në vitin 1936 Stalini filloi deportimin e Armenëve në Siberi në një përpjekje për të zvogëluar numrin e popullsisë Armene dhe të projektonte aneksimin e saj prej vendlindjes së tij, Gjeorgjisë. Gjithashtu Qeveria Sovjetike mori masa për të persekutuar Kishën Apostolike Armene, e cila tashmë ishte dobësuar nga gjenocidi. Koren Muradpekian (i njohur si Koreni i parë) udhëheqësi i Kishës Armene u vra, dhe Katedralja Eçmixin u mbyll. Është për t'u thënë që po të mos kishte kishte qenë Diaspora Armene, Kisha Armene zor se do ta kishte mbijetuar këtë periudhë.

Shpërthimi i Luftës së Dytë Botërore e zhvendosi vëmendjen e Stalinit. Ndërkohë që nazistët i kishin vënë qëllim vetes të kapnin fushat e pasura naftëmbajtëse të Azerbaixhanit, ata kurrë nuk synuan zonat e Kaukazit Jugor. Sidoqoftë, Armenia luajti një rol të rëndësishëm në ndihmën që i dha aleateve. Më tepër se 500 000 Armenë morën pjesë në luftë, dhe pothuajse gjysma e tyre ra në fushën e betejës.

Armenët e Divizionit të 18 Sovjetik “Tamanian” luftuan në beteja të ashpra në Kaukaz, në betejën e Krimesë, në betejën e Balltikut, në ofensivën Vistula – Oder, dhe në betejën për Berlinin. Rreshteri Hunan Avetisian dhe S. Arakelian merituan titullin e lartë të Heroit të Bashkimit Sovjetik gjatë sulmit mbi qytetin Novorosijsk që mbahej nga Gjermanët. Dekorimi i Avetisianit u bë pas vdekjes, pasi ai ishte hedhur mbi llogoret gjermane, duke u vrarë vetë për të shpëtuar skuadrën e tij gjatë avancimit.

Një nga heronjtë më të mëdhenj të Luftës së Dytë Botërore ishte Gjenerali Hovhanes (Ivan) Bagramian, i cili më vonë u bë Marshall i Bashkimit Sovjetik. Bagramiani ishte i pari oficer jo-Sllav që bëhej komandant fronti në vitin 1944. Forcat e tij çliruan Republikat Balltike që kishin qenë të pushtuara nga Gjermanët dhe çliruan qindra qytete në Poloni dha në Çekoslakinë e mëparëshme.. Sot një nga rrugët kryesore të Erevanit mban emrin e tij, dhe një statujë e këtij heroi të madh qëndron në këmbë të Universitetit Amerikan Armen. Një tjetër monument për heronjtë e Luftës së Dytë Botërore, Ura e Fitores, ndodhet mbi lumin Hrazdan, në Erevan. I ndërtuar në vitin 1945, ai është emërtuar në nderim të atyre që luftuan në “Luftën e Madhe Patriotike”.

Në fund të Luftës së Dytë Botërore, shumë Armenë lobuan pranë Stalinit që t'i ktheheshin tokat e tyre që ndodheshin në Turqinë Perëndimore. Ndërkohë që Stalini ndërmori disa veprime të vrullshme, perpjekja u ndërpre menjëherë nga Presidenti Truman, që deklaroi se ai do të ndihmonte çdo vend që kërcënohej nga “agresioni sovjetik”. Kremli e ndërpreu menjëherë lëvizjen.

Pas luftës, Stalini, filloi një politikë më të hapur për imigracionin në Armeni. Ai ofroi që të paguajë për Armenët e Diasporës që donin

të ktheheshin në Armeni, rigjallëroi popullsinë dhe bashkoi forcat punuese. Si rezultat, pati një influks të mbi 15 000 Armenëve nga Diaspora, mbijetues të Gjenocidit, ose pasardhës të tyre, që jetonin në Francë, Greqi, Irak, Liban, dhe Siri. Sidoqoftë, mirëseardhja, nuk zgjati shumë. Në fund të viteve 1940, Stalini filloi një fushatë të re terrori, dhe mijëra Armenë u arrestuan ose u internuan në Siberi.

## Rizgjimi Kombëtar

Pas vdekjes së Stalinit në vitin 1953, në luftë për pushtetin, Nikita Hrushovi filloi një proces destalinizimi të jetës së vendit, duke u përpjekur të rikthente normalitetin dhe rregullin në zonë.

Ai vuri në përdorim më tepër burime për prodhimin e mallrave të konsumit dhe atyre shtëpiake, popullsia e Erevanit u rrit dhe ekonomia pati një rritje të ndjeshme. U lejuan liri të kufizuara fetare dhe arti filloi të lulëzojë. Një nga këshilltarët e Hrushovit dhe mik i ngushtë i tij, anëtar i Politburosë Armene, Anastas Ivanoviç Mikojan, i nxiti Armenët të rizbulojnë shkrimtarët dhe artistët klasikë. Kompozitori sovjetik Armen, Aram Kaçaturian, gjithashtu, krijoi në këtë kohë veprat e tij më të mira.

Rilindjes, që jetoi vendi në kohën e Hrushovit i erdhi fundi në kohën e Brezhnjevrit, i cili erdhi në fuqi po me ndihmën e Mikojanit. Periudha e Brezhnjevrit e viteve 1970 u karakterizua nga stanjacioni ekonomik, rënie në prodhimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në keqësimin e konditave të jetesës. Ndërkohë që Moska e humbi kontrollin qendror mbi zonën, zyrtarët partiake lokalë u bënë akoma më të fuqishëm dhe u bënë përfaqësues të mitmarrjes dhe korrupsionit.

Mbeturinat e kohës së Brezhnjevrit janë akoma edhe sot me shumicë në Erevanin e sotëm. Blloqet mëdha të apartamenteve parafabrikat të stilit sovjetik qëndrojnë akoma nëpër gjithë Erevanin, dhe ndërtesa që aktualisht bën pjesë në Universitetin Amerikan Armen ka qenë ish salla e mbledhjeve të Partisë Komuniste. E madhe dhe imponuese, ajo është një kujtim i privilegjeve që gëzonin ata që i bashkangjiteshin Qeverisë Sovjetike.

Në vitin 1987, të çarat në sistemin e Sovjetëve ishin tashmë të dukshme. Udhëheqësi sovjetik Mihail Gorbaçov kritikoi hapur veprimet e Partisë në Armeni, duke akuzuar qeverisjen lokale si “të mbërthyer në rutinë”. Politika e tij e “Glasnostit” (Hapja), inkurajoi rritjen e ndjeshmërisë kombëtare.

Goditja e fundit erdhi në 7 Dhjetor 1988 kur një tërmet i fuqishëm shkatërroi Armeninë veriore, duke vrarë së paku 25 000 vetë, përfshirë shumë punonjës shëndetsie në spitalet në gjëndje të mjerueshme lënë në mëshirë të fatit që nga epoka Brezhnjevine, dhe duke lënë pa shtëpi, në qiell të hapur më tepër se 500 000 njerëz. Shuma të mëdha parash erdhën si ndihmë direkte nga Diaspora. Moska, ndërkohë, u soll krejtësisht e papërgjegjshme.

### **Armenia e Pavarur**

Në Gusht 1991, Qeveria Sovjetike ishte zyrtarisht e shpërbërë. Në 21 Shtator 1991, në Armeni u mbajt një referendum për pavarësi. Armenët votuan totalisht për pavarësi nga Bashkimi Sovjetik. Po atë ditë, Universiteti Amerikan Armen hapi dyert e tij në Erevan. Në Tetor 1991, Levon Ter-Petrosian u bë Presidenti i parë i zgjedhur me votë nga populli në historinë e Armenisë. Sheshi Lenin, sheshi kryesor i qytetit, u riemërtua Sheshi i Republikës, dhe statuja e Leninit u përmbys. (N.q.s. dëshironi të shihni statujën tashmë pa kokë, mund të pyesni kujdestarët e Muzeut Historik Kombëtar).

Gëzimi i pavarësisë ishte jetëshkurtër. Mosmarrëveshjet e vazhdueshme të Armenisë mbi çështjen e Nagorni-Karabakut kishin arritur një pikë kulmore. Në vitin 1991, në kryeqytetin e Azerbaixhanit, Baku, kishin filluar të zënë vend progromet anti-Armene, duke vrarë rreth 90 njerëz dhe duke detyruar forcërisht shumë Armenë të braktisnin qytetin. Ndërkohë që Armenia dhe Azerbaixhani deklaruan pavarësinë nga Rusia, Nagorno-Karabaku deklaroi pavarësinë nga Azerbaixhani. (Shih përshkrimin më poshtë).

Në fund të vjeshtës së vitit 1992, një ndërmjetësi ndërkombëtare

dështoi në përpjekjet për të arritur një zgjidhje. Në pranverë të vitit 1993, forcat Armene kapën disa krahina kyçe të Nagorno-Karabakut dhe në Nëntor 1994 Armenët ishin në zotërim të plotë të territorit së bashku me disa zona rrethuese që i përkisnin Azerbaixhanit.

Si rezultat i këtij konflikti, qindra mijëra Armenë u zhvendosen nga Azerbaixhani, dhe akoma më tepër Azerë u detyruan të lënë Armeninë dhe Karabakun.

Një armëpushim zjarri i ndërmjetësuar nga Rusia u realizua në Maj 1994, por marrëdhëniet ndërmjet Armenisë dhe Azerbaixhanit vazhdojnë të mbeten të ngrira.

Lufta i kushtoi shumë shtrenjtë Armenëve që jetonin në Armeni. Gjatë konfliktit, Turqia ju bashkua Azerbaixhanit duke mbyllur kufijtë e saj me Armeninë, gjë që solli mungesa të mëdha në furnizime, qe praktikisht, çuan në asfiksimin e ekonomisë. U prek furnizimi me ujë dhe energji elektrike, me kufizime deri në pak orë në ditë, madje edhe gjatë pjesës më të ftohtë të vitit.

Pjesë përbërëse e kësaj situatë ishte edhe fakti, që industria, e udhëhequr nga sovjetët armenë, pothuajse kishte pushuar së ekzistuari pas pavarësisë. Prodhimi i përgjithshëm kombëtar kishte rënë pothuaj me 64%.

Shumë programe të zhvillimit social u bllokuan dhe shumë familje u lanë në mëshirë të fatit. Banorët në Erevan prenë pemët për lëndë djegëse dhe centrali i vjetruar bërthamor energjetik në Metsamor rifilloi punë pavarësisht paralajmërimeve që ai ishte jashtë kushteve të punës pas tërmetit të vitit 1998.

Gjatë kësaj periudhe të trazuar qindra mijëra Armenë emigruan. Shumë prej tyre shkuan në Rusi për të gjetur punë dhe për të shpëtuar nga konditat e tmerrshme. Ndërsa të tjerët u nisën për në Europë dhe SHBA. Kalifornia ishte veçanërisht tërheqëse për faktin se George Deukmeian, djali i një emigranti Armen kishte shërbyer si guvernator shteti nga viti 1983-1991.

U deshën disa vjet për ta rimarrë veten nga lufta dhe bllokada. Dhe në fillim të shekullit XXI, Armenia kishte filluar të tregonte shenja të ripërtëritjes ekonomike. Pjesa më e madhe e rritjes erdhi si rezultat i mbështetjes së jashtme – remitancat nga Diaspora dhe ndihma nga organizatat ndërkombëtare. Sidoqoftë, një zhvillim i dukshëm i ndërtimit filloi në vitet e para të shekullit të ri, gjë që ndihmoi në rritjen e prodhimit të brendshëm bruto.

Vinçat dominonin qiellin dhe ndërtesa të larta ultramoderne u shfaqën në qendër të Erevanit. Nëse ky zhvillim do të vazhdojë, dhe nëse ndërtesat do të mbushen plot, kjo mbetet për t'u parë.

### **Nagorno-Karabak: Lufta e ngrirë**

Në vitin 1930, Stalini e ndau krahinën e Nagorno-Karabakut (një krahinë kjo me shumicë Armene) nga Armenia dhe ja bashkangjiti atë Azerbaixhanit fqinj, duke krijuar kështu tensione rajonale që nuk pushuan kurrë. Në fund të viteve 1980, një program Azer, i projektuar mbi qytetin e Sumgait, bëri që situata të arrinte pikën e vlimit.

Kur Bashkimi Sovjetik ra në kolaps, Armenia dhe Azerbaixhani deklaruan pavarësinë nga Rusia dhe vetë Nagorno-Karabaku deklaroi pavarësinë nga Azerbaixhani. Fill pas kësaj shpërtheu lufta ndërmjet tyre për Nagorno-Karabakun. Ndonëse armatosur shumë më mirë, forcat Azerbaixhanase u mundën nga Armenët dhe u detyruan të tërhiqen dhe të lëshojnë terren. Ndërkohë që ishte vendosur një armëpushim i ndërmjetësuar nga Rusët, Armenia kishte marrë kontrollin jo vetëm të Nagorno-Karabakut, por edhe të disa pjesëve të Azerbaixhanit.

Konflikti mbi Nagorno-Karabakun është konsideruar një “luftë e ngrirë”. Ka shkëmbime zjarri ndërmjet forcave të

Azerbaixhanit dhe Armenisë. Gjithashtu kjo është një nga çështjet qendrore në diskutimet ndërmjet Armenisë dhe Turqisë. (Turqia mbështet Azerbaixhanin)

Trupat ruse janë në Armeni për të ruajtur vendin kundër Turqisë. Armenët janë shumë të dhënë pas çështjes së Nagorno-Karabakut. Shumë prej tyre kanë humbur njerëzit e tyre të dashur në këtë konflikt, prandaj ata e konsiderojnë veçanërisht të rëndësishme për vendin e tyre që ta mbajë këtë krahinë.

## QEVERIA DHE POLITIKAT

Kushtetuta e Armenisë, e adoptuar në vitin 1995, e përcakton si një Republikë Demokratike Presidenciale, me të drejtë vote universale për të gjithë banorët mbi 18 vjeç. Presidenti zgjidhet prej votës popullore çdo 5-vjet. Parlamenti përbëhet nga një dhomë që quhet Asamblea Kombëtare, ose në Armenisht “Azkain Zhoov”. Nga 131 vendet, 90 anëtarë zgjidhen nga listat partiake dhe 41 anëtarë me votim direkt. Kryeministri emërohet nga Presidenti mbështetur në propozimet e Asamblesë Kombëtare. Në vitin 2009 qeveria përbëhej nga një koalicion i 4 partive politike; Partia Republikane Konservative e Armenisë (HHK), Partia e Prosperitetit Armen, Federata Revolucionare Armene (Dashnak ose ARF), Partia e Ligjit dhe Rregullit. Partia kryesore opozitare, Partia e Trashëgimisë, aktualisht është në favor të të qenit pjesë e BE dhe NATO.

Armenët ndihen të dyzuar: cinik nga njera anë dhe nga ana tjetër me shpresë përkundrejt qeverisë së tyre. Ndërkohë që vendi lëviz përpara drejt demokracisë së vërtetë, ai ka provuar vrasje në sallën e Parlamentit, protesta të dhunshme dhe ankesa të vazhdueshme për manipulim votash. Megjithatë Armenët vazhdojnë të bëjnë presion për ligje më demokratike. Kulmi i turbullirës politike ndodhi në 27 Tetor 1999, kur, pas një dekade turbullirash, kryeministri Vazgen Sargsyan, Kryetari i Parlamentit Karen Demirçian, së bashku me 6 zyrtarë të tjerë

u vranë në godinën e Parlamentit. Ky akt shënoi fillimin e një periudhe protestash e paqëndrueshmërie gjatë të cilave pati disa përpjekje të pasuksesëshme nga ana e Partisë Opozitare për ta detyruar Presidentin Robert Koçarian të jepte dorëheqjen. Koçarian u rizgjodh në vitin 2003, por e filloi mandatin e tij me akuza për manipulim votash. Në fillim të 2004, protestuesit dolën përsëri në rrugë duke kërkuar dorëheqjen e tij. Sidoqoftë partia e tij mbeti në fuqi. Turbullira të reja shpërthyen në vitin 2008 me zgjedhjen e zëvendësit të tij, Serzh Sargsian. Opozita duke mbështetur Presidentin e mëparshëm Levon Ter-Petrosian, përsëri diskutoi rezultatet për më tepër se një javë në Erevan. Në datë 1 Mars 2008 shpërtheu dhuna ndërmjet policisë dhe protestuesve duke lënë të paktën 10 njerëz të vdekur. U vendos gjëndja e emergjencës për 20 ditë. Një vit më vonë, më tepër se 10 mijë njerëz u mblodhën në qendër të Erevanit për të mbajtur një kortezh paqësor në kujtim të të vdekurve.

## VLERAT DHE MENTALITETI

Kush e shpiku skanimin tomografik me rreze pozitron (PET)? Kush ishte kampion bote në shah për vite me rradhë? Kush ka më tepër se 30 aeroporte? Kush fitoi tetë turne Grand Slam në tenis individual dhe një medalje të artë olimpike? Kush shiti më tepër se 275 milion disqe në mbarë botën dhe është një nga më të njohurit Pop-Stars? Ka mundësi që ju tashmë ta dini përgjigjen. Një Armeni!

Krenaria kombëtare shkon shumë thellë. Pothuajse çdo Armeni mund të përmendë një përsëritje të mërzitshme të emrave të bashkëkombasve: Mishel Ter-Pogosian, shpikësi i PET skaner; Gero Kasparov, kampioni i shahut; miliarderin Eduad Eurnekian; kampionin e tenisit Andre Agasi; këngëtaren Cher, që janë vetëm një pjesë e vogël e atyre që duhen përmendur. Është fakt që të gjithë këta persona kanë një background të përbashkët (shpesh edhe një “ian” ose “jan” si prapashtesë në mbiemrat e tyre). Që të gjithë këta persona janë Armenë, pra janë të familjes. Dhe të qenit pjesë e familjes Armene që ka ndarë gëzimet dhe hidhërimet së bashku, kjo është gjëja më e rëndësishme nga të gjitha.

Ndonëse ka shumë karakteristika që përcaktojnë se çfarë do të thotë të jesh Armeni, më domethënësjat janë: Familja, Edukimi, Mikpritja dhe Krenaria e spikatur kombëtare.

## FAMILJA

Në Amerikë, një “Reality Show” televiziv i quajtur “Keeping up with the Kardashians” paraqet bëmat e një familjeje nga Diaspora Armeno-Amerikane që banon në Los Anxheles. Çfaqja është e mbushur me aventura provokative siç është rasti i vajzës së madhe që pozon për Playboy (me bekimin e nënës së saj). Është e mjaftueshme të themi se kjo nuk përfaqëson një familje tipike Armene.

Familja tipike që jeton në Armeni vazhdon të ruajë vlerat tradicionale, konservative. Gratë martohen në fillim ose në mes të viteve 20 dhe burrat në një moshë vetëm fare pak më të madhe. Tipike, është të kenë dy ose tre fëmijë dhe martesë e tyre normalisht vazhdon për gjithë jetën. Divorci dhe ndarja ndonëse janë të lejuara ligjrisht, normalisht në jetën reale vazhdojnë të konsiderohen si një tabu.

Tërheqja familjare vazhdon të jetë akoma shumë e fortë. Të rinjtë e sapomartuar vazhdojnë të sjellin nusen në shtëpinë e prindërve dhe jetojnë ndën një çati me prindërit për disa vjet. Kjo mund të vijë si rezultat i konditave ekonomike, por gjithashtu është edhe shenjë e dëshirës për të ndenjur pranë njerëzve të dashur. Siç mund ta pohojë edhe ndonjë Armen “nuk mund të çohet nëpër mend që njeriu mund të jetojë vetëm”. Kështu që, Armeni tipik është gjithnjë i rrethuar nga hallat, tezet, xhaxhallarët, dajallarët, kushërinjtë dhe të afërmit e tjerë për gjithë jetën. Dikush tjetër thotë “Familja është gjithçka që na bën neve të ndihemi mirë”.

Fëmijët e mësojnë rëndësinë e familjes që në moshë të njomë. Brenda çdo ekonomie shtëpiake, jeta, pothuajse gjithmonë, vërtitet rreth fëmijëve dhe familja i rrethon ata me kujdes, vëmendje dhe me shumë dashuri. Në fillim janë nënat ato që u qëndrojnë më afër, pastaj vijnë gjyshet, hallat, tezet dhe kushërinjtë. Kur lindin, ata rrethohen nga dhurata. Kur rriten fillojnë festimet e ditëlindjeve dhe prania e shumë kushërinjve në festën familjare.

Familja gjithashtu ofron mbrojtje. Në Armeni, fëmijët mbrohen dhe për ta tregohet kujdes i madh edhe në moshën e adoleshencës –

kohë kjo shumë më e gjatë se në shumë vende Perëndimore. Shumica nuk lihen kurrë “në shtëpi vetëm” pa ndonjë kujdestar të rritur, bile edhe në vitet e fundit të dhjetëvjeçarit të dytë.

Largimi nga shtëpia konsiderohet një lëvizje e madhe dhe bëhet vetëm me bekimin e familjes.

Takimet janë të lejuara, por shpesh ndën mbikqyrje – ju mund të shihni çifte që shkëmbejnë përqaftime vjedhurazi në shkallët e Kaskadës së Erevanit dhe të tjerë në vende larg syve të kalimtarëve. Miqësitë ndërmjet të rinjve dhe të rejave vazhdojnë të shihen me dyshim, veçanërisht nga brezi i vjetër, të cilët nuk arrijnë të kuptojnë se si të rinjtë mund të jenë “thjesht miq”. Për të vjetrit, qëndrimi i një burri dhe një gruaje sëbashku, mund të nënkuptojë vetëm një gjë – qëllimin e tyre për të krijuar familje.

Madje edhe më vonë në jetë, burrat dhe gratë Armene ndahen në mënyrë tipike, po kështu, edhe çiftet e martuara; ato kanë tendencë për të mbajtur lidhje me seksin e tyre si në aktivitetet e jetës së përditëshme, kur udhëtojnë me metro, ashtu edhe kur aktivizohen në jetën shoqërore.

## EDUKIMI

Edukimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm në kulturën Armene – kaq i rëndësishëm, sa që edhe gjatë viteve të hershme të vështira të Pavarësisë, ndërsa të gjitha shërbimet e tjera ishin asfiksuar, sistemi i edukimit mbeti i pacënuar. Të jesh i edukuar do të thotë të jesh i aftë të plotësosh shpresat e familjes dhe të vendit. Nga të gjithë djemtë dhe vajzat pritet që të frekuentojnë shkollën, të studjojnë dhe të dalin me rezultate sa më të mira. Herët në mëngjes, në Erevan, ju mund të shihni fëmijë me uniforma të pastra në blu dhe të bardhë, që nxitojnë për në shkollë, shumë prej tyre dorë për dorë me prindërit.

Me shkollimin si një element shumë të rëndësishëm të kulturës, Armenia ka një shkallë të lartë arsimimi. Sot, vlerësohet në 99,4%. Frekuentimi i shkollës është shumë i lartë si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale dhe afërsisht 80% e të gjithë studentëve mbarojnë

shkollën e lartë. Kolegji (Studimet e larta) është një synim për shumë studentë Armenë, si meshkuj ashtu edhe femra.

## ARMENËT DHE TRADITA

Në qendër të rrethrotullimit në Sheshin e Republikës në Erevan ndodhet një sipërfaqe e madhe ovale. Ndërkohë që përpiqeni të negocioni me taksitë që qarkullojnë çmendurisht, ja vlen të përpiqeni t'i hidhni një sy. Gdhendur në ovalen prej çimentoje është gjurma e një sixhadeje Armene – e njëjta e përdorur në pjesën më të madhe të dhomave të pritjes së miqve – që simbolizon mikpritjen e njohur botërisht të popullit Armen.

Në njëfarë kuptimi, mikpritja Armene është një vazhdim i kujdesit për familjen. Në një kulturë ku “familja shtrihet deri tek halla, tezja, xhaxhallarët, dajallarët, kushërinjtë, dhe shumë më larg, shumë veta janë të mirëpritur në këtë përfaqim të ngrohtë. Armenët i mbajnë të hapura dyert e tyre për miqtë dhe ndajnë kohën e tyre me ta mbi bazën e disa rregullave. Shpirti i mikpritjes është i përhapur në të gjithë vendin, por dallohet në mënyrë të veçantë në zonat rurale, ku është fare normale dhe e zakonshme që vizitorët të ftohen në shtëpi për një kafe, verë të përgatitur nga vetë i zoti i shtëpisë, ose edhe për ndonjë ushqim.

Në Erevan, nuk mund të thuhet që është e njëjta gjë, pra që është gjë e zakonshme të ftohesh në shtëpi, megjithatë ju do të gjeni një shpirt mikpritje që nuk mund ta gjeni në asnjë qytet tjetër. Turistët mund ta ndjejnë këtë shpirt miqësor, në gjestet e njerëzve që pothuajse gjithmonë i ndalojnë nëpër rrugë dhe i pyesin nëse kanë nevojë për ndonjë gjë, nëse u duhet orientim, ose qoftë edhe një ushqim i mirë.

## QËNDRIMI NDAJ GRAVE

Ndoshta një nga pjesët më komplekse dhe të diskutueshme të kulturës tradicionale Armene është roli i grave. Një shoqëri tepër tradicionale, Armenia përmban në vetvete shumë qëndrime të modës

së vjetër kur bëhet fjalë për rolin e gruas, madje edhe sot ka njëfarë presioni ndaj tyre për t'u pajtuar me të. Sidoqoftë kjo situatë ka filluar të ndryshojë me gjeneratën e re të Armenëve, të cilët po i rishqyrtojnë marrëdhëniet e vjetra mashkull – femër.

Në familjet tradicionale, një djalë trajtohet shumë më ndryshe nga motrat e tij. Ai konsiderohet princi i shtëpisë dhe prej tij nuk pritet ndonjë pjesëmarrje në punët e shtëpisë. Për të duhet të kujdeset ndonjera nga femrat e shtëpisë.

Mashkulli i dikurshëm, mashkulli Armen bëhej mbreti i ekonomisë shtëpiake. Ai ishte përgjegjës për të ardhurat që hynin në shtëpi dhe të gjitha vendimet e rëndësishme ekonomike siç ishte blerja e një shtëpie apo makine ishin e drejtë e tij. Gratë, nga ana tjetër, kishin përgjegjësinë e të gatuarit, të pastruarit dhe rritjes së fëmijëve. Dhoma e gatimit ishte pothuajse jashtë kufijve të burrit, pasi kjo ishte një zonë ku një grua tradicionale Armene dinte të spikaste. Ishte nder i madh për një grua Armene të pyetej për ndonjë recetë gatimi nga një grua tjetër, që njihet si gatuese e zonja.

Një vrojtuesi të huaj, këto role do t'i dukeshin paksa të limituara për një grua. Në një ekonomi shtëpiake tradicionale nuk ishte e pazakontë për një burrë që t'i tregonte gruas se kur ajo mund të dilte jashtë me miqtë e saj dhe kur duhet të qëndronte në shtëpi për t'u kujdesur për shtëpinë dhe familjen. Madje edhe në një çift të sapo krijuar, djali dikton aktivitetet e mikeshës së tij.

Përveç kësaj, çdo njeri mund të vërejë se gratë punojnë shumë fort. Gjatë ditës, gratë i sheh nëpër dyqane ose zyra. Në ora 6.00, ato nxitojnë të blejnë ushqime nëpër markete dhe pastaj vrapojnë për në shtëpi të përgatisin ushqimet, të lajnë rrobat, të kujdesen për fëmijët dhe të pastrojnë shtëpinë. Burrat, nga ana tjetër, ndalen në qoshet e rrugëve, flasin me miqtë ose njerëzit me të cilët i lidh puna, tymosin duhan dhe pastaj marrin rrugën e kthimit për në shtëpi ku e dinë se do të gjejnë ushqimin mbi tryezë.

Për të qenë korrekt, duhen përmendur disa faktorë të rëndësishëm.

Papunësia i ka detyruar shumë njerëz të lenë vendin dhe të kërkojnë punë në Rusi (po të udhëtoni me avion në linjën Erevan – Moskë, do të vëreni se shumica e pasagjerëve janë meshkuj). Pra, të shohësh një grua duke bërë kaq shumë punë, është e vetkuptueshme, pasi ato kanë ngelur seksi predominant në vend, dhe shprehja “detyrë e dyfishtë” e kryer nga gratë gjatë ditës, nuk është gjë e re.

Në kohët sovjetike, gratë presupozohej të konsideroheshin si shoqe në forcat prodhuese dhe në të njëjtën kohë si shtëpiake të mira.

### **Busybody. (Kujdestari lokal)**

Duke qenë se Armenia është një vend me shoqëri kaq të mbyllur, kjo ka nxjerrë në skenë figurën më të mërzitshme – kujdestarin lokal. Pothuajse çdo bllok apartamentesh ka një të tillë dhe ajo - sepse zakonisht është femër – është e frikshme dhe ofenduese, veçanërisht me të rinjtë. Sipas fjalëve të një vajze të re “Kjo është e vetmja gjë që unë nuk mund të honeps në Armeni. Kontrollorja fqinjë di pothuajse çdo gjë për ty”. Armenët janë më tepër gjykatës të vetvetes se sa të të tjerëve. Lloji i sjelljes që tolerohet për jovendasit, siç është p.sh. puthja në publik, nuk është e pranueshme për Armenët – veçanërisht për të rinjtë. N.q.s. një i ri shihet të vijë shumë vonë në shtëpi ose të çfaqë në publik shenja afeksioni për mikun apo mikeshën e tij, është e sigurtë që kjo gjë do të do të shkojë në veshin e shtëpisë së tij nga kontrollori.

Tashmë së fundmi, gjërat duket se po ndryshojnë. Femrat që popullojnë shumë nga kolegjet dhe universitetet janë të ndërgjegjshme se ato janë një gjeneratë në zhvillim. Ndërkohë që nënat dhe baballarët e tyre tentojnë të qëndrojnë fort në traditën, të rinjtë janë duke riparë rolin e tyre. Sa vjen e bëhet më e zakonshme të shohësh një baba të ri

duke luajtur në park me fëmijët e tij, ose t'i marri ata me vete ndërkohë që shkojnë për "Shopping".

## QËNDRIMI NDAJ HOMOSEKSUALITETIT

Presioni për të ruajtur rolet tradicionale në Armeni, patjetër që e bën të vështirë jetën e personave Gay. Por duket se po ndodh njëfarë ndryshimi. Armenia ka miratuar disa reforma që parashikojnë më shumë tolerancë ndaj komuniteteve lesbike, gay, biseksual dhe heteroseksual. Më kryesorja ndër reformat e fundit është shfuqizimi i Artikullit 116 të vitit 1936, sipas të cilit homoseksualiteti dënohej me ligj. Me shfuqizimin e këtij ligji një Gay-scene filloi të dukej në Erevan. Bari i parë Gay u hap në Erevan në vitin 2004. Dy të drejta të Gay-ve NGO të rregjistruara së fundmi brenda vendit, duke përfshirë Informacionin Publik dhe qendrën Nevoja për Njohuri (PINK) në Erevan, e cila gjithashtu ka një Website informativ.

Sidoqoftë, çiftet e deklaruara Gay e kanë akoma jetën të vështirë. Çiftet Gay normalisht nuk shprehin intimitet në publik. Ndonëse, në mënyrë paradoksale, njerëzit e të njëjtit seks shpesh e mbajnë njeri tjetrin për dore ose puthen kur takohen, këto veprime konsiderohen pjesë e traditës dhe nuk tregojnë një stil jetese Gay.

## MINORITETET ETNIKE

Në një vend ku më pak se 3% e popullsisë nuk është etnikisht Armene, çdokush mund ta imagjinojë se jeta nuk është gjithnjë e lehtë për ata që konsiderohen minoritarë., Megjithatë, një intolerancë e plotë është jashtëzakonisht e rrallë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në Erevan, ku lokalet shpesh shkelin rregullat e tyre kur bëhet fjalë për akomodimin e atyre që nuk flasin Armenisht ose nuk duket të jenë Armenë.

Komuniteti më i madh etnik dhe fetar në Armeni janë Yazidis, një komunitet Kurd, që numëron rreth 40 000 vetë në perëndim të vendit. Shumë Yazidis erdhën në Armeni dhe Gjeorgji gjatë shekullit të XIX dhe fillimet e shekullit të XX, për t'i shpëtuar persekutimit fetar nga Turqit

Otomanë, të cilët u përpoqën t'i konvertojnë ata nga Yazidizmi, që është një besim monoteist i cili bashkon shumë tradita Çifute, Kristiane dhe Muslimane, në fenë Islame. Historia e tyre është e ngjashme me atë të Armenëve, të cilët u masakruan së bashku me ta gjatë gjenocidit në fillim të shekullit të XX.

Marrëdhëniet e tyre me Armenët janë relativisht të qëndrueshme dhe Yazidis kanë vendosur lidhje të forta me vendin. Gjatë luftës në Nagorni–Karabak, anëtarët e komunitetit Yazidi, refuzuan lidhjen e tyre me Kurdët Muslimanë, madje disa prej tyre morën armët në mbështetje të ushtrisë Armene.

Një tjetër minoritet i vogël, Mollokët, gjithashtu kanë një lidhje historike me Armeninë. Një sekt fetar i përbërë kryesisht nga fshatarë rusë, Mollokanët u shkëputën nga Kisha Ortodokse Ruse në vitin 1550. Këtë emër ata e morën nga fjala Ruse për qumështin (molloko), sepse ata refuzuan të marrin pjesë në ditën Ortodokse të agjërimit, duke pirë qumësht si kundërpërgjigje. Mollokët gjithashtu ndjekin ligjet e së drejtës së dietës sipas Testamentit të Vjetër. Ata pretendojnë të jenë pasardhës direktë të tribuve të lashta Armene që migruan nga Bullgaria, Bosnja dhe Serbia. Shumë është folur për Çifutët në Armeni. Popullsia Çifute filloi të çfaqej në Armeni rreth viteve 80 BC, kur Tigrani i Madh u kthye prej Palestinës me rreth 10 000 Çifutë. Sot, nga komuniteti Çifut ka mbetur shumë pak dhe ata që kanë mbetur normalisht jetojnë në qetësi. Sidoqoftë, Çifutët, si edhe të tjerët që bëjnë pjesë në minoritetet e Armenisë, janë të ndërgjegjshëm që ata nuk janë pjesë e shumicës Armene.

## RËNDËSIA E FESË

Çdokush që pyet një Armen, se çfarë është ajo që e dallon vendin e tij, pothuajse gjithnjë do të marrë të njëjtën përgjigje, “Ne jemi kombi i parë Kristian në botë”. Ky dallim përbën një pjesë shumë të madhe të identitetit kombëtar, pavarësisht faktit nëse ndokush e ndjek ose jo kishën në mënyrë të rregullt. Shumica dërmuese e Armenëve

(90%) bëjnë pjesë në Kishën Apostolike Armene, që është besimi fetar shtetëror. Ndonëse kushtetuta e vendit lejon liri fetare për anëtarët e komuniteteve të vogla të kishave Jo-Apostolike, kisha shtetërore gëzon shumë privilegje që nuk i kanë grupet e tjera.

Kisha Apostolike Armene është një entitet fetar tërësisht i pavarur brenda llojit të saj. Ajo i ashpërsoi marrëdhëniet me Romën dhe Kostantinopolin në vitin 554 pasi refuzoi vendimin e propozuar nga Këshilli i Kalcedonisë mbi natyrën e Krishtit. Ajo udhëhiqet nga nga udhëheqësi i saj shpirtëror, Katolikosi i të Gjithë Armenëve, i cili është President i Këshillit të Lartë Shpirtëror dhe i Kolegjit të Bishopëve, është një figurë qendrore në kulturën Armene. Ai e ka vendqëndrimin në qytetin Eçmiaxin, katedralja e të cilit është ndërtuar në kohën e Shën Gregorit.

Në periudhën sovjetike, frekuentimi i kishës u dobësua, veçanërisht gjatë periudhës së Stalinit, kur u bënë përpjekje për ta eliminuar kishën. Koreni I, Katolikosi i asaj kohe, u vra, dhe kisha u rrënuar. Sidoqoftë, pavarësisht rregjimit të tij despotik, Stalini nuk mundi t'i përkeqësojë marrëdhëniet e Armenëve me kishën e tyre, e cila mbijetoi në sajë të një lëvizjeje të fshehtë në Armeni si dhe besnikërisë së Diasporës.

Pas sundimit sovjetik vendi provoi një rigjallërim në ndjeshmërinë fetare. Në vitin 1999, ishin vetëm njëqind priftërinj në Armeni. Që prej asaj kohe, numri i priftërinjve është më tepër se dyfishuar. Nga 17 kisha në periudhën para Pavarësisë, tashmë numërohen rreth 200 të tilla që ushtrojnë predikimin në Armeni. Ndonëse jo të gjithë Armenët janë frekuentues të rregullt të kishës (pjesëmarrja është akoma e ulët), ndjeshmëria ndaj besimit si pjesë i identitetit kombëtar është shumë e lartë dhe me gjasa për t'u rritur akoma më tepër. Dhe si dëshmi e qendresës së kishës në Armeni, Katedralja e Shën Gregorit në Erevan u shenjtërua në vitin 2001. Ajo u ngrit për të festuar përvjetorin e 1700 vjetorit të Kristianizmit në Armeni dhe simbolikisht, ajo ka 1700 vende (mban 1700 njerëz).

## PASURIA DHE PARAJA

Imazhi i Armenit si një person i biznesit konsumator ka një histori të gjatë. Në përplasje të vazhdueshme me qeverisjet e huaja, dhe pa ndonjë shans real për të fituar politikisht brenda vendit të tyre, Armenët, në periudhën e mesjetës organizuan një klasë të re udhëheqësish, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Këta ishin tregtarët e stabilizuar dhe ata të atë lëvizshëm. Shpejt ata fituan një reputacion si biznesmenë të mirë, duke përhapur shkrim e këndim dhe kulturën kudo që shkonin, nga Europa në pjesët e tjera të Azisë. Duke vënë re ndikimin Armen në Indi, historian francez Fernand Braudel shkruante: “Ku do të ishte Madrasi pa Armenët?”.

Reputacioni i Armenëve si biznesmenë të aftë, lulëzoi gjithashtu edhe nëpërmjet Diasporës. Sot, shumë biznesmenë të shquar në mbarë botën deklarojnë me krenari rrënjët e tyre Armene. Dhe kjo shkathtësi e veçantë në çështjet e biznesit mbetet një burim krenarie për Armenët.

### Talenti për Biznes

Një armen, i quajtur Artash, shkoi në një bankë në qytetin e New York-ut dhe kërkoi një nëpunës kredie. Ai i tha nëpunësit që ai po shkonte në Erevan për biznes për dy javë, dhe i nevojiteshin 5 000 dollarë kredi.

Nëpunësi i tha që për t'i dhënë këtë kredi, bankës i nevojiteshin disa garanci. Artashi i dorëzoi çelsat e një Ferrari të ri të parkuar në rrugë përballë bankës. I tregoi dokumentat e pronësisë, kontrolluan makinën dhe e pranuan si garanci.

Artashi mori kredinë dhe u nis. Presidenti i bankës Amerikane dhe nëpunësit u tallën me Armenin që ofroi një makinë 250 000 dollarëshe si garanci për një kredi 5 000 dollarëshe, dhe një nëpunës e çoi makinën në garazhin e bankës në ruajtje. Dy javë më vonë, Artashi u kthye dhe riktheu kredinë së bashku me interesat që arrinin në 15,41 dollarë.

Nëpunësi që i kishte dhënë kredinë i tha: “Zotëri, ne jemi të lumtur që patëm rast të bëjmë biznes me Ju, dhe ky transaksion funksionoi për bukuri, por jemi pak si të hutuar. Ndërkohë që ju ishit në udhëtim, ne kontrolluam pozicionin Tuaj dhe zbuluam që Ju ishit multimilioner. Ajo që nuk kuptojmë është fakti se përse Ju u shqetësuar për të marrë 5 000 dollarë kredi?”

Artashi u përgjigj: “Në çfarë vendi tjetër në qytetin e New York-ut unë mund ta parkoja makinën time për dy javë me vetëm 15,51 dollarë dhe të shpresoja ta gjeja aty ku e lashë?”

Ah, truri Armen.....

Kjo është arsëyeja që në këtë fushë Armenia ka një emër të shkëlqyer.

Brenda vetë Armenisë, shanset për prosperitet ekonomik janë më të kufizuara. Gjenocidi, i ndjekur më pas me sistemin sovjetik e mbyti dhuntinë Armene për sipërmarrje. Deri në periudhën e recesionit të vitit 2009, Armenia u përpoq të ngrihej me këmbët e veta, dhe ishte duke e bërë këtë me një ritëm relativisht të shpejtë. Prodhimi i brendshëm mesatar bruto për frymë popullsie në Armeni pothuajse u trefishua nga viti 2000 deri në vitin 2005, por ai përsëri mbeti në nivelin e më pak se gjysmës së GDP për frymë që kishin fqinjët e saj, Gjeorgjia dhe Azerbaixhani.

Armenët patën një prirje pozitive përkundrejt akumulimit të pasurisë dhe i pëlqenin historitë që qarkullonin mbi njerëzit e suksesshëm në biznesin Armen. Sidoqoftë, ata ishin të ndërgjegjshëm që klasa e re e përfolur e biznesit Armen ishte akoma në fazën e eksperimentimit të ripërtëritjes Armene. Për një sukses real, Armenia moderne duhet të kapërcente disa dobësi ekonomike përcaktuese. Së pari, rritja ekonomike ishte shumë e varur nga rritja e eksportit, i cili ishte vështirësuar së tepërmi nga bllokimi i kufijve. Gjithashtu produktet dhe shërbimet e eksportueshme ishin relativisht të kufizuara (p.sh. lëmimi dhe shkëlqimi i diamanteve).

Qeveria, gjithashtu, duhet të lironte kontrollin e saj mbi tarifatat dhe taksat. Për të rivendosur krenarinë ekonomike të së kaluarës, Armenia kishte nevojë për investime të mëdha, zgjerim të tregut të kapitalit, madje edhe reforma të mëtejshme në sistemin qeverisës dhe atë bankar.

Një vështirësi e dytë ishte varësia e vazhdueshme prej remitancave që vinin nga emigrantët Armenë. Sipas Fondit Monetar Nderkombëtar (FMN) dhe Bankës Qendrore të Armenisë, remitancat aktualisht kalonin buxhetin vjetor të vendit. Kjo varësi kaq e madhe gjithashtu e bënte vendin shumë të ndjeshëm ndaj luhatjeve në ekonominë globale, siç rezultoi me goditjen që pësoi vendi në periudhën e rëcesionit global të vitit 2009.

Gjithashtu, ka diferenca të mëdha në pasuri në krahina të ndryshme të vendit. Ndonëse ekonomia e vendit ka pësuar rritje, Erevani, me një të tretën e popullsisë së vendit, prodhon më tepër se gjysmën e prodhimit të brendshëm bruto. Sipas statistikave të Programit për Zhvillim të Kombave të Bashkuara, rreth gjysma e popullsisë rurale të Armenisë, pra rreth 1,5 milion banorë jetojnë në varfëri. Qeveria, grupet e Diasporës dhe organizatat ndihmëse joqeveritare kane aplikuar disa programe për të lehtësuar gjendjen e vështirë në zonat rurale; megjithatë, për shumë njerëz, gjendja vazhdon të mbetet shumë serioze.

Pastaj, vijnë oligarkët. Ashtu si edhe në Rusi, një klasë e fuqishme shumë e pasur oligarkësh është ngjitur në majë të shoqërisë. Që pas Pavarësisë, ngritja e kësaj elite të re, i ka mbytur reformat ekonomike. Këta biznesmenë shumë të fuqishëm jo vetëm që kontrollojnë industrinë kyç të vendit, por gjithashtu kanë zënë vend edhe në Parlament. Shumë Armenë shpresojnë që reformat do t'i çlirojnë një ditë nga rrjeta e oligarkëve, si të atyre që janë në biznes ashtu edhe të atyre që janë në pushtet, por mbetet akoma shumë për të bërë. Oligarkëve nuk u vjen turp të tregojnë pasurinë e tyre. Ata ndërtojnë pallate tepër luksoze; ata u dhurojnë fëmijëve të tyre makina Mercedes kur ata mbushin 16 vjeç; ata frekuentojnë dyqanet e pasura me pakicë të ndertuara përgjatë bulevardit Verior të Erevanit. “Mbrojtësit” e tyre muskuloze njihen mirë. Këta nuk janë një rilindje e tregtarëve Armenë të kohëve të mëparëshme; pranohet gjerësisht se influenca e tyre në çështje të tilla,

siç është shpërndarja e pasurisë, antikorruptioni, reforma në gjykatën e krimeve dhe privatizimi është duke e dëmtuar rëndë procesin e reformave progresiste ekonomike.

## INFLUENCA RUSE NË SHOQËRINË ARMENE

Shumë vizitorë të huaj çuditen me faktin se sa shumë të lidhur janë Armenët me Rusët. Pjesa më e madhe e kësaj lidhje të ngushtë është projektuar startegjikisht nga Rusët, që shihen si mbrojtësit e Armenëve nga Azerbaixhani. Megjithatë, lidhjet me Rusinë janë më të thella se sa edhe vetë kjo aleancë politike. Mallrat që ndodhen në dyqanet Armene janë kryesisht të prodhuara në Rusi. Çfaqjet televizive Ruse - veçanërisht ato me kartona - janë shumë popullore. Të rinjtë dëgjojnë muzikën Pop Ruse dhe janë shumë familjarë me festat Ruse. Të shkuarit në një Universitet Rus është një arritje shumë e madhe. Dhe, n.q.s. ju ndjeheni shumë i sëmure, destinacioni i juaj është ndonjë spital në Moskë.

Armenët pretendojnë se kanë shumë vlera të ngjashme me Rusët, veçanërisht kur vjen fjala për nderimet familjare, për t'u pajisur me edukatë dhe nga mënyra e të parit të botës me më tepër skepticizëm se sa Perëndimori më optimist. N.q.s. u jepet rasti për të bërë një zgjedhje ndërmjet Ruisë dhe një vendi Perëndimor, shumë Armenë do të zgjidhnin Rusinë, sepse siç e perkufizon një vendas "Rusia është më e afërt për ne".

Në mënyrë interesante, e gjithë kjo afërsi me Rusinë, dhe natyrisht, historia e burokracisë Komuniste, kanë influencuar në njëfarë mënyre në psikikën Armene.

Ka akoma nga ata që kapen pas traditave të vjetra dhe besojnë se shërbimi ndaj klientit është monopol i administratës dhe burokracisë. Për një të huaj është e pamundur, që të paktën një herë, të mos bjerë në kontakt me anën e pakëndshme dhe kokëfortë të Armenisë së influencuar nga koha Sovjetike. Kjo gjë ndodh p.sh. në postë, kur dikujt i thuhet se diçka nuk mund të bëhet, dhe në bankë kur thuhet se një transaksion është "i pamundur". Ndonjëherë, vizitori arrin të shpëtohet nga një situatë

e tillë aspak e këndshme nga ndonjë vendas, i cili thjesht nuk mund të pranojë që të ndodhë diçka e tillë Gjithsesi, në rast se duhet të gjendeni në një rast të tillë dhe të mos keni asnjë lloj ndihme, është më e mira që të shihni përpara, duke ditur që, edhe pse e rrallë në pamje të parë, një anë kokëfortësisht e ngurtë e Armenisë akoma ekziston.

## **KARAKTERISTIKA PËRCAKTUESE:**

### **AFTËSIA PËR TË MBIJETUAR!**

Ekziston një këngë pikëlluese Armene e cila njihet si nga Armenët vendas, ashtu edhe ata të Diasporës. Refreni është një bashkëbisedim ndërmjet një Armeni të Diasporës, larg nga vendi i tij, dhe një lejlëku që fluturon mbi të. “A sjell lajme të mira nga vendi ynë?” pyet Armeni nga Diaspora. Por refreni është shprehur me një melankoli kaq të trishtuar sa gjithkush e di përgjigjen. Historia e gjatë e keqqeverisjes, deportimit, dhe masakrës është pjesë e eksperiencës Armene. E megjithatë, kjo këngë ka një aspekt tjetër, i cili është frymezues, sepse Armenët ndajnë një ndjenjë që i kanë mbijetuar gjithçkaje. Asgjë nuk është vërtet tronditëse dhe – sikur ka treguar dhe historia – asgjë nuk i ka rrëzuar ata përfundimisht. Në përballje me qeveritarë brutalë, luftën, gjenocidin, tërmetin dhe kufizimet, kultura armene mbijetoi. Mbase mund mos ketë lajme të mira nga Armenia për dikë që e do atë, por pavarësisht gjithë këtyre trazirave, ai vazhdon të mbetet Atdheu i tij.

Disa besojnë se aftësia për të marrë veten e Armenëve nuk është asgjë më tepër se sa një mrekulli. Të tjerët mbështesin tezën që është shpirti Armen, vendosmëria dhe, pse jo, këmbëngulja që i ndihmon ata të ruajnë kulturën e tyre, e cila gjithmonë ringrihet në këmbët e saj, pavarësisht se sa e madhe ka qenë goditja që ka marrë. Kombi i parë Kristian, një gjuhë dhe një alfabet unik, një shoqëri relativisht homogjene – të gjithë këta faktorë do të mbijetojnë siç kanë bërë për mijëra vjet. Të bësh gjithçka që është e mundur për të siguruar që kultura të kalojë nga brezi në brez – kjo do të thotë që të jesh një Armen i vërtetë.

## FESTIMET DHE ZAKONET

Ndonëse moti, konditat ekonomike dhe një sërë faktorësh të tjerë e të shumtë e bëjnë të vështirë jetën në Armeni, shumë pak gjëra i pengojnë ata për të festuar festat e tyre. Problemet e jetës së përditëshme harrohen kur afrohen ditët e festave. Dhe ajo që është më e rëndësishmja dhe ana më e mirë e ditëve të festave, është fakti që ato shërbejnë si rast për organizime të mëdha familjare.

Interesant është fakti, që kalendari i festave Armene përmban si festat Kristiane ashtu edhe ato Pagane. Ndonëse shumë vetë çuditen përse ekziston akoma kjo përzierje, shpjegimi më i thjeshtë është se Kristianët e hershëm nuk njiheshin për jetë aktive sociale kaq të gjallërishtme dhe gazmore, ndërsa paganët dinin se si t'i bënin gjërat argëtuese gjatë aktiviteteve si p.sh. kërcimi mbi zjarr ose lagia e miqve me kova me ujë. Bile edhe celebrimet kryesore Kristiane të Pashkëve dhe Krishtlindjeve mbajnë vulën e zakoneve të larmishme pagane të kohës para Krishtit.

Natyrisht më të zhurmëshmet janë festimet e ngjarjeve jetësore që mbledhin miqtë dhe familjen, siç është: pagëzimi, ditëlindja dhe sidomos martesat. Të ndjekësh një dasëm Armene, është si të shohësh një familje Armene në veprim. Ulje - Ngritjet e jetës familjare çfaqen të gjitha atje, ndërkohë që festimi, në dukje i pafund, vazhdon të zhvillohet. Thuhet që dasma Armene është e tërë eksperiencia Armene në një ngjarje të vetme të rëndësishme.

## PUSHIMET E DIMRIT

Kisha Armene ndjek kalendarin e vjetër Julian (krijuar në vitin 46 BC), jo kalendarin e reformuar Kristian të futur nga Papa Gregori XIII në vitin 1582. Kjo do të thotë që vizitorët Perëndimore mund t'i gjejnë festimet e zakonshme jo sipas rregullit që ata njohin, p.sh Dita e Vitit të Ri festohet përpara Krishtlindjeve Armene, i cili është aktiviteti kulmor i sezonit të pushimeve.

Në vitet e fundit, sidoqoftë sezoni i pushimeve ka filluar pak më herët, me festimin shtesë të Krishtlindjeve Perëndimore në 25 Dhjetor. Një pemë e madhe metalike me të tre ngjyrat e flamurit Armen ngrihet tashmë në Sheshin e Republikës, dhe rreth saj ngrihen dyqane të vegjël kur afron kjo ditë. Bile, gjatë atyre ditëve, ju mund të shihni Santa Claus (Babagyshë të Vitit të Ri) që lëvizin në grup përpara këtyre dyqaneve në qendër të Erevanit. Në kohën e sotme, më 25 Dhjetor, disa Armene mbliidhen së bashku me familjet dhe miqtë e tyre.

### Dita e Vitit të Ri

Realisht atmosfera fillon të ndjehet disa ditë përpara Ditës së Vitit të Ri. Kjo duket me përgatitjet e shumta shtëpiake. Në të kaluarën, këto ishin ditë të përgatitjeve ushqimore intensive, dhe nuk ishte e pazakontë për një shtëpiake që të përgatiste rreth një duzinë ëmbëlsirash. Sidoqoftë, rritja ekonomike ka sjellë më tepër lehtësira dhe tashmë është e zakonshme të shohësh njerëzit të bëjnë “shopping” të “çmendur” për sende ushqimore gjatë këtyre ditëve parapërgatitore. Gjithashtu, ju mund të shihni sallone bukurie të mbushura plot me gra që përgatiten për festë. Familjet më të pasura shkojnë për ski në resortin Çahkaxor, i cili është pothuajse plotësisht i prenotuar që në Tetor.

Disa thonë që festimet e Vitit të Ri janë bërë më të shpenzueshme. Përpara vitit 1990, festimi i Vitit të Ri Armen ishte në formën e një darke të qetë familjare në shtëpi në prezencën e ndonjë stacioni televiziv lokal ose Rus. Sot nuk është vetëm bollëku i ushqimeve, por edhe dhuratat – mollë ose monedha për tradicionalistët, dhe sende më të

kushtueshme për familjet moderne. Dhe për disa, Viti i Ri, nënkupton ushqim festiv në restorant.

Për ata që ngulmojnë në traditën, janë disa rituale të veçanta për t'u kryer në darkën e Vitit të Ri. Në mesnatë, dritat janë të fikura dhe familja reciton me zë të lartë sëbashku Lutje Zotit. Pas kësaj dritat ndizen nëpër të gjithë shtëpinë për t'u dukur sa më e shndritshme. Pjestarët e familjes shtrohen për të ngrënë tasin e “anushabur” (supë e ëmbël) që gatuhet me grurë, sheqer dhe fruta të thata.

Dita e Vitit të Ri është dita për t'u veshur mirë, për të blerë rroba të reja për fëmijët dhe për të shtruar në tryezë pjatat më të mira dhe takëmet prej argjendi. Familjet, si ato tradicionale ashtu edhe ato moderne, mirëpresin sa më shumë miq në shtëpitë e tyre dhe po ashtu bëjnë sa më shumë vizita tek të njohurit e tyre. Bile, disa i mbajnë hapur dyert e shtëpive të tyre gjatë këtyre ditëve me qëllim që çdokush ta dijë se është i mirëpritur. Gjithashtu ka një fluks të madh telefonatash dhe SMS urimi. Kjo nuk është absolutisht jo një kohë për të menduar të shtrëngosh rripin, pasi ushqimi luan një rol të madh. Në pragjet e dyerve ju do të shihni shegë të coptuara që kanë mbushur me farëza dhe pulpë dyshemetë. Ky është një simbol i shpresës për një bollëk akoma më të madh në vitin që sapo ka ardhur. Brenda shtëpive, tryezat janë mbushur me fruta, mish të grirë dhe peshk, karamеле dhe kek, për miqtë që vijnë e shkojnë. Armenët besojnë se sa më tepër miq të vijnë dhe sa më tepër ushqim ata të konsumojnë, aq më i begatë do të jetë viti në vazhdim.

## **Krishtlindjet**

Krishtlindjet Armene janë më tepër një festim i qetë në familje, dhe për disa, një shërbesë fetare. Në vigilje të Krishtlindjeve, më 5 Janar, familjet tradicionale ndezin qirin dhe shkojnë në kishë, ku mbahet liturgjia hyjnore dhe kungimi i shenjtë. Ata sjellin në shtëpi një qiri kisha të ndezur me qëllim që të mbushin shtëpitë e tyre me dritën hyjnore. Në mëngjesin e 6 Janarit, familjet tradicionale shkojnë përsëri në kishë. Një basen i madh me ujë vendoset përpara altarit dhe kryqi

zhytet në ujë për të simbolizuar pagëzimin e Krishtit. Pjesëmarrësit në kishë më pas i afrohen basenit dhe marrin nga uji i shenjtë për ta çuar në shtëpitë e tyre. Çdo ditë e javës në vazhdim (deri në 13 Janar) konsiderohet pjesë e celebrimit. Miq dhe të afërm vazhdojnë të vizitojnë shtëpitë e njeri-tjetrit dhe të përshëndesin njeri-tjetrin. Disa nga përshëndetjet që mund të dëgjoni përfshijnë ‘Tzez yev mes mdez avedis’ (Lajme të mira për gjithkënd), ‘Krisdos dzunav yev haydnetsav’ (Krishti lindi dhe u shfaq mes nesh), dhe ‘Orhniah eh haydnootiunun Krisdosee’ (Bekuar qofshin zbulesat e Krishtit). Në 13 Janar, kremtimet, si të Armenëve të Diasporës ashtu edhe të atyre vendas, zyrtarisht marrin fund.

Në qoftë se ju keni planifikuar ndonjë aktivitet biznesi gjatë periudhave të festimeve, kini parasysh që Armenët i marrin shumë seriozisht kremtimet e tyre të Vitit të Ri dhe të Krishtlindjeve. Si data 1 Janar, ashtu dhe data 6, janë festa zyrtare, kështu që bizneset janë të mbyllura. Gjithashtu, gjatë periudhës së festimeve është pothuajse e padëgjuar që të mos shpenzohet koha me familjen ose miqtë. Kështu që ka pak mundësi për biznes. Sidoqoftë, edhe nëse ju nuk arrini të realizoni qëllimet tuaja të biznesit, janë të gjitha mundësitë që ju të jeni i ftuar tek shtëpia e dikujt për një drekë tipike Armene.

## NË PRANVERË

### Dita e Shën Sargisit

Dita e Shën Sargisit festohet të shtunën, 63 ditë përpara Pashkëve. Dita është emëruar në nder të Shën Sargisit, një ushtar i fuqishëm i shekullit të III që ngjiste një kalë të bardhë dhe mbrojti Krishterimin. Dita nuk është festë zyrtare, por festohet nga të rinjtë dhe ata që ndihen të rinj në shpirt. Sipas traditës, ju duhet të hani një kek shumë të kripur përpara se të shkoni në shtrat dhe të mos e shplani atë me asnjë lëng. Pastaj, ju duhet të përqëndroheni në ëndrrat tuaja. Në qoftë se ju ëndërroni rreth dikujt që po mbush një gotë ujë, ai person është i destinuar të jetë bashkëshorti/bashkëshortja juaj. Armenët gjithashtu gatujnë një ëmbëlsirë, të quajtur Pokhindz, dhe e lenë atë në oborrin

e tyre në natën e Shën Sargisit. Në qoftë se kali i Shën Sargisit le një gjurmë thundre në ëmbëlsirë, viti në vazhdim do të jetë i mirë.

Sot Shën Sargisi konkurron me ditën e Shën Valentinit për nga vëmendja që i kushton rinia Armene. Sidoqoftë, duke qenë se Shën Sargisi vjen i pari, disa Armene modernë e shohin atë si një mundësi për të dëshmuar ndjenjat e dashurisë së tyre të mundshme. Në qoftë se, personi ndaj të cilit ushqeni ndjenja, shfaqet në ëndrrat tuaja në natën e Shën Sargisit, pa dyshim ja vlen ta ndiqni atë person në ditën e Shën Valentinit.

## Terendez

Një tjetër festival që shfaqet ditën përpara ditës së Shën Valentinit është Terendez. Për kishën ajo është dita e celebrimit të 40 ditëve pas lindjes së Krishtit. Besimtarët ndezin qirinj në kishë dhe marrin Dritën e Shenjtë me vete në shtëpitë e tyre. Gjithsesi, kënaqësia e vërtetë e festimeve të Terendez vjen nga një traditë e huazuar pagane, për të cilët ky është momenti i “Kapërcimit të zjarrit”. Një zjarr - një simbol pagan për ngrohtësinë dhe ripërtëritjen – ndizet, dhe çifte të martuara ose të fejuara inkurajohen që të kalojnë përmes tij, në mënyrë që të sigurojnë fertilitetin e tyre. Në disa fshatra, fëmijë dhe gra shtatzëna ose mama të reja ftohen gjithashtu që të kryejnë kapërcimin. Pas kësaj, të gjithë ftohen për të kërcyer, dhe pasi zjarri fiket, hiri i tij shpërndahet ndërmjet pjesëmarrësve të festivalit. Hiri gjithashtu konsiderohet shumë i rëndësishëm për ripërtëritjen, dhe i jepet grave shtatzëna ose të sëmurëve për ta spërkatur në ushqimet ose pijet e tyre.

Disa njerëz gjithashtu e shpërndajnë hirin nëpër fusha ose strehët e bagëtive, ose e vendosin atë në furrat ku ata kanë zakon të bëjnë lavash (buka Armene). Ajo që nuk përmendet shpesh në guidat tradicionale Armene është fakti që vodka është gjithashtu shpesh pjesë përbërëse e festimeve Terendez. Së fundmi, kjo mund të çojë në një djegie të konsiderueshme të lëkurëve të këpucëve.

## Dita e Grave

Ndërsa dashnorët kanë ditën e tyre në Shkurt, gratë e kanë ditën e tyre për një muaj të tërë në pranverë. Festimet fillojnë me ditën e 8 Marsit, që është një festë totale. Në këtë ditë është tradicionale të nderohen të gjitha gratë që rrethojnë jetën tuaj (gruaja, nëna, motrat, mikja e zemrës, madje edhe koleget femër të punës) me dhurata siç janë çokollatat dhe lulet. Në kulturën sovjetike, 8 marsi i dedikohet lëvizjes për të drejtat e grave, por Armenët e kanë bërë atë akoma më romantike.

Afërsisht një muaj më vonë, në 7 Prill, vjen Dita e Nënës dhe Dita e Bukurisë. I gjithë muaji shndërrohet në kohë aktiviteti komercial. Dyqanet dhe restorantet ofrojnë ulje çmimesh dhe promocione dhe shumë organizata joqeveritare zgjedhin këtë muaj për të zhvilluar evente speciale, leksione dhe çfaqje me qëllim që të ngrenë sensibilitetin mbi problemet e grave.

## Dita Përkujtimore e Viktimave të Gjenocidit.

Çdo vit, në 24 Prill, Armenët nderojnë kujtimin e 1,5 milion viktimave të Gjenocidit të vitit 1915. Në Erevan, mijëra njerëz bashkohen në një procesion vjetor nga qendra e qytetit deri tek memoriali i gjenocidit për të treguar respektin e tyre. Procesione të tilla zhvillohen në këtë ditë në mbarë vendet e Globit ku ndodhet Diaspora.

## Pashkët

Pashkët (Zadik) janë një ditë e preferuar e Armenëve. Pas një dimri të ftohtë, çdokush sheh i etur përpara për pushimet që afrojnë. Gjatë periudhës që i paraprin Pashkëve, familjet Armene vendosin thjerrëza ose fara të tjera mbirëse mbi një tabaka, i mbulojnë ato me një mbulesë pambuku dhe e vendosin tabakanë në një vend me dritë dhe diell në shtëpi. Rreth kohës së Pashkëve, farat fillojnë të mbijnë duke simbolizuar pranverën dhe zgjimin e botës. Të mbirat gjithashtu bëhen “bari” që shërben si zbukurim tradicional Armen për tryezën në

festën e Pashkëve. Gjatë Pashkëve ju gjithashtu mund të shihni kulaçë dhe shumë gjëra të tjera, përfshirë vezë, të lyera me të kuqe, të cilat simbolizojnë gjakun e Krishtit.

## NË VERË

### Vardavar

Në rast se ju qëllon të lageni nga ndonjë kovë ujë në një ditë vere në Erevan, mos pandehni se ky është një sulm personal ndaj jush. Ju jeni thjesht një tjetër pjesëmarrës në Vardavar, një festë Armene që zhvillohet të dielën e tretë të Korrikut. Zakoni i të hedhurit ujë mbi kokën e dikujt në një ditë në mes të Verës, gjithashtu i ka rrënjët në të kaluarën pagane të vendit, kur populli hyjnizonte Astgik, perëndesha e dashurisë dhe bukurisë. Sipas legjendës, Astgiku shpërndante dashuri nëpër Armeni duke spërkatur ujë trëndafili mbi tokë.

Vardavari sot është një rast për fëmijët çapkënë, adoleshentët dhe ndonjëherë edhe për të rriturit që të bëjnë shaka me enë me ujë në kërkim të dikujt për ta lagur. Nuk ka asnjë përjashtim, madje edhe ata që besojnë se janë të mbrojtur duke qenë brenda makinës ose taksisë. Kini kujdes! Ju mund të lageni përmes dritareve. Nëse ju ndodh të lageni, mos u ofendoni. Kjo ndodh njëherë në vit, dhe zakonisht në një ditë të nxehtë, kështu që merreni atë ashtu siç duhet marrë, me shpirtin e një shakaje të këndshme.

### Dita e parë e Republikës dhe e Pavarësisë

Teknikisht, Armenia ka dy ditë pavarësie. Festa publike e njohur si dita e parë e Republikës festohet në 28 Maj, dhe shënon formimin e Republikës së parë Armene në vitin 1918. Ndonëse kjo Republikë ishte jetëshkurtër, ajo ishte shumë domethënëse në atë çfarë dëshironin Armenët, me shpresën e rimëkëmbjes së kombit të tyre.

Një festë publike më e madhe është dita e Pavarësisë që festohet më 21 Shtator, pasi në këtë datë në vitin 1991 Armenët pothuajse totalisht

votuan për shkëputje nga Bashkimi Sovjetik që ishte në rënie. Dy ditë më vonë parlamenti i parë post-komunist i Armenisë formalisht deklaroi pavarësinë.

Që nga viti 1991, dita e Pavarësisë është festuar në trajta të ndryshme. Fillimisht, vendi ishte shumë i shqetësuar me luftën dhe kufizimet për t'u angazhuar së tepërmi me festimet. Sidoqoftë, në vitet e fundit Armenët kanë filluar ta festojnë atë me parada, festivale filmash, koncerte dhe shfaqje me fishekzjarre. Si zakonisht, në një ditë pushimi, njerëzit gjithashtu festojnë së bashku me familjen.

### Festa të tjera zyrtare

Në 1 Maj Armenët festojnë ditën e punës me një festë publike. Në 9 Maj kujtohet fundi i luftës së dytë botërore me Ditën e Fitores dhe të Paqes. Kjo ditë ka qenë një festë zyrtare në të gjithë Bashkimin Sovjetik dhe vazhdon të shihet si një ditë e shënuar në Armeni. Ajo është dita tipike e atyre që luftuan në luftë.

Data 5 Korrik është Dita e Kushtetutës, që është një tjetër festë publike. Kushtetuta e Republikës së Armenisë u miratua nëpërmjet një referendumi kombëtar në 5 Korrik 1995.

Në 7 Dhjetor, Armenët nderojnë ata që humbën jetën në tërmetin e vitit 1988 me Ditën e Përkujtimit. Kjo nuk është festë publike, por është normale të shohësh në këtë ditë ceremoni përkujtimore në mbarë vendin.

#### Fishekzjarret në Erevan

Në verë, pothuajse çdo natë, shoqërohet nga çfaqje fishekzjarresh në qiellin e Erevanit; kjo ndodh zakonisht pas orës 22.00, në mbyllje të shatërvanëve në Sheshin e Republikës. Për të sapoardhurit, këta fishekzjarre të netëve të vona, që nuk kanë lidhje me ndonjë festë të veçantë, mund të jenë paksa çoroditëse

në momentin që në qiell dëgjohen zhurma eksploduese, por normalisht kjo është pjesë e jetës së përditëshme në Erevan gjatë stinës së verës. Ndërkohë ju duhet të jeni i përgatitur për një çfaqje shumë të fuqishme fishekzjarresh në Ditën e Pavarësisë, e cila fillon rreth mesnatës.

## MARTESA: FESTA MË E MADHE NGA TË GJITHA

Martesa në Armeni është një festë e madhe – shpesh më e madhe se festa e Krishtlindjeve apo Dita e Vitit të Ri. Festimet e dasmës mund të zgjasin disa ditë dhe janë një rast i mirë për të gjithë familjen – shpesh për të gjithë fshatin – për të festuar me hare. Kur vjen puna për të zgjedhur shokun e jetës, Armenët jo vetëm që inkurajohen të zgjedhin një Armen, por mundësisht të jetë djalë apo vajzë e zonës. Siç thotë një fjalë e urtë Armene “ Bashkëshorti më i mirë është ai që jeton në rrugën tënde”. Sidoqoftë, shoku i zgjedhur nuk mund të jetë qoftë edhe farefisni e largët. Sipas traditës, nuk mund të ketë përzierje gjaku farefisnor deri në shtatë breza. Duke pasur vështirësi në përcaktimin e shokut të vërtetë të mundshëm të jetës, nuk është për t’u çuditur që Armenët e bëjnë “zgjedhjen e duhur” me kaq delikatesë.

Rituali i martesës, tradicionalisht, fillon me propozimin. Presupozohet që, familja e djalit të ri shkon pranë familjes së vajzës për t’i kërkuar prindërve të saj dorën e vajzës së tyre. Të gjithë hyjnë në lojën “pranim i vështirë”. Prindërit e vajzës, edhe n.q.s. ata janë plotësisht të gatshëm të miratojnë këtë bashkim, supozohet që nuk do ta japin që me kërkesën e parë. Prindërit e dhëndrit pritët të rikthehen deri sa vjehri i ardhshëm të japë pëlqimin e tij. Dhe për ta bërë këtë punë sa më të vështirë, babai i vajzës zakonisht nuk thotë direkt “po”, por lëshon një shprehje tipike “le të mos e diskutojmë më!”.

Posa që finalizohet marrëveshja, fillojnë planifikimet për dasmën dhe shpenzimet. Kostot janë të larta, jo vetëm për shkak të shpenzimeve

të ashtuquajtura “luksi”, por edhe për arsye të numrit të madh të personave të ftuar në dasëm. Zakonisht, familja e dhëndrit paguan për shpenzimet e dasmës, ndërsa familja e nuses paguan shpenzimet e fejesës – sipas rastit, një koktejl me një numër të kufizuar miqsh. Të dy familjet i dhurojnë çiftit të martuar nga një dhuratë të veçantë. Në ditën e dasmës, si në familjen e dhëndrit ashtu edhe në atë të nuses, ka pritje. Gratë mblidhen që herët në shtëpinë e nuses për ta ndihmuar atë të vishet. Dhëndri vjen me rrobet dhe këpucët (zakonisht këto i blen familja e tij, por në martesat moderne zakonisht atij i thuhet se çfarë duhet të blejë). Pastaj, dikush vjedh një nga këpucët e nuses dhe asaj i kërkohet të paguajë për ta marrë atë mbrapsht. Kur ajo ka mbaruar së veshuri, gratë më të vjetra e rrethojnë nusen për t’i uruar asaj mbarësi.

Ceremonia në Kishë është relativisht e shkurtër, por e mbushur me ritual. Kur dhëndri dhe nusja afrohen në altar, prifti vendos kurorat në kokat e tyre. Pastaj ata qëndrojnë përballë njeri tjetrit ndërkohë që marrin bekimin. Në fund ata pinë verë nga një kupë e përbashkët dhe deklarohen të martuar. Dasma zgjat 8 deri 9 orë. Kryesuesi i martesës dhe i dasmës festive që e shoqëron atë është prifti, i cili zgjidhet në këtë pozicion nderi me pëlqimin e çiftit. Ai jo vetëm që shërben si prijës i martesës, por supozohet të jetë këshilluesi i tyre përgjatë gjithë jetës martesore. Gruaja e tij, priftëresha, gjithashtu mban një pozicion nderi, dhe supozohet që ta ndajë eksperiencën e saj me ta.

Të ftuarit në dasëm kercejnë shumë dhe gjithashtu ngrenë shumë dolli. Njera prej tyre, më klasikja është “ u mplakshi bashkë në një jastëk !”

Shpesh nusja paraqitet në dasëm me stoli prej ari dhe gjate kërcimit ajo rrotullohet nëpër dhomë me qëllim që të ftuarit të kenë mundësi t’i shohin. Miqtë beqarë marrin dhurata të vogla nga çifti (tarosiks) në shenjë urimi “Fat i Mbarë!”, urim për martesë të shpejtë edhe për ta. Gjithashtu, besohet se n.q.s. një person i pamartuar vendos një “tarosik” ndën jastëkun e tij (saj), atëhere gruaja e tij e ardhshme (burri i saj i ardhshëm) do të çfaqet në ëndrrat e tij (saj).

Ka disa bestyttni të rëndësishme që e rrethojnë një ditë dasme. P.sh. është shenjë e keqe n.q.s. dy nuse takojne ose shohin njera tjetrën në ditën e martesës. Armenët tentojnë ta evitojnë martesën në muajin Maj, pasi supozohet që më pas ajo sjell fatkeqësi. Dhe nusja bashkë me dhëndrin, për të larguar syrin e keq, duhet të thyejnë dy pjata të zbukuruara në prag të derës së shtëpisë ku do të jetojnë. Pjatat duhet të thyhen që me goditjen e parë me qëllim që riti të ketë efekt.

## MIKPRITJA

Natyrisht, në shumë familje, jo çdo festim zhvillohet sipas traditës, jo të gjitha martesat zhvillohen në përputhje me traditat përshkruar më sipër. Mënyrat e vjetra janë zëvendësuar me të reja dhe lehtësirat që ofron koha e sotme i bëjnë gjërat më të thjeshta.

Sidoqoftë, ruajtja e traditës është një pikë shumë e diskutueshme si për familjet Armene në Armeni ashtu edhe për familjet Armene të Diasporës. Shumë Armenë e ndjejnë se duhet ta ruajnë traditën, pasi e shohin si vendimtare për ruajtjen e kulturës Armene tek familjet që arritën t'i mbijetojnë gjenocidit.

Ky sens i lartë ndërgjegjësimit mbizotëron madje edhe tek të rinjtë, të cilëve media u ekspozon më shumë kulturë të huaj se sa çdo gjeneratë tjetër në të kaluarën.

Shumë të rinj ndjehen të privilegjuar të kenë tradita të nderuara, që i kanë rezistuar kaq shumë kohës. Familja, kultura dhe zakonet e të kaluarës së tyre shërbejnë për ta si burim përkatësie dhe krenarie, të cilat shumë prej miqve të tyre jo-Armenë duket t'i kenë humbur.



## TË BËSH MIQ

Me arritjen në Aeroportin Ndërkombëtar të Erevanit – Zvartots - , menjëherë do t'ju bjerë në sy ndjeshmëria me të cilën Armenët trajtojnë familjen e tyre dhe miqtë. Njolla buzëkuqi dhe përdorimi masiv i façoletave janë në rend të ditës gjatë largimit ose mbërritjes së njerëzve. Po të qëndroni njëfarë kohe në vend, ju do ta ndjeni ngrohtësinë e popullit Armen. Madje ju do arrini të dëgjoni emrin tuaj të përdoret me mbaresën afektive xhan, një kompliment që ju bëhet juve, dhe një sinjal që ju tashmë keni bërë miq ndërmjet të zotërve Armenë të shtëpisë. Xhan në përkthimin fjalë për fjalë nënkupton “shpirt”, por në Armeni ajo përdoret më tepër në kuptimin që i japin japonezët fjalës së tyre san. Madje edhe ju vetë pa kuptuar do ta gjeni veten duke e përdorur këtë fjalë, kur i adresoheni miqve tuaj të mirë Armenë.

### MIQËSIA

Armenët kanë tendencë të jenë të dashur dhe të hapur në momentin që ju konsideroheni pjesë e shoqërisë së tyre. Të rritur në familje relativisht me shumë pjestarë, ata përpiqen të tregojnë kujdes për njerëzit e tjerë dhe e njohin vlerën e miqësisë dhe të të treguarit afërsi. Ata i përqafojnë fëmijët e të tjerëve kur i takojnë në rrugë; kolegët puthen në të dy faqet kur e takojnë njeri-tjetrin pas disa orësh, dhe bile çdo njohje merr një tundje dore ose ndonjë shenjë tjetër përshëndetje kur qëllon që përballen në rrugë. Madje edhe kamerieri i restorantit ku keni

darkuar një natë më parë mund t'ju përshëndesë duke tundur dorën që nga ana tjetër e rrugës.

Ju e keni fare të kollajshme të njihni njerëzit që takoni në jetën e përditëshme. Pavarësisht gjithë kësaj atmosfere aktive, Erevani, në fund të fundit, mbetet një qytet i vogël ku pothuajse të gjithë e njohin njeri tjetrin. Ju do të takoni patjetër fytyra të njohura në kafene apo dyqane.

Të bësh miq Armenë është një gjë e mrekullueshme, pasi ka mundësi të fitoni miq për jetë. Armenët janë mësuar të kenë kontakt të vazhdueshëm me të afërmit e tyre në Diasporë që ndodhen me mijëra kilometra larg, kështu që mos u çudisni kur të merrni rregullisht lajme nga miqtë Armene, pasi të jeni kthyer në shtëpi. Ka mundësi që ata t'ju sjellin juve Email, ku kërkojnë të dinë se si jeni dhe si kaloni ju dhe familja juaj. N.q.s. mundeni, përpiquni ta mbani korrespondencën, pasi do ta kuptoni se është plotësisht e mundur që të ruani një miqësi të fortë, edhe n.q.s. kontaktet e drejtpërdrejta janë të kufizuara.

## RREGULLAT E MIRËSJELLJES

Është e rëndësishme të kuptohet se si e organizojnë jetën e tyre shoqërore Armenët. Pjesa dërmuese e tyre janë rritur të rrethuar nga ambient familjar – jo thjesht familja e tyre, por edhe kushërinjtë, hallat, tezet, xhaxhallarët, dajallarët dhe çdo anëtar tjetër me lidhje gjaku. Të jesh pjesë e kësaj peme shumë të degëzuar familjare është një gjë shumë e rëndësishme, kështu që, n.q.s. ju vini në Armeni, qoftë edhe si një i afërm apo kushëri i largët, ju do të ndjeni një avantazh të dukshëm në krahasim me çfarëdo të huaj tjetër pa lidhje afërie në Armeni. Ata që janë me gjithë familje duhet të jenë të përgatitur që të mbulohen me të puthura ose përqafime.

N.q.s. ju vini në Armeni si një i huaj pa lidhje familjare apo sociale, atëherë ka disa rregulla mirësjelljeje. Së pari, duhet ta pranoni krenarinë e çfaqur dukshëm të Armenëve për vendin e tyre. Mos u përpiqni të kundërshtoni ose replikoni kur të dëgjoni prej tyre shprehjet “muzika më e mirë, ushqimi më i mirë, vendi më i bukur, etj...”. Është e këshillueshme të dëgjoni dhe të vlerësoni ndjenjat e forta që Armenët

ushqejnë për vendin e tyre. Mbi të gjitha, duhet pasur parasysh, se një kulturë nuk mund të mbijetojë kaq gjatë pa një pasion të tillë të fortë. Së dyti, kini parasysh, që çdo gjest sado i vogël merr dhenë. Për Armenët thuhet që kanë një “sens të dytë” për të nuhatur se kush është vërtet njeri i mirë. N.q.s ata ju perceptojnë juve si një person miqësor e mirëdashës, ju do ta fitoni menjëherë miqësinë e tyre.

Njohja paraprake e bën më të këndshëm qëndrimin tuaj në Armeni dhe thëllon njohuritë tuaja për këtë vend. Në Erevan, Armenët janë mësuar tashmë të kenë vizitorë në shtëpitë ose në qendrat e tyre të punës, por shpesh këta janë të afërm ose miq nga Diaspora të cilët në përgjithësi kanë njëfarë njohurie për Armeninë. Ky informacion bazik përfshin njohuri mbi qytetet dhe qytezat kryesore, artistët dhe shkrimtarët e famshëm, disa njohuri mbi historinë e Armenisë së lashtë, gjenocidin dhe pavarësinë moderne. Gjithashtu, është mirë të njihen disa përshëndetje kryesore në gjuhën Armene. Ky libër do t’ju ndihmojë të njihni disa nga gjërat bazike, por do të ishte akoma më dobiprurëse paraprakisht të lexonit disa tekste historike përpara se të arrini këtu. Disa prej tyre janë listuar në fq. 165 të këtij libri.

Prej jush pritet gjithashtu që të keni disa njohuri elementare rreth emrave Armenë (emër dhe mbiemër). Ju duhet të jeni në gjendje të shqiptoni në mënyrë korrekte disa emra tipikë, si p.sh. Gohar (femërore, Go-har), Gayane (femërore, Gi-a-neh), Tigran (mashkullore, Tig -ran), Areg (mashkullore, A -reg), Nane (femërore, Na-neh), Varduhi (femërore, Var-du-hi), Arsen (mashkullore, Ar -sen), Gevork (mashkullore, Ge-vork), dhe Hasmik (femërore, Has-mik).

Mbimërat zakonisht kanë lidhje historike me zanatin e familjes ose origjinën gjeografike. Të treguarit vëmendje dhe vlerësim për gjenealogjinë e dikujt është diçka që konsiderohet respekt për tjetrin.

## **TAKIMET E PARA**

Armenët e pëlqejnë shoqërinë. Ju do të hasni në grupe aktive kurdoherë që do keni rast të shkoni nëpër kafene, nëpër shkallët e Sheshit të Republikës apo në sheshin tregtar Vernissage. Të ndërhysh në

një grup Armenësh që janë në mes të debatit do të ishte tepër e vështirë. Ju do të konstatooni që jeni futur mes një grupi njerëzish që njihen që nga shkolla apo që nga lindja – ata mund të jenë të gjithë kushërinj ose mund të jenë rritur në të njëjtin bllok apartamentesh.

Ata nuk janë fort të prirur të ndalojnë dhe të përkthejnë për një visitor që nuk ka lidhje me të kaluarën apo gjuhën e tyre.

Mënyra më e mirë për të fituar një miqësi, është të ftosh një mik të ri ose koleg pune për një çaj ose një birrë. N.q.s. është verë, preferoni një kafene të hapur. Miku juaj do të jetë më i prirur për një pije të thjeshtë se sa një e ngrënë, madje edhe n.q.s. jeni ju ata që ofroni të paguani, pasi çmimet e restoranteve për shumë njerëz janë jashtë mundësive të tyre, ndërsa të ulurit dhe të pirët e një çaji apo kafeje janë absolutisht normale. N.q.s. ky është një takim “njohjeje”, miku juaj Armen do të përpiqet të hyjë në bisedë me disa pyetje për të parë se çfarë njohurish keni ju nga vendi i tij apo saj. Një pyetje e zakonshme është, “si ju duket ushqimi Armen?” Juve mund t’ju duket e vështirë t’i jepni një përgjigje, veçanërisht nëse ju nuk keni arritur akoma të shijoni një ushqim Armen të gatuar në shtëpi dhe keni ngrënë vetëm ushqimet e restorantit. Përgjigja juaj më e mirë do të ishte rreth diçkaje që e keni provuar e shijuar siç janë frutat e freskëta, lëngjet, konjaku, lavash-i dhe t’i lavdëroni ato.

Armenët nuk e kanë problem të dëgjojnë rreth çështjeve të caktuara për vendin e tyre, por të kritikosh diçka të rëndësishme, siç është ushqimi apo kultura, është e pakëshillueshme.

N.q.s. doni të shprehni rezervat tuaja rreth diçkaje, gjëja më e mirë (më e sigurt) për t’u ankuar është trafiku në Erevan. Çdo njeri është në dijeni të drejtuesve të papërmbajtur të automjeteve dhe rreziqeve që shfaq, në rastin më të thjeshtë, kalimi i rrugës nga këmbësorët. Kjo i jep të kuptojë mikut tënd që ju keni dëshirë të shihni qytetin, me kusht, që nuk doni të rrezikoni jetën dhe gjymtyrët tuaja. Kjo mund t’ju drejtojë në disa vende më të ngritura nga ku mund të shijoni pamje të bukura, ndoshta edhe disa pika që paraqesin rrezik për këmbësorët.

Të huajt me mend i lënë miqtë Armenë që ta udhëheqin ata bisedën.

Në këtë mënyrë, në shumë pak kohë, ata padyshim do të njihen me fakte interesante nga jeta në Armeni, si pozitive dhe ato negative. Ka disa çështje, që nuk këshillohet të preken, veçanërisht nëse ky është një takim fillestar. Çështje të cilat mund të bëhen objekt nervozizmi, janë çështjet që përfshijnë femrat dhe rolin e gjinive (ndonëse femrat tentojnë të flasin rreth kësaj më tepër se sa burrat), homoseksualiteti dhe lidhjet seksuale. Mund të bëhen vërejtje ose pyetje rreth Kishës, por vetëm n.q.s. ato përmbajnë shenja respekti.

Kur vjen puna për politikën, ekziston një ndarje e thellë në shoqëri, ndërmjet atyre që janë pro dhe kundër qeverisë. Përpara se të bëni ndonjë deklaratë të nxituar në çfarëdo drejtimi, përpiquni të parandjeni në cilin krah anon bashkëbiseduesi. Në varësi nga pozicioni i mikut tuaj, ju mund të jeni më shumë ose më pak kritikë rreth situatës politike në vend. Shumica e Armenëve, që nuk hyjnë tek të pasurit, kanë prirje për të qenë kundër qeverisë. Por të qënë kundër qeverisë nuk do të thotë domosdoshmërisht të jesh pro-opozitës, pasi njerëzit në qëndrimin ndaj opozitës janë njëlloj të ndarë ashtu siç janë edhe në qëndrimin përkundrejt autoriteteve. Shumë njerëz dëshirojnë ndryshime dhe nuk e pëlqejnë grupin e njerëzve që është aktualisht në fuqi, por ata nuk janë as nga alternativa tjetër. Janë të gjitha mundësitë që miqtë tuaj të hapin bisedën me probleme rreth politikës, si lokale ashtu edhe globale, pasi kjo është një temë e zakonshme bashkëbisedimi. Kurrë mos ndërhyjni me komente si p.sh “Unë nuk mund ta kuptoj përse njerëzit nuk ngrihen dhe protestojnë rreth politikanëve të tyre të korruptuar”, pasi shumica e Armenëve janë të mirëinformuar rreth politikës botërore. Në këmbim do të merrni një shpjegim të detajuar të asaj çfarë është e korruptuar dhe e gabuar në qeverinë tuaj.

Në këmbim të pyetjeve tuaja, përgatituni të merrni disa të tilla prej miqve tuaj Armenë.

Armenët kanë prirje të jenë shumë kureshtarë rreth biografisë së familjes dhe jetës personale, gjë e cila i bën të huajt shpeshherë të ndjehen në zor. Një grua e pamartuar, rreth të tridhjetave ose më e vjetër, ka mundësi të pyetet pse ajo është beqare. Ndonëse kësaj pyetje

nuk është domosdoshmëri t'i jepet përgjigje, e mira është që ta ketë një përgjigje të përgatitur me shumë takt.

## MËNYRA E KOMUNIKIMIT ME MIQTË

Në përgjithësi Armenët preferojnë të përdorin emrin e parë të personit, përveç se në rastet kur i drejtohen dikujt me autoritet ose shumë i vjetër. Siç e kemi parë, fjala “xhan” është një term afiniteti, i cili zakonisht përdoret pas emrit të parë të personit. Ju do te degjoni shpesh këtë term nëse ju do të bëheni një mik i ngushtë.

Përrjashtim i madh nga “rregulli i emrit të parë” ndodh kur të rinjtë i adresohen njerëzve më të vjetër ose grave. Të rinjtë inkurajohen të tregojnë respekt për më të vjetrit e tyre. Është e zakonshme për fëmijët dhe të rinjtë që t'u referohen njerëzve më të vjetër në moshë - madje edhe atyre që nuk i njohin, me fjalët si –teze, xhaxha, gjysh ose gjyshe.

## FTESA NË SHTËPI

Ju mund të arrini në Armeni me një listë të gjatë të miqve të miqve, ose të të afërmeve, të cilët, një mik nga Diaspora, ka kërkuar prej jush, që t'i kontaktoni. Mos u frenoni që t'i kontaktoni këta njerëz të panjohur: “miqtë e miqve” do të vijnë me kënaqësi, dhe thjesht duke përmendur një emër të njohur, ju mund të merrni një ftesë për çaj ose për darkë.

Në qoftë se ju jeni i ftuar në një shtëpi Armene, është e zakonshme që të sillni me vete një dhuratë të vogël, siç mund të jetë një shishe verë ose një ëmbëlsirë. Një dhuratë nga vendlindja juaj do të ishte e mirëpritur, por nuk është e domosdoshme. Duke qenë se shërbimi postar është i ngadaltë dhe jo i sigurt, ardhja i ngarkuar me letra, fotografi ose dhurata nga të afërmit nga Diaspora vlerësohet në mënyrë të veçantë. Kur përshëndetni mikun tuaj, një shtrëngim dore është i mjaftueshëm për herën e parë. Sidoqoftë, disa puthje ajrore (në të dyja anët, por jo në lëkurë) janë të pritshme prej atyre që janë më të afërt me njeri-tjetrin. Pas përshëndetjeve, ju do të ftoheni në dhomën e ndenjes ku do t'ju

rekomandohet të uleni në një pozicion të rehatshëm. Nëse ju ftoheni për të ngrënë, paraprakisht do të servireni me diçka të thjeshtë të shtruar në tryezën e vogël për kësi rastesh (arra, biskota të kripura, etj) ku ju jeni i ftuar t’i bëni shërbim vetes. Kini parasysh që ju duhet patjetër të merrni diçka, pasi askush nuk do të fusë gjë në gojë përpara se të keni filluar ju.

Jini i përgatitur për t’u angazhuar në dolli të shumta dhe të gjata përpara dhe përgjatë kohës së të ngrënit. Si një i ftuar, dollia do të ngrihet për ju (thoni Genac! që do të thotë “Gëzuar!”). Gjithashtu, dollitë për të afërm më të moshuar janë të nevojshme. Ju duhet të ngrini dolli edhe për mikpritësin tuaj. Por ruani një lloj ritmi – shumë dolli me konjak Armen ose vodka mund të çojnë në një dehje të shpejtë.

Një darkë tipike fillon me dolma (gjethe rrushi ose lakre të mbushura, zakonisht me oriz), vazhdon me një pjatë me mish, dhe përfundon me fruta dhe ëmbëlsirë. Nga çdokush pritët që të hajë çdo gjë në pjatën e tij. (Në shqip do të thonim – ta boshatisë pjatën). Dhe kini parasysh – zakoni thotë, që mikpritësi duhet ta rimbushë pjatën e të ftuarit sa herë që e sheh bosh.

### Çfarë ka në një emër Armen?

Ju e dini se zakonisht emrat Armenë përfundojnë me –ian, ose më së tepërmi në Armeninë post-Sovjetike, mbarojnë me –jan. Në Turqi, do të shikoni se –ian është zëvendësuar nga –oglu. Në Rusi, shumë njerëz e ndërrojnë në –ov, si p.sh. Geri Kasparov, ose në –ski, si Aivazyan në Aivazovski, një piktor i famshëm Armeno-Rus. Por kjo është vetëm një pjesë e historisë. Një mbiemër familjeje mund të tregojë një origjinë gjeografike (vendlindjen ose prejardhjen), prejardhje nga një zanat, aristokraci ose tipar tjetër.

Mbimrat që fillojnë me një emër dhe mbarojnë me –ian ose –jan tregojnë se mbiemri vjen nga emri i babait. Armenët

e Diasporës zakonisht përdorin –ian, ndërsa Armenët vendas përdorin –jan. Për shembull, Davidian është i biri i Davidit, dhe Krikorian është i biri i Krikorit ose Gregorit. Fillimisht, emrat e parë u morën nga Bibla, ndaj dhe ka shumë mbiemra që kanë originë fetare (Sokhomonian është i biri i Solomonit).

Disa mbiemra bazohen në emrin e një vendi prej nga ku kanë ardhur. Për shembull, mbiemri Vanetzian vjen nga fjala Vanetzi, një person që ka lindur në Van. Një rast tjetër është Sasunyan, një person i ardhur nga Sasuni.

Mbaresat me –uni ose –ooni mund të tregojnë që familja vjen nga aristokracia e lashtë Armene e Persisë Parthe (klasa e princërve). Jo shumë prej këtyre emrave mbijetojnë sot. Shembull janë Sasuni dhe Rshtuni.

Interesant është fakti që emrat të cilët tregojnë zanatin e paraardhësve shpesh janë vënë prej taksambledhësve, të cilët ua vinin njerëzve për qëllim mbledhje taksash. Duke qenë se taksambledhësit sipas rastit kanë qenë Turq, Persianë ose Arabë, edhe emrat i kanë rrënjët e tyre jo vetëm në gjuhën Armene, dhe mund të shihen qartë dallimet ndërmjet Armenëve lindorë dhe atyre perëndimorë, pasi emrat lindorë shpesh i kanë rrënjët e tyre në gjuhën Persiane, Gjeorgjiane ose Ruse, ndërsa perëndimorët mund t'i kenë ato në gjuhët Turke, Arabe ose Greke. Mbiemrat Naxharian, Tarpinian, Goshkarian dhe Terzakian nënkuptojnë respektivisht djali i marangozit, djali i kovaçit, këpucarit dhe rrobaqepësit.

Në emrat më të çuditshëm janë ata të cilët janë bazuar në një tipar të shquar të paraardhësit. Për shembull, Harutunian do të thotë “djali i ringjalljes” – gjë që presupozon se zotëruesi i parë i emrit ka mundësi të ketë lindur rreth periudhës së Pashkëve. Emrat me parashtesën Der ose Ter tregojnë që paraardhësi ka qenë një Zoti Baba (ose Atë), një prift famullie i martuar, një

pozicion i një niveli të lartë shoqëror në Armeni. Dy shembuj të zakonshëm janë : Der Bedrosian dhe Ter Petrosian. Shumë emra të Diasporës janë shkurtuar ose modifikuar, dhe shpesh u ka rënë mbaresa –ian. Për shembull, Mugerdiçian ose Mëgërdiçian janë kthyer në Mugar, dhe Sargasyan u kthye në Sark.

*(Adoptuar nga një studim i emrave Armenë nga Gary Lind-Sinianian i Librarisë dhe Muzeut Armen të Amerikës në Massachusetts.)*

## TAKIMET

Paqartësia e “a është ky vërtet një takim?” rrallë ekziston në Armeni. Është shumë e pazakontë për të rinjtë që të jenë thjesht miq me seksin e kundërt, kështu që në rast se ju ftoni dikë (ose jeni i ftuar) thjesht për një pije, kjo në fakt konsiderohet si një takim. Së paku ai është një tregues i fortë se personi tjetër është i interesuar për ju në mënyrë romantike. Megjithatë, kini parasysh që, në rast se ju jeni një i huaj perëndimor, ju do të shiheni si më i privilegjuar seksualisht se një Armen vendas. Është e mundur që një “birrë të jetë vërtet një birrë”, por ajo mund të perceptohet gjithashtu si parathënie e diçkaje më tepër.

Kur vjen puna për familjen, partneri juaj në takim mbase nuk ju çon në shtëpi për të takuar prindërit, në rast se ajo nuk është një lidhje vërtet serioze. Edhe pse ka shumë takime që zhvillohen pa dijeninë e prindërve, brezi i vjetër tenton të besojë që ju duhet të dilni vetëm me personin që ju do të martoheni, kështu që partneriteti rastësor do të ishte shumë shqetësues – dhe i ndaluar – për shumë prej prindërve. Takimi rastësor në Ameninë rurale është pothuajse gjë e padëgjuar. Gjithsesi, edhe në Erevan, të dalësh me dikë për më shumë se një vit ose 18 muaj pa u martuar ose të paktën fejuar me të është gjithashtu shumë e pazakontë. Të dalësh me të huaj është kryesisht për femra. Edhe pse disa meshkuj Armenë do të dalin me gra të huaja, ata kërkojnë për nuse Armene. Ka

shumë arësye për këtë, por kjo kryesisht ndodh sepse një nuse Armene ka më shumë prirje për të ruajtur një shtëpi tradicionale Armene.

Në takime, ashtu si në shoqëri, kini parasysh se do të ketë ndryshime kulturore. Asnjëherë mos u siguroni se zakonet tuaja janë më superiore, dhe gjithmonë qëndroni i hapur nga të bërit të gjërave në mënyra të reja. Nëse ju gjeni dashurinë e jetës tuaj ose thjesht fitoni shoqëri të reja, të njohësh njerëz nga Armenia është një eksperiencë “që të zgjat jetën”.

# ARMENËT NË SHTËPI

## SHTËPIA ARMENE

Kosto e lartë e jetesës në Erevan i ka detyruar shumë Armenë të jetojnë në godinat e vjetra. Disa prej tyre i përkasin stilit tërheqës “Tamanian”. Në vitin 1920, arkitekti Aleksandër Tamanian hartoi planin e qytetit Erevan dhe futi në të shumë godina të projektuara në mënyrë klasike, duke i dekoruar ato me zbukurime dhe gdhendje të ndërlikuara guri. Tamanian i ndërtoi ato me “tuf”, një lloj guri ngjyrë rozë, shumë i fortë i marrë nga shkëmbinjtë vullkanikë (duke i dhënë kështu Erevanit emrin “Qyteti rozë”). Të banuarit në një nga banesat e Tamanianit përbën një burim krenarie.

Megjithatë, shumë nga familjet në qytet tentojnë të banojnë në apartamentet që ndodhen në godinat e mëdha të tipit Sovjetik me konstruksion betoni të cilat u ngritën gjatë gjysmës së dytë të shekullit të XX. Nga jashtë, ato duken si përbindësja të tmershëm që janë gati të shkërmoqen në çastin që po i shikoni. Por mjafton të hysh brenda, dhe ju me siguri do të gjeni diçka më të këndshme. Me shumicën e familjeve që banojnë në to, të cilat kanë zgjedhur që më mirë të rimodelojnë apartamentet nga brenda se sa të largohen prej tyre, brendësia e këtyre godinave mund të konsiderohet plotësisht luksoze. Mos u çudisni kur të gjeni dysheme të shtruar me parket, dhoma pritjeje të bollshme të mobiluara shumë mirë, dhe kuzhina moderne të pajisura me makina larëse pjatash.

Në pjerrësitë e kodrave në periferi të Erevanit ju mund të shihni zhvillimin e lagjeve të banimit me rezidenca luksoze, shumëkatëshe, të cilat u ngjajnë rezidencave Amerikane” McMansion”, të cilat popullojnë lagjet e pasura të SHBA. Këto janë shtëpitë e mirënjohura të atyre pak familjeve më të pasura Armene, zakonisht të oligarkisë.

Në kontrast me to, jeta në fshatrat Armene është shumë e ndryshme. Shtëpitë janë të ndërtuara prej guri ose material jo i shtrenjtë. Ndonëse shumë prej shtëpive janë përmirësuar, shumica e popullsisë jeton në varfëri të plotë, dhe për disa ngrohja dhe pajisjet hidraulike janë një luks i paarrtshëm.

### **Të zotërosh pronë private në Armeni**

Ndonëse, të marrësh kredi nga një bankë për të blerë një shtëpi, është një ide relativisht e re në një vend, ku tradicionalisht ka qenë shteti që kujdeset për t’i pajisur me shtëpi qytetarët e vet, tashmë gjithnjë e më shumë çifte të reja po tentojnë të marrin kredi për të pasur një shtëpi të tyre. Kjo shihet jo vetëm si një ndryshim nga mënyra tradicionale shumëgjeneratëshe e të jetuarit, por është gjithashtu një shenjë që po krijohet një gjeneratë e re e interesuar të gjejë burime kreditimi për të financuar të ardhmen e vet.

Duke ndeshur në kërkesën për më shumë kredi për shtëpi, disa banka kanë filluar të ndryshojnë politikën e tyre të kredidhënies. Zakonisht, ato kërkonin 25 deri 30% pagesë fillestare me afat skadence brenda 10 viteve dhe interes bankar mbi 10%. Tashmë kredidhënësit ofrojnë pagesë fillestare më të ulët dhe afat skadence më të gjatë, ndonëse të huajt mund t’i konsiderojnë ato të limituara.

Natyrisht, çmimi i një apartamenti apo shtëpie vazhdon të jetë larg mundësive për shumë të rinj; por ka shenja që do të ketë ndryshime të reja. Duke prezantuar vizionin e tij për Armeninë në pesë vitet e ardhshme, kryeministri ka premtuar “Çdo familje e re që do të krijohet, do të ketë mundësinë për të blerë një apartament dhe një makinë”.

## STRUKTURA FAMILJARE

Tradicionalisht, shtëpia e parë për çiftin e sapomartuar është shtëpia e prindërve të burrit. Për nusen e re, kjo mund të jetë shpeshherë një betejë serioze e fuqishme. Gruaja më e vjetër e shtëpisë sillet si kryetarja e ekonomisë shtëpiake, duke drejtuar jetën e përditëshme dhe duke mbikqyrur punët rutinë të ekonomisë shtëpiake. Zakonisht këto kryhen nga gruaja më e re e bashkësisë familjare, kështu që nga gruaja e re pritet që t'i shërbejë jo vetëm burrit të saj, por edhe të gjithë familjes, duke bërë gjithçka, që nga përgatitja e ushqimit deri tek larja e rrobave, ndoshta së bashku me kunatat e saj n.q.s. ato janë akoma në shtëpi. (Është për t'u vënë në dukje se ndonëse kjo vërehet kryesisht tek familjet me mentalitet të vjetër, tek familjet moderne nuk mund të shpresosh të shohësh këtë gjë). Aktualisht çiftet e reja mund të kursejnë para mjaftueshëm për të lëvizur nga shtëpia e prindit, por kjo do të thotë të largohesh nga familja.

Në zonat rurale, familjet tentojnë të jenë sa më të mëdha. Ka një stimul shtetëror për familjet me mbi tre ose më shumë fëmijë, por kjo është një shumë relativisht e vogël parash dhe zakonisht nuk e justifikon mbajtjen e një familjeje shumë të madhe. Në Erevan, familjet janë më të vogla. Aborti është legal, dhe tenton të jetë forma e preferuar, e përshtatëshme për kontrollin e lindjeve (kontraceptivët oralë janë të vlefshëm, por të kushtueshëm). Disa grupe femërore aktualisht janë duke ekzaminuar madhësitë e familjeve dhe shërbimin riprodhues në Armeni nga pikëpamja e perspektivës sociale dhe ekonomike.

Ndonëse numri i lindjeve ka rënë, Armenia është një vend me moshë mesatare relativisht të re. Të rinjtë e kalojnë dukshëm numrin e të moshuarve në rrugët e Erevanit, prania e tyre rrezaton energji të dukshme në qytet. Të krijohet ndjesia, që këta të rinj kanë shumë për të thënë për të ardhmen e familjeve dhe të vendit të tyre.

## TË RRITESH NË ARMENI

Në Armeni sistemi i edukimit është duke pësuar ndryshime. Për vite me rradhë, vendi ndiqte sistemin Sovjetik të edukimit, që fillonte

me arsimin fillor në moshën 7-vjeçare. Sidoqoftë Ministria e Edukimit ka vendosur ndryshimin e sistemit Sovjetik që ishte nga 10 deri 11 vjet për arsimin primar dhe atë sekondar dhe kalimin në sistemin Perëndimor me 12 vjet.

Gjithashtu mosha e fillimit të shkollës për fëmijët është vendosur të jetë 5 vjeç. Qëllimi është që t'u lihet më tepër vend lëndëve të artit dhe atyre jotradicionale të cilat nuk trajtoheshin në vitet e kaluara. Gjithashtu fëmijët fillojnë të shkojnë në shkollë të shtunave kur janë në vitin e katërt.

Universiteti Shtetëror i Erevanit është Universiteti më i madh i Armenisë. I themeluar në vitin 1919, ai ka 110 departamente akademike me rreth 1 350 studentë të diplomuar (pasuniversitarë) dhe 8 500 studentë. N.q.s ju qëllon të ndodheni pranë universitetit, në çdo kohë të ditës, do të krijonit idenë se e gjithë bota përbëhet nga studentë kolegji të moshës 20-vjeçare.

Universitete të tjera janë : Universiteti Shtetëror Ruso-Armen, Universite Française en Armenie, dhe Universiteti Amerikan Armenia. Të gjithë këto ndodhen në Erevan. Shumë më të rinj se Universiteti Shtetëror i Erevanit, të gjithë këto universitete janë duke fituar reputacion si institucione të fuqishme edukimi.

## SHOPPING-U I PËRDITSHËM

Armenët shpenzojnë shumë kohë duke bërë shopping dhe sido që ta marrësh është e vetkuptueshme. Blerësit e Erevanit mund të blejnë ushqimet e tyre dhe sendet e tjera në një sërë njësisish tregtimi, duke filluar nga supermarketet moderne deri tek tregtuesit e lagjeve. Sekretet është të dish se çfarë ke për të blerë dhe ku ta blesh. Supermarketet e mëdha janë kryesisht në formën e një zinxhiri njësisish tregtimi të vendosur kudo përgjatë gjithë qytetit. Ndonëse çmimet tentojnë të jenë shumë më të larta se sa në dyqanet e lagjeve, mundësia e zgjedhjes është më e madhe. Më shumë njerëz ka në orët e pasdites, kur gratë që dalin nga puna nxitojnë për të blerë ushqime për përgatitjen e darkës. Duke

qenë se shumica e marketeve të mëdha janë të hapura ditë e natë, është e mira që në to të shkohet jo në orët pikut, pasi jashtë orëve të pikut shërbimi është më i mirë dhe raftet janë të mbushura plot. Në Armeni ekziston edhe fenomeni i disa dyqaneve vetshërbim të quajtura “retail hoverers”, në të cilin punonjësi i shërbimit ju ndjek mbrapa në të gjitha kthinat. Ndonëse ato janë krijuar që ju të gjeni atë që ju dëshironi, prezenca e tyre mund të jetë çoroditëse për ata që janë të ambientuar të bëjnë blerje pa nevojën e ndihmësit.

Për blerje të vogla, ka dyqane lagjesh në çdo rrugë. Zgjedhja në këto dyqane nuk është shumë e madhe dhe nuk është pothuaj kurrë vetshërbim. Ju mund t’i thoni shitëses – pothuajse gjithmonë është grua – që është mbrapa banakut pikërisht atë që ju dëshironi të merrni. Të huajt zakonisht edhe mund të bëjnë me shenjë nëse është e nevojshme. Normalisht caktohet një grua për çdo zonë specifike të dyqanit – buka, djathi, produktet e larjes, etj. Ajo nuk mund t’ju ndihmojë juve me një produkt që nuk është i sektorit të saj; n.q.s. ju keni marrë bukën dhe dëshironi djathë, duhet të prisni deri sa gruaja që merret me djathin të jetë e disponueshme.

Për sa i përket produkteve të freskëta, Armenët nuk i marrin në këto lloj dyqanesh, as në minimarkete apo supermarket. Zgjedhja në këto vende, jo vetëm nuk ka shumë variacion, por ato zakonisht i mbështjellin produktet e tyre që e kanë humbur freskinë në qese plastike dhe i shesin me shumicë. Kur ju shkoni në shtëpi dhe hapni qesen mund të gjeni që produkti që duket i mirë është në fillim të qeses, ndërsa ndën të mund të gjeni mall që pothuajse është i papërdorshëm. Me fjalë të tjera nuk keni bërë një blerje të mirë. Gratë shtëpiake të Erevanit e dinë se blerjet më të mira në qytet për fruta dhe zarzavate mund të bëhen në dyqanet e lagjeve, produktet e të cilëve janë më të freskëta dhe pak më të lira se sa në dyqanet e mëdha. Në muajt e nxehët ato shesin shumë varietete fruta dhe perime të shijshme. Ju i gjeni këto dyqane ose njesi tregtimi ambulante në rrugë ose xhepa të vegjël të qytetit siç është sipërfaqja komunale për bllokun e apartamenteve prapa sheshit Saharov. Për variacion më të madh produktesh, kërkoni

për marketet e hapura të njohura si shukas (Shuka – në Armenisht do të thotë – pazar, treg). Këto janë sheshe të mbushur plot dhe ju mund t’i lejoni vetes që të kaloni shumë kohë duke bërë pazar atje. Shukas-et janë të mbushura me mish të freskët të sapo prerë (shpesh herë të mënjanuara nga qendra kryesore e tregut), peshk (si të freskët të sapo kapur ashtu dhe të gjallë), fruta dhe zarzavate, erëza, produkte të ditës, bukë dhe disa ushqime të paketuara. Shitësit në shuka zakonisht do t’ju ofrojnë ta provoni ushqimin para se ta blini. Një nga kohët më të mira për të bërë pazar atje është stina e Vjeshtës, kur mollët dhe rrushi janë të sezonit dhe në treg gjen një sasi të madhe frutash të thata. Është fare e lehtë ngopesh duke provuar mostrat, përpara se të kesh vendosur për të blerë diçka.

Në shuka nuk ka çmime fikse, ndaj dhe mund të hyhet në diskutim për çmimin. Të huajve u thuhet se gjithçka është njëmijë dram – në fakt nuk është ashtu. Fraza më e mirë për të marrë vesh se sa duhet të paguani është “verç’in ki’në inç e?” (“cili është çmimi përfundimtar?”). Shpesh, përpara hyrjes së tregut, ju mund të gjeni fshatarë që ofrojnë produkte ushqimore të të njëjtit kualitet me çmim më të lirë.

Ëmbëlsirat e gatshme janë njëfarë luksi për Armenët me një buxhet të shtrënguar, por ka disa pastiçeri të mira nëpër Erevan. Shitësit me eksperiencë e dine saktë se kur dhe si duhet pregatitur çdo lloj keku, dhe mbi këtë bazë edhe se kur mund t’i blejnë produktet në freskinë e tyre të plotë. Ka një shumëllojshmëri keku me çokollatë dhe vanilje nëpër vitrina, por mundohuni të provoni ëmbëlsirat tradicionale me arra dhe mjaltë, si dhe ëmbëlsirën kombëtare, që është një bukë e ëmbël e quajtur gata.

## VERNISAZH

Për më shumë se 30 vjet, blerësit janë dyndur nëpër tregje të hapura të njohura si Vernisazh. Shumë më tepër se sa një tërheqje interesante turistësh, ky është vendi ku banorët e Erevanit tani mund të blejnë gjithçka, që nga pikturat në vaj deri tek kokat e dusheve.

Në fillim, ky treg ishte një vend ku artistët vendas ekspozonin punën e tyre për publikun e gjerë. Fjala franceze Vernisazh (varnishing) kishte kuptimin e një shfaqjeje private të mbajtur përpara hapjes së një ekspozite arti. Sidoqoftë, kur turmat mblidheshin për të parë pikturat, tregtarët vendas panë një mundësi për të shitur mallrat e tyre. Ata filluan të sillnin produktet e tyre në fushë dhe hapësira e jashtme u bë një supermarket duke shitur një varietet të gjerë artikujsh.

Ndonëse disa njësi tregtare Vernisazh qëndrojnë atje përgjatë gjithë javës, aksioni i vërtetë është në fundjavë. Njësitë tregtare kryesore fillojnë nga stacioni i metrosë tek Sheshi i Republikës dhe vazhdojnë përgjatë gjithë rrugës Khanjian, duke vazhduar me njësitë më të vogla tregtare që trajtojnë artikujt e përdorimit të përditshëm (furnizim me pajisje hidraulike, telekomanda, mjete të reja dhe të përdorura) dhe më pas me ato të veprave të artit, qilimave të qëndisur, stolive, sa më tepër i largohemi Sheshit të Republikës. Ndoshta pamjet më të çuditshme të tregut të mallrave janë ato në kufijtë e tregut ku gjen kimikate, kupa, mikroskopë, tuba provash, pinca dhe furnizime të tjera kirurgjikale. Aktualisht, për to, ka pak blerës.

Për banorët e Erevanit, të shkosh në Vernisazh, do të thotë të marrësh disa sende shtëpiake të nevojshme ose të kërkosh nëpër koleksionin e gjerë të librave. Për turistët, ky është një shans për të fiksuar nuancat lokale dhe për të marrë suvenire dhe dhurata. Është krejtësisht e përshtatshme për të negociuar në Vernisazh. Shumica nga shitësit flasin anglisht ose rusisht. Sidoqoftë, tregtarët mund të vlerësojnë menjëherë se kush është vendas dhe kush është turist dhe, natyrisht, turistët paguajnë më shumë.

## DITA E PUNËS

Në Erevan, dita fillon herët. N.q.s. banon pranë Ujvarës, ti do të zgjohesh nga zhurma e madhe që shkaktohet nga rënia e ujit. Çdokund tjetër, do të dëgjosh zhurmën e trafikut, te mprehtë dhe të parakohëshëm. Nxitimi kryesor fillon rreth orës 8.00 të mëngjesit, me

banorët të cilët nxitojnë të shkojnë në punë në këmbë, me metro ose minibus. Fëmijët shkojnë në shkollë të shoqëruar nga mamatë e tyre me taka të larta, të cilat pastaj ikin me nxitim për në punë. Aftësia e grave Armene për të vrapuar me taka të larta është legjendare dhe në mënyrë të veçantë të bën përshtypje aftësia e tyre për të kaluar nëpër shkallët e Erevanit pa u rrëzuar.

Dyqanet zakonisht hapen rreth orës 9.00 të mëngjesit, orë kur ju mund të shikoni femra duke shëtitur nëpër trotuare. Pas nxitimit të mëngjesit, ritmi ngadalësohet në qytet. Ritmi rifillon te gjallërohet rreth orës 5:00 ose 6:00 të pasdites, kohë kur familjet nxitojnë në shtëpi për të ngrënë darkë.

## TË GJESH PUNË

Ndoshta sfida më e madhe e jetës në Armeni është të gesh një punë me rrogë të mjaftueshme për të jetuar. Fatkeqësisht, bizneset që kanë ardhur në Armeni, shpesh mendojnë se Armenia është një vend në zhvillim, ku njerëzit nuk po kërkojnë për paga sipas nivelit të pagave në Perëndim. Sidoqoftë, kjo është shumë larg nga e vërteta. Me koston e jetesës, vazhdimisht dhe dukshëm në rritje, Armenët duan dhe kanë nevojë për paga që t'i pergjigjen nivelit të kostos së jetesës. Në pamjaftueshmëri për të plotësuar nevojat e jetesës me pagën që marrin në punën e përditëshme, disa njerëz, përpiqen të bëjnë dy, madje edhe tre punë. Disa të tjerë pranojnë edhe punë me pagesa të vogla, deri sa t'u dalë në shteg diçka më e mirë, gjë që është zhgënjyese për punëdhënësit e tyre. Dhe ka edhe nga ata që kërkojnë për punë jashtë vendit.

Këtë periudhë, frontet kryesore e më të shumta të punës i përbëjnë shërbimet civile. Shumë studentë të universitetit aspirojnë për pozicione në qeveri, të cilat konsiderohen si mundësitë më të mira. Megjithatë të fitosh një punë të tillë është goxha e vështirë, ata që ja arrijnë janë konsideruar si shumë të suksesshëm dhe që i kanë dhënë një kontribut vendit të tyre. Të rinj të tjerë (të sapodiplomuarit) gjejnë punësim në shumë organizata ndërkombëtare joqeveritare që dhurojnë ndihma në

të holla dhe përpiqen të shpërndajnë ndihmën e tyre në të gjithë vendin , siç janë WorldVision, World Wildlife Foundation and UNICEF. Këto kanë tendenca të paguajnë pak, por i kanë pagat të sigurta dhe ofrojnë përvojë të vlefshme pune. Organizata të tilla janë emra të njohura për punëdhënësit në mbarë botën dhe puna në to shërben si një C.V. (Curriculum Vitae) shumë e dobishme. Shumë të rinj, që sigurojnë punë të mirë, do të vendosin edhe zemrën në të. Ata i kushtohen asaj me rigorozitet të madh dhe nuk shpenzojnë kohën kot për dreka e darka të panevojshme. Nuk është e pazakontë të shikosh të rinj, meshkuj dhe femra, duke punuar deri vonë për të mbaruar një projekt ose një kontratë, dhe, edhe pse jashtë orarit të punës, të bëjnë ose të marrin telefonata pune nga telefonat e tyre të punës.

Ndërsa të rinjtë janë të shumë të vetëdijshëm për nevojën e gjetjes së një pune të mirë dhe për të patur një karrierë, Armenët e vjetër akoma kanë nostalgji për kohën sovjetike kur kishte punë të mundshme për çdonjeri. Të parët që hypin në metro pas punës janë pothuajse gjithnjë të njëjtët, grupi i moshës së mesme dhe të madhe, të cilët e kanë të lehtë të dallojnë punën nga angazhimet familjare. Për ta, të arriturit në shtëpi për vaktin e darkës është gjëja më e rëndësishme. Duke qenë se numri i lindjeve në Armeni ka filluar të zvogëlohet, Armenët janë gjithashtu të shqetësuar se nuk do të jenë aq të mbrojtur sa ç’janë prindërit e tyre ne moshë të vjetër. Në Armeni, pensionet janë zakonisht 20,000 dram për muaj, ose afërsisht 65 dollarë Amerikanë – shumë kjo, pothuajse e pamjaftueshme për të blerë ushqimet e jo më gjë tjetër.

Në zonat rurale, ekonomia është shumë më e zymtë. Më fatlumët punësohen në administratën qeveritare. Pjesa tjetër mbështeten në agrikulturën e vogël. Për të rinjtë, mundësia e vetme është pothuajse gjithnjë që të shkojnë për të kërkuar punë në Erevan.

## SHËRBIMI USHTARAK

Ndonëse shumë patriot, publiku Armen është disi i përçarë në qëndrimin e tij përkundrejt rekrutimit në shërbimin ushtarak, ndoshta

kjo, një mbeturinë nga koha e rregjimit Sovjetik kur Armenët zhvilluan demonstrata të shumta kundër draftit që i detyronte ata të kryenin shërbimin ushtarak në mbarë Bashkimin Sovjetik. Ky qëndrim u ruajt edhe në periudhën post-Sovjetike. Në dy vitet e para të pavarësisë rekrutimi ushtarak ra në nivele shumë të ulta.

Sot, të rinjtë e moshës 18 deri 26 vjeç duhet detyrimisht të kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak që është 2 vjet. Përjashtim bëhet për ata që ndjekin studimet në Universitet, një situatë kjo që shpesh i detyron disa të rinj të qëndrojnë në shkollat e larta deri në moshën 27 vjeç, pas së cilës nuk i kap ky detyrim. Sidoqoftë, po diskutohet që të hiqet ky përjashtim, me qëllim që të mund t'i nënshtrohen këtij rekrutimi edhe të rinjtë e lindur në fillimet e viteve 1990, periudhë kjo, që korrespondon me uljen e numrit të lindjeve dhe emigrimin masiv. Ata që kundërshtojnë ndryshimin e ligjit për studentët universitare, besojnë se duke i bërë thirrje krenarisë kombëtare do të mund të realizohet kjo gjë pa qenë nevoja e ndryshimit të ligjit. Ata pretendojnë se të rinjtë janë mjaft krenarë për vendin e tyre dhe mjafton një thirrje që rradhët e ushtrisë të mbushen me rekrutë të rinj.

# KOHA E LIRË

## TË LARGOHESH NGA GJITHÇKA

Tradicionalisht, banorët e pasur të Erevanit verojnë në male ose pranë liqenit Sevan, ku shtëpitë e pritjes dhe të verës u ofrojnë lehtësim nga zagushia që ka qyteti. Plazhet mbushen plot me plazhista, dhe në mbrëmje aroma e mirë e barbekjusë ndjehet ngado. Por tani, çmimi i pushimeve edhe në Armeni është rritur përtej mundësive financiare të shumicës së njerëzve. Një rezervim në një shtëpi pritje në qytetin-resort të Jermukut kushton afërsisht sa paga mesatare mujore e një personi, dhe udhëtimet dimërore për në resortet e skive janë përjashtim vetëm për njerëzit shumë të pasur.

Për ata, që fatmirësisht kanë mjaftueshëm fonde për pushime larg, variantet janë të ndryshme. Disa njerëz kanë gjetur mundësi më të lira në vendet fqinje. Fondacioni për Zhvillim i Turizmit Armen raporton që udhëtimet për në Gjeorgji thuajse janë dyfishuar në vitet e fundit. Kohët e fundit një shërbim special i shërbimit hekurudhor ka filluar nga Erevani për në Batumi dhe agjentët e udhëtimit kanë filluar të ofrojnë “marrëveshje me leverdi” pikërisht për atë pjesë të Armenëve që dëshirojnë të realizojnë ëndrrën e tyre për të shkuar sa më larg. Një tjetër vend për të cilin po çfaqet një interes i rritur është Turqia. Edhe pse kufijtë janë akoma të mbyllur, zbutja e kufizimeve kohët e fundit, kanë rritur popullaritetin e bregdetit mesdhetar Turk, veçanërisht Antalia. Familjet Armene janë tërhequr si nga kostoja relativisht e ulët dhe cilësia e

shërbimeve, po aq sa edhe nga mundësitë e çmimeve të lira të fluturimeve me avionë tip Charter nga Aeroporti Zvartnots, të cilat janë gjithashtu lehtësime në kalimet kufitare. Bullgaria është bërë një tjetër zgjedhje relativisht e lirë. Dhe, për më të pasurit akoma, aksesit për të shkuar në Dubai dhe Athinë nga Aeroporti Zvartnots, është relativisht i kollajshëm.

## MËNYRË PËR T’U SHPLODHUR

Ndërkohë që pushimet e kushtueshme larg vendit janë akoma një ëndërr e largët për shumë Armenë, ata nuk mendojnë se u duhet të shpenzojnë të gjithë kohën vetëm duke punuar. Madje edhe profesionistët ambiciozë me kollare të bardhë, me zilen e telefonit celular që u bie vazhdimisht për çështje pune, dinë të ulin ritmin e punës herë pas here. Armenet i vlerësojnë momentet e kohës së lirë si një mundësi për t’u shoqëruar, dhe, siç e kemi treguar më sipër, koha e lirë për ta do të thotë bashkim me familjen ose miqtë: ata kanë shumë darka familjare dhe evente speciale për të festuar së bashku, siç janë ditëlindjet dhe përvjetorët. Në raste të tjera koha e lirë mund të shijohet me një shetitje në park.

Të dalësh, për të parë një film apo koncert me miqtë, është një mënyrë e mirë për të shijuar kohën e lirë. Dhe me ringjalljen që ka pësuar kohët e fundit filmi dhe artet në Erevan, aty paraqiten shumë mundësi të mira për të kaluar kohën e lirë. Vendet më popullore për t’u takuar, gjithsesi, mbeten kafenetë dhe baret. Pas pune dhe gjatë mbrëmjes, kafenetë janë të mbushura me të rinj që flasin, qeshin, dhe, sigurisht tymosin. Ndërsa të moshuarit presin të grumbullohen rreth një loje tavlle, kafenetë janë bërë një vendqëndrim i ri për gjeneratën e të rinjve. Përsa i përket bareve, ata janë të mbushur me rini minorene që e konsideron veten pjesë e ajkës së Erevanit, “njerëzit e bukur”.

## Dëshira për t’u paraqitur hijshëm

Kush thotë që paraqitja nuk është gjithçka? Ata, që natyrisht nuk kanë qenë në ndonjë bar apo disko të Erevanit! Pavarësisht nga të

ardhurat e pakta, Armenët janë shumë të etur për t'u veshur mirë e për t'u dukur të hijshëm. Në fakt, shumë të rinj minorenë e gjejnë të pakuptimtë veshjen e çkujdesur të shumë prej vizitorëve të huaj. Në Erevan, ju, shumë thjeshtë mund të gjeni vendin ku ka qëndruar i huaji nga ajo çfarë ai ka veshur; një Armen, i veshur me të shkurtra, xhinse të çara, këpucë tenisi ose sandalle do të shihej si një Armen pa vetrespekt. Bluzat e shkurtra, fundet e shkurtra, varëset e qafës dhe shumë rroba që tregojnë lakuriqësi, të cilat janë shumë popullore për shumë nga femrat vizitore, nuk janë veshur kurrë nga femrat Armene të çdo gjenerate. Për gruan Armene, të paraqitesh në mënyrën më të hijshme të mundshme, është çështje e një krenarie të veçantë. Me fytyrën e ullinjtë dhe ndriçimin e flokut të zi, ato thjesht nuk mund të anashkalohen. Floku është zakonisht i gjatë dhe i krehur mirë, thonjtë janë të manikyrosura në perfeksion, dhe rrobat mbajnë etiketën (të vërtetë apo jo) të modelistëve më të mirë. Këpucët janë pothuajse gjithmonë me taka të larta për shumicën e të rejave, madje edhe gjatë kohës me dëborë dhe akull të dimrit, dhe se si rezistojnë mbi taka gjatë kohës së keqe, kjo është një gjë që të bën përshtypje. Femrat e biznesit veshin kostume të qepura me shumë kujdes.

Me gjithë këtë prirje për t'u kujdesur për veshjen, blerja e rrobave dhe e sendeve shoqëruese të tyre është bërë një sport kombëtar. Ka disa “emra të mëdhenj”, siç është Armani, me qendër operimi në zonën strategjike të North Avenue, por kosto e këtyre rrobave është në mënyrë të konsiderueshme jashtë mundësive financiare të një banori të zakonshëm të Erevanit. Megjithatë, në qendrat e mëdha tregtare ju mund të gjeni edhe dyqane me mallra që janë imitime të markave të dëgjua, të cilët shesin me çmime më të ulta, prandaj nuk ka vend për hutim kur të shihni çmimet. Për shkak se shumë pak artikuj prodhohen në Armeni, rrobat në përgjithësi importohen nga perëndimi dhe kanë një kosto shumë të lartë. Ndonjëherë cilësia e materialeve është zhgënjyese nëse merret parasysh çmimi me të cilin ofrohen. Për të ruajtur një variacion në dollapet e tyre dhe brenda buxhetit, shumë gra armene shkëmbejnë rroba me miqtë ose të afërmit e tyre, gjithashtu

gjejnë mënyra të ndryshme dhe tepër krijuese për përdorimin e një artikulli të caktuar veshjeje.

Për sa i përket bizhuterive, janë të zakonshme varëse të trasha argjendi me gurë gjysmë të çmuar (si, oniks, qelibar, opal dhe malakait) dhe vathë të varur që stolisin në përgjithësi veshët e armenëve. Në tregjet e hapura, siç është Vernissage, është e lehtë të gjesh bizhuteri me dizajn tradicional si “evil eye”, gjithashtu stile moderne. Mos kini frikë të veproni si vendasit dhe të bëni ujdj për një çmim më të ulët.

Vajtja tek parukieri është një aktivitet tjetër i rëndësishëm dhe ju mund të gjeni një sallon pothuajse në çdo rrugë në Erevan, ku krahas rregullimit të flokëve ju mund të kryeni edhe një shërbim manikyri, pedikyri apo edhe trajtim fytyre. Praktikuesit janë tepër të aftë dhe sallonet punojnë shumë që klientët të mbeten të kënaqur. Këto shërbime kanë gjithashtu një kosto relativisht të ulët dhe ka gjithashtu çmime të veçanta për nivele të ndryshme trajtimesh dhe marka të ndryshme produktesh (kjo vlen më tepër në rastin e bojës së flokëve, ku klientët përzgjedhin markën e preferuar). Pa merak për rastin e biondeve dhe kokëkuqeve: parukierët nga Erevani dinë si të arrijnë nuancën e duhur!

Burrat gjithashtu vishen në mënyrë serioze, duke veshur zakonisht rroba të zeza dhe këpuçë të zeza lëkure. Kostumet janë të detyrueshme për biznesmenët, shoqëruar zakonisht nga kollaret. Ngjyrat janë tepër të kufizuara, për të mos thënë që mungojnë plotësisht. Tonalitetet e hapura si bluja e çelur apo roza nuk përdoren aspak, ose janë të pranishme vetëm në detaje. Flokët në përgjithësi janë të shkurtër dhe shumica e rinisë i kushton rëndësi të veçantë tendencave më të fundit. Flokët e gjatë dhe të kapur bisht janë tepër të pazakontë dhe mund të përdoren nga të huajt ose nga artistët që kërkojnë të tregojnë rebelim ndaj të zakonshmes.

Interesant është fakti se, megjithëse i kushtohet shumë rëndësi paraqitjes, vihet re një frekuentim i ulët i palestrave krahasuar me vendet perëndimore. Disa prej “emrave të mëdhenj” të palestrave perëndimore pritet të mbërrijnë në Erevan, por anëtarësimi është

i kushtueshëm dhe palestrat shumë të mëdha janë të vendosura larg qendrës së qytetit. Disa hotele me palestra i lejojnë vendasit të aplikojnë për anëtarësim. Ambientet zakonisht janë të vegjël por të pajisur mirë me makineritë e zakonshme të ushtrimeve dhe disa pishina të mbyllura gjithashtu. Ose, mund të përdoret zgjidhja praktike. Shumica e femrave në Erevan arrijnë të ruajnë linjat duke realizuar ecje të gjata përgjatë qytetit dhe duke qenë të zëna gjatë gjithë kohës!

## CAFÉ LIFE

Po ç'është gjithë kjo jehonë mbi kafenetë legjendare të Erevanit? E thjeshtë; numri i përgjithshëm i tyre mund të shërbejë si tregues i popullaritetit në rritje të këtyre vendeve. Sigurisht, pyesni këdo se çfarë bëjnë njerëzit në Erevan gjatë verës dhe përgjigja do të jetë “dalin në kafe’”. Frekuentimi i tyre është pjesë integrale e kulturës së Erevanit, për këtë arsye, vizitorët shpesh kujtohen për Lindjen e Mesme. Gjatë verës kafenetë mbushen me të rinj të cilët takohen për të pirë ndonjë pije apo kafe. Muzika zakonisht është e lartë dhe konsumohet shumë duhani (ambientet e ndaluara për duhanpirësit janë të pakta në Erevan).

Kafenetë janë zakonisht të vendosura nëpër parqe, sidomos pranë Sheshit të Operas – disi kontradiktore, duke qenë se kjo dikur ka qenë një hapësirë e hapur e gjelbër. Rruga Abovian është një tjetër vend popullor për kafe’, megjithëse hapësira e gjelbër është e pakët. Shumica e tyre hapen rreth orës 11:00 të paradites dhe punojnë deri pas mesnate. Disa kanë të vendosur kolltukë në ambientet e jashtme dhe karrige të rehatshme duke imituar një dhomë ndenjeje të mobiluar mirë. Në disa kafene ofrohet muzikë “live”, gjithashtu është i pranishëm edhe i kudogjenduri “Eurobeat” për të shoqëruar ushqimin.

Sigurisht, kafenetë e hapura janë sezonale, por pronarët mundohen ta zgjasin sezonin e tyre të biznesit sa më gjatë të jetë e mundur. Shumica e bizneseve hapen në pranverë dhe qëndrojnë hapur deri në mesin e tetorit, para fillimit të sezonit dimëror.

## RESTORANTET

Armenët janë tepër krenarë për prodhimin e tyre kombëtar, për këtë arsye restorantet me ushqim tradicional Armen janë të shumtë. Sigurohuni të pyesni një vendas për restorantet më të mirë Armenë, të cilët, në përgjithësi, nuk funksionojnë me synim turizmin. Aty do të mund të shijoni ushqimin tradicional i cili përfshin antipasta të shijshme, supa të mrekullueshme dhe një shumëllojshmëri të mishit të tymosur. Shmanguni nga restorantet e turistëve, të cilët kanë zakonisht tabela me mbishkrime “ushqim tradicional Armen”. Këto vende realisht duhet të quhen “kuzhinë tradicionale post-sovietike”. Aty do të gjeni sallata misterioze, bukë të ndenjtur dhe mish pa shije dhe të fortë pule apo viçi. Nëse kërkonti një barbekju të shkëlqyer, “loë-cost”, duhet të provoni restorantet në Proshian Street, të njohur edhe si Barbeque Street. Erevani është një vend shumë i mirë për të gjetur ushqim mesdhetar. “Sharma” është një pjatë e mirënjohur, siç janë edhe “hummus, kebabet dhe pitet”.

Ju informojmë se janë të paktë restorantet me zona të ndara për duhanpirësit (65% e meshkujve armenë janë duhanpirës). Në dimër kjo mund të jetë disi shqetësuese, duke qenë se nivelet e tymit janë të larta, gjë kjo që gjeneron një kërkesë për ambientet e jashtme të ushqimit edhe gjatë sezonit të dimrit.

Në shumicën e restoranteve, nevojitet të presësh derisa dikush t’ju drejtojë drejt tavolinës përkatëse. Mund të kërkonti të shihni një menu edhe përpara se të jeni ulur. Është e zakonshme që të jetë i pranishëm dikush që flet gjuhën angleze ose në disa raste është e disponueshme një menu multi-gjuhësore. Çmimet e restoranteve janë relativisht të arsyeshme nëse krahasohen me ato të restoranteve në Britani apo SHBA, por duhet të dihet se në disa vende (sidomos në kafenetë e hapura) mund të faturoheni më tepër për shkak të qëndrimit në hapësira të veçanta të restorantit.

Natën vonë, shumë klube nate ofrojnë një menu të plotë dhe janë vendet ideale për të ngrënë pas mesnate, atëherë kur shumica

e restoranteve janë të mbyllur. Në disa raste, ushqimi mund të shoqërohet nga një këngëtar ose një shfaqje kërcimi. Ju mund të porosisni edhe ndonjë pije të shtrenjtë ekzotike dhe sigurisht mundet edhe të pini duhan. Disa restorante dhe klube ofrojnë edhe nargjile.

Nëse keni mundësi, provoni të vizitoni edhe zonat periferike, ku mund të gjeni shumë restorante peshku apo barbekujuje të shkëlqyera me një paraqitje të këndshme. Darkat realizohen me kabina të vogla private, ku shërbehet mish dhe peshk i përgatitur nga ekspertë, si edhe fruta apo perime të freskëta. Do t'ju sjellin ndërmend bukurinë dhe qetësinë natyrale të kampeve verore, por me një ushqim shumë më të mirë! Duke udhëtuar akoma më tepër jashtë qytetit, restorantet përqark qyteteve-resort pranë liqenit Sevan janë të famshëm për shërbimin e pjatave me peshk skare, ndërsa në zonën e Dilijan për pjatat me goca deti dhe kërpudha. Armenët i quajnë restorantet me ambiente të mëdha panoramike Veteroks (nga rusishtja “puhizë”). Ashtu si në çdo destinacion të famshëm turistik, shikoni ku drejtohen vendasit dhe jo drejt ku ndalojnë shumica e autobusëve turistikë. Do të përfitoni një vakt më të mirë me një çmim më tepër të arsyeshëm.

Megjithëse shumica e restoranteve priren drejt ushqimit Armen, në Erevan do të mund të gjeni pothuajse çdo lloj stili gatimi ndërkombëtar. Për shembull, gjenden restorante Meksikane, Indiane, Japoneze dhe Kineze të vendosura brenda rrezes së një apo dy blloqeve nga Opera House dhe restorante Tibetiane dhe Arabe në një distancë të vogël nga Sheshi i Republikës. Për të plotësuar edhe shijet vendase, shumica e tyre ofrojnë edhe ushqim tradicional Armen.

Kur të keni mbaruar së ngrëni, mos prisni që ndokush t'ju nxisë të ngriheni nga tryeza, siç bëjnë në restorantet Amerikane. Ju duhet të kërkoni t'ju sjellin faturën përpara se dikush ta sjellë atë tek ju. Ndonëse CASH-i është pagesa më e preferuar, në ato restorante që pranojnë pagesë me Kartë Krediti zakonisht pranohet karta VISA ose MasterCard (Diners Club dhe American Express pranohen rrallë).

### **Bakshishi**

Fenomeni i bakshishit çfaqet që me mbërritjen tuaj në Aeroport. N.q.s. ndokush ofrohet që t'ju ndihmojë me mbajtjen e valixheve, kjo është një shenjë që ai pret një bakshish. Gjithashtu, taksisti që ju merr në aeroport, pret një bakshish; si rregull 10 deri 15%. Në restorante, përsëri llogarisin që mund të marrin 10 deri 15% bakshish. Dhe, përfundimisht, nga një i huaj, presin që t'u ofrohet bakshish më shpesh dhe natyrisht më i lartë.

## **USHQIMI ARMEN**

Ushqimi Armen është shumë domethënës për ata që vizitojnë Armeninë. Ai reflekton bujarinë e krahinës, dashurinë e njerëzve për traditat e lashta, respektin për traditat e besimit, dhe influencat e jashtme që janë pjesë e historisë së gjatë dhe të larmishme të vendit.

Për Armeninë, unikal është fakti që shumica e ushqimeve janë thjesht vendase, pavarësisht forcës politike që ka qenë në fuqi në kohë të ndryshme. Pjata tipike Armene përfshin çomlek me kungull (ghapama), supë jogurt (tahnabur), qofte mishi Armene (hajasdan kjufta), troftë Sevani (ishkan), qull me mish qengji (harise), dhe supë e zier fort me thundra lope(kash – për të cilin do flasim më poshtë).

Në rastin më të mirë, ushqimet Armene përbëhen prej prodhimesh të fresketa (bio) të rritura në luginat e buta e të shumta të vendit. Fiqtë, kajsitë, mollët, hurmat, qershitë, shegët, portokallet dhe rrushi janë përbërësit më të zakonshëm në ushqimin Armen. Domatet, kastravecet, majdanozi, preshi dhe misrat e ëmbël janë gjithashtu të përfshira në menunë tipike të ushqimit

Ndjehet një farë krenarie në faktin se një vakt Armen merr shumë kohë për t'u përgatitur. Disa receta u përkasin mijëra viteve më parë ose edhe më shumë, dhe ka shumë kërkesa për përgatitjen e tyre. Shumë ushqime tradicionale Armene të shpenzojnë më tepër kohë në

përgatitje se sa në zbatimin e recetave duke përdorur pajisje moderne. Përzjerja e frutave për basteg (e ngjashme me një shtrydhëse frutash) kërkon 10 ditë për t'u tharë. Suxhuku (mish viçi i tharë), zakonisht i bërë në fillim të vjeshtës, të merr 2 ditë kohë për t'u përgatitur dhe një muaj që të jetë gati për t'u ngrënë.

Feja dhe komuniteti luajnë gjithashtu rol kryesor në përgatitje. Për shëmbull, është madag - u, një përkujtim i gjenocidit, që përfshin shërbimin fetar dhe grumbullimin e madh të njerëzve për të ndarë një vakt komunal. Ushqimet tipike për rastet e organizimeve madag përfshijnë çomlek qingji me pilaf të bërë nga bulgur (bollguri), dhe lavash (shih më poshtë). Ushqimi kërkon ditë për t'u përgatitur dhe shumë individë nga komuniteti shkojnë për të ndihmuar.

Disa thonë se ushqimi Armen është Lindja e Mesme, por kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Kuzhina Armene është shumë e ndikuar nga Lindja e Mesme, por kulturat Europiane dhe mesdhetare gjithashtu kanë formuar historinë e tyre. Ju mund të gjeni **baba ganoush**, **tabouleh**, **hummus**, and **halvah** (hallvë) në shumë tavolina Armene, por ju gjithashtu mund të gjeni pica dhe patate të skuqura alla franceze (patate fritte).

### Përse kaq shumë shegë?

Armenët e quajnë shegën – noor. Noor-i ose shega enigmatike ze një vend të veçantë në kulturën Armene si symbol i ciklit të jetës dhe rilindjes. Sipas legjendës, secila nga kokrrat (farat) e kuqe të tejudkshme, përfaqëson një ditë të veçantë të vitit aktual të jetës tuaj (një shegë e plotë besohet të ketë 365 kokrra). N.q.s. ju hani një kokërr (farë) në ditë, thuhet që do ju sjellë fat të mbarë! Shegët janë në ngjyrë të kuqe, ngjyrë kjo, e respektuar nga Armenët. Ajo përfaqëson të gjithë gjakun që është derdhur gjatë shekujve për hir të Atdheut.

Shegët janë një zgjedhje e shëndetshme. Ky frut ka shumë vitamina C dhe B dhe ka zëra që pohojnë se ka edhe antioksidantë. Sidoqoftë, të hash atë, duhet mjeshtëri e veçantë dhe durim. Fruti çahet me thikë dhe hapet me qëllim që kokrrat të nxirren veç nga cipa mbështjellëse që i mban kokrrat të bashkuara. Ka nga ata që përtojnë t'i veçojnë kokrrat dhe i hanë bashkë me cipën mbështjellëse, ndonëse duhet thënë që pjesa më e shijshme është kokrra. Ka nga ata që nuk duan t'i hyjnë aventurës së hapjes së shegës, por preferojnë të blejnë reçel shege, që gjendet me shumicë në tregun Armen.

Drejtori Armen Sergei Parajanov, në vitin 1968, nxorri filmin Ngjyra e Shegës. Ai u lavdërua nga kritikët dhe fitoi shumë çmime prestigjioze, por më vonë ai u censurua dhe u ndalua në Bashkimin Sovjetik si shumë modern. Filmi është një biografi e poetit Armen, Sajat Nova, që përshkruan jetën e tij nëpërmjet imazheve përfytyruese të nxjerra nga imagjinata e Parajanovit dhe poemat e autorit. Aktori kryesor luan gjashtë role, si mashkullore dhe ato femërore, dhe ka fare pak dialog ose levizje kamerash. Sidoqoftë, ai është konsideruar si një film pikë referimi në lëvizjen kinematografike Armene.

### Lavashi (Pite – në Shqip)

Elementi kryesor i pothuajse çdo vakti është lavashi, një lloj buke e sheshtë, e butë, e hollë, e bërë me miell, ujë dhe kripë. Pothuajse çdo restorant e shërben atë, dhe pothuajse çdo gjë në fund të fundit mund të mbështillet në të dhe të hahet si një vakt. Lavashi Armen është shumë ndryshe dhe shumë më i hollë se sa ai që shitet në vendet perëndimore.

Si shumë ushqime te tjera Armene, Lavashi kërkon shumë kohë dhe përpjekje për t'u përgatitur. Pothuajse gjithmonë përgatitet me duar. Brumi përgatitet dhe bëhet i sheshtë, pastaj piqet në një furrë tradicionale tip Lavash nga nxehtësia që lëshojnë muret e saj (e ngjashme

me një furrë balte). Gjatësia e lavash-it duhet të jetë midis 60 dhe 70 cm dhe gjerësia 30 dhe 38 cm. Nuk duhet të jetë më i trashë se 0.2 cm (2 mm). Për faktin që lavashi është një element kaq parësor në jetën Armene, disa bukëpjekës formojnë një kryq në brumë para se ai të piqet - një nderim i vogël ndaj Zotit që u siguron këtë nevojë bazike.

Ndonëse është shumë i përkulshëm kur është i freskët (i ngjashëm me një tortilla), lavashi thahet jashtë shumë shpejt dhe bëhet i brishtë dhe i fortë pas disa orësh. Një sasi e vogël uji mund ta sjellë përkohësisht në gjendjen fillestare, por është pothuajse e pamundur për t'u ruajtur gjatë natës dhe nuk duhet të vendoset në frigorifer – do të bëhej thërrime të thata në mëngjes.

## **Khash and Khashing**

Një traditë e ushqimit Armen që mbetet enigmatike për shumicën e Perëndimorëve është festa e Khash-it. E thënë troç, ai është një festival supe të gatuar me kukurec dhe thundra. Por sigurisht, si shumica e traditave, është me shumë se sa aq. Khashing është një kundërhelm ndaj dimrave të gjatë Armenë. Ndërsa jo çdokush mund të përballojë që të shkojë të bëjë ski ose të udhëtojë në vende të nxehta, pothuajse çdokush mund të shkojë për khashing dhe të kalojë një kohë shumë të këndshme (edhe nëse ata e hanë supën ose jo). Në një fshat Armen një festë khash mund të zgjasë disa ditë.

Shumë kultura të Lindjes së Mesme kanë ushqim të ngjashëm me ato të festës khash. Në kohët e herëshme, të varfërit kishin të bënin me mbetjet e mishit të hedhura nga të pasurit. Pra, nga nevoja, fshatarët sajuan gjellë për t'i bërë ato sa më të ngrënëshme që të ishte e mundur. Të bërit Khash është një proces i lodhshëm pune, shumë intensiv. Se pari, mishi duhet të pastrohet, të njomet mirë në ujë dhe të cfijëzohet - një proces që mund të marrë më shumë se 24 orë kohë. Pastaj, kur supa është duke u gatuar, një person duhet të qëndrojë pranë tenxheres dhe

---

Shënim: Në Shqip, fjala Armene kashel përkthehet ziej, vloj. Kash – do të thotë – e zier, e vluar.

ta përziejë atë në intervale të rregullta kohe. Dhe duhet kontrolluar në mënyrë konstante, për të parë nëse ajo ka arritur trashësinë e duhur.

Sapo të jetë gati, khashi shërbehet me hudhër, majdanoz, rrepka dhe lavash . Khash-lavash është një rimë që zakonisht e dëgjon në një bashkim khash. Lavashi mund të hidhet direkt në supë ose përdoret veçmas për t'u ngjyer në khashin e trashë. Një tjetër përbërës për khashing, që nuk duhet të mungojë, është sigurisht vodka, e cila është pjesë shumë e rëndësishme e ritualit social.

N.q.s. je i ftuar në një festë khash, ti thjesht duhet të shkosh. Dhe mos u shqetëso - shumica e fillestarëve falen nëse nuk boshatisin komplet tasat e tyre.

### **Mëngjesi (Nahaxhash) dhe dreka (Xhash). (Të ngrënët)**

Armenët e kanë zakon të hanë mirë. Ndonëse darka është vakti kryesor, janë të gjitha mundësitë për të provuar specialitetet Armene përgjatë gjithë ditës.

Për mëngjes, shumica e Armenëve që janë me nxitim, marrin kafe të forta, shoqëruar ndoshta me biskota ose bukë dhe marmelatë. Në restorante zakonisht ju mund të merrni ushqim të bollshëm që përfshin mish të ftohtë, peshk, perime të konservuara dhe omleta. Një omletë me vezë të rrahura dhe me domate të freskëta është gjithashtu mjaft tradicionale dhe këtë zakonisht mund ta porosisësh edhe në hotel. Në pjesën rurale të Armenisë, njerëzit shijojnë kosin e freskët (maxun) të maleve që vjen me lloje dhe trashësi të ndryshme. Ndonjëherë, shtohet mjalt ose sheqer për ta ëmbëlsuar atë.

Tradicionalisht, vaktet e drekës janë të lehta. Sallatra, patate dhe mishra të pjekura ose të përgatitura në barbekju janë ushqimet më të mundshme nëpër restorante. Picat gjithashtu janë bërë popullore në Erevan. Disa njësi ofrojnë porcione të vogla për turmat e njerëzve në mesditë. Në ditët e nxehta është tipike të hahet një "sharma" ose një tjetër ushqim i shpejtë në një Fast-Food (që zakonisht shërben vetëm si një dhomë qëndrimi).

## Ngjarja kryesore: Darka (Të ngrënë)

Darka zakonisht hahet pas orës 17.00. Shumica e familjeve e hanë atë zakonisht rreth dy orë më vonë, kur puna, shkolla dhe të psonisurit ka mbaruar dhe nëna ka kohë për përgatitjen e ushqimit. Restorantet dhe kafenetë e servirin darkën deri vonë, shpesh deri në mesnatë.

Shumica e familjeve nuk kanë rast ta shijojnë çdo natë ushqimin Armen në tërë kompleksitetin e tij, kështu që mund të konsiderohet trajtim i veçantë pjesëmarrja në një darkë të tillë. N.q.s ju qëllon që të merrni ftesë për darkë në shtëpi, ku darka do të shërbehet për miqtë, kjo do të jetë një eksperiencë që ju dhe stomaku juaj nuk do ta harroni.

Sapo të mbërrini, do të ftoheni të qëndroni në dhomën e pritjes, ku do të gjeni të shtruara antipasta të shumëllojshme. Bëni kujdes me to, pasi mund të hani aq shumë prej tyre sa nuk do të keni më vend për ushqimet e tjera. Zakonisht, si antipastë shërben djathi Armen, suxhuk feta, hummus, bathë dhe sallaturina vegetale, natyrisht dhe buka. Dollmatë janë gjithashtu shumë popullore, të gatuar me gjethe rrushi në verë dhe lakre në dimër. Në këto raste ka gjithmonë edhe Lavash. Pjata e parë, zakonisht, është supë (siç është spasi, i përgatitur me kos dhe drithë, ose borshi) ose ndonjë specialitet tjetër siç është mish i palosur i mbushur me djathë ose erëza. Për fat të mirë, këto shërbehen në porcione të vogla, pasi ka akoma shumë për të ardhur.

Pjata kryesore është me mish ose peshk, në disa raste edhe të dyja bashkë. Ndërgjegja shëndetsore ndjehet e kënaqur kur vëren se mishi, zarzavatet dhe peshku në pjesën më të madhe janë të ziera, të pjekura në grill ose barbekju. Shashliku (fjalë Ruse) – një imitim Arab, i cili në Armenisht thirret khorovats, është i pjekur në grillë dhe jo domosdoshmërisht shërbehet me hell. Gjithashtu, popullore janë baskyrat, të cilët janë rripa shumë të hollë – pothuajse si fije – mish viçi të zier të përzier me arra dhe cilantro (coriander) dhe të mbuluar me kos. Shumica e pjatave kryesore shërbehen me oriz.

Normalisht, menuja kompletohet me fruta dhe ëmbëlsira, të ndjekura më pas me një kafe të fortë Armene. Mund të çfaqen edhe keku

e ëmbëlsirat e stilit Perëndimor, ndonëse fundi mund të jetë edhe me një bakllava të rëndë. Armenët besojnë në shprehjen “pastroni pjatën”, kështu që ata e marrin të ngrënë shtruar dhe përpiqen të përfundojnë çdo gjë që u serviret përpara. Dhe mos u çudisni kur të konstatooni që posa të keni mbaruar pjatën, mikpritësi juaj t’ju a mbushë atë përsëri, madje më shumë së më parë. Kur mendoni që keni ngrënë mjaftueshëm, ju mund të thoni: shad mersi, gusht jem, ose shnorhagalutjun, gusht jem (faleminderit, jam ngopur), ose el çe (jo me), ose pavarar e (mjafton).

### Një ushqim i vonë

Për ata që janë ende në gjendje të përballojnë ushqimin përpara se të tërhiqen, ka gjithmonë një ushqim të lehtë të natës së vonë. Ky mund të përbëhet nga çaji barishtor ose Anglez, bukë me reçel, dhe shpesh kosi. Një specialitet Armen është popoki muraba (reçel ose gliko arre), e cila është e bërë nga arra e gjelbër (arrë e njomë me lëvozhgën jeshil) e zier në shurup derisa bëhet shumë e ëmbël. Është një ëmbëlsirë unike Armene, dhe më shpesh e gjendur në fshat.

### PËR TË PIRË

Fëmijët dhe shumë të rritur gjithashtu, kënaqen nga shumëllojshmëria e lëngjeve të freskëta që ofrohet në Armeni. Frutat siç janë banania dhe qershia e zezë mund t’i gjeni në shumë dyqane dhe restorante. Çaji nuk është aq popullor sa kafeja, e cila gjithmonë shërbehet e fortë. Uji mineral nga fshati është me bollëk, dhe është çështje krenarie. Uji i paketuar dhe ambalazhuar është një fenomen i ri, i cili vjen nga vizitorët e huaj (kryesisht Amerikanët) të cilët pyesin për këtë lloj. Pija alkolike kombëtare është konjaku. Në fakt, konjaku Armen ishte i preferuari i Winstron Churchillit (i cili e priste me padurim dërgesën e konjakut, pasi Stalini ja kishte rekomanduar për herë të parë në Jaltë). I famshmi konjaku Ararat vjen nga lugina e Araratit, ku toka vullkanike është shumë e mirë për të rritur rrushin e konjakut. Shumëllojshmëria e konjakut varet nga mosha, ku më i miri është gjithmonë më shumë se

12 vjeçar. Ju mund të takoni disa nga prodhuesit e konjakut në Erevan. Vodka Armene me frut mani, e cila prodhohet si industrialisht ashtu edhe në shtëpitë Armene, është shumë popullore. Përveç se është shumë e shijshme, besohet se ka edhe disa veti kuruese.

Vera ka një histori më të ndërlikuar se konjaku. Armenët kanë një histori tremijëvjeçare të të bërit të verës, por pas rënies së Bashkimit Sovjetik tregu i veres shterroi, kantinat e verës u mbyllën, dhe cilësia dhe sasia e verës së prodhuar ranë shumë. Megjithëse prodhuesit e verës po provojnë të rikthehen në treg, ata po përballen me verërat e lira që vijnë nga Australia, Argjentina, Kili dhe Gjeorgjia. Vera e kuqe Armene, që prodhohet aktualisht, priret të jetë shumë më superiore se vera e bardhë.

## EVENTET KULTURORE

Në Armeni, jo gjithçka është kafe dhe ushqim. Në kohën e lirë, ata janë gjithashtu të përkushtuar ndaj muzikës, artit visual, teatrit dhe filmit. Në Erevan, ndjehet një ringjallje dhe një vlerësim i ri për artin Armen. Galeritë, sallat e koncerteve dhe teatrot gëlojnë nëpër gjithë qytetin.

## Filmi

Më eksituese është situata e filmave Armenë. Pyet çdo banor vendas, dhe ai ose ajo me entuziazem do t'ju thotë se industria e filmit në Armeni është në ngritje. Një gjeneratë e re, e talentuar e prodhuesve të filmave janë qartësisht të fokusuar në paraqitjen e historive Armene në mënyra të reja (inovative). Pse ky lulëzim në filmat Armenë? Është thënë se, megjithëse shteti vazhdon të mbajë nën kontroll gjithçka që është prodhuar në periudhën Sovjetike, studio Hayfilm, që është akoma ndërmarrje shtetërore, nuk vazhdon në rrugën klasike të trajtimit të çështjeve siç vazhdon në pikturë apo muzikë.

Kështu që, prodhuesit e filmave që nuk kanë qenë të lidhur me ndonjë traditë të veçantë, kanë qenë të lirë për prodhuar punime të cilat janë me të vërtetë shprehje e tyre individuale. Industria e filmit

është në qendër të vëmendjes në verë, me Festivalin “Golden Apricot International Film”, që zhvillohet në Erevan. Duke filluar nga 2004, aktivitetet e realizuara synojnë të ndërtojnë ura lidhëse ndërmjet kulturave dhe grupeve etnike. P.sh. nuk është gjë e zakonshme për festivalin që të organizojë një seminar të përbashkët të filmprodhuesve Armenë dhe Turq. Gjatë festivalit, Erevani gjithashtu, paraqitet me më të mirën e tij, me koncerte dhe çfaqje të tjera në ambientet e jashtme. Po gjatë pjesës tjetër të vitit, ku mund të shihen filma Armenë? Lokalet që ndodhen në Galerinë Kombëtare Armene të dyndin me çfaqje filmash. Shpeshherë ato janë çfaqje tematike, por më interesante janë ato që ofrojnë sesione me pyetje dhe përgjigje nga drejtorët e filmave.

## Muzika

Përsa i përket muzikës, në shikim të parë, të krijohet ideja se komuniteti muzikor Armen është i fiksuar pas muzikës klasike. Godina e Operas, p.sh., ofron Orkestrën Filarmonike Shtetërore Armene e cila luan muzikë dhome, dhe kurdoherë që është e mundur ajo prezanton artistë dhe produksione Armene. Shpesh ju mund të dëgjoni ekzekutimin e muzikës së të madhit kompozitor Armen Aram Kaçaturian (përpara godinës së Operas qëndron një statujë e tij me duart madhështore). Muzikë klasike mund të dëgjohet gjithashtu në disa prej ambienteve më të vogla, duke përfshirë këtu Konservatorin Muzikor Shtetëror të Erevanit dhe Sallën e Orkestrës së Dhomës.

Nga ana tjetër, duket një preferencë e qartë për muzikën popullore Armene, e cila është shumë e ndryshme nga ajo që dikush mund të dëgjojë në vendet e Europës Lindore ose të ish Bashkimit Sovjetik. Muzika popullore tradicionale Armene është bazuar në sistemin tetrakord (jo si ajo Europiane oktav), e ngjashme me muzikën e Lindjes së Mesme ose Indiane. Nota e fundit e një tetrakorde, në shumë prej muzikave popullore Armene, shërben gjithashtu si notë e parë e një tetrakorde tjetër, e cila teorikisht e bën shkallën të pafund.

Armenia ka zhvilluar veglat e veta muzikore për të luajtur

muzikën e vet unikalë. Në to hyjnë Tar (një lloj lahute qafë-shkurtër), Duduk (një instrument me kallam), Oud (lahutë), dhe Dhol (daulle). Ju mund të blini secilin prej këtyre instrumentave në Vernisazh, ndonëse të luash me to është shumë më e vështirë se ç'duket me shikim të parë. Për të dëgjuar muzikën e Dudukut të madh është mirë që të blini një kompakt disk jo të shtrenjtë të ndonjerit prej mjeshtrave në Vernisazh.

Kërcimi popullor, gjithashtu, po jeton një ringjallje. Fëmijët i mësojnë këto valle që në vegjëlinë e hershme dhe pastaj i praktikojnë ato në ngjarje festive apo dasma. Madje, edhe në restorante apo grupime festive, nuk është e pazakontë të shohësh grupe femrash, që duke dalë nga rutina tradicionale, të kërcejnë valle popullore në sheshet e vallëzimit. Më popullor është vallëzimi linear Armeni, i cili mund të jetë i thjeshtë ose i përpunuar. Është shumë e mundshme për një të huaj që të shtiret sikur po imiton këto lëvizje, pa qenë shumë i sigurt në atë që bën. Kujdes, - një valle popullore Armene mund të zgjasë 15 minuta ose më shumë.

Muzika moderne ka tendencë të shkojë drejt muzikës pop dhe rock Ruse dhe Amerikane (videot e tyre muzikore janë të pranishme në klubet e natës, hotelet, sallat e gjimnastikës dhe, madje në sallonet e rregullimit të flokëve). Një pakicë pop starësh nga Armenia janë duke çarë përpara, dhe ka shumë grupe të tjera të suksesëshme nga Diaspora (si p.sh. System of a Doën). Gjithashtu, ka disa muzika interesante në skenat ku luhet muzikë Jaz dhe ajo që quhet Avant-Gardë. Më e njohura, Banda Detare Armene, emri i së cilës në fakt, nuk përfaqëson gjë tjetër përveçse “një përshendetje ironike” për vendin e vet pa dalje në det, luan shpesh në Erevan.

## Artet vizuale

Artet vizuale ndoshta kanë qenë artet më të kufizuara në periudhën Sovjetike. Direkt pas rënies së Sovjetëve, u rizbuluan lëvizje të tilla siç ishte Kubizmi dhe stilet revolucionare të Rodshenkos dhe Kandinskit.

Për fat të keq, në fillim të viteve 1990 pati një periudhë kur “çdo gjë që shitej” ishte në rend të ditës. Që nga momenti që ekonomia filloi të rimerrte veten, sidoqoftë, artistët filluan të ndjenin një frymë liberalizimi, dhe liria e rigjetur prej tyre është e dukshme në shumë nga veprat e tyre. Ndër artistët bashkëkohorë më të njohur hyjnë Karen Agamian, Artur Sarkisian dhe Hagop Hagopian.

Punët e para të artistëve të rinj mund të shihen në galeritë dhe panairët e tjera që organizohen nëpër Erevan. Megjithatë disa prej artistëve preferojnë të qëndrojnë larg galerive, pasi pronarët e tyre shpesh kërkojnë nënshkrimin e kontratave ekskluzive ose me kushte tepër kufizuese. Këta individë preferojnë t’i ekspozojnë punët e tyre në “tregun e lirë” në Vernisazh, ku artisti mund t’ja shesë direkt pikturën e tij klientit, pa ndërmmjetës. Në të vërtetë, në piktorët e Vernisazh bëjnë pjesë edhe shumë tradicionalistë, të cilët ofrojnë piktura me vallet Armene si dhe shumë nga ato me pamje të Araratit; por mjafton të shihni përreth dhe do të dalloni një sërë artistësh të shquar. Ngjyrat e çelura dhe trajtat e mprehta janë më të preferuarat për artistët e Vernisazh. Një tjetër vend ku artistët i ekspozojnë shpesh punimet e tyre është edhe sheshi pranë Godinës së Operas.

## Drama

Teatrot kanë vënë në skenë një sërë dramash tradicionale Armene (dramat e William Sarojan luhen shumë shpesh). Për ata që kërkojnë të shohin dramat moderne, kontrolloni se çfarë luhet aktualisht në Qendrën Armene të Artit Eksperimental Kontemporan, ku artistët luajnë në një metër kuadrat skenë, dhe interpretojnë akte të tjera interesante. Pothuajse të gjithë këto lloj çfaqjesh, tashmë, luhen në Armeni.

## Aktivitete të tjera

N.q.s. ju mërzhiteni nga teatrot, galeritë e arteve, filmat dhe koncertet, ose fëmijët tuaj ju luten për diçka më të pranueshme,

gjithmonë do të mund të shihni Shatërvanet Vallëzues në Sheshin e Republikës. Shatërvani i madh publik është i ndriçuar me drita me ngjyra të ndryshme dhe lazer, dhe uji “vallëzon” si me muzikën klasike ashtu edhe me këngët pop. Në një natë të ngrohtë vere, kjo mund të shërbejë si një zbatimje e mirë familjare, si edhe një shans i mirë për një shetitje në qendër të Erevanit. Për të pasur një informacion më të saktë dhe aktual të eventeve në Erevan, mund të vizitoni; [visitarm.com](http://visitarm.com). Lista e eventeve aktualizohet çdo javë dhe ju ndërkohë mund të keni njoftime në E-mailin tuaj. Ndërkohë përpiquni të kontrolloni në Facebook për ndonjë grup artistësh Armenë. Ju do të keni informacion të rregullt se ku do të zhvillohet çfaqja tjetër e rradhës e tipit modern (avant-garde).

## SPORTET

Pa dashur ta quajmë saktësisht sport, loja e shahut, është pa dyshim mënyra më e mirë për të kaluar kohën e lirë për Armenët në nivel kombëtar. Armenia ka fituar Olimpiadën Bienale Ndërkombëtare të Shahut në vitin 2006 dhe 2008. Kampionatet e shahut zhvillohen rregullisht në shkollat Armene. Dhe ndonëse ju mund të shihni shumë lojtarë të apasionuar të tavllës nëpër rrugët e Erevanit, konkurrentët më të fuqishëm janë ata që luajnë shah. Futbollit është lojë popullore, ndonëse në vitet e fundit rezultatet e skuadrave Armene nuk i kanë kënaqur shpresat e tifozëve të saj. Tifozët më entuziaztë të këtij sporti, në shumicën e rasteve, kanë nga një klub European të preferuar siç është Real Madrid ose Manchester United. Kampionati European dhe ai Botëror janë ngjarje të mëdha për qytetin e Erevanit, ku nëpër kafenetë vendosen monitorë të mëdhenj për tifozët e apasionuar të basteve. Sportet individuale, siç janë peshëngritja, mundja dhe boksi, janë gjithashtu popullore. Kampioni i Botës në boks Vahtang (Vic) Darçinian, që ka lindur në Vanadzor të Armenisë, tani jeton jashtë shtetit; por ai ka mbetur një hero i krahinës së tij.



## UDHËTIMI, SHËNDETI DHE SIGURIA

Të shkuarit në Armeni është një aventurë. Duke qenë se ajo ndodhet jashtë rrugëve të rrahura, ju duhet të bëni më tepër përgatitje, por kjo do t'ju shpërblehet. Ndërkohë që turistët që kanë vizituar kullën Eiffel janë me miliona, sa janë ata që kanë arritur ta shohin majën madhështore të malit Ararat në një mëngjes të qartë e të freskët?

Armenët janë të mirëpërgatitur për të pritur vizitorë, kushdo qofshin ata, udhëtarë kuriozë ose kushërinj nga Diaspora të çfaqur pas kushedi sa kohësh mungesë. Janë dizenuar shumë web site të cilët hedhin dritë mbi vendet me interes për t'u parë brenda Armenisë; dhe agjensitë turistike të vendosura në Erevan dhe në të gjithë zonën e Kaukazit mund t'ju ofrojnë ture dhe udhëtime turistike me udhëheqës si dhe mund të kujdesen për akomodimin tuaj nëpër hotele apo apartamente. Disa prej këtyre agjensive kombinojnë vizita turistike në Tbilisi dhe Erevan.

Përveç tureve, është plotësisht e mundur të aventurosh në Armeni pa qenë nevoja për të formuar ndonjë grup formal. Ndonëse njohuritë në gjuhën Armene ose Ruse do të ishin shumë të nevojshme në këtë sipërmarrje, në Erevan ka shumë Anglisht-folës që mund të ndihmojnë atje ku është e nevojshme, dhe ka shumë restorante dhe hotele ku ju do të gjeni ushqim dhe shplodhje. Mjafton të jeni të përgatitur për eksperiencën të reja dhe ta keni mendjen e kthjellët.

Të rinjtë me prejardhje Armene (së paku njeri nga gjyshërit), të cilët janë në moshën ndërmjet 20 dhe 32 vjeç mund të aplikojnë për

një udhëtim miqësor nga programi i të drejtës së lindjes Armene. Ata të cilëve u miratohet aplikimi përfitojnë falas udhëtim me avion, akomodim në familje miqësore, takime miqësore dhe ekskursione, dhe në këmbim të kësaj kryejnë shërbim vullnetar ushtarak për tetë javë (zakonisht jashtë Erevanit). Prej tyre pritët që të kenë së paku një njohje bazike të gjuhës Armene; në rast të kundërt, n.q.s. është e nevojshme, për ta përgatitet një kurs i shkurtër njohës.

## VIZA

Për të hyrë në Armeni duhet të kesh me vete pasaportën dhe vizën e hyrjes. Viza kërkohet për të gjithë shtetasit e huaj, me përjashtim të atyre që janë nga Commonwealth of Independent States. Marrja e Vizës është relativisht e lehtë. Ju mund ta merrni atë në çdo Ambasadë Armene në çdo vend të botës, ose kur të arrini në Aeroportin Zvartnots të Erevanit. Një Vizë hyrëse kushton rreth 50 USD dhe është e vlefshme për 120 ditë qëndrimi dhe vlen vetëm për një hyrje (n.q.s. ju dilni nga vendi, ajo duhet rinovuar – dhe duhet paguar – për rihyrjen). Gjithashtu është e mundur që të merret Vizë një vjeçare me shumë hyrje-dalje, e cila natyrisht që kushton më shtrenjtë.

Për shtetasit e huaj që kërkojnë të qëndrojnë më tepër se 120 ditë për qëllime biznesi kërkohet që të dërgojnë në Armeni një letër kërkesë nga kompania në të cilën punojnë. Letra duhet të përshkruajë natyrën e biznesit që mendohet të kryhet, emri dhe adresa e kompanisë (personit) pritës në Armeni, dhe garancia e mbulimit të shpenzimeve që do kryhen nga ana juaj dhe e detyrimit tuaj për t'u kthyer në vendin nga keni ardhur.

Disa të huaj mund të pajisen me Status Special Rezidencial (qëndrimi) për 10 vjet. Zakonisht, kjo aplikohet për qytetarët e huaj me paraardhës Armenë dhe për ata që kanë dhënë shërbime të çmueshme në dobi të Armenisë dhe janë të përfshirë në aktivitetet ekonomike e kulturore që zhvillohen në vend. Njëkohësisht në Armeni, ata gëzojnë të gjithë mbrojtjen që u siguron ligji Armen, kanë të gjithë të drejtat dhe detyrimet si qytetarët Armenë, me përjashtim të drejtës së votës dhe

emërimin në detyra shtetërore zyrtare. Gjithashtu, ata janë të përjashtuar nga shërbimi ushtarak. Të mbijetuarit e gjenocidit Armen zakonisht pajisen me këtë status pa qenë nevoja për pagesë.

Kur dilni nga Armenia, jeni i detyruar të paguani një pagesë dalje. Përpiquni të verifikoni sa është pagesa aktuale (pasi ajo ka tendencë të ndryshojë vazhdimisht) me qëllim që të keni me vete një sasi të mjaftueshme lekësh (dram) në momentin e largimit. Pagesa e daljes duhet bërë detyrimisht përpara se të bëhet Check-ini i fluturimit.

## **MBËRRITJA NË ARMENI**

Kontakti juaj i parë me Armeninë ka mundësi të jetë në Aeroportin Internacional Zvartots, që ndodhet jashtë Erevanit. Shumë prej fluturimeve hyrëse apo dalje nga Armenia janë planifikuar të mbërrin në natën vonë ose herët në mëngjes, por mos u shqetësoni. Aeroporti është në gatishmëri të plotë për t'u kujdesur për ju.

Zvartots-i është burim krenarie për shumicën e Armenëve. Ai është ndërtuar në vitin 1961, dhe e ka hapur terminalin e tij të mbërritjes të rinovuar në vitin 2006. Ana e brendshme është plot shkëlqim, modern dhe shumë mikpritëse. Përpara se të kaloni nga Dogana, ju kaloni ndërmjet dyqaneve Duty Free Shop, ku shërbejnë plot zell djem e vajza të reja. Nëpunësit e Doganës normalisht janë shumë efikasë, sidomos në rastet kur ju e keni marrë Vizën e hyrjes që parë; në rast të kundërt, procedura e hyrjes do ju marrë pak më tepër kohë.

Në Aeroport ka autobuse dhe minibusë që mund t'ju çojnë në Erevan (i cili ndodhet rreth 12 km larg nga Aeroporti), ose më thjesht, mund të merrni një taksì. Në fakt, do të gjeni plot taksistë që do t'ju luten t'ju transportojnë juve në qytet. Bëni kujdes që të zgjidhni një taksì të licensuar, pasi taksitë e pa licensuara mund t'ju kërkojnë më shumë para. Normalisht, udhëtimi me taksitë e licensuara kushton 4000 deri 5000 dram, të cilave ju duhet t'i shtoni një bakshish 10 deri 15%. Sidoqoftë, është më mirë që të bini dakord me drejtuesin e mjetit për çmimin përpara se të hypni në taksì.

## TË VIZITOSH EREVANIN

Kur të mbërrini në Erevan, do ta kuptoni që, në qofte se ju lejon moti, të ecurit në këmbë është mënyra më e mirë për një lëvizje normale nëpër qytet, dhe kjo është ajo që bën pjesa më e madhe e njerëzve. Në qoftë se ju preferoni të lëvizni me automjet, ose në qoftë se distanca e lëvizjes do të jetë e gjatë, do të mund të gjeni metro, autobuz, taksi dhe tren.

Erevani është një qytet relativisht i vogël dhe nuk është e vështirë për ta shetituar në këmbë sheshin qendror brenda dy orëve, në të gjithë gjerësinë e tij. Por duhet të keni kujdes, pasi kalimi nëpër kryqëzimet e rrugëve mund të jetë i rrezikshëm. Duke qene se qyteti ndodhet në një shpat kodre dhe është afërsisht 975 metra mbi nivelin e detit, gjë që ndikon shumë mirë për zhvillimin e muskujve, ju do të ndiheni i lodhur për shkak të lartësisë. Vështirësitë në frymëmarrje janë veçanërisht të zakonshme në verë kur cilësia e ajrit jo gjithmonë është e mirë; në qoftë se doni të freskoheni, gjeni një park dhe një stol, dhe një akullorë – ju e meritoni një pushim!

### Kalimi nëpër kryqëzimet e rrugëve në Erevan

Thuhet që Erevani është një qytet shumë i sigurt, me përjashtim të rasteve, kur të qëllon të kalosh në kryqëzimet e rrugëve. Këmbësorët përballen me rreziqe serioze kur përpiqen të kalojnë këto kryqëzime; në to ka pasur aksidente të rënda, madje edhe fatale. Për fat të keq, semaforët nuk janë gjithmonë të besueshëm. Ndonëse drita jeshile që tregon “kalo” mund të jetë duke pulsuar, automjetet akoma vazhdojnë të rrotullohen në kryqëzim sepse sinjalet e lëvizjes nuk janë sinkronizuar për të realizuar një kalim të sigurtë të këmbësorëve. Për më tepër këmbësorët që janë duke kaluar kur sinjali duket që është hapur për ta, shpeshherë përballen me boritë dhe kërcënimet e shoferëve që mendojnë se kanë të drejtën e rrugës. Kur keni për të kaluar rrugë me trafik si Mashtots dhe Sayat Nova, kaloni me dritë jeshile dhe ndaloni në ishullin e vogël të pikturuar në mes të rrugës. Prisni atje dhe sigurohuni që edhe në qoftë se semafori ka dritën jeshile të ndezur, të mos ketë

makinë duke kaluar. Ndonëse është tunduese të shohësh vendasit se si negociojnë për të kaluar këto kryqëzime, një mendje e pavendosur mund t'iu çojë në parakolpin e ndonjë shoferi agresiv. Gjithmonë mbajini sytë hapur dhe shikoni në të gjitha drejtimet, përpara se të provoni të kaloni rrugën.

## Metroja

Metroja e Erevanit është një sistem shumë i thjeshtë i përbërë nga vetëm një linjë dhe dhjetë ndalesa. E ndërtuar nga Sovjetikët, është e vjetër, por efikase, dhe e subvencionuar gjerësisht nga shteti. Një udhëtim kushton 50 drams. Planet për ta zgjeruar u lanë mënjanë gjatë krizës ekonomike të viteve 1990, dhe nuk janë marrë më seriozisht në konsideratë që atëhere.

### Si u bë Erevani me metro

Për shkak të kodrave të pjerrëta mbi të cilat është ndërtuar qyteti, rezidentët dhe zyrtarët qeveritarë në Erevan dëshironin të kishin një metro si edhe qytetet e tjera në Bashkimin Sovjetik. Megjithatë, në vitin 1970 Departamenti Sovjetik i Planifikimit Inxhinierik të Qyteteve deklaroi qartë se metro do të ndërtohej vetëm në ato qytete që kishin mbi 1 000 000 banorë. Pavarësisht nga kjo, Armenët filluan të gërmonin tunele – të cilat i deklaruan si rrugë për autobusë urban – në pritje të kohës kur qyteti të plotësonte kushtet për të pasur metro. Në vitin 1978, infrastruktura kishte përfunduar, por numri i popullsisë akoma nuk kishte arritur shifrën që duhej për metro. Kryetari i Partisë Komuniste Armene, Karen Demirçian, me mjeshtri e bindi Kryetarin e Sovjetëve të asokohe, Leonid Brezhnjev, ta anashkalonte rregullin. Ai arësyetoi në këtë mënyrë, “ Çdo Armen që jeton larg prindërve të tij duhet t'i vizitojë ata çdo

ditë. Si rezultat numri i pasagjerëve që lëvizin do të ishte 1.5 herë më i madh se fluksi i projektuar. Për më tepër, herët ose vonë, Diaspora do të kthehej në atdhe.” Demirçiani ishte kaq bindës, sa arriti ta fitonte metronë. Përfundimisht, në vitin 2006, Erevani arriti të kishte mbi 1 000 000 banorë.

### **Marshrutka (Taksitë e përbashkëta)**

N.q.s. shihni që metroja nuk ka stacion pranë vendit ku ju doni të shkoni, një nga mënyrat më të lira dhe më praktike për të lëvizur nëpër qytet, brenda dhe jashtë Erevanit, është të merrni mikribuse tipVan të quajtur Marshrutka. Udhëtimi me të kushton 100 dram, dhe mund t’ju marrë dhe çojë juve kudo nëpër qytet. Në orët e pikut, ato zakonisht janë plot dhe ju mund ta gjeni veten pak ngushtë, por ky është një transport i sigurtë.

Zakonisht ato janë mjete me 8 deri 10 vende dhe marrin e zbesin pasagjerë në pikat e qëndrimit të autobusit (kangars), por jashtë qytetit ato ndalojnë kudo që ka njerëz që duan të hipin dhe ndalojnë kudo që ju dëshironi të zbrisni. Numrat e rrugëve dhe emërtimet e vendeve ose të rrugëve duken që nga dritarja (në gjuhën Armene). Kontrolloni për numrat e rrugëve, pasi këto janë ato që ju realisht mund të shihni ndërsa kaloni me shpejtësi nëpër rrugë. Marshrutkat ndjekin një plan shpërndarës, që fillon me qytetet e mëdha dhe vazhdon me transportin lokal për në fshatrat që rrethojnë qytetin; njëlloj vlen edhe për lidhjen me Erevanin. Gjithashtu, është i mundur edhe transporti me këto lloj mjedesh për në Gjeorgji ose Karabak.

### **Taksitë**

Brenda qytetit, taksitë janë relativisht të lira. Ka vendqëndrime zyrtare për taksitë, përfshirë grumbullimin masiv të taksive në Sheshin Saharov, por në qendër të Erevanit, ju mund të ndaloni ndonjë taks

në çdo kohë të ditës. Shumica e taksistëve, përveç Armenishtes, mund të flasin edhe Rusisht, dhe vetëm pak prej tyre Anglisht. Taksistët e vlerësojnë shumë bakshishin (10 – 15%). Kini kujdes kur merrni taksi të palicensuar, pasi këto nuk kanë taksimetër. N.q.s. doni të merrni taksi për udhëtim të gjatë, si p.sh. për të shkuar në liqenin Sevan ose në kufirin Gjeorgjian, është më mirë që ta rregulloni këtë gjë që më përpara.

## Treni

Sistemi hekurudhor, kohët e fundit, është marrë në kujdestari nga një kompani Ruse. Trenat, në Armeni, kanë reputacion jo të mirë, pasi konsiderohen të ngadalshëm dhe jo të rehatshëm. Stacioni Qendror i Trenave në Erevan ndodhet mbi ndalimin e metrosë të Sasuntsi David (Davidi i Sasunit). Prej këtu, ju mund të merrni trenin që shkon në Yumri (Jumri), liqenin Sevan, dhe Gjeorgji. Gjithashtu, këtu mund të gjeni marshrutkas te gatshme për t’ju çuar në Gjeorgji ose në çdo pjesë tjetër të vendit.

## Makinat dhe biçikletat

Armenia është një vend kaq i vogël, saqë udhëtimi për të vizituar atë, normalisht, duhet të ishte fare i thjeshtë. Megjithatë, të huajt mund të konstatojnë shumë shpejt, që ka disa vështirësi, përfshirë gjetjen e rrugës së duhur në një vend ku shumë tabela treguese mungojnë ose janë fare të pakta. N.q.s. ju vendosni ta drejtoni vetë mjetin nëpër rrugët e Erevanit, ju do të tregoheni më trim se shumica e të huajve që e vizitojnë atë. Ata drejtues mjeti që nuk respektojnë kalimtarët, veprojnë njëllor edhe me drejtuesit e tjerë të mjeteve, dhe kufijtë e shpejtësisë, shpesh, nuk respektohen. Polici mund t’ju ndalojë, por jo gjithmonë ai gjendet aty. Gjithashtu, udhëtimi mbi vijën e bardhë ndarëse të korsive, konsiderohet e pranueshme. Jashtë qytetit do të hasni gropa dhe kafshë endacake me bollëk.

Pak makina janë të siguruara, dhe dëmtimet nga përplasjet e vogla si dhe parafangot e shtrembëruara janë gjë e zakonshme. Sidoqoftë, nëse ju keni vendosur të udhëtoni, në Erevan ka shumë kompani që japin

makina me qira. Ato do t'ju japin makinë me qira dhe do t'ju urojnë shumë fat pasi t'i keni hipur. Duke marrë parasysh situatën e trafikut, biçikletat janë relativisht të rralla në Erevan. Megjithëse, në Erevan, shiten biçikleta, ato përdoren kryesisht nga fëmijët për të shetitur në park. Çiklistët e rritur shihen si diçka e çuditshme, kështu që shoferët në qytet surprizohen kur i shohin ata dhe shpesh nuk tregojnë mirësjelljen e zakonshme që është kaq e pranishme në vendet e tjera. Vozitja me biçikletë në fshat është një nismë e sigurtë, nëse keni planifikuar t'ju ngjiteni kodrave. Shumica e çiklistëve, në rrugët e fshatit, preferojnë të udhëtojnë në grup.

## Të orientohesh nëpër rrugë

Lajm i mirë është fakti, se për të gjetur rrugën për në monumentet kryesore dhe për t'u orientuar në udhëkalimet e Erevanit është relativisht e lehtë. Qyteti ende ndjek planin e paraqitur në vitin 1920 nga Aleksandër Tamanian, statuja soditëse e të cilit përshëndet vizitorët që janë në Kaskadë.

Megjithëse Tamaniiani parashikoi një qytet për pak qindra mijë banorë, ai parashikoi në mënyrë gjeniale një seri rrugësh të gjera në formë rrethi, rrugët kryesore me unazë, dhe shumë parqe me hije. Tre janë pikat kryesore me më interes: Sheshi Republika, Shkallët Kaskadë, dhe qendra e vërtetë e qytetit, Godina e Operas. Rrugët kryesore (Mashtots, Bagrahmian, dhe Sayat Nova), të gjitha ndërpriten tek Godina e Operas. Madje edhe Bulevardi i Veriut të çon në këtë pikë qendrore të qytetit.

Lajm i keq është fakti që shenjat e rrugëve dhe adresat e rrugëve jo gjithmonë janë të ekspozuara dukshëm. Gjithashtu, zyrat dhe rezidencat e rëndësishme shpesh ndodhen nëpër rrugët dhe rrugicat dytësore. Përpara se t'i hyni aventurës për të gjetur ndonjë shtëpi ose zyrë, gjëja më e mirë është që të tregoni ndonjë orientim specifik. Në rast të kundërt, shoferët e taksive mund t'i gjejnë adresat ose nga eksperiencia ose duke pyetur. Ju duhet thjesht t'i tregoni shoferit një copë letër ku të jetë shkruar destinacioni juaj (do ishte mirë që të ishte e shkruar në

Armenisht). Gjithashtu, banorët e Erevanit, duke e ditur që orientimi nëpër qytet është shumë i vështirë për vizitorët e huaj, përpiqen që të jenë sa më ndihmues ndaj tyre. Në fakt, ndërkohë që ju qëndroni në rrugë përpara hartave të hapura, të jeni të sigurtë, që patjetër do t'ju afrohet dikush që do t'ju ofrojë ndihmë. N.q.s. as ata vetë nuk e dinë rrugën, patjetër që do gjejnë dikë që do ta dijë.

## DESTINACIONET

N.q.s vendosni të udhëtoni jashtë Erevanit, udhëtimet tuaja nuk do të jenë shumë të vështira. Ka rrugë që ju çojnë juve në çdo qytet të madh ose qytezë, dhe n.q.s. jeni i prirur të vizitoni gjithë vendin, këtë mund ta bëni pothuajse brenda një jave.

Jashtë Erevanit ndodhen provincat, të quajtura ndryshe marz , secila me historinë dhe bukurinë e vet. Per shkak të pranisë së shumë manastireve në Armeni, shumica e vizitorëve bëjnë gabimin të mendojnë se ato janë gjithçka që mund të shohësh jashtë qytetit. Por nuk është kështu, ka akoma shumë më tepër gjëra për të parë:

**Argatson-i**, në perëndim të vendit, është vendi i Bairakanit, një nga teleskopët astronomikë më të mëdhenj ne botë, të ndërtuar në kohën Sovjetike, që ofron pamje madhështore të qiellit.

**Armavir-i**, ndodhet në jug të vendit dhe është shumë i njohur për qytetin Eçmixin, qendra e Kishës së shenjtë Apostolike Armene, dhe katedralen e tij, kisha më e vjetër në botë, ndërtuar ndërmjet viteve 301 dhe 303.

**Ararat-i**, dikur kryeqytet i Armenisë së vjetër. Ai është marzi më i afërt me malin Ararat, dhe vizitorët mund të shijojnë pamjen e malit të shenjtë nga Manastiri Khor Virap.

**Gegarkunik-u** është pranë liqenit Sevan, liqeni më i madh i Armenisë. Sevani është i famshëm për peshkun e tij, por akoma më i famshëm si vend pushimi veror për banorët e stresuar të Erevanit të nxehtë, të cilët vinë për t'u shplodhur dhe për barbekju.

**Kotaik-u**, ndodhet në veri të Erevanit, është një emër shumë i njohur për dashamirët e birrës, e cila prodhohet nga uji i tij i famshëm për freskinë. Kjo krahinë është gjithashtu e njohur për resortin dimëror të skive për pasanikët vendas Armenë, Çakaxor-in. Garni, një tempull i vjetër Grek, është i vendosur në Kotaik, po ashtu si edhe Gegard-i, një manastir piktoresk i shekullit XII - XIII.

**Lori**, që takon kufirin verior, është marz-i më i madh dhe vendndodhja e Vanaxor-it, qyteti i tretë më i madh i Armenisë. Njerëzit shëndetligë vijnë në Manastirin Hahpat për ujrat e tij kurativë.

**Shirak-u** ka si kryeqendër të tij qytetin Gymri (ish Leninakan), qyteti i dytë më i madh i Armenisë. I njohur si qyteti i “tregtisë dhe arteve”, ai është gjithashtu i famshëm për shkollat dhe teatrot e tij. Realizimi i parë operistik Armen u krye në Gymri në vitin 1921, dhe godina e parë e operas Armene u ndërtua po këtu në vitin 1923. Kjo zonë u dëmtua shumë rëndë gjatë tërmetit të vitit 1988.

**Sjunik-u** është marz-i më jugor i Armenisë. Nga perëndimi ai kufizohet me Nahiçevanin, me Karabakun nga lindja, dhe Iranin në jug. Sjuniku është një vënd malor dhe i gjelbëruar, por në kontrast me këtë qëndron fakti se ai është edhe një zonë minerare me shfrytëzim intensiv. Shfrytëzimi i minierave të Uraniumit prej kompanive Ruse në fshatin Lernaxor është shndërruar në temë kryesore të shqetësimit për ambientalistët dhe banorët e zonës.

**Tavush-i** është në verilindje të vendit, dhe kufizohet me Gjergjinë në veri dhe Azerbaixhanin në lindje. Ai rrethon eksklavat Barkudarli dhe Jukari Askipara të Azerbaixhanit, të cilat kanë qenë të kontrolluara nga Armenia që nga koha e zaptimit të tyre gjatë luftës së Nagorni – Karabakut.

**Artsak (Karabak)** është një zonë fshatare dhe e shëndetshme, shumë e preferuar nga udhëtarët këmbësorë që lëvizin në këmbë me çanta shpine, por të shkuarit ose jo në rajonin e kontestuar të Karabakut është vendimi juaj. N.q.s. vendosni të shkoni atje, duhet të keni parasysh se udhëtimi me automjet është shumë i kufizuar, ndërkohë që nuk ka as aeroport dhe as vijë hekurudhore.

## Aksesi për karrocet e invalidëve

Erevani ka bërë shumë përmirësime në lidhje me rritjen e mundësive për lëvizjen e karrocave të invalidëve, dhe disa godina tashmë e kanë një lehtësi të tillë, por mbeten akoma shumë godina të vjetra që kanë shumë shkallë, por nuk kanë plan të pjerrët për lëvizjen e këtyre karrocave. Shumica e ankesave dhe kërkesave në ndihmë të kësaj pjese të popullsisë vjen nga grupet joqeveritare, jofitimprurëse të cilat bëjnë presion mbi qeverinë për të treguar më shumë kujdes. Sidoqoftë, në qytet ka akoma shumë vende ku aksesi i këtyre mjeteve vazhdon të mbetet një sfidë e madhe. Taksistët dhe drejtuesit e minibuseve përpiqen t'i ndihmojnë ata që lëvizin me këto lloj mjetesh, me pak apo aspak hezitim, dhe po kështu edhe qytetarët e zakonshëm janë gati të ofrojnë ndihmën e tyre. Mos ngurroni të kërkonin ndihmë, n.q.s ajo ju nevojitet.

## MONEDHA

Monedha Armene është dramë, që në vitin 2009 ka qenë 370 dram për një dollar amerikan dhe 600 dram për një paund britanik. Pas Pavarësisë, Banka Qendrore e Armenisë vendosi vlerën e saj, por në 2009 u lejua liberalizimi i kursit të këmbimit i valutës dhe dramë u zhvleftësua tej mase.

Uljet dhe ngritjet e dramit datojnë që në fillimet e viteve 1990. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik, ekonomia Armene varej shumë nga dollarët e Diasporës në Shtetet e Bashuara të Amerikës. Në fillimet e viteve 2000, vendi ishte aq i mbushur me para amerikane sa që vlera e dollarit ra në mënyrë dramatike përkundrejt dramit (disa thonë se këtë e sollën oligarkët në mënyrë që të mund të importonin mallrat më lirë). Në vitin 2003, Banka Qendrore e Armenisë lëshoi një dekret se dollarët nuk do të ishin më pjesë e parasë Armene, dhe u bë i detyruar përdorimi vetëm i dramit. Që prej asaj kohe, Banka Qendrore promovon së tepërmi dramën, dhe ka ngritur edhe një statujë të saj në Erevan. Me një rritje prej 45% në vlerë përgjatë 5 viteve ne vazhdim, thuhej se dramë mund të përbënte rrezik për një rritje të pakontrolluar, gjë

që do të prekte përfundimisht prodhuesit lokalë, për të cilët do të ishte krejtësisht pa fitim që të eksportonin mallrat e tyre. Nga ana tjetër, kjo rritje u synua që të sillte përfitime për ata pak importues të cilët donin të sillnin mallra me çmime të lira.

Me zhvlerësimin e kohëve të fundit, situata duket se ka ndryshuar sërish. Një gjë është e sigurtë, që Armenia është një shoqëri që funksionon me para në dorë. Megjithëse disa supermarkete mund të pranojnë karta krediti, pothuajse të gjitha transaksionet preferohet të kryhen në Cash, në prerje më të vogla se 20,000 dram (disa markete refuzojnë të thyejnë kartmonedhën tuaj 20,000 dram). Çeqet dhe mandat-pagesat janë të rralla. Çeqet e udhëtuesve pranohen në disa banka, por jo aq shumë nga tregtarët, dhe këshillohet për më mirë që t'i lini ato në shtëpi, duke qenë se do të dëshpëroheni duke u munduar t'i përdorni ato. Në Erevan, pothuajse në çdo rrugë, ka ATM, të cilat japin para Cash. Pjesa më e madhe e këtyre makinerive kanë një opsion që lejon kryerjen e veprimeve në gjuhën Angleze.

Erevani ka disa banka lokale dhe pak unione krediti. Gjithashtu, legjislacioni i Armenisë mbi bankat është më liberali ndër shtetet e ish Bashkimit Sovjetik dhe nuk ka kufizime ndaj bankave të huaja. Prandaj, bankat Britanike dhe Europiano-Perëndimore janë të përhapura në Erevan. HSBC ka një prezencë të madhe në qytet, dhe të gjithë punonjësit e stafit flasin gjuhën Angleze. Pjesa më e madhe e bankave, të huaja ose lokale, kanë personel Anglisht-folës.

Duke qenë se shumë tregtarë kërkojnë pasaportën para se të kryejnë një shitje të madhe, do të ishte me vend që të mbanit pasaportën tuaj me vete. Bankat gjithashtu kërkojnë një pasaportë nëse ju doni të kryeni një tërheqje të madhe parash, dhe po ashtu edhe zyra postare do t'u a kërkojë këtë mjet identifikimi kur të jeni duke tërhequr një pako. Lejet e drejtimit të mjeteve zakonisht nuk pranohen si identifikim i përshtatshëm, dhe shumë Armenë e mbajnë

---

Shënim: Monedha Armene vazhdon të jetë dram, që në gusht 2015 ishte përafërsisht :

1 USD = 478 AMD

1 EURO = 524 AMD

1 All (Albanian Lek) = 3.75 AMD

pasaportën e tyre me vete gjatë gjithë kohës. Rastet e vjedhjes së pasaportave janë shumë të pakta.

## KU TË QËNDRONI

Një udhëtues i ditëve të sotme ka disa mundësi për një akomodim të rehatshëm në Erevan. Çmimet variojnë nga më të shtrenjat deri tek më të arsyeshmet. Në krye të kësaj liste është hoteli “Marriott”. I ndërtuar 50 vjet më parë në Sheshin e Republikës (më parë Sheshi “Lenin”), ai u quajt fillimisht hotel “Armenia”, dhe u bë i njohur gjerësisht si vendqëndrimi më i preferuar i turistëve të huaj në Erevan. Pasi u rinovua në 2004 me një shumë prej 38 milion dollarësh, hoteli “Marriott” është një shembull i shkëlqyer i arkitekturës duke përdorur “tuf”-in Armen (gur ngjyrë rozë i Erevanit). Sot, ky hotel me pesë yje në qendër të qytetit është investimi më i madh amerikan në vend dhe quhet gjithashtu edhe “hub”-i për popullsinë Anglisht-folëse. Në ditë të ngrohta, ju mund të gjeni shumë qytetarë Amerikanë dhe Britanikë të ulur në kafenenë “Meeting Point” që ndodhet në pjesën e jashtme të hotelit, duke shijuar çdo gjë, që nga hamburgerët, e deri tek kesadiljat (quesadillas).

Krahasuar me “Marriott”-in, hoteli “Congres” ofron komoditete Perëndimore me çmime më të arsyeshme. Gjithashtu, ka edhe një restorant Italian shumë afër.

Për një atmosferë më Lindore, janë hotelet “Ani Plaza” dhe “Golden Tulip”, ku të dyja kanë mbetje nga e shkuara e tyre sovjetike. Hoteli “Ani Plaza” është një ambient i këndshëm me dhoma funksionale më të vogla, por nuk lejohet duhanpirja. Në Erevan ka edhe hotele më të vegjël dhe më pak të shtrenjtë. Ato zakonisht janë të pastër dhe funksionalë. Kontrolloni nëse ka ujë të rrjedhshëm kur ju duhet, sidomos në stinën e verës, kur disa rajone të Erevanit përjetojnë ndërprerje të furnizimit me ujë. Disa hotele nuk kanë ashensorë; në këto raste ju duhet të përgatiteni t’i ngjisni bagazhet tuaja lart, dhe shpeshherë, me disa vajtje-ardhje.

Kini kujdes nga hotelet me kazino, veçanërisht ato të cilat ndodhen

rrugës për në aeroport. Thuhet se ato janë të lidhura me tipa me qëndrim të dyshimtë, dhe zakonisht nuk i ofrojnë të huajve llojin e shërbimit që ata kërkojnë.

## Jashtë Erevanit

Vendet më të zakonshme për të qëndruar jashtë Erevanit janë disa hotele familjare (Guesthouses-shtëpi miqsh), pronë e familjeve vendase. Vakti i mëngjesit është i përfshirë në çmim. Edhe pse akomodimi mund të mos jetë shumë luksoz, këto hotele familjare ofrojnë një mundësi të shkëlqyer për të takuar banorë vendas dhe për të mësuar mbi jetën në pjesën rurale të Armenisë.

Ju gjithashtu mund të gjeni edhe hotele më të rinj në zona turistike, siç është Tsakhkadzor. Ka shumë ambiente për pasanikët e mëdhenj, zyra të mëdha konferencash, tavolinë bilardo dhe fushë bowling, disko, si edhe qendra “spa” – të gjitha, sigurisht, përkundrejt një çmimi ditor mjaft të konsiderueshëm.

## SHËNDETI

Armenia ka socializuar mjekimet (shërbimi shëndetsor është shtetëror), edhe pse ndonjëherë kualiteti i shërbimit mungon. Trazirat ekonomike të viteve 1990 e shtrënguan së tepërmi sistemin shëndetësor, dhe pasojat ndjehen ende edhe sot, veçanërisht në zonat rurale. Nëse ju e gjeni veten në nevojë të një mjeku, kontaktoni me ambasadën tuaj, e cila do të jetë në gjendje t’ju sigurojë një liste doktorësh të cilët flasin gjuhën tuaj (shumë mjekë flasin Anglisht në Erevan) dhe spitalet e rekomanduara për të huajt. Shërbimet dentare Armene njihen për standartet e tyre të larta dhe ofrojnë trajtime me çmime më të ulta se në Amerikë për të njëjtat shërbime. Disa Armenë nga Diaspora udhëtojnë me avion drejt vendit me qëllim që të marrin një shërbim dentar cilësor me një çmim të arsyeshëm.

## SIGURIA

Erevani njihet si një qytet i sigurtë. Përveç rasteve kur ndonjë person i moshuar ju kërkon për ndonjë lëmoshë, nuk ndodh që t’ju afrohet ndonjë personazh i dyshimtë. Pjesa më e madhe e krimeve përbëhen nga vjedhjet e automjeteve ose hyrjet me forcë, dhe turistët nuk para bëhen shenjestër. Është një ndër qytetet e paktë, në të cilët gratë mund të ecin të qeta edhe të vetme në rrugët kryesore gjatë natës.

Duke thënë këtë, do ishte me mend që të merren disa masa. Femrat duhet t’u shmangen rrugëve të shkretuara gjatë natës, dhe të ulen në sediljen e pasme të taksisë nëse janë duke udhëtuar vetëm. Megjithëse qyteti funksionon me para Cash, kini kujdes që t’i mbani paratë tuaja të sigurta, sidomos kur mbani me vete prerje të mëdha parash. Dyert e dhomave të hotelit dhe apartamentit duhen mbyllur me kyç pasi largoheni nga ndërtesa.

Nëse ju rastis të jeni viktimë e një krimi, ju mund t’i drejtoheni policisë, por të jini të bindur që pjesa më e madhe e policisë lokale është e interesuar më tepër në ndezjen e sirenavë dhe ndjekjen e shkelësve të trafikut, se sa në gjetjen e hajdutëve. Përpjekja juaj, për të dorëzuar një kallëzim në polici, do t’ju duket shumë irrituese.

Armenia është shtet tërmetesh dhe duket të jetë relativisht e papërgatitur për “një tërmet të madh”. Ndërtesat prej çimento (parafabrikat) dhe shkallët e shkatërruara duken kudo; nëpër rrugë ka gjithashtu edhe mure të deformuar dhe struktura të tjera potencialisht vdekjeprurëse. Një tjetër shqetësim është centrali bërthamor Armen i kohës së Bashkimit Sovjetik në Jug-Perëndim të Erevanit. Centrali u mbyll përkohësisht në 1988 pas tërmetit shkatërrues, por u rihap në 1995. Armenia ndodhet nën presionin ndërkombëtar për ta mbyllur përgjithmonë centralin për shkak të shqetësimeve të sigurisë.

Gjithashtu, kini kujdes nga qentë e egër. Ata mund të duken të afrueshëm, dhe ndonjëherë duken edhe të këndshëm për të huajt që përpiqen t’i afrojnë ata, por këto janë kafshë të egra dhe mund të jenë të paparashikueshëm. Për më tepër, shumë prej tyre mund të udhëtojnë

në tufa. Histori mbi udhëtarë të ndjekur nga tufa qensh janë ka me shumicë. Mënyra më e mirë për t'ju drejtuar një qeni ose disa qensh është komanda universal "shoo!".

Ka gjithmonë rrezik të gjendeni i përfshirë në situatën aktuale politike të Armenisë. Siç e kemi parë, në Mars të vitit 2008, një demonstratë politike u kthye në një gjendje shumë të dhunshme. Të paktën 10 veta mbetën të vrarë ndërsa qeveria u vërsul mbi opozitën. Të huajt duhet të mbajnë në mendje, që edhe demonstratat me qëllimet më paqësore, mund të kthehen në një konfrontim fizik dhe mund të bëhen edhe më të dhunshme. Mund të dalloni kur një demonstratë do të ndodhë, sepse policë dhe ushtarë rreshtohen për rreth zonës. Më e mira do të ishte ta shmangnit, duke qenë se tensioni mund të rritet.

# PËRSHKRIM I SHKURTËR I SITUATËS EKONOMIKE

Në vitet 1990, të gjitha shenjat tregonin një të ardhme të mjerueshme ekonomike për Armeninë. Vendi vuante nga mungesa e ushqimit dhe ujit. Këtyre u shtohej furnizimi i dobët me vetëm pak orë energji elektrike në ditë. Ai ishte i gjymtuar nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, i shkatërruar nga tërmeti i vitit 1988, dhe përfshirë në një luftë me Azerbajxhanin. Për shumicën e vëzhguesve, nuk ka pasur pothuajse asnjë perspektivë shpresëdhënëse.

Në vitet që pasuan, megjithatë, Armenia perjetoi një rritje të GDP-së prej 10 për qind në vit, dhe u shfaq si një lider ekonomik në rajon. Në librin e vitit 2007, *The Caucasian Tiger* (Tigri Kaukazian): Në mbështetja të rritjes ekonomike në Armeni, autorët Saumya Mitra, Douglas Andrew, dhe Bartek Kaminski ja atribuojnë këtë transformim reformave radikale, një angazhimi për të mbajtur inflacionin relativisht të ulët, dhe një fluksi hyrje parash në CASH që nuk ishte përjetuar në vende të tjera post-sovjetike. Për shkak të këtyre masave, vendi doli nga mjerimi i tij dhe shumë shpejt u bë i njohur si vendi më i mirë post-sovietik i Kaukazit për të bërë biznes. Një raport i Bankës Botërore deklaroi se Armenia është, “një ekonomi në tranzicion model që duhet të vazhdojë të rritet.”

Me gjithë këtë lajm të mirë, marrja e disa rrethanave në konsideratë është e nevojshme. Parësore është të kuptuarit se zona e Kaukazit është e njohur për paqëndrueshmërinë e saj, kështu që

duke qenë më e mira në Kaukaz ende lë vend për përmirësim. Për shembull, fuqia punëtore armene është ende disi e paqëndrueshme për shkak se shumë prej punëkërkuësve eventualisht kërkojnë punë jashtë vendit. Bazuar në sondazhet e fundit, rreth 100.000 njerëz në vit (3 për qind e popullsisë) emigrojnë për të gjetur punë. Korrupsioni mbetet një shqetësim i madh, dhe kufijtë e mbyllura vazhdojnë ta bëjnë tregtinë të vështirë. Sipas fjalëve të gazetarit të biznesit S. Adam Cardais, “[Reformat e nevojshme] do të kërkojnë më shumë kohë sesa të ndezësh prapë dritat.”

## KULTURA E BIZNESIT

Mendjemprehtësia historike e Armenëve për biznesin dhe tregtinë ka treguar një rigjallërim në vitet e fundit. Në bizneset tipike hyjnë bizneset e vogla familjare; sipërmarrësit e rinj; degët Armene të kompanive shumëkombëshe; dhe organizatat e mëdha të drejtuara nga oligarkët. Për të pasë një ide më të qartë të skenës së biznesit Armen, kontaktoni Shoqatën Armene të Marketingut ([www.armenianmarketing.com](http://www.armenianmarketing.com)) dhe kërkonit për Katalogun vjetor të Eksportit Armen.

Gjithashtu, një brez i ri i njerëzve të biznesit po shfaqet në vend, dhe kjo krijon mundësi që mënyra e vjetër e bërjes së gjërave të ndryshojë me shpejtësi. Biznesmenët e rinj të sotëm kanë qenë të ekspozuar tërësisht ndaj praktikave të biznesit Perëndimor dhe cilësive që konsiderohen të rëndësishme për sukses në tregun global, dhe nganjëherë e gjejnë veten duke luftuar me ata të shkollës së vjetër të brezit sovjetik. Ashtu siç tha një biznesmen i ri Armen, “Unë jam i ri, unë nuk kam asnjë problem ta konsideroj veten ambicioz.” Megjithatë, shpjegoi ai, biznesmenët e vjetër (të cilët kanë tendencë të jenë ende në krye) janë arsimuar në stilin sovjetik të menaxhimit dhe zakonisht nuk e vlerësojnë “ambicien” e të rinjve, të cilët duket se kanë një mirëkuptim të natyrshëm me kompjuterët, teknologjitë wireless, dhe qasjet më efikase për biznesin. “Kjo është një luftë e vazhdueshme në mes të mënyrave të vjetra dhe të reja,” tha i ri.

## Kontaktet Lokale dhe Marrëdhëniet Personale

Pra, çfarë do të bëni Ju nëse keni një ide biznesi, që ju besoni se do të shkojë mirë në Armeni? Para së gjithash, mos harroni se Erevani (ku do të jetë shumica e biznesit tuaj) është një vend shumë i vogël, në kuptimin që ata të cilët ju njihni dhe që ju njohin, është diçka shumë e rëndësishme. Nëse keni lidhje me dike, me një nivel të caktuar të ndikimit në komunitetin e biznesit Armen, ju do të gjeni dyert hapur shpejt, edhe në qoftë se ju jeni vetëm kushëri i largët i një miku të një miku në Erevan.

Të hysh në një biznes me një ide të re dhe pa kontakte biznesi, është e pakëshillueshme. Si i huaj, ju mund të shikoheni me një farë dyshimi, veçanërisht në qoftë se ju nuk keni kontakte biznesi Armene, por shanset e suksesit do të përmirësoheshin në mënyrë dramatike në qoftë se ju do të mund të arrinit të vendosnit kontakte të tilla lokale.

## TAKIMET

Nëse ju doni të organizoni një takim në Armeni, sfida juaj e parë është të kalosh rojtarin më të frikshëm nga të gjithë – administratorin e zyrës. Shumë njerëz të biznesit ankohen se ky person është i ngarkuar me detyrën që të ta bëjë sa më të vështirë që të jetë e mundur organizimin e një takimi me shefin e tij ose të saj. (“Puna e tyre është për të krijuar sa më pak punë që është e mundur për bosët e tyre,” thotë një person i biznesit). Ndaj kërkesës tuaj për një takim të vendosur, Ju ndoshta do të dëgjoni disa herë përgjigjen tip: “kjo nuk është e mundur”, nga zyrtari administrator. Edhe një e-mail, dërguar direkt personit në fjalë, zakonisht është zbuluar nga administratori, i cili shpesh do të përgjigjet me një përgjigje negative. Sekretin për të kaluar përtej administratorit është të siguroni numrin personal celular të kontaktit tuaj. Ky është një grusht shteti i madh, por një hap i rëndësishëm, dhe një që duhet të ndiqet deri në fund.

Nëse dëshironi të arrini të siguroni një takim, dini që Armenët preferojnë të organizojnë seancat e tyre të biznesit në një mënyrë

të ngjashme me mënyrën se si bëhet në Perëndim. Ju duhet të keni një axhendë të cilën ju duhet t'ja paraqisni administratorit të zyrës paraprakisht. Ata, që mendohet t'ju presin, do ta vlerësojnë këtë gjë duke u përgatitur për takimin, dhe ata do të duan gjithashtu të dinë nëse ju do ta drejtoni seancën në gjuhën angleze. Zakonisht nuk ka asnjë problem lidhur me këtë, por është e këshillueshme dhe një mënyrë e sjellshme për të dhënë paralajmërim.

Vetëm disa vjet më pare, ju ndoshta do të kishit takuar vetëm me pronarin e biznesit. Sot, ju ndoshta do të takoni me një ekip. Përveç drejtorit, janë edhe specialistët, të cilët janë të pranishëm për shkak të njohurive të tyre në lidhje me diçka që lidhet direkt me temën e takimit. Kjo përfshirje e ekipit specialist e ka bërë shumë më të lehtë marrëdhënien e biznesit, sepse pronari nuk i di - ose nuk pretendon të dijë çdo gjë - në lidhje me çdo aspekt të biznesit.

Takimet zakonisht fillojnë në kohë, por në qoftë se ka një vonesë, juve do t'ju kerkohet falje nga personi i kontaktit. Shtrëngimi i duarve është gjë normale, dhe ju duhet t'u jepni kartën tuaj të biznesit të gjithë të pranishmëve. Një kartë e shtypur në dy gjuhë, në gjuhën Armene dhe Angleze është një ide e mirë, dhe do të vlerësohet. Kur dikush tjetër ju jep kartën e tij, shiheni me kujdes, dhe, në qoftë se jeni i pasigurt se si duhet shqiptuar emri, pyesni për këtë. Adresimi ndaj individëve me emrin e parë, zakonisht është i pranueshëm.

## PREZANTIMET

Edhe pse prezantimet në PowerPoint dhe LCD janë duke u bërë të zakonshme në Armeni, mos e merrni automatikisht të mirëqenë se pajisjet e duhura do të jenë gjithmone në dispozicionin tuaj. Kontrolloni këtë mundësi paraprakisht me administratorin e zyrës. Kompjuterat Apple janë të rrallë në Armeni, kështu që nëse ju jeni duke përdorur një Mac dhe do të kishit nevojë për ndonjë ndihmë teknike, pyesni paraprakisht nëse dikush në zyrë ka njohuri në përdorimin e kësaj marke.

Pasi ju filloni takimin, mos u habitni nëse telefonat celularë vazhdojnë të bien, pasi çdokush varet nga këto telefonata. Jini i përgatitur, gjithashtu, për një bisedë me nënkuptime ose ndërthurje bisedash, madje edhe ndërsa ju jeni duke komunikuar me grupin. Kjo mund të çfaqet në formën e një pjesëmarrësi që bën përkthimin për një tjetër. (Nga ana tjetër, kjo mund të jetë vetëm një diskutim). Ka të ngjarë të ketë shumë komente nga ana e personit me funksionin më të lartë në takim, por kini parasysh, gjithashtu, se të gjithë do të duan që të kenë një rol. (“Të gjitha Armenët kanë një Napoleon të vogël brenda tyre,” thotë një person i biznesit.) Kjo është veçanërisht e vërtetë gjatë një takimi. Si një vizitor, është detyrimi juaj për të dëgjuar dhe të jeni i sjellshëm. Megjithatë, nëse ju jeni duke marrë shumë pyetje dhe dëgjoni komente të mjaftueshme, kjo është një shenjë që takimi juaj është duke shkuar mirë.

## NEGOCIATAT

Koha që do t’i duhet homologut tuaj për të marrë një vendim varet kryesisht nga shkalla e organizimit dhe nga personi që ndodhet në krye të organizimit që ju keni kontaktuar. N.q.s ju kontaktoni me pronarë biznesesh të vogla, të cilët janë të interesuar t’i mbyllin shpejt punët, vendimet normalisht merren shpejt. Në organizime më të mëdha gjërat lëvizin më ngadalë. Ka shumë mundësi që personi fillestar i kontaktit të mos ketë të drejtën e vendimit përfundimtar.

Gjatë diskutimeve, normalisht pritet të ketë edhe negociime. Këto negociime normalisht bëhen gjatë takimeve ndërmjet personave fizikë dhe jo me E-mail; ka shumë rëndësi aftësia për të negociuar në këto lloj kontaktesh. Mos u përpiqni të përdorni stil agresiv apo arrogant në këto lloj takimesh. Përpiquni ta orientoni bisedën në frymë miqësore, dhe n.q.s. keni mundësi, vini në dukje njohjet tuaja dhe rëndësinë e rrjetit tuaj funksional. Gjithashtu, përpiquni të merrni mësim nga tregtarët e Vernissage: ju mund të bëni Pazar, por mos pritni që të merrni gjithmonë pikërisht atë që dëshironi. Biznesmenët Armenë janë të gatshëm të largohen nga negociatat, posaqë të shohin që çmimi nuk është i përshtatshëm.

## KONTRATAT DHE RESPEKTIMI I TYRE

Në Armeni, kontrata e shkruar ka shumë rëndësi. Për fat të keq, kontrata ka shumë të ngjarë të jetë në gjuhën Armene, kështu që duhet të jini i përgatitur të keni një përkthyes të mirë me vete. Pavarësisht nga pajisjet kompjuterike apo ato skanuese, shumë nga bizneset kanë kontrata të parapërgatitura që i ruajnë nëpër “filet” e tyre. Posa që një marrëveshje kontraktuale të jetë përfunduar, përgatituni që të firmosni një sasi të madhe fletësh që përbëjnë kontratën. Normalisht, ju do ta merrni kontratën në format të printuar – mos prisni që ajo t’ju vijë e skanuar apo e depozituar elektronikisht. Pasi të jetë nënshkruar kontrata, ju mund t’i ofroni partnerit tuaj të ri një pije apo një drekë për të festuar rastin, por kjo nuk është e domosdoshme.

N.q.s. gjatë zbatimit të kontratës ju dalin probleme, bisedimet kokë më kokë janë zgjidhja më e mirë. Ka mundësi që takimi juaj i parë të jetë me një person me funksione modeste, i cili do përpiqet t’ju a bëjë të vështirë diskutimin por pa qenë në gjendje t’i japë zgjidhje. Ju duhet të insistoni, natyrisht me takt, që të merrni kontakt me personin që ka fuqi vendimmarrëse.

N.q.s. nuk arrihet në ndonjë marrëveshje, mosmarrëveshjet tregtare mund të zgjidhen ose në gjykatën shtetërore ose nëpërmjet arbitrazhit. Mosmarrëveshjet tregtare apo ato që lidhen me pronësinë mund të zgjidhen me grupe ekspertësh institucionale apo të ngritur posaçërisht për këtë rast siç është dhoma e tregtisë apo grupimet bankare.

## DY FJALË RRETH KORRUPSIONIT

Korrupsioni mbetet një pengesë e konsiderueshme për mbarëvajtjen e biznesit në Armeni. Duke qenë se ky problem tashmë njihet, së fundmi janë ndërmarrë një sërë reformash, duke përfshirë këtu thjeshtimin e procedurave të licensimit, reformën e shërbimit civil, një kod të ri penal, privatizimin në sektorin energjetik, kalimin e ligjit dhe rregulloreve antikorrupsion, dhe ngritjen e Këshillit Antikorrupsion. Sidoqoftë, ky problem vazhdon të jetë mjaft i përhapur, kështu që duhet ta keni në vëmendje.

Korrupsioni i vogël është ai që dominon. Nuk është e pazakontë që një biznesmeni t'i kërkohet të paguajë një "taksë" më shumë se një herë ose të plotësojë aq shumë formularë, sa instiktivisht atij i bëhet e qartë se duhet të gjejë rrugë më të thjeshta e më të përshtatëshme për t'i bërë gjërat të lëvizin përpara.

Akoma më serioze bëhet çështja kur flitet për oligarkët e lidhur me shtetin të cilët kanë monopolizuar pjesën më të madhe të prodhimeve dhe shërbimeve. Ata janë individë që manipulojnë tregun familjar shtëpiak, duke diktuar çmimet dhe inflacionin.

Këto praktika nxisin proteksionizmin, inkurajojnë krijimin e monopoleve të mëdha që pengojnë konkurrencën, dhe minojnë përpjekjet e qeverisë për t'i dhënë hov rritjes së sektorit privat. Natyrisht, jo të gjitha bizneset janë të kapura nga oligarkët, dhe jo të gjithë nëpunësit e shtetit janë të korrumpuar. Si një person i biznesit në Armeni, ju nuk mund t'ja lejoni vetes të injoroni mundësitë e të bërit biznes.

## GRATË NË BIZNES

Roli i grave në biznes po pëson, gjithashtu, ndryshime të ndjeshme. Të rritura nga nëna që në kohën e tyre, epokën sovjetike, punonin krah për krah me burrat, gratë e reja Armene e kanë marrë shumë seriozisht punën dhe rolin e tyre në shoqëri. Në dallim nga nënat e tyre, ato shohin se si rriten nga dita në ditë ndërtesat shumëkatëshe të mbuluara me xham, dhe në to ato shohin gjithashtu mundësinë e jashtëzakonshme për të shkuar përpara në botën e biznesit n.q.s. janë të gatshme t'i ofrojnë klientit shërbim cilësor, punë pa kufizim orari, dhe pjesëmarrje në projekte që tejkalojnë përgjegjësitë e punës së tyre të zakonshme. Shumë prej këtyre grave janë me të vërtetë jashtëzakonisht të shkathta dhe shumë të afta, dhe i kanë të gjitha kapacitetet për të shkuar përpara në botën e biznesit. Një vëzhgues i kësaj dukurie ka thënë: "E ardhmja e Armenisë qëndron në duart grave tepër të talentuara 26 vjeçare".

### **Dëshironi të shkoni përpara në biznes? Shkoni në një panair tregtar!**

Në një vend të vogël si Armenia, dhe në një ambient biznesi ku marrëdhëniet personale janë shumë të rëndësishme, një nga aktivitetet e preferuara është panairi tregtar. Njerëzit e biznesit i përdorin këto panaire për të ekspozuar mallrat e tyre, për të organizuar takime pune dhe për t'u njohur me kolegët e tjerë.

Kur të qëllojë të jeni në panair, përpiquni ta shpenzoni kohën duke biseduar me klientë perspektivë dhe ekspozues të ndryshëm. Kontaktet që merrni mund të jenë shumë të rëndësishme për biznesin tuaj. Ashtu si edhe në perëndim, performanca e paraqitjes dhe cilësia e mostrave janë shumë të rëndësishme. Gjithashtu, kini parasysh, se Armenët parapëlqejnë të bëjnë biznes me Armenët, prandaj mos u çudisni kur njera nga pyetjet e para që ju bëhen, ka lidhje me njohjet që keni në Armeni apo lidhjet tuaja të afërta me Armeninë.

# KOMUNIKIMI

## GJUHA ARMENE

*Gjuha është harta e rrugëtimit të një kulture,  
Ajo ju tregon se nga vjen populli që e mbart këtë kulturë  
dhe  
drejtimin se ku shkon.  
Rita Mae Brown*

Gjuha Armene përgjithësisht klasifikohet si një degë e pavarur e familjes së gjuhëve Indo-Europiane, dhe ndryshon nga fqinjët e saj nga forma dhe struktura gramatikore. Disa studjues shohin njëfarë lidhjeje ndërmjet saj dhe gjuhëve të vjetra Hurrian dhe Urartian të Anadollit. Cilado të jetë origjina e saj, është bukur të thuash që gjuha Armene është një gjuhë unike dhe e sofistikuar, gjë që shërben si burim krenarie kulturore për popullin Armen.

Hero i gjuhës Armene konsiderohet Mesrop Mashtotc, një murg dhe studjues i shekullit të V-të të erës sonë, që më vonë mori titullin e shenjtorit, i cili krijoi alfabetin Armen (duhet thënë që, më përpara përdorshin simbolet Greke, Persiane dhe Siriake, nga të cilat asnjera nuk prezantonte në mënyrë të saktë tingujt komplekse).

Pasi kishte krijuar 36 karaktere origjinale, në Armeni shpërtheu një lëvizje e paprecedent në sferën edukative. U aktivizuan studentë

për të mësuar gërmat e reja, për t'ja u mësuar pastaj këto të tjerëve. Një grup tjetër studentësh u dërgua në vende të tjera për të studjuar dhe për të marrë me vete kopje të shkrimeve të autorëve Jo-Armenë të cilat mund të përktheheshin në Armenisht. Kjo filloi me shkrimet e shenjta, dhe gradualisht u zgjerua me përkthimin e librave nga shkencat e matematikës, mjekësisë, astronomisë dhe të tjera. Përfundimisht, ky përqëndrim në gjuhë dhe literaturë frymëzoi një epokë të artë për literaturën dhe artet në Armeni.

Gjuha zyrtare e Republikës së Armenisë është Armenishtja Lindore, që, gjithashtu, flitet edhe nga Armenët në Iran. Me lëvizjet e Armenëve në Perëndim në shekullin e XIX-të, u cfaq edhe një version tjetër i gjuhës Armene, i njohur si Armenishtja Perëndimore. I bazuar në dialektin Armen të Anadollit përpara gjenocidit, dhe aktualisht e folur nga Diaspora, ky version i gjuhës ndryshon në disa shqiptime, madje edhe në disa gërma. Megjithatë, surprizues mbetet fakti që, Armenishtja e folur në atdhe mbetet në mënyrë të dukshme e pacënuar që nga koha e Mashtot-it, si në karakteristika ashtu edhe në strukturën gramatikore. Në sajë të sistemit kombëtar të edukimit, pothuajse të gjithë Armenët mund ta lexojnë dhe shkruajnë gjuhën e tyre amtare. Armenët e Diasporës shpesh kërkojnë nga fëmijët e tyre të mësojnë gjuhën e tyre amtare.

Megjithatë, për të huajt, të cilët nuk janë të familiarizuar me shqiptimin Armen, mësimi i gjuhës Armene mund të jetë shumë i vështirë. Disa gërma kanë një tingëllim shumë të ngjashëm, dhe nga ana tjetër ka disa bashkëtingëllore të cilat nuk kanë ngjashmëri në shqiptim me ato në gjuhë të tjera.

## **KONTAKTI ME NJERËZIT**

Armenët tentojnë të jenë shumë miqësorë përkundrejt miqve të tyre. Individët e të njëjtës gjini përqafohen dhe shpesh puthen ndërkohë që përshëndeten me shprehjen "Xhan!". Shpesh i sheh të ecin duke u mbajtur për dore, disa herë në grupe dyshe, në raste të tjera - tre ose katër veta.

Grupet e burrave ose të grave shpesh mund të jenë shumë bashkëbisedues, nëpër rrugë ose në transporte publike. Mos u çudisni kur të dëgjoni shpërthime të qeshurash nga grupe të rinjsh ose të rejash ndërkohë që ndodheni në autobus ose në metro. Meqë po flasim për transportin publik, duhet të kini parasysh që, konsiderohet sjellje e përshtatshme, që një burrë t'i lirojë vendin e tij një femre, sidomos kur ajo është më e moshuar. Nëse do t'i ofronit vendin tuaj, do të merrnit si shpërblim një “merci” (falenderim) dhe një buzëqeshje. Nëse njerëzit i buzëqeshin njeri-tjetrit në rrugë, kjo zakonisht ndodh sepse ata njihen. Një buzëqeshje e pa kërkuar vërehet si jo e sinqertë dhe shumë “Amerikane”. Gjithashtu, përgëzime të tepruara për arritje në punë ose në shkollë shihen si një qëndrim “Amerikan” i panevojshëm që shpërblen njerëzit pa arritur domosdoshmërisht diçka të madhe. E njëjta gjë vlen edhe për ndarjen e çertifikatave dhe trofeve, të cilat shihen si diçka e rëndomtë dhe pa kuptim.

Fëmijët marrin buzëqeshje nga pothuaj çdokush. Armenët i adhurojnë dhe janë të dhënë pas tyre. Nëse ju keni fëmijë, mos u çudisni nëse ata përkëdhelen në kokë ose i dhurohet ndonjë karamele, ose edhe ndonjë dhuratë e vogël nga njerëz plotësisht të panjohur. Prindërit e të vegjëlve shpeshherë ndjejnë se Armenët i japin liri vetes duke kërkuar që të shohin ose edhe të mbajnë fëmijët e vegjël dhe bebet. Të tjerë do të ofrohen që të kujdesen për fëmijën tuaj ndërsa ju lëvizni nëpër rrugicat e ngushta të marketeve. Kjo mund të jetë diçka çorientuese për prindërit e rinj, por në përgjithësi ka plotësisht qëllim të mirë.

## **MEDIA**

Armenët kanë qëndrime të ndryshme lidhur me konceptin e lirisë, veçanërisht kur bëhet fjalë për mediat. Disa pajtohen me pohimet e shoqatës “Reporterë pa Kufi”, sipas të cilëve vërehet progres në lirinë e shtypit. Disa të tjerë e vënë theksin në ngjarje të tilla, siç është protesta datës 1 Mars 2008 (shih Kap. 1) dhe thonë që qeveria ka ndërhyrë

brutalisht në lirinë e shtypit. Kohët e fundit, janë raportuar disa shqetësime serioze lidhur me sulme ndaj gazetarëve dhe Blogger-ve.

Ndonëse në dukje ekziston një shtyp i lirë, shumë prej kanaleve televizive (burimi më i preferuar i lajmeve) i përkasin figurave politike pro-qeveritare ose bizneseve të lidhura ngushtë me partitë qeverisëse. Gazetat zotërohen nga politikanë të ndryshëm të cilët e deformojnë përmbajtjen. Qarkullimi është gjithashtu i limituar. Të vetmet media që transmetojnë lajme relativisht të paanshme janë burimet Online. Faqja A1plus.am aktualisht filloi si një stacion televiziv deri sa u detyrua të pushonte trasmetimet pasi transmetimet e saj binin ndesh me partinë në fuqi. Tani së fundmi, ajo ka marrë një linjë transmetimi lajmesh online e cila i përditëson lajmet disa herë në ditë.

Suksesi i A1plus.am e detyroi qeverinë të hapte faqen e saj të Internetit për lajmet ditore, tert.am, dhe me qëllim që të vendoste një ekuilibër në përmbajtjen e lajmeve, ftoi dy nga gazetarët më të njohur nga ana e opozitës për të shkruar lajmet në këtë faqe.

Gjithashtu, ka edhe një sërë Bloggerash të pavarur. Disa gazetarë të shquar tashmë i përgatisin raportimet për Armeninë nëpërmjet GlobalVoices.com ose nëpërmjet blogeve të tyre personale. Një gazetë Interneti, Hetq.com, gjithashtu transmeton në mënyrë transparente dhe të ndershme ndodhi të reja, shpeshherë me rrezik për jetën personale të punonjësve të saj; botuesi i saj është sulmuar kohët e fundit në Erevan.

Megjithatë, ndonëse shtypi lokal është në një farë mase i kufizuar, Armenët kanë relativisht akses të lirë për lajmet që vijnë nga jashtë vendit të tyre. Shumë prej shtëpive në Erevan janë të pajisura me television satelitor të cilët japin në lajme raporte nga Rusia, USA (CCN) dhe UK (BBC). Dhe, natyrisht, të gjitha këto pjata satelitore që ju shihni kudo nëpër Armeni, shpërndajnë gjithashtu edhe një sërë programesh argëtuese. Krahas programeve Armene, lokalet japin edhe programe zbavitëse në gjuhën Angleze dhe Ruse.

Gazetat dhe revistat periodike Armene janë të disponueshme në pothuajse çdo vendqëndrim. Megjithatë, mos shpresoni të gjeni ndonjë

kopje të Financial Times ose International Herald Tribune – publikimet në Anglisht gjenden me vështirësi.

## TELEFONI

Kur përdorni telefonin me kabëll nëntokësor (telefoni fiks), sistemi telefonik lokal është relativisht i thjeshtë për t'u përdorur. Telefonia me kabëll nëntokësor shërbehet nga kompania Beeline (e cila gjithashtu ofron edhe DSL), dhe kompania Armentel dhe VivaCell janë shpërndarësit popullorë të telefonisë celulare.

Ndonëse shumica e të moshuarve vazhdojnë të përdorin telefoninë fikse, të rinjtë përdorin gjerësisht telefonin celular. Është normale për njerëzit të hapin telefonin e tyre sa herë që u bie zilha, pavarësisht se ku ndodhen – në klasë, në takim pune apo në autobus. Madje edhe kamerierët, ndërkohë që janë duke marrë porosinë, e kanë zakon që të hapin telefonin kur u bie zilha.

N.q.s jeni duke udhëtuar nëpër Erevan, blini ose merrni me qira një celular që e ka sistemin GSM të zhbllokuar (n.q.s jeni duke udhëtuar jashtë vendit tuaj, sigurohuni që telefoni juaj, pavarësisht Rooming-ut tuaj, të punojë në vendin ku do të shkoni). Kartat SIM janë relativisht të lira sapo që të ndodheni në vend, dhe përdorimi i tyre mund t'ju kursejë shumë para krahasuar me shpenzimin Rooming.

## INTERNETI

Armenia ka nivel cilësor në teknologjinë e lartë. Pothuajse çdo rrugë në Erevan ka një dyqan kompjuterash ose lokal Interneti. Kjo gjë nuk ka pse të jetë surprizë. Dikur, në epokën sovjetike, Armenia ishte qendra teknologjike, ose Lugina e Silikonit, për Bashkimin Sovjetik. Të rinjtë kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të stimuluar të studjojnë shkencat kompjuterike në shkollë dhe të ndjekin Teknologjinë Informatike si profesion. Faqja SiliconArmenia.com ofron informacion mbi mundësitë që ofron Armenia në IT. Megjithatë entuziazmi Armen për gjëra të

teknologjisë së lartë ka një limit. Ndonëse çdokush në Erevan mund të blejë një laptop, problemi qëndron tek çmimi. E njëjta gjë vlen të thuhet për të gjitha tipet e pajisjeve audio dhe video. Ndonëse ofrohet pothuajse çdo gjë, ekonomikisht blerja e tyre shpesh është e papërbalueshme për banorët vendas tipikë të Erevanit.

Përsa i përket Internetit, shumica e personave të fushës së biznesit në Erevan kanë filluar ta shohin atë si formën primare të komunikimit. Disa mallra dhe shërbime mund të merren online (ka një magazinë grosiste që ofron shërbime online); megjithatë shumica e këtyre gjërave i përket të ardhmes.

Shërbimet dial-up janë forma dominuese e shërbimeve në Armeni. Ndonjeri mund të përdori wireless, por kjo formë është akoma shumë e kushtueshme dhe përdoruesit shpesh ngarkohen me pagesa “download” ose “upload” si pjesë e kontratës. Janë hartuar disa projekte për t’ju ofruar wireless edhe komunitete të vogla të zonave rurale (fshatare), por këto vazhdojnë të mbeten në kuadrin e planeve. Aktualisht, n.q.s. ju keni nevojë për shërbim Interneti, lidhja më e mirë mund të jetë DSL, e cila është shumë më e arësyeshme në çmime se sa wireless.

Shumica e bizneseve në Armeni parashikojnë të kenë një Web Site. Zakonisht, ky është një Site bazik me informacion mbi produktin dhe kontaktet. Normalisht në gjuhën Angleze dhe Armene, me mundësi përkthimi në Rusisht. E-commerce dhe Web 2,0 (programe tepër ndërvepruese) janë akoma relativisht të ralla për bizneset në Armeni. Bloggig-u është shumë popullor ndërmjet të rinjve si formë e komunikimit personal, veçanërisht nëpërmjet platformës Live Journal.

## MAIL

Shërbimi postar është diçka për të cilën Armenët nuk do të kishin dëshirë të flisnin. Ndonëse janë rimëkëmbur disa prej zyrave postare, posta Armene (shërbimi postar shtetëror) mbetet në nivelin e shërbimit si një herë e një kohë. Marrja e një pakoje të ardhur nga një vend tjetër, është një veprim që kryhet shumë ngadalë dhe shumë stresues. Nuk

është e pazakontë për një pako, që të arrijë një ose dy muaj pasi ajo të jetë dërguar.

Ndonëse zakonisht, ndodhet gjithmonë dikush, në postën Armene, që flet Anglisht, kjo nuk është e garantuar. Duke qenë se posta Armene është vendi ku paguhen edhe faturat e mirëmbajtjes së shtëpive, juve mund t'ju duhet të prisni në rradhë për njëfarë kohe përpara se të mund të merrni pakon ose të tërhiqni një të humbur prej shumë kohësh.

## KONKLUZION

Për ata Armenë të Diasporës, që banojnë në qytete me popullsi të madhe Armene të Diasporës, është e lehtë të krijohet një përfytyrim mjaft romantik i vendit. Vetëm në Armeni mund të kuptohet se çfarë lufte të vazhdueshme bëjnë Armenët krenarë për të ruajtur atdheun e tyre të dashur. Ndërkohë që shumë vende të vogla i kanë hapur rrugë shteteve pushtuese ose kanë lejuar që traditat dhe zakonet e tyre të shuhen, Armenët gjithmonë i kanë rezistuar presioneve për asimilim.

Kur të qëllojë që të shkoni në Armeni, kujdesuni që të merrni kontakt me njerëz të gjeneratave të ndryshme. Nga të vjetrit, ju do të dëgjoni histori nga jeta e tyre në kohën e sistemit Sovjetik, luftërat pa krye, mungesat, dhe dëshirën e tyre për malin Ararat. Nga brezi i ri, ju do të dëgjoni shpresat e tyre për të ardhmen e vendit të tyre. Ju do të arrini të mësoni dhe të respektoni këta realistë krenarë, të cilët e kuptojnë pjesën e përgjegjësive për të ruajtur atë për të cilën është luftuar dhe për t'u a transmetuar atë të tjerëve dhe fëmijëve të tyre.

Kini parasysh që, një vizitë në Armeni do të kishte vlera, vetëm n.q.s. ju do të linit mënjane paragjykimet dhe do të shkonit me mendje e zemër të hapur. Mos u acaroni nga mënyra se si janë bërë gjërat në një vend ku jeta e përditëshme është një luftë e vazhdueshme me vështirësi nga më të ndryshmet. N.q.s. dëgjoni njerëzit, merrni prej tyre bukurinë e vendit, dhe vlerësoni historinë e gjatë të tij, me siguri që do të frymëzoheni nga ky vend i lashtë si edhe krenaria, ngrohtësia dhe qëndrueshmëria e popullit të tij.







# 1500 - VJETORI

i Kanunit të shkruar Armen

Përshtatur në shqip nga libri:

“Երավակարգի 1500 - ամյա ակունքներն Արցախում”  
i shkrimtarit Կիմ Ղահրամանյան (Kim Hahramanian),  
botuar në Jerevan, 2010.



# 1500 – VJETORI I KANUNIT TË SHKRUAR ARMEN

Formimi i Republikës së Karabakut Malor, konsolidimi dhe forcimi i mëtejshëm i organizimit shtetëror në periudhat e nxehta kohore të luftës dhe të pasluftës i dhanë shkas krijimit të një sërë pikëpyetjeve.

Si ishte e mundur që, pas afro 70 vjetëve të një politike anti-Armene, Azerbaixhani dështoi vazhdimisht në përpjekjet e tij për të asimiluar dhe zotëruar atë hapësirë të vogël malore, pasi kishte përdorur të gjitha mjetet e mundshme për të ndryshuar në mënyrë sistematike përbërjen etnike të popullsisë së Arcah – Karabak. Si ishte e mundur që një grusht njerëzish të ngriheshin për mbrojtjen e identitetit të tyre brenda një rregjimi të egër siç ishte ai i Bashkimit Sovjetik? Edhe kur Azerbaixhani përdori gjerësisht mbështetjen politike dhe ushtarake të Moskës për fillimin e një lufte për të shtypur betejën për vetëvendosje, për të çfarosur Armenët nga ajo krahinë, ai ishte i detyruar të përballej me një dështim të turpshëm. Si u arrit t'i merrej fitorja një armiku shumë herë më të madh në numër dhe shumë më superior në armatime?

Si është e mundur që, në kondita lufte dhe pranisë së një krize ekonomike, të vendoset një tip modern organizimi demokratik shtetëror, mbi parimet së drejtës ndërkombëtare të njohura botërisht?

Përgjigjet e këtyre pyetjeve janë të dobishme jo vetëm në kontekstin historik, por edhe për vazhdimësinë efektive të arritjeve ekzistuese. Përgjigjet e drejta dhe të sakta do t'u jepnin mundësi fuqive politike të gjenin mënyrën për të rregulluar situatën, në përputhje me kuptimin

korrekt të thelbit të problemit të Karabakut dhe dhënies një zgjidhje të barasvlershme. Përgjigjet e drejta dhe të sakta do të ishin të dobishme për popujt që luftojnë për pavarësi dhe janë në rrugën e vendosjes së një organizimi të ri shtetëror.

Para së gjithash, duhet kuptuar mirë që çështjet e sipërpërmendura kanë historinë e tyre. Si sukcesi ushtarak ashtu edhe fitoret politike janë të lidhura ngushtë mes tyre. Asgjë e re nuk ka ndodhur në gjithë këtë histori, por gjithçka është zhvilluar kryesisht në përputhje me rrjedhën normale të kohës.

Në çdo kohë, kërcënimet ndaj sovranitetit dhe besimit, i kanë bashkuar njerëzit, fuqitë shoqërore dhe politike të Armenisë. Kjo shpjegon arrijtjen e fitoreve në vitin 1918 në betejën e Sardarapat-it, kundër forcave shumë herë më të mëdha Turke, duke krijuar kështu kushtet për rivendosjen e bazave të organizimit shtetëror Armen. Një nga çfaqjet e vazhdueshme të këtij bashkimi ishte fitorja e popullit Armen në luftën për Arcah-un.

Këto fitore kanë rrënjë historike dhe ligjore, gjë që dëshmohet në një dokument historik interesant dhe me vlera. Ky është Kushtetuta e Vaçakanit të Devotshëm, që është shkruar në krahinën e Arcah-ut 1500 vjet më parë dhe është ruajtur për mrekulli, për të mundur të arrijë deri në kohën tonë në gjendje të mirëmbajtur. Një studim i thelluar i këtij dokumenti ligjor unik, si dhe i rrethanave në të cilat është shkruar, sipas mendimit tonë, do të ndihmonte për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë realitetet e kohëve të shkuara, dhe përse jo edhe ato të tashme.

Pas luftërave të gjata e të vazhdueshme, në vitin 387 pas Krishtit, Mbretëria Armene u nda ndërmjet Perandorisë Bizantine dhe Persisë. Pjesa perëndimore e vendit u aneksua nga Perandoria Bizantine, ndërsa tokat lindore (përfshirë Arcah-un) ju dhanë Persisë. Përfundimisht, në vitin 428 pas Krishtit, Mbretëria Armene tashmë ndodhej e shkatërruar. Ajo u reformua dhe u shndërrua në një Marz (Krahinë periferike); dhe me qëllim që të siguronte sa më lehtë qeverisjen e kësaj njësie të re administrative, Persianët eliminuan të gjitha rrugët e mundshme

të rivendosjes së pavarësisë dhe shkëputën prej saj krahinat lindore – Arcah dhe Utik, të cilat gjithnjë ishin quajtur si “Pjesa Lindore” ose “Bota Lindore”. Këto të fundit ju aneksuan fiseve Albane, që në atë kohë qeveriseshin nga Persia, dhe që zinin një hapësirë që fillonte nga lumi Kura deri në vargmalet Kaukaziane, duke krijuar kështu një tjetër provincë të quajtur Ahvank (të njohur ndryshe si Albania e Kaukazit ose Alvania).

Krahina e porsakrijuar Ahvank përbëhej nga dy pjesë të cilat nuk kishin kurrfarë afërie me njera tjetrën, arësyeja kryesore kjo, që kjo provincë nuk arriti kurrë të bëhej një njësi administrative e unifikuar. Zona në veri të lumit Kura ishte e banuar nga një duzinë fisesh të vogla të cilët jetonin të veçuar nga njeri tjetri dhe nuk kishin një tregti, gjuhë, kulturë apo besim të përbashkët. Në kontrast me ta, Bota Perëndimore Armene, jetonte si një bashkësi unike, fliste të njëjtën gjuhë, duke kultivuar bashkarisht të njëjtat vlera kulturore dhe fetare.

Bile edhe historianët Grekë dhe Romakë të kohës së vjetër kanë shkruajtur se Armenia ndahej prej fiseve Albane nga lumi Kura. Në përpjekje për të rishikuar këto burime informacioni, i ashtuquajturi themelues i disiplinës historike të Azerbaixhanit, Abass-Kuli-Aga Bakikanov ka shkruajtur: “Kufiri Armen shtrihet përgjatë bregut të djathtë të lumit Kura deri në pikën ku lumi Araks fillon rrjedhën” (Gjylistan-Iram, Baku, 1926, c,8).

Zonat në veri të lumit Kura ishin të populluara nga një duzinë fisesh të vogla, dhe përgjithësisht nga historianët e vjetër ishin të njohura si “Albania”, që do të thotë “vendi i maleve”. Ja vlen të përmendim këtu që këto vende kanë këtë emër akoma edhe sot, pasi “Dagestan” në gjuhën e vendit përkethehet si “Vendi i Maleve”. Sot, këto vende banohen prej shumë grupeve të ndryshme etnike, ashtu siç ka qenë edhe në të kaluarën. Kjo ndasi ishte edhe arësyeja kryesore për ndarjen e kësaj krahine ndërmjet Ruisë Sovjetike dhe Azerbaixhanit në vitin 1920. Që nga koha e shembjes së Bashkimit Sovjetik, popujt që jetonin atje kanë qenë duke luftuar për unifikim, veçanërisht rreth 1 milion lezginë që

synonin të bashkoheshin me gjysmën tjetër, bile edhe pas asimilimit ndën rregjimin e Azerbaixhanit. Po kështu, rreth 800 000 Talish luftojnë për të drejtën e tyre për vetvendosje, dhe janë shtypur ashpërsisht prej qeverisë së Azerbaixhanit, përfshirë këtu edhe ndalimin e përdorimit të termave etnike, dhe duke i emëruar të gjithë - Azerë, në të njëjtën mënyrë siç veprojnë Turqit duke e emëruar kombin shumë-milionësh Kurd si “Turqit e Malësisë”.

Duke u kthyer mbrapa në realitetin historik, pjesa Jugore e krahinës së porsakrijuar me emrin “Albania” ose e thënë ndryshe, bregu i djathtë i lumit Kura, ishte në atë kohë kufiri Lindor i Mbretërisë Armene, me një popullsi të unifikuar që kishte të njëjtën gjuhë të përbashkët, të njëjtin besim, zhvillonte të njëjtat vlera kulturore, historike dhe praktika tregtare. Falë këtij uniteti, në shekullin e 5-të, në këtë vend u formua një mbretëri e vogël dhe pjesërisht e pavarur, ndën rregjimin Persian, e drejtuar nga Dinastia Armene e Aranshahik. Lëvizjet dhe luftërat për liri të gjysmës së dytë të shekullit të 5-të kontribuan në konsolidimin e kësaj mbretërie si rezultat i së cilës Persia u detyrua ta lehtësojë politikën shtrënguese ndaj Armenëve, duke nënshkruar Traktatin e Nvarsak-ut.

Që nga ajo kohë të drejtat dhe liritë e Krahinës (Marz-it) Armene u zgjeruan; autoritetet tradicionale të ministrave Armenë të vendosura sipas traditës, që për detyrë kryesore kishin mbajtjen e forcave të armatosura dhe mbledhjen e taksave, u rivendosën plotësisht.

Natyrisht, këto kompromise ju përcollën gjithashtu edhe Dinastisë Aranshahik të themeluar në Anën Lindore. Një historian Armen i shekullit të 5-te, Movses Korenatsi shkruante se kjo dinasti vinte nga Hajk Nahapet. Ai gjithashtu shkruante që Mbretëria Armene ishte vendosur “զեզեղբբ հայկալաւն խօսիցս.” (citim nga Armenishtja e vjetër), që do të thotë në një zonë ku njerëzit flasin Armenisht dhe marshallët (drejtuesit) emërohen nga gjenerali Hajk Nahapet për të qeverisur në tokat e Mbretërisë. Pjesa Veri-Lindore e Armenisë shtrihej nga lumi Araks deri në bregun e djathtë të lumit Kura, duke përfshirë edhe Kështjellën e Hnarakert-it, provinca Kambeçan, në bregun e majtë të lumit Kura. Korenatsi tregon se Arani fisnik dhe guximtar ishte emëruar për të

qeverisur mbi këto toka (Մովսես Խորենացի, Պատմութիւն հայոց, գիրք երկրորդ, գլուխ Ը).

Dinastia ministeriale e Aran-it, e cila qeverisi popullin Armen në këto toka për shekuj, përdori ligjet e veta tradicionale dhe themeloi atë Mbretëri të vogël Armene të shekullit të 5-të. Disa herë kjo Mbretëri u quajt sipas organizimit të ri territorial – Ahvank, por ajo jetoi dhe u zhvillua si një tokë Armene, dhe me Armeninë.

Në vitin 301, në Armeni u adoptua Kristianizmi, si fe zyrtare. Kjo fe që ishte praktikuar nga Armenët në Armeni shumë kohë përpara se të bëhej fe zyrtare, aplikohet edhe në shtetet Lindore të Arcah dhe Utik, por në vitin 301 ajo u adoptua si fe zyrtare dhe për të gjithë Armenët. Nipi i Grigor Iluminatorit, Grigoris u emërua si Bishop (Peshkop) në tokat e pjesës Lindore, që ishin Arcah dhe Utik, duke marrë në konsideratë rëndësinë ushtarake dhe politike të forcimit të fesë së re në këto zona të Armenisë.

Mbreti i Armenisë dhe Katolikosi i gjithë Armenëve e dinin që Kristianizmi do të kontribuonte në unitetin kombëtar dhe do të shërbente si barrierë për fiset e shumta barbare që vazhdimisht sulmonin nga Lindja. Pas kësaj, kur u formuan Dioqezat Peshkopale të Kishës Armene, Dioqeza e Anës Lindore, në përshtatje me njësinë e re administrative të porsakrijuar, u emërua si Dioqeza e Ahvank-ut.

Përsëri, referuar jo vetëm interesave ushtarake dhe politike, autoritetet e kësaj Dioqeze u zgjeruan, dhe ajo u reformua ndën Dioqezën e Katolikosit, brenda Kishës së bashkuar Armene, ndën kujdestarinë e Eçmiaxin-it. Më vonë, pas ndërtimit të Kishës së Gandzasar-it, emri “Ahvank” u shndrrua në Kryepeshkopata Gandzasar.

Me qëllim evitimin e konfuzionit që mund të krijohet për shkak të emrit të kësaj krahine Armene dhe vendit Albania, që shtrihej në bregun e majtë të lumit Kura, për shkak se që të dyja, me ristrukturimin krahinor që bëri Persia, u futën në një Marz (Krahinë) të emërtuar Ahvank, shkrimtarët e kohës gjithnjë e diferenconin Ahvankun Armen nga vete Ahvanku historik, Albania. Si shembull sjellim shkrimtarin A.A

Sakareli, i cili ndan qartë krahinën e Albanisë, e cila shtrihet në veri të lumit Kura, nga Ahvanku Armen, (Грамоты и другие исторические документы 18-го столетия, относящиеся до Грузии, том 2, под ред. А. А. Цагарели) që shtrihet në Jug. Libra të shumtë, shtypur me urdhër të Perandorit Rus Aleksandër, e shikojnë lumin Kura si kufirin ndërmjet Armenisë dhe Albanisë (Описание Кавказа с кратким историческим описанием Грузии, СПб, 1805, с. 28). Nga burimet e informacionit që i serviroshin Carëve Rusë, vazhdimisht është konfirmuar që bregu i djathtë i lumit Kura është Armen dhe është “qeverisur nga Armenët deri në ditët e sotme” (Акты собранные Кавказской Археографической комиссией. Под ред. Ад Берже, том 6, часть 1, 1874, с. 840). Në punimet e tij, një studjues Rus, Nikollaj Frolovski, vëren ekzistencën e një tjetër grupi etnik, përveç Armenëve, në anën e majtë të lumit Kura në mes të shekullit 19-të, dhe jep shpjegimet e mëposhtëme: “Armenët kanë qenë banorët më të hershëm të këtyre tokave, dhe tatarët erdhën nga ana tjetër e Detit Kaspik” (Обозрение российских владений за Кавказом, ч.2, СПб, 1836, с. 439). Është e rëndësishme të vihet në dukje që popujt e ardhur rishtas, të mësuar me klimën e thatë dhe shkretëtirat e pjesës Lindore të Detit Kaspik, zbuluan një klimë komplet të ndryshme dhe një natyrë të ndryshme në Botën Lindore të Armenisë, të pasur me pyje, dhe me lëndina e kopshte të shumtë. Ata e emërtuan këtë vend Karabak, që në gjuhën e tyre do të thotë “Një Kopësht i Madh me Fruta”, në të njëjtën mënyrë siç quajnë sot Karakum – Një Rërë e Madhe ose Kara Bogaz gyl – Një Liqen i Thellë i Zbrazët, etj. Që prej asaj kohe Arcahu mori emrin e tij të dytë, si Karabak.

Historia e Azerbaixhanit përmban shpjegime justifikuese lidhur me ndryshimet në përbërjen etnike në tokat e përmendura Armene në bregun e djathtë të lumit Kura. Një nga themeluesit e disiplinës historike të Azerbaixhanit, I. A. Pahomov ka shkruar që në mesin e dytë të shekullit të 18-të, shumë kohë përpara formimit të Khanateve, në këto vende qeveriste një dinasti bejlerësh, e cila e ruajti identitetin e vet madje edhe gjatë Khanateve, ndonëse paralelisht me emërimet e bejlerëve Tatar – Turq nga udhëheqësit e fiseve të ardhura rishtas: “Më pas trashëgimtarët

e udhëheqësve të këtyre fiseve u ftuan nga Shahët Sefeviane (Persianë) në këto toka dhe u ra dakord të nguliteshin në Transkaukazi duke filluar nga shekulli i 16-të. (E. A. Пахомов, О земельно - сословном вопросе Азербайджана, Баку, 1926, сс. 1 - 2).

Ky proces vazhdoi deri në mesin e shekullit të 18të kur Persia formoi një Khanat të veçantë në Arcah. Me qëllim që të forconte një qeverisje të besueshme në këto vende, udhëheqësi nomad mysliman i një fisi Turk Panah u deklarua Khani i Arcah – Karabakut Kristian. Vetë Khani gjithnjë u përpoq të vendoste një mbështetje të fortë shoqërore, e cila do të bënte të mundur ruajtjen e qeverisjes së tij mbi këto toka. Historiani i Khanit shkruante se Khani solli forcërisht një duzinë me barinj nomadë për t’u vendosur në krahinën e Shushit së bashku me familjet e tyre, atje ku ishte edhe vendqëndrimi i tij (Мирза Адигезаль–бек, Карабах–наме, Баку, 1950, с. 50-59). Këto familje nuk arritën kurrë të nguliteshin përfundimisht në ndonjë vend dhe rezultuan një katastrofë për banorët vendas, pasi ata shkatërruan kullotat e bagëtive dhe kopshtet, vodhën bagëtinë dhe morën rob bujqit. Një nga burrat e shquar shtetërore të historiografisë së Azerbaixhanit, V. N. Leviatov ka treguar pasojat shkatërrimtare të gjithë këtyre proceseve në ekonominë e rajonit në përgjithësi (В. Н. Левиатов, Очерки истории Азербайджана в 18 в, Баку, 1948, с. 54-55).

Kjo politikë solli ndryshime në përbërjen etnike nëpër të gjithë zonën, ndonëse, duke ju referuar një historiani tjetër të njohur Azer, Gasi Abdulajev: “Feudalët Armenë Melik vazhduan të qeverisin në pjesët malore të Karabakut” (В. X. Левиаов, Очерки истории Азербайджана в 18 в., Баку, 1958, с. 54-55).

Ekzistenca e kësaj Mbretërie të vogël në Botën Lindore të Armenisë, për herë të parë u studjua me kujdes nga orientalisti i njohur S. V. Jushkov, bazuar në veprën e Movses Kaghankavatski “Historia e Ahvankut” dhe burime të tjera. Me qëllim që të evitonte ndonjë konfuzion ose keqkuptim mbi burimet historike të informacionit, Jushkovi theksoi se Mbretëria e përmendur në “Historia e Ahvankut” ishte në territorin e Armenisë së lashtë dhe ishte “fragment” i Shtetit dikur të fuqishëm të Armenisë

(К вопросу о границах древней Албании. Исторические записки АН СССР, том 1, Москва, 1937, с. 137). Është me vlerë të përmendet që Movses Kaghankavatski i paraqet fiset (tributë) Albane si “njerëz të ashpër” dhe sundimtarët e tyre si “mizorë” (Book 1, Chapter 11). Kjo nënkupton që autori i “Historia e Ahvankut” i paraqet fiset Albane si të pazakonshëm dhe armiqësore.

Në këtë pjesë të diskutimit duhet rikujtuar se njohja korrekte e pozicionit geografik dhe e emrave etnikë është me rëndësi të veçantë për perceptimin e saktë të realiteteve historike. Punime shkencore lidhur me këtë çështje janë kryer edhe në Azerbaixhan, në vitet e para të formimit të këtij vendi. Përpara vitit 1930 popullsia bazë e Azerbaixhanit përbëhej prej grupeve Tatar, Tat, Tallish, Lezgin, Avar, Turqit Kaukazianë, Kurd dhe Persian, përfshirë këtu Armenët dhe Rusët, si edhe grupe të tjera etnike. Duke filluar nga viti 1930, të gjitha grupet etnike myslimane u quajtën Azerë, sipas emrit të shtetit të porsakrijuar. Është interesante të vihet re se po ai popull që e quan veten “Azerbaixhani”, në gjuhën e përditëshme rutinë e quan veten thjesht Mysliman, që do të thotë se vetë perceptimi i “Azerbaixhanit” në praktikë nuk ekziston.

Në ditët tona, Republika e Azerbaixhanit, në fazën fillestare të themelimit dhe të deklarimit është identifikuar si Republika Demokratike Myslimane e Transkaukazit Lindor. Duke ndjekur këshillat e forcave politike më me influencë në Turqi, Azerbaixhani si pasojë u riemërua në përputhje me objektivat Pan Turke për zgjerim influence në të ardhmen.

Emri Azerbaixhan, siç shkruhet në historinë e këtij vendi, nuk lidhet me territorin e vendeve që ai ka pushtuar. Letërsia shkencore e publikuar në Baku, thekson: “emri Azerbaixhan kurrë nuk u përhap në vendet në Veri të Lumit Araks. Kur Komisariati Transkaukazian u nda në Gjeorgji, Armeni dhe Transkaukazia Lindore (1918), lindi ideja që të krijohet një shtet që të mund të unifikonte të ashtuquajturit “Turqit Azerë” të Rusisë dhe Persisë. Ky vend u quajt përkohësisht Azerbaixhan(sipas emrit të njerit prej shteteve veriore të Iranit)..., dhe megjithëse Shteti i krijuar rishitas përfshinte vetëm Kaukazin Lindor, emri Azerbaixhan nuk u ndryshua, pasi emrat Shirvan dhe Aran pasqyronin vetëm pjesë

të territorit” (E. A. Пахомов, Краткий курс истории Азербайджана, Баку, 1923, с. 11).

Krijimi i alfabetit Armen në vitin 405 dhe i librave të parë Armenisht prej Mesrop Mashtotc mund të konsiderohen si ngjarje të tjera të rëndësishme, pas adoptimit të Kristianizmit. Krijimi i germave të reja nuk kishte vetëm rëndësi kulturore por edhe rëndësi të madhe politike. Siç është përmendur edhe më parë, në fillim të shekullit të 5-të Armenia ishte e ndarë në dy pjesë, ndën sundimin e dy perandorive të fuqishme, ku secila prej tyre përpiqej që forcërisht t’i përfshinte Armenët brenda vlerave të tyre kombëtare dhe të eliminonte në këtë mënyrë çdo përpjekje të mëtejshme të Armenëve për rifitimin e pavarësisë. Mbreti i Armenisë Lindore, Vramshapuh dhe Katolikosi Sahak Partev (Isaku i Armenisë), brenda mundësive të tyre e mbështetën Mesrop Mashtotcin, duke kuptuar se germat Armene do të bëheshin një mjet i fuqishëm për të bashkuar popullin e ndarë të këtyre dy vendeve.

Pas krijimit të germave të reja, Mashtotci vuri të gjitha përpjekjet e tij për krijimin e shkollave të reja nëpër të gjithë Armeninë. Bile në atë kohë ai i kushtoi më tepër vëmendje krahinave Veri – Lindore të vendit – asaj që quhej asokohe Bota Lindore Armene. Hapja e shkollave të reja filloi piksëpari atje. Ndodhet një pemë gjigante në afërsi të fshatit Verin Shen, në ish krahinën Sovjetike të Shahumjanit, diametri i së cilës është rreth 25 m. Ndodhet një lutje në fund të pemës, e cila është bërë vend pelegrinazhi. Ky vend i shenjtë është quajtur “Kir Kaç”, që nënkupton se ai i është kushtuar germave Armene. Njerëzit thonë se pema është mbjellë nga vetë Mesrop Mashtotci. Mbretëria e formuar në Botën Lindore Armene e arriti kulmin e saj në gjysmën e dytë të shekullit të 5-të, në kohën e Mbretit Vaçakan, i cili e mori kurorën e tij nga Shahu i Persisë. Jeta dhe aktiviteti i tij janë përshkruar në librin “Historia e Ahvankut” të Movses Kaghankavatskit. Shkrimtari pohon që ministrat e këtyre vendeve mbajtën një qëndrim unik në zgjedhjen e njerit prej trashëgimtarëve të fronit nga dinastia e mbretërve Armenë, një djali të ri të gjatë dhe të pashëm, të ditur dhe kurajoz, emri i të cilit ishte Vaçakan; ata e çuan atë në Persi, ku ai u kurorëzua nga Mbreti Persian Vagharshak.

(Մովսես Կաղանկատվացի, Պատմություն Աղվանից աշխարհի, գիրք առաջին, գլուխ 17) Vlen të përmendet fakti që Mbreti Vagharshak i besoi Vaçakanit qeverisjen e tokave në bregun e majtë të lumit Kura, që do të thoshte se Vaçakani ishte mbret në Anën Lindore dhe në tokat e Ahvankut në Jug të lumit Kura (Shih: “Principality of Khachen in the 10-16 centuries. Yerevan, 1975, p. 61”).

Për shkak të bashkëpunimit aktiv dhe të frutshëm me Kishën, Mbreti Vaçakan mori edhe emrin “I Devotshmi”.

“Historiografia” provon se Vaçakani ndërtoi aq shumë kisha, sa ka viti ditë, dhe hapi shumë shkolla të reja. Vaçakani ndërtoi kisha në Botën Lindore dhe në Ahvank (Albania), shteti ekzistues në bregun e djathtë të lumit Kura, ku atëkohe ekzistonin vendbanime të vogla Armene. Shumë prej këtyre kishave qëndruan për një kohë të gjatë, por u shkatërruan në mënyrë të programuar nga Azerbaixhani Sovjetik. Megjithatë, ndonjera prej tyre vazhdon të qëndrojë, ndonëse në gjendje të rrënuar (është e qartë që qeveria e Azerbaixhanit do t’i shkatërrojë edhe ato, ashtu siç shkatërroi Gurët–Kryq Armenë të Xhuga-s disa vjet më parë).

Vepra madhore (Kurora e veprave të tij) e punës së Vaçakanit ishte Kushtetuta, e cila u ruajt për mrekulli për të arritur deri në ditët tona. Interesant është fakti që edhe 1500 vjet më parë ajo është quajtur “Kushtetutë”, dhe është konceptuar, zhvilluar dhe finalizuar në mënyrë mbarëkombëtare. Me gjithë veçoritë e saj ky dokument mund të quhet demokratik, qoftë edhe e krahasuar me kriteret e sotme të demokracisë, natyrisht duke marrë në konsideratë realitetet e atyre ditëve.

Përse kishte lindur nevoja për një Kushtetutë dhe si u krijua ajo? Përgjigja e detajuar gjendet po në të njëjtin burim. Shkrimtari shpjegon se pas shkatërrimit të Mbretërisë së Bashkuar Armene, Persia (ashtu si edhe Bizanti në Pjesën Perëndimore të Armenisë) bëri ç’ishte e mundur për të parandaluar shpalljen e pavarësisë në Armeni dhe rivendosjen e Mbretërisë Armene. Ajo përdori të gjitha mjetet dhe mënyrat për të krijuar sekte fetare, u përpoq të nxiste konflikt të brendshëm brenda Kishës Armene, si edhe ndërmjet Kishës dhe Fisnikërisë krahinore

Armene. Persianët ua hoqën tokat nga zotërimi princërve Armenë dhe i shpërndanë ato ndërmjet pronarëve të ndryshëm. Bazat tradicionale të marrëdhënieve shoqërore dhe jeta shoqërore në përgjithësi ishin të trazuara.

Kjo politikë destruktive pati si rezultat konfrontime serioze ndërmjet popullatës Armene në mes të shekullit të 5-të. I ndezur nga një frymë e përgjithëshme lirie i gjithë vendi ishte përfshirë në një lëvizje kombëtare për liri, që, natyrisht, përfshiu edhe pjesët Lindore të vendit, pra Anën Lindore. Në fillim të vitit 480, lëvizja çlirimtare e Armenëve përfundoi me nënshkrimin e marrëveshjes së Nvarsark-ut. Persia u detyrua të ndryshojë politikën e saj ndaj Armenisë: më pas ajo u pozicionua në një pozicion më miqësor, kështu që vala e kryengritjeve nuk vazhdoi të përhapej në krahinat e tjera të vendit. Këto ishin kushtet e favorshme kur autoritetet Princërore të Anës Lindore sollën në fron Vaçakanin. Është me vlerë të përmendet momenti i kurorëzimit, kur Mbreti i Persisë me kurorë në dorë i dha Vaçakanit gjithashtu zgjedhjen e tij, duke i thënë: “Çdo fe do të ketë zgjedhjen dhe dëshirën e vet. Ne nuk mund ta detyrojmë popullin të besojë (Մովսես Լաւրաւնկատվացի, զիրք առաջին, զլուխ ԺԷ).

Mbreti Vaçakan hapi shkolla për fëmijët e të gjitha shtresave të shoqërisë, si dhe ndërtoi shumë kisha. Me qëllim konsolidimin e bazave të jetës shoqërore dhe rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shtresave të ndryshme të popullsisë, autoriteteve fetare dhe administrative, ai inicioi krijimin e Kodit të Ligjeve që buronte nga traditat historike të popullit Armen. Si model, Vaçakanit i shërbeu Katolikosi Nerses i Madhi. Në mes të shekullit të 4të, kur Dinastia Armene e Arshakunit jetonte kohët e veta më të vështira, Nersesi i Madh ishte i bindur që bazat ligjore të shoqërisë duhej të forcoheshin me qëllim forcimin e Mbretërisë. Ai studjoi ligjet dhe traditat Armene, si edhe ligjet kryesore të Kristianizmit, që ndiqeshin deri në atë kohë në botën e Krishterë. Bazuar në këto të fundit, ai krijoi Kodin e Ligjeve, i cili reflektonte problemet bazë të shoqërisë Armene të asaj kohe, pra të shekullit të 4të, siç ishin taksat, zbutja e konflikteve ndërmjet grupeve dhe shtresave të ndryshme shoqërore, zbatimi i ligjit. Ai ngriti çështjen e ngritjes së shkollave, ndërtimin e shtëpive për të pastrehët

dhe jetimët në komunitete të ndryshme, çrrënjosjen e traditave pagane, etj. Vendimet rregulluese të shkruara nga Katolikosi Nerses u adoptuan në vitin 356, në Forumin Ligjvënës të Ashtishatit, me pjesëmarrjen e Peshkopëve dhe Princërve më të vjetër.

Duke marrë në konsideratë eksperiencën ekzistuese të popullit Armen, Vaçakani i bëri thirrje mendimtarëve të shquar Armenë të cilët jetonin në krahina të ndryshme të Armenisë dhe u kërkoi këshilla, duke përmendur këtu priftin shkencëtar Matte, Peshkopin Abraham të Mamikonianëve dhe të tjerë. Të gjithë këto shkrime pjesërisht janë përfshirë në “Historia e Ahvankut”. Referenca të tjera gjenden në punimet e historianëve të tjerë. P.sh., Stepanos Orbelian ka shkruajtur se Mbreti Vaçakan shkoi tek Peshkopi Petros (Bedros) i Sjunikut: “për t’u konsultuar për çështje të ndryshme shumë serioze dhe të komplikuara duke marrë përgjigje që jepnin zgjidhje të qarta” (Ստեփանոս Օրբելյան, Սյունիքի պատմությունը, Երևան, 1986, էջ 20).

Iniciativa e Mbretit Vaçakan u vu në zbatim në dy faza. Faza e parë ishte hartimi i projekt-Kodit të Ligjeve (Rregullave) dhe Faza e dytë ishte diskutimi dhe vënia në fuqi e këtij dokumenti. Faza e parë kishte për qëllim unifikimin e mendimit ligjor dhe të traditave historike të gjithë Armenisë dhe jo vetëm të krahinave të veçanta, dhe përfshirjen e të gjithë mendimtarëve të famshëm të kohës në pjesëmarrje në këtë proces. Faza e dytë kishte për qëllim t’i jepte vlerë këtij dokumenti pasi duke kaluar nëpër këtë rrugë ky dokument nuk ishte më një dokument i bërë vetëm me urdhër të Mbretit, por me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha shtresat e popullsisë.

Ky Forum nuk udhëhiqej vetëm nga Mbreti, por edhe nga njeri prej Princërve të provincave Armene – Vartani, i ashtuquajturit Guximtari. (Մ. Կաղանկուղի, “Պատմություն”, գիրք 3, գլուխ 10).

Pas hartimit të ligjeve, Vaçakani organizoi një mbledhje të madhe në rezidencën e tij verore në Agven, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga të gjitha shtresat shoqërore. Në njëfarë mënyre kjo nënkuptonte idenë e tij për të formuar një trup të lartë legjislativ, n.q.s. ne do të përpiqeshim

të bënim një paralele me sistemet moderne të adoptimit të ligjeve. Kjo mbledhje përfundimisht miratoi Kushtetutën; dhe çdo pjesëmarrës u betua solemnisht në përkrahje të zbatimit të saj, firmosi dhe vulosi mbi të. Pas kësaj Kushtetuta u vulos nga Mbreti, për ta konsideruar përfundimisht të aprovuar.

Mbreti Vaçakan jo vetëm që i mori në konsideratë ligjet e hartuara nga Katolikosi Nerses i Madh, por gjithashtu i ngriti ato në një nivel më të lartë, në përputhje me nevojat e Mbretërisë së kohës së tij. Kjo duket qartë në dy dokumentat legale të përmendur më sipër. Ashtu si edhe Nersesi i Madh, Mbreti Vaçakan i kushtoi gjithashtu vëmendje serioze eliminimit të konflikteve sociale ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore, aktiviteteve me karakter bashkëpunimi reciprok ndërmjet pushtetit laik dhe atij fetar, reduktimit të taksave dhe shumë çështjeve të tjera, siç ishte ajo e përfshirjes në Kushtetutë të kërkesës për lirin e të varfërve nga detyrimi për të paguar taksa.

Në luftë të vazhdueshme kundër sekteve të ndryshme fetare, ai lejoi barazvlershmërinë e shkollave dhe të edukimit Kristian të fëmijëve të anëtarëve të këtyre sekteve, gjë që tregon se aktiviteti legjislativ i Vaçakanit ishte shumë më praktik.

Kushtetuta e Vaçakanit kishte edhe një tipar tjetër interesant dhe shumë të rëndësishëm. Siç e kemi përmendur tashmë, Forumi Legjislativ i Ashtishatit ishte ftuar nga Katolikosi Nerses i Madhi për të hartuar ligje. Kishte pasur arësye të forta për këtë, pasi Katolikosi i të gjithë Armenëve luante një rol të rëndësishëm publik në Mbretërinë Armene. Përveç të qenit udhëheqës shpirtëror, ai ishte edhe gjykatësi i madh. Nga këtu rridhte e drejta dhe detyrimi i tij natyral për të punuar për forcimin e bazës ligjore. Një shekull e gjysëm pas kësaj, Mbreti Vaçakan inicioi hartimin (institucionalizimin) e bazave ligjore për rregullimin e jetës shoqërore. Ai hartoi ligje dhe institucionalizoi një trupë legjislative. Forumi për adoptimin e Kushtetutës nuk u udhëhoq nga Mbreti apo Katolikosi, por prej njerit nga princërit më me autoritet, ndonëse funksioni i gjykatës i takonte Kishës së asaj kohe. Këto fakte mund të konsiderohen si hap

shumë të rëndësishëm në rrugën e formimit të ligjit kushtetues në Armeni.

Nga këtu mund të konkludojmë që Kushtetuta e Mbretit Vaçakan ishte një hap përpara në rrugën e zhvillimit të mendimit konstitucional në Armeni. Ajo nuk ishte thjesht produkt i një mendimi apo ëndrre të organizimit të ardhshëm shtetëror, por një dokument i dalë si rezultat i nevojave reale të Mbretërisë, i zhvilluar mbi një bazë të gjerë kombëtare dhe i pranuar kombëtarisht.

Kushtetuta e miratuar në Agven luajti një rol të rëndësishëm në formimin dhe konsolidimin e mendimit ligjor në krahinë. Nuk ishte e rastit që po të njëjtit princër të malësive të Arcahut iniciuan zbatimin e Kodit të ri të Ligjeve, për shkak të ndryshimit të rrethanave në shekullin e 12-të.

Siç dihet, pas Vaçakanit, shteti i unifikuar Armen u rivendos në kohën e fuqisë së Mbretërisë Armene të Bagratunit. Sidoqoftë kjo mbretëri zgjati vetëm dy shekuj (deri në vitin 1405), dhe me pas i hapi rrugë mbretërive dhe principatave Armene të vogla e të shumta në numër. Një nga më të fuqishmet prej tyre ishte Principata e Kaçenit në Arcah, sundimtarët e të cilës shpesh konsideroheshin mbretër. Pikërisht këta Princër i sugjeruan studjuesit të famshëm Mkitar Gosh të shkruante kodeksin e tij “Tadasdanakirk” (Libri i Ligjeve) në vitin 1184. Është interesant fakti që pas përfundimit të kësaj vepre, Mkitar Goshi la një urdhëresë (porosi) të rëndësishme: “Zot i Plotfuqishëm, beko princin tënd besimtar dhe fisnik mbi të gjithë, bir i Armenisë dhe le ta ndihmojë libri im i kodeve të hartojë urdhëresa të drejta në qeverisjen e tij.” (Մխիթար. Գօշ, Դասնասունսնագիրք, Վաղարշապատ, 1880, էջ 71).

Në sajë të aftësisë për të “qeverisur korrekt”, mbi bazën e ligjeve të pranuar, u arrit të mbahej në këmbë organizimi shtetëror Armen në këto toka, ndonëse në forma të ndryshme. Principata dikur e fuqishme e Arcah – Kaçenit tashmë në shekullin e 17-të ishte rrënuar; dhe mbeturinat e saj shërbyen si bazë për formimin e njërive të vogla e të shumta të pavarura (principatat Melikiane) ndën sundimin e Persisë.

Secili prej Melikëve (Melik – në gjuhën Armene do të thotë princ) ishte një princ i vogël, që kishte njësinë e vet të armatosur, që mbliidhte taksat dhe vazhdonte të vepronte “korrekt”, në përputhje me kodet historike dhe traditat kombëtare.

Në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 18-të, Persia ishte duke provuar konflikte të brendshme; ajo ishte dobësuar, dhe Turqia e Rusia po tentonin të pushtonin tokat fqinje të Persisë. Armenët po përpiqeshin të bashkoheshin, të rivendosnin unitetin e kombit, të rifitonin pavarësinë. Për këtë qëllim Armenia ishte në negociata sekrete me Rusinë, që ishte i vetmja fuqi e madhe Kristiane në afërsi me Armeninë dhe kishte të njëjtat interesa. Sidoqoftë, Ambasada Angleze në Turqi mësoi për planet e Rusisë për pushtimin e Armenisë, Gjeorgjisë dhe Persisë dhe informoi qeverinë Turke për këtë. Turqit nxituan të lëviznin ushtrinë e tyre në kufirin Persian (О. П. Маркова, Россия, Закавказье и международные отношения в 18 веке, М., 1966, с. 19 – 30).

Edhe në këto kohë të vështira të anarkisë, Melikët u treguan të aftë të mbronin tokat e tyre prej pushtuesve. Dokumentat ekzistuese provojnë që “Armenët ishin pozicionuar fort në malet e tyre dhe luftonin armikun, veçanërisht rinia e cila tashmë kishte korrur shumë fitore”. (Армяно - русские отношения, том 2, часть 2, Ереван, 1967, с. 27 – 28).

I dërguari i Perandorit Rus Pjetri i I (Pjetri i madh), Ivan Karapeti vizitoi Karabakun në vitin 1724, pati takime me Melikët dhe u premtoi mbështetjen e Rusisë për rivendosjen e shtetit Armen. Ivan Karapeti mbeti i çuditur nga fuqia dhe pasuria e këtyre principatave të vogla. Në raportin e tij dërguar në Rusi, ai thotë: “Çdo fshat është një fortesë, dhe rrugët për të arritur tek Princi Jesai janë shumë të vështira pasi të gjitha kalojnë nëpër male të mbuluar me pyje... Në disa vende mjaftojnë pesë burra me pushkë për të prapsur me mijëra kundërshtarë” (Армяно - русские отношения в первой трети 18 века. Сборник документов, том 2, часть 2, Ереван, 1967, с. 185 - 187).

Këto malësi ishin shumë të pasura me miniera metalore dhe kishin fuqi puntore me bollëk; e gjithë popullsia ishte e armatosur mirë. Madje të

gjithë ishin në gjendje të kuptonin që fuqia e vërtetë mund të vinte vetëm nga bashkimi i të gjithë principatave të vogla, rrjedhimisht duke formuar një Shtet të bashkuar Armen. Duke marrë në konsideratë realitetet politike të ditëve tona, mund të konsiderohet një fakt interesant ai që ka arritur të ruhet për të arritur deri në ditët tona. Ai shpjegon arësytet për bindjen e thellë të popullit Armen të asaj kohe, dhe mund të jetë i rëndësishëm edhe aktualisht. Në vitin 1725 tre Pashallarë Turq hynë me kalorësinë e tyre për të pushtuar malësitë e sipërpërmendura. Më 1 Mars, Melikët arritën që të shkatërrojnë plotësisht njësitë ushtarake dhe të kapnin rob Salahun, njërin prej Pashallarëve.

Ky i fundit pohoi se qëllimi final i Perandorisë Turke ishte të pushtonte të gjithë vendet deri në Kaukazin Verior; dhe duke qenë se Armenët përbënin pengesën e vetme për realizimin e këtij qëllimi Turqit kishin planifikuar t'i çfarosnin Armenët. "Armenët nuk duhet të jenë në mes, ata duhet të çfarosen, në këtë mënyrë rruga jonë për në Baku dhe Derbent do të jetë e hapur", tha Salah Pasha (Армяно - русские отношения, том 2, часть 2, Ереван, 1967, с. 249).

Pasi mësuan për këto plane të tmershme të Perandorisë Turke, u bë e qartë se edhe forcat e një Armenie të bashkuar nuk do të ishin në gjendje t'i bënin ballë një sulmi të tillë; nevojitej një aleat i fuqishëm. Për këtë qëllim, që në fillim të shekullit të 18-të kishin filluar bisedime aktive për marrëveshje me Rusinë. Ky pozicion i Melikëve Armenë ishte shumë i favorshëm për qëllimet ekspansioniste të Perandorisë Ruse. Sidoqoftë, Rusia dhe Turqia, në vitin 1724 nënshkruan një marrëveshje sekrete bashkëpunimi dhe vendosën të ndajnë tokat e Persisë në Kaukaz ndërmjet tyre, pa luftë. Kështu që, në vend që të ndihmonte Armenët, Rusia e la fatin e Kombit Armen në dorë të Turqisë.

Njëkohësisht, Rusët e dinin që pozicionimi pro rus i Armenëve mund të luante në të ardhmen një rol të rëndësishëm në Kaukaz në përputhje me qëllimet e tyre ekspansioniste.

Për këtë arsye, ata vazhduan t'u premtinin mbështetje Armenëve. Ata kishin vendosur që as t'i refuzonin, dhe as t'i mbanin premtimet

e tyre, deri sa të kalonte njëfarë kohe dhe situata të kishte ndryshuar mjaftueshëm për të ndërmarre hapa të tjera. Udhëheqësit ushtarakë Rusë vendosën të "iniciojnë një lëvizje mashtruese të forcave të armatosura dhe të frymëzonin Armenët... në shpresat e tyre të shenjta (Армяно - русские отношения в 18 веке, том 3, Ереван, 1978, с. 20).

Armenët e Arcahut ndërkohë, ndonëse pa mbështetje të jashtme, vazhdonin të mbronin tokat e tyre. Në datë 16 Gusht 1725, i dërguari Rus pranë Armenëve, raportonte si më poshtë: "Unë nuk kam parë asnjë komb tjetër të luftojë siç luftojnë Armenët e Karabakut, sot ata kanë 12.000 (dymbëdhjetë mijë) kalorës, secili me një shpatë dhe një pushkë, i gatshëm të luftojë në çdo moment, ka akoma më tepër këmbësorë dhe të gjithë janë të armatosur me pushkë. Këta njerëz prodhojnë 10 pushkë çdo ditë" (Армяно - русские отношения, том 2, часть 2, с. 225, 266 ).

Për të kuptuar se çfarë fuqie përfaqësonte pushka në atë kohë, është me vlerë të kujtojmë që pothuajse 80 vjet pas këtyre ngjarjeve, luftëtarët e Mbretit Gjeorgian ishin akoma të armatosur me çomage; dhe vetëm dy në dhjetë vetë kishin pushkë. (Акты Кавказкой археографической комиссии, том 1, Тифлис, 1866, с. 124 ).

Është me vlerë të përmendet që të dyja palët, si Mbreti Vaçakan në kohën e vet, ashtu edhe Melikët, ishin duke i zgjidhur problemet në lidhje me Shtetin e ardhshëm në forumet e përgjithshme me përfaqësues nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Një sasi e madhe dokumentash me shkrime të kësaj natyre kanë mbijetuar që prej shekujve 17 - 18, të cilat vërtetojnë fuqinë jetëgjatë të Kushtetutës së hartuar nga Mbreti Vaçakan në këto vende. Në këtë kuptim, përgjigja, dhënë të dërguarit Rus Ivan Karapet në vitin 1726, është me interes të veçantë. Letra është shkruajtur prej Abrahamit – Komandanti i Forcave Ushtarake në Melikatin e Gjylistanit, biri i Tamrazit – prifti Melikset, biri i Sarkisit – Navasardi, biri i Movsesit – Mirzakhani, dhe 26 fshatarë të tjerë, të cilët betoheshin të mbanin premtimet e hedhura në letër (Армяно - Русские отношения в первой трети 18 века. Сборник документов, том 2, часть 2, Ереван, 1967, с. 282 ).

Kjo nënkuptonte që letra dërguar Rusisë ishte shkruajtur me pjesëmarrjen e të gjithë komunitetit, rrjedhimisht çdo anëtar nënshkruar ndjehej përgjegjës për të dhe fatet e vendit të vet. Vetëm ndjenja e përgjegjësisë së përbashkët krijoi mundësinë për të luftuar një armik, i cili ishte shumë herë më superior në numër. Fakti që Arcahu nuk kishte pasur kurrë skllavëri gjithashtu shpjegon shpirtin e njëlojtë të njerëzve që jetonin atje. Banorët vendas e konsideronin veten si pronarë të tokave të tyre, dhe ndjenin përgjegjësi për mbrojtjen e tyre. Është me vlerë të përmendim një incident të vogël që ilustron fare mirë sa më sipër është thënë.

Në vitin 1766, kur Melik Hovsepi po kthehej me ushtrinë e tij në një nga fshatrat e Gjylistanit, ai i shpërndau ushtarët dhe i la të lirë të shkonin në shtëpi, duke mbajtur me vete vetëm 40 pushkatarë. Pasi kishte bërë këtë veprim, mësoi se Khani i Gandzakut, Shahverdi, organizoi një sulm të shpejtë me shpresë që do të gjente Hovsepin në pozicion të dobët. Hovsepi u mbrojt me ata pak ushtarë që kishte dhe ndërkohë u dërgoi lajm atyre që ishin nisur për t'u kthyer në shtëpi. Ata u kthyen menjëherë, sprapsën armikun dhe e ndoqën atë deri në fortesën e Gandzakut. Pasi i dërgoi trofe të vlefshme Hovsepit, Khani u detyrua të rivendoste marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë (Գլխու քահանայ Աղանւտանց, Դիվան հայ պատմութեան, գիրք Ա – Բ, Թիֆլիս. 1899, էջ 664).

Vetëm ajo ushtri që dëshëron të mbrojë tokën e vet mund të jetë e aftë të rezistojë dhe të çojë betejën në fitore. Shumë forca të armatosura të botës së sotme do ta kishin zili një disiplinë të tillë, pasi ajo nuk mund të krijohet vetëm me detyrim. Është edukimi i vullnetit të lirë ajo që këta njerëz kultivuan për shekuj dhe e transmetuan nga gjenerata në gjeneratë.

Në luftën e ashpër të Karabakut në vitet 1988 – 1994, armiku i fuqishëm, rreth 40 herë më superior në sasi, nuk mundi të fitonte. Formacione të mëdha ushtarake u detyruan të tërhiqeshin në panik përballë reparteve të vogla të Armenisë së Vogël, pasi ata nuk kishin fare as idenë ligjore dhe as vlerat historike që mund t'i lidhnin ata me këto vende.

Lëvizja për liri e vitit 1720 nuk mori mbështetje nga Rusia dhe gradualisht u zbeh, duke mos arritur qëllimin kryesor, rivendosjen e shtetit të pavarur. Sidoqoftë, duke mbrojtur tokat e tyre nga politikat pushtuese të Turqisë, Melikët (princat) e Karabakut i shterrën mundësitë e Turqisë për zgjerim në Lindje, duke kontribuar kështu në interesat (kombëtare) të Persisë. Me këtë shpjegohet fakti që kur Persia arriti të stabilizohet, Melikët e Karabakut fituan autoritetet të qenësishëm real prej Persisë.

Shpresa për rivendosjen e shtetit Armen me ndihmën e Ruisë u rikthye në kohën e Perandoreshës Ekaterina. Gjenerali i Famshëm i Ushtrisë Ruse, Suvorov, studjoi me hollësi mundësitë e zgjerimit të kufirit jugor të perandorisë në vitin 1780. Melikët e Karabakut, nga ana e tyre, negociuan aktivisht me Rusinë. Suvorovi konstatoi që Melikët përfaqësonin një fuqi të konsiderueshme ushtarake dhe ekonomike dhe mund të kontribuonin shumë seriozisht në mbështetjen e forcave Ruse në Kaukaz. Suvorovi shkroi kështu në hartën e Armenisë së Lashtë: "... Armenët jetojnë në Karabak ndën qeverisjen e Melikëve, dhe Karabaku është ndarë në pesë qarqe mbrojtëse..." (A. В. Суворов, Документы, том 2, с. 224 - 225 ).

Në datë 19 Maj 1783, Princi G. A. Potjomkin i dërgonte një rekomandim Perandoreshës Ekaterina: "...Në rastin më të mirë, ne mund t'i dhurojmë sovranitetin Karabakut, me gjithë popullsinë e tij Armene, duke krijuar një Shtet të Krishterë në Azi, në përputhje me premtimet e Madhërisë Tuaj, të cilat unë ua prezantova Melikëve" (Армяно - Русские отношения в 18 веке, сборник документов, том 4, Ереван, 1990, 241).

Po atë ditë, P. Potjomkin urdhëroi Gjeneralin G. S. Potjomkin që të eliminonte Khanin Persian të Karabakut: "Ibrahim Khan i Shushisë duhet dëbuar, pasi që nga ky moment Karabaku duhet të bëhet një krahinë Armene që të varet nga Rusia. Bëj më të mirën që ke mundësi për formimin e kësaj krahine në të mirë të popullit të saj që jeton atje, pasi kjo do të shërbejë si shembull për krahinat e tjera Armene dhe do t'i bëjë njerëzit që të shkojnë në Karabak" (Армяно - Русские отношения в 18

веке, том 4, с. 239). Komandanti shpjegonte gjithashtu edhe rrugët se si duhej bërë dëbimi i rregjimit Persian prej këtyre vendeve. Megjithatë këto plane nuk u arrit të zbatoheshin dhe Karabaku ju aneksua Perandorisë Ruse vetëm në vitin 1805.

Pas aneksimit, rregullat e Khanateve dhe Melikëve u shfuqizuan, ndonëse pasardhësit e Melikëve të mëparshëm ruajtën zotërimin e tyre mbi këto toka deri në kohën e vendosjes së rregjimit Sovjetik në vitin 1920. Në vitin 1917 kur Rusia qeverisej nga Qeveria e Përkohëshme dhe më pas Bolshevikët realizuan revolucionin dhe morën fuqinë, Arcahu ishte i pari vend në atë territor të pafund që bashkoi të gjitha fuqitë politike. Ata vazhduan traditën e paritetit, të vendosur prej kohësh të mbretit Vaçakan, duke lënë mënjane të gjitha grindjet e brendshme dhe duke krijuar Partinë e Popullit për të mbrojtur vendin e tyre. Në periudhën 1918 – 1920 e gjithë krahina e Arcah – Karabakut ishte në territorin e Republikës së re të Armenisë, e cila ishte sanksionuar në ligjin e Shtetit në datë 25 Maj 1920. Çështjet e kufijve të brendshëm ndërshtetërorë nuk ekzistonin ndërmjet shteteve të porsakrijuara të Kaukazit të Jugut, por ky fakt ishte pranuar menjëherë prej të gjithëve si edhe prej Qeverisë Bolshevike të Rusisë. Madje kjo e fundit mori zotërimin mbi Kaukazin e Jugut në vitin 1920 – 1921 dhe vendosi të bashkëpunojë me qeverinë Turke me qëllim të përforcimit të pozitës së vet në arenën ndërkombëtare. Si rezultat i këtij bashkëpunimi, provinca Armene e Karsit ngeli në territorin Turk, kurse krahina e Karabakut dhe Nahiçevani u aneksuan forcërisht nga Azerbaixhani, si një republikë e formuar me mbështetjen e Turqisë.

Megjithatë traditat ligjore të formuara gjatë një periudhe shumëshekullore, bashkuar me ndjenjat e detyrimit dhe përgjegjësisë për fatet e atdheut dhe të brezave të ardhshëm, i ndihmuan njerëzit e këtij vendi t'i rezistojnë për 70 vjet politikës represive të Azerbaixhanit, që kishte për qëllim largimin e Armenëve nga tokat e tyre. Në vitin 1988 kjo politike u shndërrua në aksione të dhunshme; atëhere trupi legjislativ i Arcahut – Këshilli i Deputetëve të Krahinës Autonome të Karabakut vendosi shkëputjen nga Azerbaixhani dhe bashkimin me Armeninë

Mëmë. Reagimi i Azerbaixhanit ndaj këtij veprimi ishte armiqësor. Moska zyrtare e mbështeti Azerbaixhanin me të gjitha mjetet e mundshme për të shtypur kërkesat e Armenëve për shkëputje. Por edhe në këtë situatë të vështirë, kur si direkt Azerbaixhani ashtu edhe në përgjithësi qeveritë Sovjetike ishin kundër vullnetit të lirë të popullit Armen, ky i fundit veproi në përputhje me ligjin. Kjo sjellje pati pasojat e veta, pasi në vitin 1989 Qeveria Sovjetike në Moskë vendosi shkëputjen e Territorit të Krahinës Autonome të Nagorni – Karabak prej Azerbaixhanit duke formuar një Komitet Qeverisës special. Ky ishte një tip i ri i organizimit shtetëror të Arcahut, i cili nuk pati ndonjë farë vlerësimi. Pas kësaj, duke ndjekur praktikën ligjore të Bashkimit Sovjetik, në vitin 1991, në po atë territor, u formua dhe u deklarua Republika e Karabakut Malor.

Ajo jo vetëm që u formua, por u mbrojt me kujdes nga lufta që i shpalli Azerbaixhani. Tashmë, ka mbi 20 vjet që Republika e Nagorni-Karabakut (NKR = Nagorno-Karabakh Republic) përpiqet të mbrojë kufijtë e saj, të rimëkëmbë ekonominë, të ndërtojë dhe konsolidojë një tip të ri shteti ligjor. Ky proces përmban brenda padyshim mendimin shtetformues të atyre njerëzve që u përpoqën në këtë drejtim që 1500 vjet më parë.

Për hir të së vërtetës, këtu duhet përmendur edhe një fakt tjetër i rëndësishëm. Marrëveshja e armëpushimit e vitit 1994 vendosi një atmosferë paqeje relative në kufirin ndërmjet Azerbaixhanit dhe NKR. Ndonëse Azerbaixhani vazhdimisht e ka prishur këtë situatë armëpushimi, NKR qëndroi e qetë brenda kufijve të saj. Dhe më e rëndësishmja, ndonëse tingëllon e çuditshme, është që paqja relative ka kontribuar në pastrimin etnik në të dy anët e kufirit.

Pas studimit të hollësishëm të konditave të kombeve Kristiane në Perandorinë Turke në shekullin e 19-të, përfshirë edhe masakrat sistematike ndaj Armenëve, Grekëve dhe kombeve të tjera, historianët Europiane shkruajtën: “Popujt e tjerë, duke u zhvilluar, bëhen gjithnjë mirë e më mirë, ndërsa Turqit po bëhen gjithnjë keq e më keq... kundër së keqes që nuk mund ta shndërrosh në të mirë ka vetem një mjet: ta çrrënjosësh atë”. (Л. А. Камаровский, Восточный вопрос, Москва, 1986, с. с. 12, 16).

Faqet e mëtejshme të ashpra të historisë treguan se sa të sakta ishin këto ide (mjafton të rikujtojmë këtu masakrat e popullit Kristian në Turqi, që kulmuan me Genocidin e tmerrshëm të Armenëve në vitet 1915 – 1923). Realiteti nuk ndryshoi për gjatë gjithë shekullit të 20të, madje edhe në fillim të shekullit të 21-të. Ja përse, pasi mori në shqyrtim politikat e kohëve moderne, Samuel Huntington arriti në konkluzionin se “...Kufijtë e Islamit janë të përgjakura dhe do të mbeten të tilla akoma edhe për një kohë të gjatë” (Shih gjithashtu: Levon Shirinyan, Հայաստանի քաղաքակրթական ինքնությունը Հանրիզգրոնի հիպոթեզի նսպնյակում, Քաղաքագիտության հարցեր: 2009: Երևան, 2010, էջ 12).

Madje edhe sikur fuqitë e mëdha politike të ditëve të sotme të përpiqen të injorojnë këto realitete, faktet mbeten (dhe kjo është evidentuar në luftën e gjatë e të përgjakëshme ndërmjet Serbëve dhe Shqiptarëve të Kosovës, ose marrëdhënieve të pazgjidhura Arabo – Izraelite). Prej këtu rrjedh se zgjidhja e çështjes së Arcahut është pa kuptim dhe madje e rrezikshme pa marrë parasysh këto realitete.

Vaçakan i Devotshmi qeverisi në periudhën nga viti 480 deri në vitin 510. Emri dhe vepra e tij u respektuan në kujtimin e njerëzve për shumë vite. Histori të shumta të ndërhuara mbi figurën e tij kanë mbërritur deri në ditët tona, dhe karakteri i tij është përshkruar në legendën “Anahit”, shkruajtur kaq bukur nga Gazaros Agaian. Dhoma e varrimit e Mbreti Vaçakan qëndron akoma në krahinën e Martakertit të NKR, në oborrin e prapëm të Manastirit Jirvishtik të Apostullit Jegishe. Ne mendojmë se rezidenca verore e Agvenit ka qenë në të njëjtin vend. Ka baza të forta për të bërë një supozim të tillë. Në kohët e lashta, kur Krishterimi sapo ishte çfaqur, propaganduesit persekutoheshin nga përfaqësuesit e Shtetit. Rrjedhimisht, është e natyrshme të mendohet, që eshtrat e Jegishes, si propaganduesi i parë i Krishterimit në këtë zonë, të vendoseshin në një vend ku mund të arriheshin me vështirësi. Gjithashtu është e natyrshme që Mbreti fisnik e ndërtoi rezidencën e vet verore në atë vend të shenjtë, në majë të një shkëmbi të paarrtshëm, të mbuluar me pyje të pakapërcyeshëm. Mbreti, i cili ndërtoi një numër të madh kishash dhe

kontribuoi në përmirësimin e shkollave, natyrisht që kishte një kishë dhe një shkollë në afërsi të rezidencës së tij verore, gjë që mbështetet nga struktura të ndryshme, por fatkeqësisht jo mirë të studjuara.

Pas degradimit të Mbretërisë, Agveni gradualisht u reformua në Manastir, emëruar sipas Apostullit Jegishe. Ka mbeturina të shumta të shumë qytetesh të lashtë, kishash që kanë rezistuar në këmbë ose që janë pjesërisht të shkatërruara, në rrugën që të çon nga Manastiri për në fortesën legjendare të Gjylistanit; dhe asnjë prej tyre akoma nuk është studjuar. Muret dhe kullat madhështore të Manastirit–Fortesë të Apostullit Jegishe kanë rezistuar për të arritur deri në ditët tona në gjendje fare të mirë. Dhoma e varrimit e Mbretit Vaçakan është veçanërisht tërheqëse, me skulptura të bukura brenda saj. Në vitin 1286 pranë dhomës së varrit u ndërtua një kishë e re. Në gurin që ndodhet në ballë të dhomës së varrit shkruhet: “Këtu prehet Mbreti Vaçakan. Me bekimin e Zotit kjo kishë u ndërtua nga Katolikosi Simeon në vitin 1286”. (Այս է հանգիստ Վաչագան թագաւորին, ԱՕ ողորմի հայրապետս եւ իյր ծնողացն որ շինեց զեկեղեցիս յարաջնորդութի ՏԴ Սիմեոնի: Թիվ “ՉԼԵ” էր (1286) (Դիվան հայ վիճագրութեան, պրակ 5, Արձախ, կազմեց՝ Ս. Գ. Բարխուդարյան, Երևան, 1982, 110).

Atje ndodhet, gjithashtu, një statujë e vogël e Vaçakanit mbi kalë, me kurorë në kokë dhe simbolin e Mbretërisë në dorën e djathtë. Persona të tillë si Vaçakani janë unikë jo vetëm në historinë e Armenisë, por edhe në historinë botërore. Mbretër të tillë, varret e të cilëve, me shkrimet mbi to në gjuhën natyrale të kohës dhe statujat e të cilëve janë ruajtur për mbi 1500 vjet, nuk janë shumë. Kjo dëshmon që populli Armen gjithmonë i ka nderuar përpjekjet e çmuara të Mbretit të vet të Devotshëm.

Duke përdorur politikën antifetare të Bashkimit Sovjetik, Qeveria e Azerbaixhanit filloi menjëherë të mbyllë të gjitha Kishat Armene në territorin e saj, konfiskoi pasuritë e tyre dhe persekutoi priftërinjtë në vitin 1920. Në ato ditë, prifti i njerës prej Kishave, At Hovasapi, filloi një inventar të pasurive të të gjitha Kishave dhe manastireve të krahinës, si edhe mori përsipër kopjimin e të gjitha dorëshkrimeve kryesore. Në raportin e tij, dërguar në Eçmiaxin në vitin 1924, ai përfshiu edhe

shkrimin në varrin e Mbretit Vaçakan, krahas informacioneve të tjera (ՀՀ ՊԱ, ֆոնդ 149, ցուցակ 1, գործ 119, թ. 43).

Ai gjithashtu përmendi 3 komunitete të krijuara përreth zonës së residencës verore, apo të Manastirit të emëruar sipas emrit të Apostullit Jegishe, dhe më pas të tre këto komunitete u emëruan sipas emrave të tre vajzave të Mbretit Vaçakan – Blihana, Dastakert dhe Magtagis. Fshati i parë u shkatërrua komplet, Dastakerti u banua deri në fund të shekullit të kaluar dhe fshati i emërtuar Magtagis vazhdon të ekzistojë akoma në një distancë 5 – 6 km nga Manastiri, por sot emri ka një diferencë të lehtë në shqiptim – Matakis.

Në periudhën e viteve 1992 – 1993 Azerbaixhani pushtoi sipërfaqet e përmendura të Martakertit, në NKR, për një periudhë të shkurtër kohe, por kjo kohë ishte e mjaftueshme për ushtarët “kurajozë” të Azerbaixhanit për të shkatërruar plotësisht monumente të shumta historike, të hedhin në erë Kishën e mrekullueshme të Gjylistanit, mbeturinat e së cilës mund të shihen me sy të lirë nga vija e kufirit. Ata përdhosën varrin e Vaçakanit. Statuja e bukur, 5 m e lartë, mbeti, por guri i varrit u hoq dhe varri u hap, ka të ngjarë në kërkim të ndonjë thesari pa arritur të kuptojnë që thesari më i madh që la pas Vaçakani ishte Kushtetuta që ai shkroi. Për mbi 1500 vjet, direkt apo indirekt, kjo Kushtetutë kontribuoi në formimin e mendimit ligjor, forcimin e rregullit dhe së fundmi, për mbrojtjen e tokave Armene. Ky monument ligjor, 1500 vjeçar, vazhdon akoma t’i shërbejë popullit të Karabakut, por fatkeqësisht ai nuk është studjuar kurrë në mënyrë të mjaftueshme dhe si i tillë nuk mund të gjejë vendin e tij unik në historinë botërore të ligjeve. Pelegrinazhet në varrin e Mbretit Vaçakan (i Devotshmi) kanë vazhduar për pothuajse 1500 vjet. Teksti i plotë i Kushtetutës ndodhet në librin “Historia e Ahvankut” (shkruar nga Movses Kaghankatvatsi). Instituti i kërkimeve shkencore të dorëshkrimeve të vjetra (Matenadaran) i Erevanit përmban një numër të madh pasazhesh të nxjerra nga kjo “Histori”, nga shekuj të ndryshëm.

# KUSHTETUTA E MBRETIT VAÇAKAN

Miratuar në rezidencën e tij verore Agven

- ① Priftërinjtë e fshatrave duhet të shkojnë të nderojnë dy herë në vit Peshkopin e tyre, dhe duhet të mësojnë prej tij rregullat dhe ligjet shpirtërore; në përputhje me Biblën dhe siç e do rregulli, ai duhet t'i çojë Peshkopit, të paktën një herë në vit, një dhuratë.
- ② Kur të urdhërohen, çdo prift duhet të japë 4 (katër) dram; ndërsa dhjaku 2 (dy) dram.
- ③ Çdo fisnik apo anëtar i familjes mbretërore, përgjatë jetës së tij, do të japë me dorën e tij, për shpirtin e tij, një pjesë të pasurisë, si p.sh. një kalë të shaluar dhe të pajisur me parzmorë, ose, në vend të tyre çdo lloj pasurie tjetër që mund të ketë. Nëqoftëse ai nuk arrin dot t'i japë këto gjatë kohës që është gjallë, këtë detyrim, pas vdekjes, duhet ta plotësojë familja e tij.
- ④ Ky do të jetë ligji përsa i përket prodhimeve të tokës që duhet t'i jepen priftit prej popullit. Ai që është i pasur do të japë 4 shinik grurë, 6 shinik me elb dhe 16 ibrikë me verë; çdo i varfër do të japë gjysmën e kësaj sasi dhe aq sasi vere sa ka mundësi; dhe asgjë nuk do të merret prej atij që nuk zotëron as tokë dhe as vreshta. Ata, të cilët japin më tepër se sa është thënë më sipër, për hatër të shpirtit të tyre, bëjnë mirë; siç thotë Pali," kush mbjell me bollëk, do të korrë me bollëk" (Gal. vi. 7). Kush ka dele në ekonominë e vet do të japë një dele, tre tufa leshi nga tre dele të qethura dhe një rrotë djathi; (kush ka kuaj, do të japë një pjellë; kush ka bagëti të trashë, do japë një viç).

- ⑤ Çdo laik, qoftë fisnik apo fshatar, si dhe çdo banor tjetër nuk do të përjashtohet nga dhënia e një dhurate në vit në kujtim të të vdekurve, me aq sa të ketë mundësi; vdekja nuk duhet të privojë askënd nga pjesa që i takon. Nëqoftëse një njeri i vdekur zotëronte kuaj, atëherë njeri prej tyre, nuk ka rëndësi se cili, duhet t'i dhurohet kishës; nëqoftëse ka pasur bagëti të trashë, duhet t'i dhurohet një nga demat.
